RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
"Mbi auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë"

Tiranë, tetor 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**1-4**
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	**4-6**
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	**4-6**
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	**4-6**
II.	**HYRJA**	**6-7**
1.	Objektivat dhe qëllimi	**7-7**
2.	Identifikimi i çështjes.....	**7-7**
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	**7-8**
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	**8-8**
5.	Kriteret e vlerësimit.....	**8-8**
5.	Standardet e auditimit.....	**8-9**
7.	Metodat e auditimit.....	**9-9**
8.	Dokumentimi i auditimit.....	**9-9**
III	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**13-105**
	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	**10-11**
1.1	Auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	**11-25**
2.1	Auditimi mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	**25-38**
2.6	Vlerësimi dhe mbledhjes së të ardhurave	**38-43**
3	Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike	**43-105**
4	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	**106-133**
4.1	Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve	**133-142**
5	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit	**143-156**
6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore	**156-160**
7	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike	**161-167**
8	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	**167-176**
IV	**REKOMANDIME**	**176-194**

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*) ka ushtruar auditimin financiar dhe të perputhshmerisë në Bashkinë Poliçan, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar.

Auditimit u krye nga data 24.03.2026 deri në datën 22.05.2026, në subjektin Bashkia Poliçan, për periudhën objekt auditimi financiar nga data 01.01.2025 deri në 31.12.2025 dhe të përputhshmërisë nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2025.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 15 akt-konstatime dhe 1 akt verifikime të cilat janë protokolluar në subjekt me 22.05.2026. Nga subjekti i audituar, është përcjell shkresa me nr. 708/20 prot., datë 06.07.2026, protokolluar në KLSH me shkresat nr. 294/4 prot., datë 07.07.2026 ku është shprehur në lidhje me njohjen me projektraportin e auditimit dhe me emeilin e datës 08.09.2026 citon se nuk është e nevojshme kryerja e takimit ballafaques në KLSH.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Poliçan si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Poliçan. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.*
- *mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.*
- *mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve*
- *mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.*
- *mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit, Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).*
- *mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nénauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 35 gjetje dhe ka dhënë 40 rekomandime, nga ku masa organizative me 27 gjetje dhe 32 rekomandime, 4 gjetje dhe 4 rekomandime në masën shpërblim dëmi në vlerën 422,241 lekë si dhe 4 rekomandime në fushën e të ardhurave në vlerën 75,299,348 lekë.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

-Procedurat e planifikimit dhe realizimit të ardhurave

- Mos nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët dhe në vijim të ndjekë të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën **67,173,477 lekë** nga subjektet e biznesit dhe taksapaguesit familjarë, në mbyllje të vitit 2025;

-Të ardhura të munguara nga taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën **241,750 lekë**, në fund të vitit 2025;

▪ **Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve**

Nga Bashkia Poliçan (Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Administrimit të Pyjeve) nuk është përgatitur dokumentacioni tekniko-ligjorë për 2294 pasuri, (prona) publike, për evidentimin e pasurive për çdo zonë kadastrale pranë NJA Vërtop si dhe përgatitja e hartave kadastrale (plan rilevimet për çdo pronë) për të bërë të mundur transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, mbështetur në pikën 3 të nenit 67 ligjit 111/2018 "*Për Kadastrën*", të nenit 22 të ligjit nr. 72/2012, "*Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjë hapësinor në Republikën e Shqipërisë"* dhe në zbatim të kryehut III pika 12 i VKM-së nr. 782, datë 7.10.2020 "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale".

Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Poliçan rezulton se për 9 raste, vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar nga IMTV në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a

-Përbërja e komisioneve të inventarizimit është në dy vitet pa ndryshuar, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kapitulli IV, paragrafi 84, "Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision".

-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk disponon të dhëna mbi kryerjen e inventarizimit fizik për Aktivet Afatgjata Materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214 përkatësisht për artikujt kontabël Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtesa e konstruksione, rrugë, rrjete e vepra ujore, instalime teknike, makineri e pajisje, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

-Nuk është kryer inventarizimi i Aktiveve Afatgjata Jomateriale, *(llogaria 202 "studime e projektime")*, që paraqitet në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare me vlerën 18,179,165 lekë në fillim të vitit 2025 dhe 15,452,290 lekë në fund të kësaj periudhe. Nuk është hartuar dhe miratuar urdhri i titullarit të Bashkisë për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Jo materiale. Nuk janë bërë pjesë e procedurës së inventarizimit të nënshkruar nga ana e Komisionit të Inventarizimit të Aktiveve llogaria 231 me vlerë 113,635,580 lekë, ku përfshihen zërin "Rikonstruksion dhe zgjerimi i ambienteve te Qendrës polivalente (Azili) Poliçan", me vlerë 93,635,580lekë dhe artikulli "Kanali ujitës Mbrakull- Stacioni nr.2, varreza Bashkia Poliçan", me vlerë 20,000,000 lekë.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata (AAGJ), i cili të verifikojë dhe të rakordojë rezultatet e inventarizimit me llogaritë kontabël përkatëse për gjithë zërat e aktiveve dhe në përfundim të punës komisioni të hartojë raportin për drejtuesin e institucionit mbi rezultatet e inventarizimit.

Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e duhura administrative e ligjore me qëllim arritjen e rezultateve reale në uljen e borxhit prej 67,173,477 lekë nga subjektet dhe familjet debitore si dhe të dokumentojë ndjekjen dhe rezultatet e këtyre masave, nëpërmjet ndjekjes në mënyrë të vazhdueshme të debitorë të krijuara.
Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Poliçan të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 241,750 lekë, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit
A. OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2025:
Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Poliçan për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.
Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Poliçan janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të "kualifikuar, me rezervë", e shprehur kjo në bazën për opinionin.
Bazat për opinionin e /kualifikuar me rezervë:
Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e Raportit të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.
Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 10,345 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2025, si dhe anomalitë e mëposhtme:
- Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 93,465,633 lekë, e cila nuk kuadron për vlerën 21,258,325 lekë, me llogaritë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 93,465,633 lekë dhe 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" që sipas akt rakordimit të mbajtur me Degën e Thesarit Skrapar është në shumën 33,356,856 lekë.
- Në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk janë kontabilizuar vlerat e gjobave të IMTV-së për ndërtime pa leje gjatë periudhës 2024 dhe 2025 për 11 subjekte, në vlerën 15,119,656 lekë, duke nënvlerësuar llogarinë 486 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogarinë 7115 "Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime".
- Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" është nënvlerësuar në vlerën 458,000 lekë, për arsye se nuk janë kontabilizuar kuotat që Bashkia Poliçan ka si aksionare në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat dhe në "KF Poliçani" shpk;
- Nga llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" rezultoi se, nuk është zbritur vlera me kosto historike 139,205,450 lekë dhe amortizim të akumuluar 110,026,475 lekë, për 38 zëra të AAGJ të kësaj llogarie, të cilat janë asete të ujësjellësit.
II. Opinioni mbi përputhshmërinë

Mbështetur në, ISSAI 4000 "Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë", Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Bashkia Poliçan me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

"Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Poliçan, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë".

Baza për dhënien e opinionit

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2025 së subjektit Bashkia Poliçan, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ISSAI 4000 dhe ISSAI 100. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Bashkia Poliçan dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar**.

Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

- Bashkia Poliçan nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.
- Në 7 procedura nga 8 të audituara, me fond limit 565,780 mijë lekë pa TVSh, u konstaua se kriteret e vendosura nuk janë argumentuar nga njësia e prokurimit, si dhe në dy raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Poliçan.
- Nga auditimi i zbatimit të kontratave u konstatua se, në 4 (katër) raste, janë kryer zëra punimesh jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe specifikimet teknike, me një vlerë totale prej 442,241 lekë pa TVSH.
- Në 3 praktika të audituara rezultoi se taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi. Diferenca e taksës së ndikimit në infrastrukturë është konstatuar si pasojë e mosllogaritjes në nivelin e duhur të taksës, sipas destinacionit të propozuar.
- Në 2 (dy) raste u konstatua se dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit të ndërtimit, si dhe dokumentacioni i kërkuar nga legjislacioni në fuqi, nuk ishte i plotë, pasi akt-kontrollet sipas fazave të ndërtimit nuk ishin përpiluar dhe dorëzuar në mënyrë elektronike, në përputhje me përcaktimet ligjore.

I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 294/1, datë 17.03.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 24.03.2026 deri në datën 22.05.2026, në subjektin Bashkia Poliçan u krye "Auditimi Financiar për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025 dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2025. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1.H. I. – Përgjegjës Grupi
2.Q. C. – Anëtar
3.I. U. – Anëtar
4.O. F. – Anëtar
5.A. K. -.Anëtar

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Poliçan kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)[1];
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Poliçan është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/ shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Poliçan dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2025.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2023-31.12.2025.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV-së.
7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Poliçan, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në Ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

[1]Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Poliçan është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Poliçan. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative";
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore";
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël";
- "VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj";
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura";
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve" i ndryshuar;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore";
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;

- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ”Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar.
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Poliçan grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“;
- ISSAI 200 “Parimet themelore të auditimit financiar”.
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *“jashtë normales”,* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Poliçan me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale[2].
Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.
Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon[3].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*; dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin *"Bashkia Poliçan"*:

Poliçani kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë Berat, në lindje me Bashkinë Skrapar, ndërsa në jug dhe jug-lindje me Bashkinë Memaliaj. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Poliçanit. Bashkia ka një sipërfaqe prej 272.02 km^2 me një densitet prej 67.42 banorë/km^2. Kjo bashki përbëhet nga 3 njësi administrative të cilat kanë në total 26 fshatra. Bashkia e Poliçanit përbëhet nga Njësia Administrative Poliçan, qyteza ish-industriale e Poliçanit dhe dy njësitë administrative Vërtop dhe Terpan. Nga këto, Njësia Tërpan, shtrihet në një terren të thyer malor. Qyteti i Poliçanit

[2] ISSAI 1315

[3] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

ka qenë një qendër e rëndësishme e industrisë ushtarake dhe e industrisë së materialeve të ndërtimit për shkak të burimeve të mëdha të gurit. Industria e nxjerrjes së gurit dekorativ është në ditët e sotme një resurs i konsiderueshëm ekonomik për zonën. Poliçani ka në territorin e tij një pjesë të konsiderueshme të parkut kombëtar të Tomorit. Për rrjedhojë, turizmi malor është një element i rëndësishëm i bashkisë. Të ardhurat në zonat rurale vijnë kryesisht nga kultivimi i ullirit dhe rrushit, por edhe drurëve të tjerë frutorë si gështenjat, arrat dhe fiqtë.

1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve;

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Poliçan si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e MFK-së kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm.

Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të MFK-së në mënyrë të detajuar argumentohet si më poshtë:

Auditimi u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Bashkia Poliçan ushtron funksionet e saj. në zbatimin e Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Të dhëna të përgjithshme të bashkisë Poliçan janë dhënë si më poshtë:

Qarku	Bashkia Poliçan	Njësitë Administrative	Numri i fshatrave	Numri i popullsisë
Berat	Qyteti Poliçan	Poliçan	Qyteti	18,341
		Tërpan	14	
		Vërtop	12	

Burimi: Bashkia Poliçan/DBNJ

Nga auditimi në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të kësaj Bashkie rezultoi sa vijon:

I. Komponenti: Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit përbëhet nga disa elementë: Integriteti dhe Vlerat Etike, Qeverisjen, Stilin të vepruarit dhe filozofinë e menaxhimit, Qëndrimin mbështetës, Strukturën organizative, Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore, Profesionalizmin e stafit, Delegimin e detyrave, etj.

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve, etj. të analizuara më hollësisht në vijim.

- Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike.

Bashkia Poliçan funksionon mbi bazën e rregullores "Mbi Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Poliçan dhe Njësive Administrative" e miratuar me Vendimin nr.2,datë 09/01/2025 të Kryetarit të Bashkisë. Në këtë dokument janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.

Me Vendimin nr.3, datë 09/01/2025 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar, "Kodi i Etikës Profesonale." për administratën e Bashkisë Poliçan, Njësive Aministrative dhe Institucioneve në varësi". Me Vendimin nr.57 datë 15.04.2025 te Kryetarit të Bashkisë "Për caktimin e personit përgjegjës në rolin e këshilltarit të Etikës" është caktuar Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse për ndjekjen e këshillimit të nëpunësve lidhur me rregullat e etikës në administratë.

Me Vendimin nr.5, datë 09.01.2025 te Kryetarit të Bashkisë, janë miratuar rregullorja "Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Poliçan" dhe rregullorja "Për hetim administrativ të kërkesës së sinjalizimit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Poliçan" ku janë pasqyruar rregullat për procedurën e shqyrtimit të hetimit organizativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga Hakmarrja, në zbatim të ligjit nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve". Me Vendimin nr.11 datë 14.01.2025 te Kryetarit të Bashkisë, është miratuar rregullorja "Për parandalimin e konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve Publike si dhe deklarimin e Pasurive në ushtrimin e Funksioneve Publike". Sipas Vendimit nr.4, datë 09.01.2025 është ngritur njësia përgjegjëse për shqyrtimin e hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizimit si organ i posaçëm sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 60/2016 dhe akteve nënligjore. Mbi këtë bazë , lidhur me marrjen e masave për zbatimin e procedurave antikorrupsion, bashkia Poliçan zbaton kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin për sinjalizuesit, ku është ngritur njësia përgjegjëse si organ i posaçëm,_por nuk ka procedura të trajtimit të rasteve të tilla dhe nuk ka mekanizma të cilat i dedikohen ankesave për korrupsion. Nga auditimi rezulton se në faqen zyrtare të Bashkisë Poliçan është ngarkuar dokumenti ku janë përcaktuar procedurat për sinjalizimin dhe ndëshkimin e rasteve të parregullsive, mashtrimeve apo veprimeve korruptive, bazuar në përcaktimet e parashikuara në legjislacionin për "Shërbimin civil" dhe "Kodin e punës". Gjatë vitit 2025 nuk ka pasur raste të raportimit të shkeljeve të rënda, korrupsionit, etj. Kërkesat apo ankesat drejtuar institucionit depozitohen zyrtarisht pranë institucionit, duke iu adresuar titullarit, dhe strukturës e cila do të angazhohet për trajtimin e tyre, sipas përcaktimeve në nenin 22 "Marrëdhëniet me publikun" të "Rregullores së Brendshme".

-Mungon Komisioni i Etikës që shqyrton rastet e parregullsive për shmangien e konfliktit të interesit dhe të ndalimit të shpërdorimit të detyrës.

Njohja e stafit të Bashkisë Poliçan me "Rregulloren e Brendshme" dhe bazën ligjore në fuqi është kryer nga Drejtoria Juridike në mënyrë shkresore dhe elektronike, sipas fushës dhe strukturave përkatëse. Drejtoritë dhe sektorët sipas strukturës organizative, në përgjithësi kanë kryer vlerësimin e punës për punonjësit respektivë, ky vlerësim është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar sipas përcaktimeve të: Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar; VKM nr. 109, datë 26.02.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë"; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

-Nga auditimi i dokumentit të rregullores së brendshme dhe procedurave në zbatimin e saj, del se janë caktuar rregullat apo proceset kryesore të përfshira, të ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësive, por nuk përshkruajnë me detaje këto procese, rrjedhën e punës

(fillimin dhe mbarimin e procesit), informimin dhe raportimin, dhe vendimmarrjen individuale, me qëllim parandalimin e risqeve dhe përgjigjen ndaj tyre.
Me anën e rregullores së brendshme, njësia publike duhet të planifikojë, zbatojë, kontrollojë dhe raportojë aktivitetet e njësisë.

-Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Nga auditimi rezulton se në rregulloren e brendshme të institucionit, për pozicionet që përfshihen, janë përcaktuar procedurat mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit lidhur me ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse të cilat përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA, stafit menaxherial dhe punonjësve të këtij institucioni sipas strukturës organizative të miratuar për vitin 2025. Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së institucionit, i cili sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisje vendore" i ndryshuar dhe ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", merr dhe analizon periodikisht raporte mbi buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga drejtoritë apo sektorët hartohen e raportohen pranë titullarit në mënyrë periodike dhe vjetore raportet dhe planet vjetore të punës mbi analizën e veprimtarisë respektive, raporte të cilat jo në çdo rast kanë ballafaquar indikatorët me objektivat, me tregues performance dhe risqet e brendshme përkatëse mbi këto objektiva, gjë që evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion..
Nga auditimi rezultoi se Bashkia Poliçan, me shkresën Nr.562/1 datë 27.02.2026 sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 18, ka dërguar pranë Njësisë Qëndrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit: Pyetësorin mbi vetëvlerësimin për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit; Raportin vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm" për vitin 2025..Planin e veprimit për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Nga auditimi, është konstatuar si më poshtë:
-Titullari, në rolin e NA së Bashkisë mbështet kontrollin e brendshëm, duke mbajtur takime me menaxherët dhe me drejtuesit e njësive të vartësisë, por pavarësisht nga kjo nuk provohet se ka vendosur rregulla dhe procedura lidhur me proceset kryesore me qëllim për të monitoruar zbatimin e tyre, p.sh si identifikohen dhe reagohet ndaj risqeve në nivelet e caktuara të strukturës së drejtimit, etj. Kryetari i bashkisë merr informacione mbi performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga; Njësia e Harmonizimit në MFE, Auditimi i brendshëm ose Auditimi i jashtëm (KLSH) nëpërmjet veprimtarisë audituese, etj.

- Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Titullari i Bashkisë ka përgjegjësinë për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së kësaj njësie publike vendore si dhe vendosjen e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë Bashkisë.

- *Struktura organizative e bashkisë*

Për vitin 2025, numri i përgjithshëm i punonjësve të institucionit është miratuar me vendim të Kryetarit të Bashkisë, nr. 1, datë 07.01.2025, "*Për caktimin e pozicioneve të punës në administratën e bashkisë Poliçan , njësive administrative dhe funksioneve të deleguara për vitin 2024"*, në mbështetje të VKB nr.70 datë 23.12.2024 "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Poliçan, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2025" dhe të VKB nr.71 datë 23.12.2024 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Poliçan, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2025", konfirmuar ligjshmëria me shkresën nr.898/1 datë 07.01.2025 nga Prefektura e Qarkut Berat .
-Në Organo gramën e Bashkisë Poliçan është e parashikuar në mënyrë të tillë që, 1 nënkryetar dhe drejtuesit e Drejtorive kryesore bashkë me Administratorët e NJA e Titullarët institucioneve të varësisë varen direkt nga Kryetari, ku dhe llogaridhënia është direkte tek Kryetari i Bashkisë, ndërsa nga niveli më i ulët specialist, përgjegjës sektori, llogaridhënia është në vijë vertikale.

Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga 8 (tetë) drejtori nga të cilat: 6 (gjashtë) drejtori janë të formuara me sektor dhe 2 (dy) drejtori që janë formuar si drejtori e sheshtë me 1 drejtor dhe 3 specialist. Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë, nëpunësit civilë dhe punonjësit që marrëdhëniet e punës u rregullohen nga Kodi i Punës. Në total struktura është me 285 vende ndërsa në fakt 265 vetë.
Deklarata e Misionit për vitin 2025, është hartuar në dokumentin e PBA 2025-2027, sipas standardeve të përcaktuara në Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm".
-Nga auditimi konstatohet se: Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Poliçan nuk përcakton objektivat dhe detyrat specifike për të gjithë sektorët dhe drejtorit sipas "Strukturës Organizative", ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive në nivel drejtorie, përgjegjësi, specialisti dhe në linjat e raportimit duke respektuar hierarkinë e pozicioneve të punës.
Detyrat kryesore mbi të cilën do të funksionojë dhe organizohet puna në Bashki dhe njësive administrative e strukturave të tjera në varësi të saj janë të përcaktuara në nenin 5 të këtij dokumenti.
-Në rregullore nuk është përcaktuar mënyra apo kriteret e rekrutimit/largimit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me "Kod Pune".

-Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre.
Mënyra e delegimit të detyrave është e përcaktuar në "Rregulloren e brendshme" të NJVQV, në nenin 5 "Kryetari i Bashkisë" dhe në nenin 6 "Detyrat e Zv/Kryetarit të Bashkisë, pika 2" ku citohet se: "Ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë dhe përfaqëson këtë institucion në të gjitha rastet kur me autorizim të kryetarit të bashkisë kjo e drejtë i delegohet...".
Nga auditimi konstatohet se: Nga ana e Bashkisë Poliçan ekzistojnë rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, por nuk konstatohen raste të delegimit të detyrave dhe funksioneve për vitin 2025.siç janë të parashikuara nga përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, si dhe paragrafi "Delegimi i detyrave", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.4, datë 26.01.2024, Kapitulli II.

-Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave.

Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e Bashkisë Poliçan në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist rregullohen sipas përcaktimeve në Ligjin nr.152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të tij, punonjësit administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Për çdo pozicion pune, janë hartuar dhe kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë sipas nëndarjeve dhe fushave përkatëse.
-Nga auditimi rezulton që :
Nuk ka një praktike apo sistem për vlerësimin e performancës për punonjësit, që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt.
-Bashkia Poliçan deri më sot nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës të unifikuar. Veprime ne kundërshtim të Ligjit nr. 10296 /2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe "Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit" miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 4 datë 26.01.2024 Kapitulli III pika 3.3.2 dhe sipas Aneksit 2, Aneksit 3.

Të dhëna për pozicionet me status nëpunësi civil dhe me "Kod pune për vitin 2025:

Referuar të dhënave të paraqitura në "Strukturën organizative" të miratuar për vitin 2025 dhe në pasqyrën përmbledhëse mbi shpërndarjen e numrit të punonjësve (me status nëpunësi civil dhe me "Kod pune"), rezulton se; numri maksimal i punonjësve të miratuar sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.70 datë 23.12.2024 dhe nr.71 datë 23.12.2024 për vitin 2025 paraqitet 285 punonjës, nga të cilët 222 janë punonjës të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me "Kod Pune" dhe 36 janë punonjës me status për nënpunësit civil. dhe 7 punonjës janë të përkohshëm.
Pasqyra e realizimit të strukturës organizative për vitin 2025;

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	Nëpunës Civilë	36
	Nëpunës me kontratë	222
Numri i të punësuarve me kontratë provizore		7
Vende vakante		20
Total		**285**

Burimi: Bashkia Poliçan/DBNJ

Drejtori i Buxhetit dhe Financës është caktuar Nëpunës zbatues, përgjegjës mbi zbatimin e programit buxhetor. Ky pozicion është plotësuar bazuar në procedura rekrutimi në përputhje me përcaktimet në kuadrin rregullator për këtë pozicion duke marrë në konsideratë plotësimin e kritereve si arsimimi dhe eksperienca në këtë profil.

Procedura e rekrutimit :
Për vendet e lira të punës për nëpunësit civil kryhen procedurat e publikimit të tyre, në përputhje me përcaktimet e: Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil"; VKM nr. 142, datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar.
Në Bashkinë Poliçan strukturat përgjegjëse hartojnë në fillim të çdo viti "Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil dhe miratimin e numrit të aplikantëve jashtë shërbimit civil" në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 "Për nëpunësin civil" neni 18, VKM nr. 108/2014 "Për plani vjetor të pranimit në shërbimin civil", të atyre me Kontratë Pune konform Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë" i ndryshuar. Për vitin 2025 me Vendimin nr.12 datë 18.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar plani vjetor i pranimit në shërbimit civil. Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë bëhet në faqen zyrtare të saj, në Portalin Kombëtar të Punësimit të AKPA si dhe në stendat për njoftime publike të Institucionit, konform kjo VKM nr. 243/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar Kreu II pika 6.
Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura nga ky institucion për rekrutimin dhe largimin e punonjësve për vitin 2025 u konstatua:
Procedura e rekrutimit për vendet e lira të punës për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me "Kod Pune" është kryer bazuar në: Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", neni 64, germa (g), Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Rezulton qe nuk është hartuar dhe miratuar struktura organizative e shoqëruar me një relacion të detajuar, mbi nevojat për punonjësit provizorë.
- Nga auditimi konstatohet se Bashkia Poliçan, strukturat përgjegjëse nuk kanë marrë masa për kompletimin e Njësisë së Auditimit në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 10 "Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm".
Nga testimi me zgjedhje i dosjeve të personelit, rezultoi se Drejtoria e Burimeve Njerëzore kishte plotësuar dosjet e personelit me dokumentacionin përkatës .
-Kriteret e punësimit nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme, për ato ku marrëdhëniet e punës rregullohen me Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
Për çdo punonjës të rekrutuar është krijuar dosja personale e cila përmban, arsimimin, kualifikimin, dokumente përkatëse që vërtetojnë gjendjen familjare, diploma e shkollës së lartë, lista e notave, certifikata për kualifikime të ndryshme, dëshmi e gjuhëve të huaja, por ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale

në punë.
Nga auditimi rezultoi se :
-Nuk ka përshkrime detyrash individuale e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës, formularët e përshkrimit të pozicioneve të punës nuk ishin pjesë e dosjes së personelit, apo shtojcë e Kontratës së punës për ata punonjës që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Në disa drejtori ka mangësi në vlerësimet periodike 6 mujore dhe vjetore të punonjësve në kundërshtim kjo me VKM nr. 142 datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar.si dhe VKM nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në VKM nr. 328 datë 31.05.2023 "Për klasfikimin e funksioneve grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufinjve të pagave, funksionarëve të zgjedhur, të emëruar të nëpunësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore".

Procedura e largimeve:
Për vitin 2025 rezultojnë 23 praktika për largime të punonjësve nga të cilët 5 (pesë) punonjës me status nëpunësi civil. Kanë mbushur moshën për pension pleqërie 7 (shtatë) punonjës. Kanë dhënë dorëheqjen me kërkesë 5 (pesë) punonjës dhe janë liruar nga detyra 6 (gjashtë) punonjës për shkak të përfundimit të kontratës.

Nr	Arsyeja e lirimit të vendeve	2025	Punësimi 2025
1	KMCAP	5	
2	Pension	7	
3	Largim me dëshirë/dorëheqje	5	
4	Shkurtime/ristrukturime		
5	Zgjidhje Kontrate/përfundim	6	
6	Largim për mosparaqitje në punë/ shkelje të përsëritura		
7	Ndërruar jete	-	
8	Refuzim të vendit të punës		
9	Leje Lindje	-	
TOTALI		23	

Burimi: Bashkia Poliçan/DBNJ

Nga verifikimi i dosjeve të personelit u konstatua se:
-Për largimet nga puna, në 2 (dy) raste, nuk është zbatuar kriteri i përcaktuar ne VKM 124, datë 17.02.2016, Kreu III, pika 29, ku të dokumentohet dorëzimi; i inventarit në ngarkim, i pajisjeve dhe mjeteve të punës në njësinë përgjegjëse si dhe dokumentacioni qe disponon punonjësi për shkak të detyrës. Gjithashtu rezulton qe nuk ka një sistem për vlerësimin e performancës për punonjësit, që të inkurajojë zhvillimin profesional të tyre dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe ti te marre masa administrative në rast te mos përmbushjes se detyrës funksionale.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Kreu II. "Dosja e Personelit";

-Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale
Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm. Në rregulloren e brendshme neni 35 janë pasqyruar kompetencat dhe përgjegjësitë e strukturave.
Grupi i Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes vendore, që ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

Me Urdhrin nr. 99, datë 17.03.2025, *"Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve(EMP) në Bashkinë Poliçan".* është caktuar përbërja e GMS për përgatitjen e PBA 2026-2028, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma b.
Për vitin 2025 përbërja e GMS është si më poshtë vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Statusi në GMS
1	A. Z.	Kryetar i GMS	Kryetar
2	L. X.	Koordinator i GMS	Anëtare
3	F. H.	Sekretar i GMS	Anëtare
4	D. Z.	Sek. E Përgjithshme	Anëtare
5	A.C.	Dr. Tatim Taksave	Anëtare
6	F. A.	Dr.Zhv.Territ.Bujq.Veterin.	Anëtare
7	A. I.	Dr. i BNJ &Sherb.Publike	Anëtare.
8	O. N.	Dr.i Mjedis.&Adm.Pyjeve	Anëtar
9	P. B.	Përgjegjës Sher..Social.	Anëtar.
10	A. K.	Shef. PMNZSH	Anëtare

-Nëpunësi autorizues është Kryetari në detyrë i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.
-Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:
GMS nuk ka zhvilluar takime të dokumentuara të aktivitetit të tij, nuk rezultojnë minuta takimi, procesverbale, vendime etj. të përcaktuara në Ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Manualin e MFK Kap. II/2.2.6 ku citohet: ../...GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
Ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Kap II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe "Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin" miratuar nga Ministri Financës me nr. 108/2016 Kap II pika 2.2.6.

II. Komponenti: Menaxhimi i Riskut.
Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes.
Titullari i subjektit ka përgjegjësinë e ngritjes të sistemit të menaxhimit të riskut, d.m.th emërimin e personave përgjegjës, krijimin e regjistrit të riskut, emërimin e koordinatorit të riskut, planin e minimizimit të riskut, etj., procedura të cilat nuk figurojnë të zbatuara.
Në Bashkinë Poliçan punën e koordinatorit të riskut e kryen Kryetari i Bashkisë/ NA.
- *Nga auditimi rezulton që* :
Nëpunësi Autorizues si koordinator risku nuk ka deleguar një pjesë të përgjegjësive të tij, në përputhje me Ligjin nr.10296 datë 08,07.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, neni 10, pika 2.
Me Urdhrin nr.99, datë 17.03.2025 është ngritur Grupi i Menaxhimit te Riskut (GMR). Për vitin 2025 përbërja e GMR është si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Statusi në GMR
1	A. Z.	Kryetar i Bashkisë	Koordinator Risku
2	D. Z.	Sekretar i Përgjithshëm	Anëtare
3	F. H.	Dr. Financës	Anëtar.
4	A. I.	DR.J.I.E.dhe SH.Mbeshtet.	Anëtare
5	F. A.	Dr.Planifik. të Teritorit	Anëtare
6	A.C.	Dr. Tatim Taksave	Anëtare.
7	P. B.	Përgj.Sek..Sher..Socialale	Anëtar

Regjistri i Riskut është i bazuar në analizën e riskut të çdo drejtorie dhe ka si pikësynim "Planifikimin dhe Përdorimin me eficencë, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë, për arritjen e objektivave". Ky regjistër përmban përshkrimin e risqeve për çdo drejtori/sektor, nivelin e risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për

të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, si dhe mënyrën apo rrugëzgjidhjen e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë. Për vitin 2025 nuk është përditësuar regjistri riskut, duke rezultuar për mungesë analize të risqeve dhe raportin mbi masat e marra nga strukturat përkatëse për menaxhimin e tij, të cilat pasqyrohen në Regjistrin e riskut të vitit pasardhës.
Nuk ka një strategji te riskut apo identifikim të tij sipas nenit 21 te Ligjit nr 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike".

– Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.
Bashkia Poliçan në hartimin e PBA ka vendosur objektiva si në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me vizionin dhe misionin e njësisë. Këto objektiva bëhen të njohura, duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA-ve në MFE, në Këshillin Bashkiak, si dhe dëgjesa me publikun. Dokumenti i PBA pjesë e së cilës janë dhe strategjia me objektivat dhe prioritetet strategjike, janë miratuar me VKB nr.53 prot., datë 23.12.2024 "Programi buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027 i Bashkisë Poliçan".

– Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.
Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se njësia publike nuk ka krijuar mekanizma të plotë funksionalë e të organizuar të procesit të menaxhimit të riskut.
-Nuk janë identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe priotizimin e risqeve të përputhshmërisë. Identifikimi, analiza dhe aktivitetet për menaxhimin e riskut, duhet të dokumentohen në regjistrat e riskut dhe planet e veprimit. Nga ana e Bashkisë nuk janë përcaktuar kontrollet specifike për çdo risk dhe niveli i risqeve pas implementimit të këtyre masave korrigjuese.
-Në Bashkinë Poliçan, për vitin 2025, nuk ka urdhër për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimit mbi risqet ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Poliçan.

-Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve .
Nga auditimi i kryer konstatohet se: Bashkia vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe me Vendimin Nr.2 datë 06.01.2023 është ngritur njësia përgjegjëse për shqyrtimin e hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizimit si organ i posaçëm sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 60/2016 dhe akteve nënligjore, por nuk ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësisë publike për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të plotë për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi.
-Ne rregulloren e brendshme nuk përcaktohet sjellja e punonjësve në lidhje me raportimin dhe monitorimin mbi ekspozimet ndaj mashtrimit dhe përballja me këto raste.

-Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme.
Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se: Efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm është në nivel mesatar. Bashkia Poliçan ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

III. Komponenti: Aktivitetet e Kontrollit.
Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm. Në Bashkinë Poliçan

zbatohet kontrolli parandalues, ndërsa kontrollet pas faktit realizohen çdo vit vetëm nga KLSH, pasi kjo Bashki nuk ka formuar NJAB etj., pra jo nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit;
Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.
Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument.
Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e Thesarit.
-Bashkia Poliçan ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet dhe ka një procedurë sipas standartit të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", për menaxhimin e aktiveve, por jo sipas Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

– Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit..
Nga auditimi në Bashkinë Poliçan, konstatohet mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.
Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
Listë prezencat plotësohen nga përgjegjësi i sektorit përkatës dhe listë pagesa përpilohet nga specialisti i pagave, të dhënat hidhen çdo muaj në librin e pagave.
Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", bashkia ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj..
Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim, etj.).
Aktivitetet e kontrollit nuk kuptohen mjaftueshëm dhe për pasojë një pjesë e mirë e tyre mungojnë, si p.sh. mungon një rregullore risku, apo rregullore për aksesin në aplikacione të ndryshme si p.sh. GIS etj.
Për sa më sipër, këto veprime janë në kundërshtim të Ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 11 pika 2 germa c, neni 20, neni 21, neni 24 pika 1, si dhe me neni 27.

- Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë
-Rregullorja e Brendshme e Bashkisë nuk përcakton objektivat dhe detyrat specifike sipas "Strukturës Organizative" të miratuar. "Në rregulloren e brendshme të Bashkisë Poliçan nuk janë të pasqyruara detyrat funksionale të specialistit të IT, çka krijon boshllëk në përcaktimin e përgjegjësive dhe në vlerësimin e performancës." Bashkia Poliçan nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar infrastrukturë IT në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Nga auditimi, bazuar në dokumentet e vëna në dispozicion, rezulton se ndryshimet e bëra në strukturën organizative nuk janë shoqëruar me përditësimin e rregullores së brendshme dhe miratimin e saj në KB.
Programi i përdorur nga sektori i financës për përpunimin e raporteve është program në Excel, ndërsa mbi sistemet e zbatimit të buxhetit sektori i financës përdor sistemin AFMIS, nga qeverisja qendrore.

-Në Bashkinë Poliçan nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

– Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

-Bashkia nuk ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësive për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.

-Gjurma e auditimit

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Gjurma e Auditimit informon mbi: Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; Aktivitetet e rëndësishme të kontrollit, që garantojnë ecurinë e duhur të operacionit; Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se: Bashkia nuk ka hartuar, miratuar, gjurmën **e** unifikuar të auditimit duke cënuar ndjekjen e ecurisë së një procesi apo procedure që lidhet me veprimtarinë kryesore të njësisë dhe duke bërë të paqartë dhe jo të plotë për të tretët, mjedisin e kontrollit dhe vendimmarrjen lidhur me to.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar Kreu II, neni 8, pika 8a, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;

-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhrin Nr.4, datë 26.01.2024 të Ministrit të Financave.

IV. Komponenti: Informimi dhe komunikimi

Në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 23 "Informimi dhe komunikimi" përfshin: *Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.*

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

-Nga auditimi rezulton qe nuk ka një komunikim efektiv, si horizontalisht, ashtu dhe vertikalisht, në të gjitha nivelet e hierarkisë të njësisë.

-Nuk shpërndahen udhëzime dhe urdhra të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.

-Nuk ka një sistem deklarimi efikas dhe të përpiktë, që të përfshijë nivelet dhe afatet për deklarimin, llojet e deklaratave që i dorëzohen menaxhimit, format e deklaratave për rastet e zbulimit të gabimeve, të parregullsive, të abuzimit, të mashtrimit ose të përvetësimit.

Sa më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". i ndryshuar.

- Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nga auditimi konstatohet se drejtuesit në Bashkinë Poliçan kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur. Sistemi i raportimit ofron pjesërisht informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten

pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit.
-Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.
Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

-Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor.
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, është përgjegjëse për komunikimin me subjektet kryesore të jashtme (ka korrespodencë shkresore zyrtare dhe elektronike sipas rastit) si dhe e çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në institucion. DBNJSHM përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit.
Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohet me komunikim verbal. Nëpunësit e bashkisë sqarojnë se nuk janë hartuar procedura të shkruara për të siguruar që menaxherët dhe personeli i bashkisë të informohen për të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve dhe nismat e tjera të bashkisë. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave sa herë që ka alokime fondesh.
- Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se bashkia nuk përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike. Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë.
-Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm.
Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe evidentohet që punonjësit në përgjithësi përdorin adresat zyrtare të e-mailit. bashkia.polican@bashkiapolican.gov.al.
Nga Bashkia kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të dokumentuara ne proces-verbale si dhe te ngarkuara në faqen zyrtare të Bashkisë Poliçan.
-Në faqen zyrtare të saj nuk është i publikuar çdo vendim i Këshillit Bashkiak. Vendimet janë të publikuara të gjitha në platformën online ku publikohen vendimet e këshillave bashkiakë "Vendime.al"
Nuk janë të pasqyruar në faqen web të Bashkisë Poliçan:
-Kalendari vjetor i dëgjesave publike;
-Regjistri i projekt-akteve për konsultim publik
Nga auditimi u konstatua se:
-Bashkia nuk përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",i ndryshuar, Kreu III, neni 23, "Informacioni dhe Komunikimi" pika 2;.,
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.4 datë 26.01.2024. Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.4.

V. Komponenti: Monitorimi dhe Raportimi.
Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm synon të vlerësojë cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.
- Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.
-Sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon pjesërisht në mënyrë efektive, ka mangësi serioze të cilat ekspozojnë njësinë publike ndaj risqeve të larta.
Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Poliçan, nuk është e plotësuar, por është siguruar si shërbim auditimi nëpërmjet Kontratës së Punës me audituesi të certifikuar në rolin e ekspertit të

jashtëm. Nuk është kryer gjatë vitit 2025 auditimi mbi vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm,, si dhe fusha të tjera me risk të lartë në veprimtarinë e institucionit.
Nga auditimi u konstatua se:
-Në Bashkinë Poliçan nuk ka rregulla të brendshme të plota e të miratuara për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
-Nuk ka një raport mbi zbatimin e planit të veprimit të miratuar për ecurinë e kontrollit të brendshëm.
Bashkia Poliçan, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 18, ka dërguar pranë Njësisë Qëndrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit: -Pyetësorin mbi vetëvlerësimin për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit; Raportin vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm" për vitin 2025. Planin e veprimit për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
-Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH;
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Kreu II, neni 8, pika8 a, Kreu III, neni 24, "Monitorimi" pika 1; si dhe ne kundërshtim me "Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.4 datë 20.01.2024, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.5.Anekset.

- Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.
Në bazë të auditimit të kryer në Bashkinë Poliçan, rezulton se titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet analizimit dhe hartimit të plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Nuk kanë gjetur zbatim të gjithë rekomandimet e dërguara zyrtarisht nga ana e KLSH në këtë Bashki.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4, pikat 19-20, neni 8, pika 8 germa "a", neni 16, pika 2, nenet 20-22, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.1, germat "a-d", pika 2.3.1, pika 3.2.1, pika 3.2.4, pika 5.2.3, pika 5.2.7, dhe "Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4 datë 26.01.2024 Kapitulli Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.5.Anekset.

1.2 Auditi i Brendshëm

Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimi, ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.
Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:
1.Karta e Auditimit të Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Poliçan;
2.Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3.Programimi i auditimeve të brendshme për vitin -2025;
4.Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm;
5.Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;

Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm.
Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Poliçan, është miratuar në zbatim Vendimit Këshillit Bashkiak nr.70 datë 23.12.2024 " Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Poliçan,Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2025" konfirmuar ligjshmëria me shkresën nr.898/1 datë 07.01.2025 nga Prefektura e Qarkut Berat. **Kjo**

strukturë është miratuar në nivel sektori me 4 punonjës, nga këto: një përgjegjës, dy specialistë dhe një ekspert i jashtëm për kryerjen e auditimit të brendshëm.
Për vitin 2025 në Bashkinë e Poliçanit në bazë të pikës nr. 6/b të Vendimit të KM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik". është siguruar si shërbim auditimi nëpërmjet kontratës të Punës nr.1812 prot,.date 01/08/2025 të nënshkruar ndërmjet z. A. Z., Kryetari i Bashkisë dhe znj. L. M., në rolin e ekspertit të jashtëm për kryerjen e shërbimeve të auditimit të brendshëm. Ky Shërbimi i auditimit është kryer mbi bazë kontraktimi me Bashkinë , ndërkohë që në strukturën e kësaj NJVQV është miratuar pozicioni i audituesit të brendshëm (struktura organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Poliçan, në zbatim të VKB nr.70, datë 23/12/2024).
Për vitin 2025 nga ana e Bashkisë Poliçan është bërë 3 herë publikimi i shpalljeve per këto pozicione te punës për audites të brendshëm si vijon, por nuk ka patur aplikime:
1) Përgjegjës sektori Auditi - Nr.346/1 prot datë 04.02.2025, Nr.1359/1 prot datë 09.06.2025, Nr.2209/1 prot datë 08.09.2025.
2) Specialist Auditi - Nr.349/1 prot datë 04.02.2025, Nr.1363/1 prot datë 09.06.2025, Nr.2193/1 prot datë 08.09.2025.

Nga auditimi në Bashkinë Poliçan rezulton se, nuk është krijuar njësia e auditimit të brendshëm, sipas përcaktimeve të pikës nr. 1/a, të Vendimit të KM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik"
Veprime në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", pika 3 "Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si audites të brendshëm në sektorin publik".

Nga auditimi konstatohet se:

1.Nga ana e audituesit të kontraktuar nga ana e Bashkisë Poliçan, nuk është hartuar *"Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik",* detyrim sipas ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* neni 12, pika c, neni 14/ b.

2. Për vitin 2025 nuk është hartuar dhe miratuar plani vjetor dhe plani strategjik 2025-2027, e për rrjedhojë për periudhat e audituara, në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *"Për auditimin -e brendshëm në sektorin publik"* neni 12, neni 14.
3. Për veprimtarinë e auditimit në Bashkinë Poliçan për periudhën objekt auditimi, nuk është raportuar në mënyrë sistematike te Titullari i Institucionit.

Nga Titullari i institucionit, nuk është hartuar dhe dërguar në NJQHAB te Ministrisë së Financave raporti periodik vjetor të shoqëruar me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB në kundërshtim me 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 10 pika 2/1, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, gërma "a" dhe VKM-ja nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin publik", pika 6, gërma "a".

Vlerësimi mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Poliçan.

Sipas program-auditimit të punonjëses së AB të miratuar me shkresën Nr.315 prot. Datë 31/12/2024 nga Titullari i Bashkisë, i nënshtrohet auditimit të plotë, Drejtoria e Tatim Taksave. Programi ka përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë, *subjektin që Auditohet, periudhën dhe afatin e misioni*t, *llojin e auditimit, drejtimet dhe grupin e punës*.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për vitin 2025 sipas **Program-Auditimi**, janë planifikuar për tu kryer **3** auditime nga të cilat janë realizuar **1** auditim.

1. Drejtoria e Tatim-Taksave.

Në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë vijon:

Pasqyra e realizimit të auditimeve për vitin 2025.

Nr	Periudha	Të dhëna sipas raportimit						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh.	Financë	Kombinuar	Performancë	Tjera
1	2025	3	1	1				

Pasqyra e realizimit të auditimit të brendshëm për vitin 2025.

Në Bashkinë Poliçan është realizuar një angazhim auditimi përputhshmërie, për Drejtorinë e Tatim Taksave.për të cilën disponohet ky dokumentacion:

.

Nr.	Dokumentacioni i Auditimit	Shkresa:
1	Autorizim për përgatitjen e angazhimit për auditim	Nr.1380/1 prot. datë 09.06.2025
2	Program audimi	Nr.1380 prot. datë 09.06.2025
3	Projekt Raport mbi "auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Tatim-Taksave" në Bashkinë Poliçan	Nr.3075 prot datë15.12.2025
4	Raport Përfundimtar mbi "auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Tatim- Taksave" në Bashkinë Poliçan	Nr.3075/1prot datë15.12.2025
5	Plan Kontrolli për vitin 2025	Nr.315/prot. datë 31/12/2024

Konkluzion: Grupi i auditimit bazuar në informacionin e grumbulluar nga pyetësorët mbi vetëvlerësimin dhe rezultatet e testimeve të kryera nga auditimi në terren, konstaton se komponentët e MFK-së nuk kanë funksionuar plotësisht, nisur nga mënyra e zbatimit të dispozitave ligjore, është konstatuar se në përgjithësi elementët e sistemeve të MFK nuk kuptohen nga njësia dhe janë të implementuara në një shkallë jo të mjaftueshme, më konkretisht:

-Në "*Rregulloren e Brendshme"* është konstatuar se rregullat apo proceset kryesore të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësive, por nuk përshkruajnë me detaje këto procese, rrjedhën e punës (fillimin dhe mbarimin e procesit), informimin dhe raportimin, dhe vendimmarrjen individuale, me qëllim parandalimin e risqeve dhe përgjigjen ndaj tyre.

-Për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës bazuar në "*Kodin punës*" nuk janë të përcaktuara: Detyrat dhe përgjegjësitë, mënyra apo kriteret e rekrutimit/largimit për çdo pozicion.

-Mjedisi i kontrollit nuk ka përfshirë rregulla dhe procedura të qarta, dhe si pasojë aktivitetet e kontrollit rezultojnë të pamjaftueshme për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Mungojnë politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, të cilat përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA, stafit menaxherial dhe punonjësve të këtij institucioni

-Për largimet nga puna, nuk është zbatuar kriteri i përcaktuar ne VKM 124, datë 17.02.2016, Kreu III, pika 29, ku të dokumentohet dorëzimi; i inventarit në ngarkim, i pajisjeve dhe mjeteve të punës në njësinë përgjegjëse si dhe dokumentacioni qe disponon punonjësi për shkak të detyrës.

-Nga ky institucion, nuk është hartuar, miratuar, gjurma e unifikuara e auditimit;

-Programi i përdorur nga sektori i financës për përpunimin e raporteve është program në Excel, ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

-Nuk ka përgatitur rregullore për shërbimin IT, dhe nuk ka sistem rezervë për ruajtjen e të dhënave të menaxhimit financiar IT (back-up) për njësinë.

Sa më sipër shkaku kryesor për gjendjen e krijuar është mungesa e krijimit të një sistemi të plotë të MFK, mungesa e funksionimit të sistemeve të MFK-së, të cilat sjellin për pasojë që këto sisteme të mos kuptohen nga njësia publike dhe mungesën e reagimit ndaj risqeve të mundëshme.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, -"Manuali i MFK i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.4 datë 26.01.2024, Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, gërma "b"; Ligjin nr.

114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13; VKM nr. 117/2014, i ndryshuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020, Kreu nr. 1, pika nr. 1; VKM nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”, pika 2.3.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. F. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

***2*.. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

2.1. Programimi PBA 2025-2027 dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2025;
2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;
2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;
2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;
2.5. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, evidentimi i detyrimeve të paarkëtuara.

Dokumentacioni i audituar si më poshtë:

- Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministritë e Linjës;
- Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MF, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
- Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat;
- Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
- Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të pa likuiduara dhe vendimeve gjyqësore;
- Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimit të ndryshimeve (në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar).
- Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
- Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “Excel”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj).

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua si më poshtë vijon:
Struktura organizative e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për vitin 2025 ka këtë përmbajtje:

Tabela nr.1 Struktura organizative e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për vitin 2025

Nr	Emërtimi i pozicionit në strukturë	Emër Mbiemër	Formimi arsimor	Numri i punonjësve/Periudha e ushtrimit të detyrës
	Drejtoria e financës dhe buxhetit			
I	**DREJTOR DREJTORIE**			**1**
1	Drejtor i Financës dhe Buxhetit	F. H.	I lartë	01-01.2023 e ne vazhdim
II	**SEKTORI I FINANCËS DHE KONTABILITETIT**			**3**
1	Përgjegjës i sektorit të financës dhe kontabilitetit	K. Z.	I lartë	16.11.2020 e ne vazhdim
2	Specialist finance në sektorin e kontabilitetit	K. S.	I lartë	13-8-2024 - 31.12.2025
3	Specialist finance në NJA Terpan	M. D.	I lartë	01.04.2016 e në vazhdim
III	**SEKTORI I BUXHETIT**			**3**
1	Përgjegjës në sektorin e buxhetit	S. GJ.	I lartë	01-01.2023 e ne vazhdim
2	Specialist e veprimeve me degën e thesarit	E. B.	I lartë	17.03.2020 e në vazhdim
3	Llogaritare dhe arkëtare	DH. S.	I mesëm	01.01.2024 e në vazhdim
IV	**SEKTORI I MENAXHIMIT FINANCIAR DHE ASETEVE**			**3**

1	Përgjegjës në sektorin e menaxhimit financiar dhe aseteve	K. R.	I lartë	01.02.2024 e në vazhdim
2	Specialiste e menaxhimit të aseteve	G. F.	I lartë	04.03.2022 e në vazhdim
3	Ekonomiste e mesme, magaziniere	R. G.	I mesëm	01.01.2015 e në vazhdim
Numri total i punonjësve në strukturë DFB			**10**	

Burimi: Bashkia Poliçan

1.1. Programimi PBA-së 2025-2027 dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025:

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025-2027, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për PBA 2025-2027 dhe buxhetin vjetor 2025 me Urdhrin nr. 99,datë 17.03.2025. Mbi këtë bazë janë hartuar Deklarata e Politikës së Programit dhe Produktet e Programit dhe kostot përkatëse të tyre si pjesë e PBA-së. Grupi i auditimit ka analizuar dokumentacionin e hartimit te PBA-se për tre fazat dhe dokumentimin e hartimit të kërkesave buxhetore nga çdo sektor apo zyrë, si më poshtë:

✓ Është miratuar në Këshillin Bashkiak nr.42, datë 22.12.2023 "Kalendari i Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 si dhe janë miratuar tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 me VKB nr.16, datë 06.03.2024. Kryetari i Bashkisë Poliçan ka miratuar udhëzimin nr.2, datë 29.03.2024 për përgatitjen e buxhetit të njësisë vendore dhe në bazë të tij janë përgatitur kërkesat buxhetore. Është dërguar pranë Ministrisë së Financave projekt-dokumenti i PBA 2025-2027 (Faza 1) me shkresën Nr.1275 prot., datë 31.05.2024. Pas dërgimit të komenteve nga Ministria e Financave mbi projekt-dokumentin e programit buxhetor afatmesëm është bërë miratimi i PBA 2025-2027 (Faza 1) me VKB nr.43, datë 15.07.2024.

✓ Janë miratuar tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm me VKB nr.42. datë 15.07.2024. Është bërë miratimi i PBA 2025-2027 (Faza 2) me VKB nr.49, datë 12.09.2024.

✓ Projekt-dokumenti i programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 (Faza 2) është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr.2151 prot., datë 13.09.2024.

✓ Sipas VKB nr. 72 datë 23.12.2024 është miratuar Buxheti Vjetor 2025 (*me të ardhurat gjithsej dhe shpenzimet gjithsej dhe të detajuara sipas natyrës, miratuar plani i të ardhurave për periudhën 3 vjeçare të PBA-së dhe detajimi i buxhetit 2025-2027 për grupin e shpenzimeve korente dhe kapitale sipas programit buxhetor afatmesëm 2025-2027).*

- Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, për vitin 2025 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve në zbatimit të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 27, pika 2, ku përcaktohet që:

Neni 27: "Takime periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë së sektorit publik":
Pika 2. Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje.

Pikën nr. 2.4.2, "Grupi i Menaxhimit Strategjik", të Manualit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 04, datë 26.01.2024 ku përcaktohet që:

Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë GMS me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike. GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

Udhëzimi nr. 3, datë 28.02.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027", pika 13, ku përcaktohet që:

13,Kërkesat buxhetore të dorëzuara te kordinatori i GMS vlerësohen dhe miratohen nga Grupi për Menaxhim Strategjik i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore.

dhe Udhëzimi MF nr. 3, datë 28.02.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027", pika 11, ku përcaktohet që:

Pika 11: Drejtuesit e EMP paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit te Koordinatori i GMS, brenda muajit prill 2024.

Një shpërndarje e programeve buxhetore për vitin 2025 sipas funksioneve/nënfunksioneve që NJVQV/Bashkitë janë përgjegjëse për ushtrimin e tyre të atribuuar nga Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", pasqyrohet në aneksin nr. 1 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Nga analiza e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, pasqyruar dhe në tabelën nr. 1, rezultoi se nga 20 programe buxhetore të miratuara nga MF për përgatitjen e PBA 2025-2027 nga ana e Bashkisë Poliçan janë planifikuar për buxhetim 16 programe; dhe *ka funksione/nënfunksione të cilat nuk kanë program buxhetimi*, të tilla si:

- Funksioni "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike" *(neni 23):* nënfunksioni **13**: "Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të kujdesit të shëndeti publik"; dhe **14**.Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Funksioni "Në fushën e mbrojtjes së mjedisit" *(neni 26);):* nënfunksioni :**1**.Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit,tokës dhe ujit nga ndotja. **2**.Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. **3**.Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit, etj.

Çdo funksion i përcaktuar në Ligjin 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* përfshihet në një program të caktuar buxhetor të përcaktuar në Udhëzimin nr.7, datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" shtojca 1. Sa më sipër, konstatohet se nuk ka një harmonizim të planifikimit buxhetor të atyre nënfunksioneve që edhe pse u përkasin funksioneve të ndryshme, me një studim dhe analizë profesionale për të mbështetur apo plotësuar qëllimin e realizimit në tërësi të shërbimeve ndaj komunitetit në territorin që mbulon Bashkia Poliçan.

Programet buxhetore të përzgjedhura nga ana e Bashkisë.

▪ Ndërsa programet buxhetore e përzgjedhura në Bashkinë Poliçan për buxhetin e vitit 2025 si viti i parë në PBA 2025-2027, krahasuar me programet e miratuara nga MF për tu patur në konsideratë nga NJVQV gjatë përgatitjes së PBA 2025-2027, pasqyrohen si në aneksin nr. 2 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Konstatim: Nga verifikimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në aneksin nr. 2 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit, të funksioneve të bashkisë dhe 20 programeve buxhetore të caktuara në udhëzimet e MF për PBA 2025-2027, rezultoi se disa programe buxhetore të lidhura me nënfunksionet e bashkive "në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike" si dhe "në fushën e mbrojtjes së mjedisit", nuk janë marrë në konsideratë nga Bashkia Poliçan për të parashikuar fonde në buxhet, në moszbatim të Udhëzimit nr. 7 datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*" shtojca 1 dhe Udhëzimit të MF nr.3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", (shtojca 4).

Takimet konsultative me grupet e interesit në komunitet:

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Poliçan për PBA 2025-2027 dhe Projekt buxhetin e vitit 2025, ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit në komunitet, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I neni 5 pika ç; ndërsa prezantimi i PBA 2024-2026 dhe Projekt buxheti vjetor 2024 nga ana e Bashkisë Poliçan është publikuar në faqen Zyrtare të Bashkisë në formatin e përshtatur për publikun.

Dëgjesat publike

Datat e mbajtjes së tyre	PBA 2025-2027	Projekt Buxheti 2025
	Shkresa nr. 1139 ,prot. , datë 16.5.2025 (data e konsultimit 22.5.2025)	
Numri i takimeve	Shkresa nr. 2821 ,prot. , datë 11.11.2025 (data e konsultimit 20.11.2025)	

Burimi: DFB/Bashkia Poliçan

Procesi konsultativ me komunitetin është realizuar nëpërmjet njoftimit zyrtar në stenda, ëeb-in e Bashkisë, rrjetet sociale etj., me anë të të cilave njoftohet komuniteti mbi takimin, objektin, platformën dhe adresën/linkun etj., vërtetuar kjo nga proces verbalet e mbajtura në secilin takim, konform kuadrit ligjor në fuqi: Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I neni 5 pika ç; Ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" Kreu IV, neni 11-20 dhe pika 16 e Udhëzimit të MF nr.3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", (shtojca 4).

16.Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore organizon takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA-së.

Kalendari i Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit Vjetor.

Bashkia Poliçan ka hartuar "Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit vjetor" për Bashkinë dhe njësitë administrative për vitin 2025 dhe miratuar me VKB nr. 73, datë 23.12.2024, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 33;

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në Këshillin e Njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Programet afatmesme 2025-2027 dhe 2026-2028 janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuarUdhëzimin e MF nr. 7 datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit", Udhëzimin e MF nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" shtojca 1, dhe VKB për miratimin e taksave vendore për Bashkinë për vitin 2025. Nga auditimi del se, është marrë në konsideratë Instrumenti i Planifikimit Financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion *(kontratat në vazhdim),* angazhimet *(detyrimet e prapambetura sipas llojit),* tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme *(kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).*

Programimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027 dhe i detajuar sipas programeve, pasqyrohet si më poshtë:

Tabela nr. 2. *në mijë lekë*

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2024	Faza e I -PBA 2025	Faza e II- PBA 2025	Projekt Buxhet 2025
600	Paga	160,668	164,182	164,182	193,716
601	Sigurime Shoqërore	27,579	28,732	28,732	34,956
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	84,569	93,827	93,826	73,026
604	Transferta Korente të Brendshme	2,450	700	700	500
605	Transferta Korente të Huaja				
606	Trans për Buxh. Fam. & Individë	849	5,427	5,427	5,700
I	**Shpenzime Korrente**	**276,115**	**292,868**	**292,868**	**307,898**
230	Kapitale të Patrupëzuara	19,785	4,432	4,432	
231	Kapitale të Trupëzuara	70,836	57,220	57,220	94,280
	Shp. Kapitale me financim të brendshëm	**90,621**	**61,652**	**61,652**	**94,280**
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj				
II	**Shpenzime Kapitale**	**90,621**	**61,652**	**61,652**	**94,280**
III	**Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti**				
I+II +III Totali I Shpenzimeve		**366,736**	**354,520**	**354,520**	**402,178**

Burimi: Bashkia Poliçan

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet e Këshillit Bashkiak si më poshtë:

- faza fillestare PBA 2025-2027, miratuar me VKB nr.43 , datë 15.07.2024;
- faza përfundimtare miratuar me VKB nr.49, datë 12.09.2024.

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2025

Të dhënat në mijë lekë

Emërtimi	Viti 2024	Viti 2025
Të ardhurat faktike	416,746	446,613
Shpenzimet faktike	366,736	375,689

Burimi: Bashkia Poliçan, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës

- Me vendimin e këshillit bashkiak (VKB) nr.70, datë 23.12.2024, është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë Poliçan, institucioneve në varësi, njësive administrative dhe funksionet e deleguara për vitin 2025.
- Me vendimin nr. 71, datë 23.12.2024 dhe VKB nr.20, dt.28.3.2025 është miratuar niveli i pagave të Bashkisë Poliçan.

Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2025-2027 me planin buxhetor 2025, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.5 *Në 000/lekë*

Nr.	**Emërtimi**	**Plan përfundimtar 2025**	**Sipas PBA 2025-2027**	**Ndryshimi**
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	237,217	237,014	203
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	89,663	90,583	-920
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	167,541	166,824	717
4	Investime nga FZHSH	0	0	0
	Total i planit fillestar	**494,421**	**494,421**	**0**
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant i kushtëzuar	223,713		
6	Shpenzime për pagat (600+601)	5,578		
7	Shpenzime (602.604.609)	92,116		
	Grant i kushtëzuar (230-231)	*321,407*		
	Gjithsej	**815,828**		

Burimi: Bashkia Poliçan

Për vitin 2025, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në Ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 72, datë 23.12.2024, konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Berat me shkresën nr.898/1, datë 07.01.2025. Referuar përcaktimeve në këtë Vendim të KB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2025 janë në vlerën 147,702,835 lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 164,302,711 lekë dhe transferta specifike në vlerën 90,172,672 lekë.

Sa më sipër, buxheti fillestar i miratuar nga Këshilli Bashkiak me VKB nr.72, datë 23.12.2024 në total ka parashikuar të ardhurat në vlerën 402,178,218 lekë, po ashtu edhe shpenzimet për të njëjtën vlerë prej 402,178,218 lekë.

Gjatë vitit 2025, janë marrë gjithashtu disa vendime të Këshillit Bashkiak Poliçan të cilat kanë miratuar ndryshimin e vlerave të buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten si vijon:

✓ Me VKB nr. 13,datë 17.02. 2025, është marrë vendim për miratimin e buxhetit shtesë për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2024, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 59,2166,118 lekë, konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Berat me shkresën nr. 168/1 prot., datë 19.02.2025.

✓ Me VKB nr. 21, datë 18.03.2025, është marrë vendim për miratimin e buxhetit shtese për bashkëfinancimin me Këshillin e Qarkut Berat për investimin me objekt *"Asfaltimi i rrugës*

Terpan, NJA Terpan , Bashkia Poliçan" në vlerën 41,626,965 lekë me cikël financimi 2025-2027 konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Berat me shkresën nr.25/2 prot., datë 01.04.2025.
✓ Me VKB nr. 29 , datë 22.05.2025, është marrë vendim për miratimin e ndryshimit të VKB Nr. 21, datë 18.03.2025 (*transferim nga njëri program në tjetrin dhe nga njëri art.buxhetor në tjetrin)* në vlerën totale 12,200,000 lekë, konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Berat me shkresën nr. 399/2 prot., datë 30.5.2025/
✓ Me VKB nr. 38 , datë 27.06.2025, është marrë vendim për miratimin e ndryshimit të VKB Nr. 29, datë 22.05.2025 për kalim të buxhetit të investimeve nga art. 231, në art. 230 me objekt "Hartim projekti për sistemim dhe rikonstruksion të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza" në vlerën 3,000,000 lekë, konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Berat me shkresën nr. 695/1 prot., datë 9.9.2025.
✓ Me VKB nr. 57, datë 25.09.2025, është marrë vendim për miratimin e ndryshimit të VKB Nr. 29 (*transferim nga njëri program në tjetrin dhe nga njëri art.buxhetor në tjetrin)* në vlerën 12.000.000 lekë, konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Berat me shkresën nr. 747/1 prot., datë 01.10.2025.
Sa më sipër në zbatim të në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues të MF nr. 2, datë 24.01.2025 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025*", pika 114:

Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore rishikon dhe përgatit buxhetin përfundimtar për miratim në Këshillin e saj. Buxheti i miratuar nga Këshilli, dërgohet në Ministrinë përgjegjëse për financat në rrugë elektronike dhe me shkresë zyrtare, sipas procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.
Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit paraqitet në aneksin nr. 3 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandet qeveritare, ndihmat ekonomike, gjendjen civile, shpërblimet e lindjes, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.
Gjatë vitit 2025 janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime), ku lëvizjet në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit të institucionit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me vendim të KB.
-Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.
-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Skrapar dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme,

janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.
-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.
Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.
Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Skrapar si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.
Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2025, referuar situacionit të shpenzimeve dhe akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin (të ardhurat e veta vendore + transferta e pakushtëzuar + transfertë sektoriale) paraqitet në aneksin nr. 4 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Konstatim: Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Poliçan së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025 kanë diferenca me vlerën e planifikuar. Për vitin 2025 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën **402,178 mijë** lekë buxheti i rishikuar ka vlerën **494,421 mijë** lekë, ndërsa realizimi është në vlerën **375,689 mijë** lekë ose në masën **76** %.

- Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën **237,014 mijë** lekë dhe është realizuar në vlerën **224,733 mijë** lekë ose në masën 94.8 %, me një mosrealizim në shumën -12.3 milionë lekë.
- Zëri shpenzime operative (602) dhe Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën **90,583** mijë lekë dhe është realizuar në vlerën **75,385 mijë** lekë ose në masën 83.2 %, me një mosrealizim në shumën -15.2 milionë lekë.
- Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 (artikulli 230-231) është planifikuar në vlerën **166,823 mijë** lekë dhe është realizuar në vlerën **75,571** mijë lekë, me një mosrealizim të këtyre fondeve prej -91,252 mijë lekë, ose realizimi në nivelin **45.3**.%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Poliçan në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim ndonëse korrigjohet gjatë vitit, nuk ka koordinuar nivelin e shpenzimeve buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9, pika 1.3, gërma "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe VKB përkatëse.

Niveli i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta:
Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2025 është në shumën **177,702 mijë** lekë ndërsa realizimi ka vlerën **145,993 mijë** lekë ose në masën **82.2** %. Bashkia Poliçan ka pasur të ardhura të trashëguara nga viti 2024 shumën 42,199 mijë lekë.

Gjatë viti 2025 shuma e përdorur e të ardhurave për të mbuluar shpenzimet operative dhe kapitale të Bashkisë Poliçan është në vlerën 114,017 mijë lekë.
Kjo vlerë ka mbuluar zërat e shpenzimeve si më poshtë:

- Llogaria 600 (Paga) në shumën 30,088 mijë lekë;
- Llogaria 601 (Sigurime shoqërore dhe shëndetësore) në shumën 826 mijë lekë;
- Llogaria 602 (Blerje mallra, shërbime) në shumën 26,654 mijë lekë;
- Llogaria 606 (Transferta buxhete familjarë, individ) në shumën 0 . lekë;
- Llogaria 230-231 (Investime kapitale) në shumën 56,449 mijë lekë.

Buxheti faktik i vitit 2025 është në vlerën 658,772 mijë lekë duke përfshirë transfertat e kushtëzuara për investime për ndihmën ekonomike dhe PAK.
Sipas realizimit të buxhetit Bashkia Poliçan me të ardhurat e veta mbulon 17,3 % të buxhetit vjetor 2025.
Sipas realizimit të buxhetit Bashkia Poliçan me të ardhurat e veta mbulon 17.3 % të buxhetit vjetor 2025. Të dhënat e mësipërme për vitin 2025, tregojnë për nivele të ulëta të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta, të cilat kanë si shkak nivelin e ulët të mbledhjes së të ardhurave më hollësisht trajtuar në aneksin nr. 5 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë:
Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" dhe nenit 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, krijohet Fondi Rezervë.
Neni 40 pika 6, i ligjit për vetëqeverisjen vendore përcakton se:

Buxheti vendor përfshin një fond rezervë dhe një fond kontingjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë ***deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara,*** *përjashtuar transfertat e kushtëzuara.*

Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontigjencës. *Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3% të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.*

Fondet e Emergjencës planifikohen për të përballuar situata emergjente në zbatim të nenit 16 të Ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001, "Për Emergjencat Civile" i ndryshuar, të nenit 29 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të pikës III/3 të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".
Mbështetur në nenin 65 të ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej ***4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre***, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si të ardhurat e veta vendore etj.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë:
Parashikimi i fondeve të emergjencave civile dhe fondit rezervë është mbështetur në përvojën e viteve të mëparshme. Fondi i emergjencave civile planifikohet në shume totale minimalisht 4% të totalit të buxhetit të Bashkisë, ka filluar nga viti 2020. Nga Bashkia Poliçan në buxhetin e vitit 2025 është parashikuar fondi i rezervë në vlerën 1,900,000 lekë.
Struktura e fondeve me destinacion:
Tabela nr.11.

Në lekë

Emërtimi	Plan 2025	Fakt 2025
Fondi rezervë,	1,900,000	0
Fondi i kontigjencës,	3,200,000	2,688,083
Fondi i emergjencës	0	0
Shuma	5,100,000	2,688,083

Burimi: Bashkia Poliçan

Vlerat e llogaritura për këtë qëllim: Fondi rezervë dhe i kontigjencës paraqitet në shumën 5,100 mijë lekë miratuar me VKB nr.72 datë 23.12.2024, "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2025 të Bashkisë Poliçan".
Në VKB nr. 72, datë 23.12.2024 është miratuar për Bashkinë Poliçan për vitin 2025, fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total **5,100,000 lekë,** si vijon:

- ✓ fondi rezervë nga granti në vlerën 500,000 lekë;
- ✓ fondi rezervë nga të ardhurat në vlerën 0 lekë;
- ✓ fondi kontigjencës nga granti në vlerën 3,200,000 lekë;
- ✓ fondi kontigjencës nga të ardhurat në vlerën 1,400,000 lekë;
- ✓ fondi i emergjencës civile në vlerën 0 lekë

- **A. Fondi Rezervë:** Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" dhe nenit 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, është krijuar Fondi rezervë. Në buxhetin e Bashkisë Poliçan për vitin 2025, është planifikuar fond rezervë nga të ardhurat 1,900 mijë lekë. Nga Fondi Rezervë për periudhën nga data 01.01.2025, deri 31.12.2025, është shpenzuar 0 lekë.

- **B. Fondi i Kontingjencës:** Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontingjencës. Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3 (tre) % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Në buxhetin e Bashkisë Poliçan janë parashikuar fondet e kontigjencës në vlerën 3,200 mijë lekë. Përdorimi i fondit të kontigjencës për vitin 2025 në vlerë totale **2,688,083 lekë**: (Tabela nr.12)

VKB	Dt. VKB	Emertimi	Personi	Vlera/lekë
15	17.2.2025	Ndihme për shpenzime shëndetësore	SH. A.	200,000
17	17.2.2025	Ndihme për shpenzime shëndetësore	A. A.	90,000
14	17.2.2025	Ndihme për pagesë qiraje	S. F.	72,000
14	17.2.2025	Ndihme për pagesë qiraje	S. Z.	72,000
16	17.2.2025	Ndihme për shpenzime shëndetësore	V. K.	500,000
26	22.4.2025	Ndihme për shpenzime shëndetësore	A. N.	200,000
30	22. 5.2025	Ndihme financiare per shpenz. çatie	S. M.	450,000
33	22.5.2025	Ndihme për fatkeqësi natyrore	M. A.	104,083
47	28.8.2025	Ndihme për shpenzime shëndetësore	A. A. dhe A. A.	500,000
63	4.11.2025	Ndihme për shpenzime shëndetësore	A. T.	500,000
				Totali 2,688,083

- **C. Fondet e Emergjencës dhe për Mbrojtjen Civile:** Në zbatim të nenit 65 të Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", fondi i emergjencave civile planifikohet në shumë totale minimalisht 4 % të totalit të buxhetit të Bashkisë, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.

Gjatë vitit 2025 janë kryer pagesa për 10 familje me fondet e dërguara nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, për dëmtimet e banesave nga fatkeqësi të ndryshme. Fondi total i akorduar ka qenë në shumën 2,688,083 lekë i ndarë :

- o Me shkresën nr. 2116 prot., datë 11.04.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të MF është bërë alokimi i transfertës specifike *"Për mbrojtjen civile",* në vlerën 2,998,816.65 lekë, e cila është shpenzuar për 2,998,717 lekë.
- o Me VKB Poliçan nr. 31, nr. 32 dhe nr.33, datë 22.5.2025, është marrë vendim për përdorimin e fondit të emergjencës së akorduar nga fondet të kushtëzuara, konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Berat me shkresën nr. 399/2 prot., datë 30.5.2025 me vlerë totale 2,998,817 lekë .

- **Subvencione:** Bashkia Poliçan për vitin nuk ka pasur subvencione për vitin 2025.
- **Kredi të marra:** Bashkia Poliçan nuk ka marrë kredi për vitin 2025.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj.,).

Në Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore", përcaktohet që:

Pika 19. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgjigjet dhe raporton në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për përgatitjen, kontrollin e brendshëm financiar publik, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit, për të gjitha funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore.
Pika 20. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore i paraqet këshillit, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit.
Pika 22. Nëpunësi autorizues publikon raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit në faqen zyrtare të njësisë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
Pika 23. Nëpunësi autorizues, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportet katër mujore dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare.

Bashkia Poliçan më datë 01.01.2025, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën **6,792,779** lekë. ***Nga kjo vlerë e përfshirë në planin e buxhetit vjetor të vitit 2025 nuk është parashikuar asnjë fond për likuidimin e këtyre detyrimeve përgjatë vitit 2025.*** Gjatë vitit 2025 është likuiduar vlera e detyrimeve të prapambetura nga shpronësimet në vlerën 193,430 lekë, Më datë 31.12.2024, vlera totale e detyrimeve të prapambetura me burim financimi nga të ardhurat e veta është në vlerën **6,599,349** lekë. Detyrimet e Bashkisë Poliçan vijnë nga kontrata të mëparshme të trashëguara edhe nga ish-komunat të cilat kanë mungesa dokumentacioni ose kompanitë të cilat kanë kryer shërbimin nuk janë më aktive.

Planifikimi i detyrimeve të prapambetura në planin e vitit buxhetor 2025 në Bashkinë Poliçan

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emërimi i detyrimit te prapambetur	Detyrimi i prapambetur progresiv deri në datën e miratimit të buxhetit vjetor 2025	Planifikimi për likuidim në planin e buxhetit 2025 i vlerës së detyrimit të prapambetur	Pagesa në fakt gjatë vitit 2025 e detyrimit të prapambetur të planifikuar në planin e buxhetit	**VKB nr.72. Datë 23.12.2024**
4864100	Detyrime të .p. per vend. Gjyqësore	4,106,389	4,106,389	0	4,106,389
4864200	D.P.per shërbime	0	0	0	0
4864300	D.P.per mirëmbajtje	0	0	0	0
4864400	D.P.per investime	0	0	0	0
4864400	D.P.per investime nga Ministritë e Infrkstruktures dhe Energjisë (Min. 06 – Linja e ujësjellësit Pronovik-Mbrakull)	1,494	1,494	0	1,494
4864400	D.P.per investime nga Ministritë e Arsimit , Sportit dhe Rinisë (Min. 11 – Rikonstruksioni i Shkollës së Mesme " M. Kondi " Poliçan)	271,466	271,466	0	271,466
4864400	D.P.per investime nga Ministritë e Linjës (specifiko FZHR etj...)	0	0	0	0
4865600	D.P. për mallra	0	0	0	0
4864902	D.P. Shpronësime	193,430	193,430	193,430	0
4864904	D.P.Transfermime të subjektit	2,220,000	2,220,000	0	2,220,000
	Totali	**6,792,779**	**6,792,779**	**193,430**	**6,599,349**

Burimi: Bashkia Poliçan

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga granti (Ministritë e linjës etj.) për vitin 2025, cilat janë objektet e këtyre investimeve, vlera e kontratës, data e kontratës, vlera e financuar, vlera e pa financuar, operatori fitues (kontraktori), arsyet e mos likuidimit të të gjithë vlerës paraqitet në aneksin nr. 6 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

<u>Monitorimi i buxhetit dhe raportimi periodik në Këshillin Bashkiak:</u>

A. ***Hartimi i raporteve katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit d*** Në zbatim të nenit 48 "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor" të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 22 dt.30.07.2018 "Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore", si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
Hartimi i raporteve katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe raportet per perdorimin e fondeve te emergjencave civile Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit/Drejtorinë e Financave Vendor:

"139. Për vitin 2025, nëpunësit autorizues të njësive të vetëqeverisjes vendore i paraqesin këshillit përkatës, sa herë që kërkohet, ***por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuara*** për çdo program buxhetor të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm. Një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për financat.
140. Raportet periodike të monitorimit gjatë vitit 2025, që njësitë e vetëqeverisjes vendore do të paraqesin në Ministrinë përgjegjëse për financat, duhet të plotësohen sipas përcaktimeve të udhëzimit standard të ministrit të financave nr. 22 datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"*.
142. Raportimet periodike dhe vjetore të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverise (SIFQ) dërgohen nga struktura përgjegjëse për Thesarin tek njësitë e vetëqeverisjes vendore në zbatim të Urdhrit të ministrit përgjegjës për financat Nr. 52, datë 06.03.2023 "Për dërgimin e raportimeve financiare periodike vjetore të sistemit të thesarit në njësitë e qeverisjes vendore".

a. ***Raportimi i zbatimit të buxhetit:*** Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Poliçan administron raportet 4, 8 dhe 12 mujore të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit për vitin 2025 si vijon:
1. Vetëvlerësimi financiar dhe detyrimet e prapambetura i 4-mujorit të parë 2025 dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr. 1241. prot datë 27/05/2025
2. Vetëvlerësimi financiar dhe detyrimet e prapambetura i 4-mujorit të dytë 2025 dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr. 2414. prot datë 29/09/2025.
3. Vetëvlerësimi financiar dhe detyrimet e prapambetura i 4-mujorit të tretë 2025 dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr. 562 prot datë 27/02/2026.

Rezulton se raportimet janë dërguar në MFE në rrugë elektronike nga adresa zyrtare institucionale dhe postare në përgjithësi brenda afatit ligjor.
Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion Raportet e Monitorimit të buxhetit të vitit 2025 janë miratuar në Këshillin Bashkiak dhe janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat.

B. ***Raportimi i stokut të detyrimeve të prapambetura.*** Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë edhe në rrugë elektronike. Raportimi në degën e thesarit është bërë sipas udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 "*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të* ***detyrimeve të prapambetura*** *të qeverisjes së përgjithshme*".
Raportimi i stokut të detyrimeve të prapambetura
1. Shkresa nr. 1241 , datë 27.05.2025

2.Shkresa nr. 2414 , dt. 29.09.2025
3. Shkresa nr. 562 , datë 29.09.2025.

C. *Raportimi në ministri mbi programi "Emergjencat Civile"* është kryer dy herë gjatë v.2025, në mospërmbushje të përcaktimeve të pikës 118 të Udhëzimit Plotësues të MF nr. 2, datë 24.01.2025 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025*", ku përcaktohet se:

118. Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat përfitojnë fonde nga programi "Emergjencat Civile" sipas pikave 18,19, 20 dhe 21 të këtij udhëzimi duhet të raportojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit/Drejtorinë e Financave Vendore në fund të çdo tremujori mbi ecurinë e realizimit të shpenzimeve faktike nëpërmjet këtyre fondeve.

Raportimi në ministri mbi programi "Emergjencat Civile"
1. Shkresa nr. 2717/1 , datë 31.10.2025
2.Shkresa nr. 2981/1, dyt. 17.12.2025.


<u>Performanca e treguesve financiarë të Bashkisë. Struktura dhe efikasiteti i shpenzimeve publike të bashkisë për të përmbushur funksionet e veta ligjore.</u>

Tabela nr .15 Analizë krahasuese e indikatorëve të të ardhurave dhe buxhetit në disa vite:

Emërtimi	2020	2023	2024	2025	Mesatarja 2020-2025
Nr. frymësh	17,167	16,833	15,789	15,635	16,356
Buxheti total	354,769,000	952,509,484	772,155,642	658,772,282	684,551,602
Buxheti për frymë (në lekë)	20,666	56,586	48,905	42,134	41,853
Te ardhurat e veta	30,632,000	135,782,362	91,353,165	145,992,909	100,940,109
Te ardhura për fryme	1784	8066	5786	9338	6171

Burimi: Bashkia Poliçan

Në trajtë grafike të dhënat mbi të ardhurat për frymë dhe buxhetin për frymë të popullsisë në juridiksionin e Bashkisë jepen në vijim:



Burimi: Bashkia Poliçan, përpunoi grupi i auditimit të KLSH-së

Të Ardhurat e veta

Ky indikator vlerëson kapacitetin e bashkisë për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme dhe diversifikuara përmes burimeve të veta. Analiza e të ardhurave të Bashkisë i kontribuon në

kuptimin e varësisë nga transfertat qendrore dhe fuqisë fiskale lokale. E drejta e njësisë së vetëqeverisjes vendore për të mbledhur të ardhura buron nga neni 11, i Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i cili përcakton burimet e të ardhurave që administrohen nga bashkia.
Të dhënat e të ardhurave të veta për bashkinë Poliçan tregojnë një trend të ndryshueshëm gjatë viteve të fundit. Në vitin 2020, të ardhurat ishin 30,6 milionë lekë dhe të ardhurat janë rritur në 135 milionë lekë në v.2023, duke shfaqur një përmirësim të indikatorit. Megjithatë, në vitin 2024, ka një rënie në 91,4 milionë lekë. Viti 2025 evidenton një nivel të ardhurash prej 145 milionë lekë, ose me një rritje mbi mesataren e periudhës prej 109 milionë lekë.
Sa më sipër, nga ana e strukturave të Bashkisë së Poliçanit është e nevojshme kryerja e një analizë e thelluar për të kuptuar arsyet e rënies së të ardhurave të veta në vite të caktuara, si p.sh. në vitin 2024, që rezulton nën mesataren e periudhës Kjo analizë mund të ndihmojë në parashikimin e stabilitetit të ardhshëm financiar të bashkisë. Ecuria e të ardhurave evidenton nevojën për planifikim të kujdesshëm dhe menaxhim të qëndrueshëm financiar.

Buxheti
Proceset e buxhetimit janë fokusuar në fazën e hartimit, miratimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor vendor, si dhe përputhshmërinë me ciklin buxhetor. Procesi i planifikimit dhe miratimit të buxhetit vendor rregullohet nga neni 21-25 i Ligjit nr. 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji nr.68/2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore" si dhe nga udhëzimet përkatëse standarde e vjetore të Ministrisë së Financave.
Të dhënat e bashkisë Poliçan tregojnë një variacion të këtij treguesi si të Buxhetit Total faktik gjatë viteve të marra në analizë, ashtu dhe buxhetit për frymë në këtë NJVQV. Në vitin 2020, që përfaqëson fillimin e periudhës së analizuar buxheti ishte 354 milionë lekë. Viti 2023 ka evidentuar një rritje të konsiderueshme, ku buxheti arrin në 952 milionë lekë, kurse në vitet 2024 dhe 2025 vihet re një rënie e treguesit të buxhetit gjithsej, me vlerën që zbriti në 658 milionë lekë në fund të vitit 2025, ose sa mesatarja e periudhës së analizuar.

2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:
- Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale e ndryshimet e tyre;
- PBA dhe program vjetor si dhe monitorimet dhe raporti i konsoliduar financiar në lidhje me planifikimin dhe të ardhurat
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifat vendore;
- Dokumentacioni i Drejtorisë të Taksave në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifat vendore;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara, akt-rakordimet me Thesarin;

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve
Për vitin 2025 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Poliçan është miratuar me VKB-në nr. 69, datë 23.12.2024 "Për miratimin e taksave dhe tarifave në Bashkinë Poliçan për vitin 2025" paraqitet në aneksin nr. 1 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 183,103 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 145,600 mijë lekë ose në masën 79.5 % me ***një diferencë mos realizimi*** në vlerën - 37,503 mijë lekë.

- Zëri fiskal "Të ardhurat nga Taksat" janë realizuar në masën **23,657** mijë lekë, ose në nivelin 59.4%, ose me mosrealizim prej lekë në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave të miratuara. Niveli i realizimi i këtij treguesi në vitin 2025 krahasuar me një vit më parë (2024) është në masë relative 64.8 %, ose -12,834 mijë lekë më pak se viti 2024.
- Zëri fiskal "Të ardhurat nga Tarifat" janë realizuar në masën **14,133** mijë lekë ose nivelin 78.9%, ose me mosrealizim prej -3,770 mijë lekë në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave të miratuara. Niveli i realizimi i këtij treguesi në vitin 2025 krahasuar me një vit më parë (2024) është në masë relative 73.2 %, ose -5,170 mijë lekë më pak se viti 2024.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura ***me tejkalim*** paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

a."Taksa mbi regjistrimin e automjeteve" është planifikuar në vlerën 5,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 5,916 mijë lekë ose realizuar në masën 118 %.

b. "Taksa e ndikimit të ndërtimeve mbi infrastrukturë" është planifikuar në vlerën 2,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,257 mijë lekë ose realizuar në masën 162%, etj.

Paraqiten me tejkalim mbi planin e miratuar disa zëra të taksave dhe tatimeve vendore. Si Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura është realizuar në nivelin 118 %. Gjobat janë realizuar në nivelin 9.7 herë mbi programim (ku nga 50 mijë lekë të programuara janë realizuar për 485,836 lekë); Të ardhurat nga ndikimi në infrastrukturë janë realizuar në nivelin 1.6 herë ndaj programimit. Renta minerare është programuar për 0 lekë dhe realizuar 11,523 lekë, por nuk ka akt-rakordim me organet tatimore e doganore. Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme**.**

Nga auditimi del se disa prej zërave fiskalë ***nuk janë realizuar*** në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave të miratuara, si më poshtë:

a."Taksa mbi tokën bujqësore" është planifikuar në vlerën 8,790 mijë lekë ndërsa arkëtmet janë në vlerën 8,515 mijë lekë ose realizuar në masën 97 %.

b. Taksa e Pasurisë, ndërtese" është planifikuar në vlerën 23,084 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 5,171 mijë lekë ose realizuar në masën ***22*** %.

c."Tarifë Pastrimi" është planifikuar në vlerën 15,522 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,054 mijë lekë ose realizuar në masën 64 %, etj.

Me mosrealizime dhe me nivele të ulëta realizimi paraqiten dhe disa zëra të të ardhurave, të tilla si tarifa e pastrimit për 64.7 % dhe me nivel mosrealizimi -5,468,905 lekë; Tatim mbi ndërtesat për 22.4% dhe me nivel mosrealizimi -17,912,429 lekë; të ardhurat nga qiratë e tokave për 75 % dhe me nivel mosrealizimi -21,610,676 lekë; Taksa mbi tokën bujqësore për 96 % dhe me nivel mosrealizimi - -275,482 lekë, etj.

Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, niveli i përgjithshëm i realizimit të tyre është 79.5 %, me një mosrealizim prej -37,502,255 lekë, nga 183,103,037 lekë të programuara.

Me mosrealizime dhe me nivele të ulëta realizimi paraqiten dhe disa zëra të të ardhurave, të tilla si tarifa e pastrimit për 64.7 % dhe me nivel mosrealizimi -5,468,905 lekë; Tatim mbi ndërtesat për 22.4% dhe me nivel mosrealizimi -17,912,429 lekë; të ardhurat nga qiratë e tokave për 75 % dhe me nivel mosrealizimi -21,610,676 lekë; Taksa mbi tokën bujqësore për 96 % dhe me nivel mosrealizimi - -275,482 lekë, etj.

Nga ana tjetër, disa zëra paraqiten me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo

përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. *Kështu,* Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura është realizuar në nivelin 118 %; Gjobat janë realizuar në nivelin 9.7 herë mbi programim (ku nga 50 mijë lekë të programuara janë realizuar për 485,836 lekë; Të ardhurat nga ndikimi në infrastrukturë janë realizuar në nivelin 1.6 herë ndaj programimit. Renta minerare është programuar për 0 lekë dhe realizuar 11,523 lekë, por nuk ka akt-rakordim me organet tatimore e doganore. Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme**.**

Nga auditimi mbi evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga Bashkia del se nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore *për secilin vit* dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë viteve paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave. *Në këtë kuadër është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Poliçan që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, invenstimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut.*

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar , neni 9, pika 3.c[4] dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 " Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5[5].

Në Bashkinë Poliçan struktura që administron dokumentacionin dhe përllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipër cituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Lidhur me ecurinë në procesin e legalizimeve për vitin 2024-2025 rezulton se, janë legalizuar 10 objekte me vlerë totale 307,765 lekë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën më poshtë:

Tabela nr. II.6.2 Taksa e ndikimit në infrastrukturë viti 2023 sipas muajve, në lekë

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Prot BASHKI	Data	Sip. totale e ndërtimit (m^2)	Vlera e taksës (lekë)	Paguar	Pa paguar

[4] Ligji nr. 95.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3.c "për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi".

[5] VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5: "Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi".

1	L.	S.	E.	932	14.04.2025	289.9	46 837.7	46 837.7	
2	Q.	K.	Th.	932	14.04.2025	113.8	18 386		18 386
3	B.	N.	B.	932	14.04.2025	118.7	19 178	19 178	
4	B.	D.	L.	932	14.04.2025	297.5	48 066		48 066
5	F.	T.	D.	932	14.04.2025	175	28 274		28 274
6	V.	Nj.	B.	943	22.04.2024	320	51 700.8		51 700.8
7	E.	Z.	B.	1202	27.05.2024	270.8	43 751.8		43 751.8
8	A.	M.	B.	1202	27.05.2024	19.6	3 166.7		3 166.7
9	F.	K.	Q.	1990	27.08.2024	231.2	37 353.8		37 353.8
10	N.	A.	K.	2632	23.10.2024	68.4	11 051		11 051
TOTALI						**1904.9**	**307 765.8**	**66 015.7**	**241 750**

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga auditimi konstatohet se, lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se për vitin 2024-2025 janë legalizuar 10 objekte me vlerë totale 307,765 lekë nga të cilat është arkëtuar vlera 60,015 lekë si dhe ka ngelur pa u arkëtuar vlera 241,750 lekë vlerë e cila përbën të ardhur të munguara për Bashkinë Poliçan.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Poliçan kryhet në programin Excel. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

Tabela nr.II.6.3: Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Poliçan 2023

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2024	150	0	4	146
		2025	146	13	4	155
2	Biznesi Madh	2024	36			36
		2025	36	0	0	36
(1+2)	Gjithsej	2024	186			182
		2025	182	13	4	191

Burimi: Bashkia Poliçan

Menaxhimi i borxhit

Subjektet Debitore

Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se gjendja e debitorëve për vitin 2025 është 82 subjekte për vlerën 9,401,757 lekë, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.II.6.4: Subjektet debitorë progresiv për vitin 2025

lekë

		Debitorët e vitit 2024		Debitorët e vitit 2025	
Nr.	**BM/BV**	**Nr.**	**VLERE**	**Nr.**	**VLERE**
1	Biznes i Madh	14	5,362,932	14	5,362,932
2	Biznes i Vogël	67	3,942,442	68	4,038,825

	TOTALI	**81**	**9,305,374**	**82**	**9,401,757**

Në menyrë te datajuar sipas zërave paraqitet si vijon:

Emërtimi njësive	Gjendja fund 31.12.2024	Arketuar 2025	Perjashtuar 2025	Shtesa gjatë vitit 2025	Gjendja në fund vitit 2025
BIZNESE					
Takse Ndertese	13,260	0	0	13,273	26,533
Takse Tabele	240	0	0	360	600
Tarife Pastrimi	28,500	0	0	64,650	93,150
Tarife Ndriçimi	2,500	0	0	5,200	7,700
Tarife Ndriçimi	2,500	0	0	5,200	7,700
Hapsire Publike	3,600	0	0	4,320	7,920
Takse Trualli	0	0	0	1380	1,380
Parkim	0	0	0	2,000	2,000
Detyrime te mbartura	7,447,183	498,185	0	**+2,305,776 sistemim nga viti 2024)**	9,254,774
Totali	**7,497,783**	**498,185**	**0**	**2,402,159**	**9,401,757**

Burimi: Bashkia Poliçan

Taksat dhe Tarifat Familjare

Në Bashkinë Poliçan familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, tarifat e pastrimit, ndriçimit dhe të gjelbërimit, Truall dhe Mirëmbajtje kanal Kullimi, rruge, paraqiten në tabelat si me poshtë:

Tabela nr. II.6.5: Familjarët debitorë progresiv për vitin 2025

Nr. debitorëve	Emërtimi njësive	Gjendja fund 31.12.2024	Arketuar 2025	Perjashtuar 2025	Shtesa gjatë vitit 2025	Gjendja në fund vitit 2025
3347	Taksa e tokës bujqësore	41,259,367	6,799,930	82,269	5,601,132	43,302,133
3347	Taksa pastrimi,gjelbrimi, ndriçimi	1,157,531	401,700	23,000	616,200	1,874,080
3347	Taks ndertese (objekt banimi)	11,687,443	1,996,788	139474	1,923,643	12,572,321
3347	Takse trualli	130,831	57,750	750	47,376	23,186
	Total detyrimi familiar	**54,235,172**	**9,256,168**	**245,493**	**8,188,351**	**57,771,720**

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se: Në fund të vitit 2024 gjendja e debitorëve të biznesit është në vlerën 9,305,374 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2025 për subjektet fizik/juridik është 9,401,757 lekë, me një rritje në vlerën 96,383 lekë vlerë kjo që sjell të ardhura të pa-arkëtuara nga planifikimi në buxhetin e Bashkisë Poliçan. Gjendja e debitorëve e familjarëve me 31.12.2024 është në vlerën 54,235,172 lekë ndërsa progresiv deri në 31.12.2025 është 57,771,720 lekë, me një rritje në vlerën 3,536,548 lekë vlerë kjo që sjell të ardhura të pa-arkëtuara në buxhetin e Bashkisë Poliçan.

Në total borxhi tatimor në Bashkinë Poliçan rezulton në vlerë 67,173,447 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Poliçan. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 4 pika 1 dhe 2, Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 89, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë", pika 89, i ndryshuar. Pas kalimit të afatit për pagimin në mënyrë vullnetare të këtyre detyrimeve, Drejtoria e Tatimeve Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave .

nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për subjektet debitore për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar, shkresa drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim e llogarive bankare të debitorëve ndaj bashkisë si dhe në asnjë rast nuk është bërë kallëzim penal bazuar në nenin 181, "*Mos pagimi i taksave dhe tatimeve*", të Kodit Penal të RSH,

miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar neni 9 "*Të drejtat dhe përgjegjësitë*". Neni 35, "*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*", me Ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

➢ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Referuar auditimit të mëparshëm rezulton se në territorin e Bashkisë Poliçan për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë janë 4 subjekte. Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për vitet 2025 të cilat paraqiten si vijon:

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	Xh. O.	L.....D		30.04.2026	1,000,000	1,000,000	
2	R. SH.P.K	K.....I	30.04.2021	30.04.2026	1,000,000	1,000,000	
3	L.	L.....D	01.08.2022	31.07.2027	1,000,000	1,000,000	
4	Q. O.	M.....C	16.10.2023	15.10.2028	1,000,000	1,000,000	
Shuma							

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se subjektet e sipercituara janë të pajisur me autorizim, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me Ligjin nr. 71.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4 "*Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*". Neni 20-Autorizimet pika 2. "*Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11*[6]*, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje*".

Konkluzion: të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë janë:

◊ Nga taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet në vlerën 241,750 lekë.

◊ Nga familjet për taksat dhe tarifat e tokës, ndërtesës, pastrimit, ndriçimit, etj., në vlerën 67,173,447 lekë.

◊ Nga bizneset debitore, në vlerën **9,401,757** lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. *Znj. A.C., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave, Tarifave Vendore;*
2. *Z. K. K., me detyrë Spcialist i Tatimeve dhe Licensimit të Detyrimeve Fiskale në NJ.A.Vërtop*
3. *Znj. S. Q., me detyrë Spcialist i Tatimeve dhe Licensimit të Detyrimeve Fiskale në NJ.A.Tërpan*

[6]Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, neni 11 Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë".

3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.
3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Hartimi i pasqyrave financiare:
Për vitin 2025 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare si më poshtë:
- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar *(bilanci);*
- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve *(Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);*
- Formati 3 - Pasqyra e flukseve monetare; *(Cash Flow).*
- Formati 4 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5 - Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
- Formati 6 - Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7 - Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto; Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata *(kosto historike).*Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata *(vlera neto).*
- Formati 8 - Pasqyra statistikore e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:
Pasqyrat financiare (PF) të Bashkisë Poliçan për vitin ushtrimor 2025 janë të nënshkruara nga z. A. Z. - Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. F. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.
PF janë depozituar pranë Degës së Thesarit Skrapar me shkresën nr. 777 prot., datë 24.03.2026, dhe konfirmuar (nënshkruar e vulosur) nga kjo Degë me datën 24.03.2026. Pasqyrat Financiare të gjeneruara nga SIFQ janë konfrimuar zyrtarisht nga Dega e Thesarit Skrapar me dt 14.4.2026.
Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore janë të shoqëruara me inventarin e llogarive, me situacionin dhe aktet e rakordimit, të hartuara mbi realizimin e buxhetit vjetor, dokumente këto të firmosura/konfirmuara nga Dega e Thesarit Skrapar.
Sa më sipër, nga auditimi i në lidhje me përgatitjen, paraqitjen dhe depozitimin të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore për vitin kalendarik të mbyllur më 31 dhjetor 2025, evidentohet se janë zbatuar afatet e detyrueshme nga ana e institucionit brenda 31 marsit të vitit pasardhës. *Sa më sipër,* vepruar në përputhje me kërkesat e Kreut V "Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore", Paragrafi nr.118, të UMF nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar.

Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit.

Nga auditimi rezultoi se, të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara me nr. 777, datë 24.03.2026 janë të njëjta me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ, në përputhje me përcaktimet e Kreut V "Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera vjetore të qeverisjes së përgjithshme", pika 10 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.127, datë 19.12.2025 "Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025":

Të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara të jenë të njëjta me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ.

Ditarët e mbajtur për regjistrimin e veprimeve kontabile: Nga verifikimi i pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore dhe dokumentacionit mbështetës rezulton se, janë mbajtur ditarët për regjistrimin e veprimeve kontabile dhe centralizatori për veprimet përmbledhëse. Llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, kuadrojnë si shumë totale (Aktivet gjithsej = Pasivet + Fondet neto); llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike, trajtuar më hollësisht në vijim. Veprimet kontabile janë azhurnuar periodikisht nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, janë pasqyruar veprimet në ditarë, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi.
Sa më sipër, kanë gjetur zbatim përcaktimet e Kreut I, paragrafi 2.2.6, të UMF nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar:

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues, të cilët dallohen në:
- *Dokumente bazë justifikuese (faturë blerje/ shitjeje, fletëhyrje/dalje, mandatarkëtim/pagesë), të prodhuara manualisht ose nëpërmjet programeve informatike dhe shërbejnë për kryerjen e regjistrimeve fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik në librat e kontabilitetit.*
- *Urdhërshpenzimi/urdhërpagesa që përdoren në marrëdhëniet e njësive të qeverisjes së përgjithshme me degën përkatëse të thesarit, për paraqitjen e kërkesave për kryerjen e një shpenzimi apo ekzekutimin e një pagese, nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).*
- *Libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.*
- *Dokumente të tjera kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme.*

Gjatë auditimit të kryer për periudhën objekt shqyrtimi, konstatohet se mbajtja e llogarive kontabile dhe nxjerrja e bilancit për vitin 2025, është realizuar në mënyrë manuale, duke përdorur programin *"Microsoft Excel".* Ky program i pa certifikuar për mbajtjen e regjistrave financiare, nuk mund të konsiderohet si *"bartës informatik*", sipas përkufizimit të dhënë nga dispozitat e akteve ligjore e nënligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
"Bartës informatik" është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Sipas Kreut 2.2 "Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik", pika nr. 6 të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 dhe UMF nr. 30, dt. 27.12.2011, "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", njësitë e qeverisjes vendore kanë për detyrë të evidentojnë në mënyrë kronologjike dhe të dokumentuar çdo transaksion ekonomik. *Çdo transaksion duhet të mbështetet në bartësit e informacionit kontabël përkatës* (mandate, fletë-hyrje/dalje, ditarë, libra kontabël etj.), në përputhje me sistemin e llogarive buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave.
Në këtë kuadër, Bashkia Poliçan duhet të ndërmarrë masa për përmirësimin e sistemit të kontabilitetit dhe implementimit të programeve financiare, *që garantojnë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.*

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2025, nga verifikimi dhe testimi i transaksioneve për çdo muaj, të ditarit kontabël të bankës për shpenzimet sipas natyrës (Klasa 6 dhe Klasa 2) me akt-rakordimin e thesarit mbi bazën e dokumentit të nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj, për shumat në çdo llogari dhe në totalin mujor e vjetor, nuk konstatohen diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës së shpenzimeve, ku janë regjistruar autorizimet buxhetore (çeljet) dhe destinacionet e përdorimit të fondeve sipas llojit të shpenzimeve dhe klasave të llogarive.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit është raportuar Degës së Thesarit, si vijon:
- Situacioni i Shpenzimeve Vjetore *(me burim nga granti i pakushtëzuar dhe specifik, nga të ardhurat dhe nga granti i kushtëzuar)* për vitin 2025, është hartuar dhe ngarkuar në sistem nga ana e Bashkisë Poliçan. Ky situacion është nënshkruar rregullisht nga NA dhe NZ i njësisë shpenzuese me datë 24.03.2026 dhe me dt. 24.03.2026 nënshkruar në mënyrë elektronike nga nëpunësi i Degës së Thesarit z.E. L.
- Me datën 12.01.2026 është mbajtur akti i rakordimit nr.12, midis përfaqësuesve të Bashkisë Poliçan dhe Degës së Thesarit Skrapar, mbi rakordimin e nivelit të realizimit të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore të periudhës Janar-Dhjetor 2025, dokument që është nënshkruar rregullisht nga NA e NZ, ku janë evidentuar dhe shumat e të ardhurave që trashëgohen nga viti 2025 në vitin 2026 në P.L.TH. Sa më sipër, nga ana e Bashkisë Poliçan është hartuar Kërkesa nr.1, (me nr. 707 prot.), datë 11.03.2026 *"Për çelje fondi nga të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2025"*, ku janë evidentuar të ardhurat e trashëguara nga viti 2025, limiti i vitit 2026, tërheqjet dhe diferencat, krahas kërkesës së institucionit. Kjo kërkesë është miratuar me nënshkrimin elektronikisht nga Nëpunësi i Thesarit, z.E. L. me dt. 17.03.2026.
- Me datën 28.01.2026 është mbajtur akti i rakordimit nr.1, midis përfaqësuesve të Bashkisë Poliçan dhe Degës së Thesarit Skrapar, mbi rakordimin e mjeteve në ruajtje (llogaria 4662104 dhe llog.4665100, në trajtë progresive për periudhën Janar-Dhjetor 2025), nënshkruar rregullisht nga NA dhe NZ, regjistruesi z.E. B. dhe Nëpunësi i Degës së Thesarit Z.E. L. (dt 26.03.2026).

Sa më sipër, rezulton se, për periudhën e audituar, në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat e Bashkisë Poliçan, janë mbajtur akt rakordimet periodike e vjetore, që janë kundër-firmuar rregullisht për të dhënat nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. *Për sa sipër*, është vepruar në përputhje me përcaktimet e:

- Ligjit nr.9936, date 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" i ndryshuar, neni 3, pika 4 dhe 6;
- Paragrafit nr.88 dhe 221, të Kreut IV, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, që përcakton se:

88. Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore /progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme. Formati i raportit gjenerohet drejtpërdrejt nga SIFQ.

221.Nëpunësi zbatues rakordon çdo muaj me strukturën përgjegjëse të thesarit në degë për të ardhurat progresive që ka realizuar njësia shpenzuese e qeverisjes së përgjithshme.

- Paragrafit nr.12, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.5, datë 21.2.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme", që përcakton se:

Sipas procedurave të sistemit të thesarit, ato rakordojnë të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave, shpenzimeve dhe pagesave, për vitin që raportohet (sipas formatit të gjeneruar nga SIFQ). Rakordimi me sistemin e thesarit është i detyrueshëm për të dy palët.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

<u>Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:</u>

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat, etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Poliçan për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2025, deri më datën 31.12.2025.** Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve të transaksioneve, proceduara anlitike dhe teste thelbësore, ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2025 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2024.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuandrojnë me ato analitike, trajtuar hollësisht në vijim. *Llogaritja e nivelit të materialitetit për vitin 2025: Treguesi i precizionit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet vjetore për bashkinë është* **10,345,476 lekë**.

Nga procesi i auditimit dhe verifikimi i vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2025, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e tyre, treguesit e aktiveve dhe aktiveve neto paraqiten si më poshtë:

Lekë

	31.12.2025	**31.12.2024**
Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	**1,044,928,881**	**1,602,743,549**
Aktivet	1,251,740,711	1,830,356,213
Pasivet	206,811,830	227,612,664

Lekë

	31.12.2025	**31.12.2024**
Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.	**305,181,205**	**259,041,531**
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues"	26,162,067	26,343,509
Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra"	185,553,505	173,431,904
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre"	93,465,633	59,266,118

Burimi: Bashkia Poliçan, PFV 2025.

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	**Emërtimi i llogarive**	**31.12.2025**	**31.12.2024**	**Diferenca/Ndryshimi 2025-2024**
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	93,465,633	59,266,118	34,199,515
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		93,465,633	59,266,118	+34,199,515

- **Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar"** paraqitet më datë 01.01.2025, në vlerën 59,266,118 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 93,465,633 lekë.

Nga të dhënat analitike sipas pasqyrave të pozicionit financiare të njësisë shpenzuese Bashkia Poliçan rezulton se llogaria 520 "Disponibilitete në Thesar" në fund të vitit 2025 është pasqyruar në vlerën 93,465,633 lekë që është shuma e gjendjeve analitike të kësaj llogarie. *Nga auditimi i të dhënave sipas akt rakordimeve shkresore me thesarin për të ardhurat e trashëguara u konstatua se nuk ka mospërputhje midis të dhënave për të ardhurat e trashëguara nga viti 2025 me llogarinë 520 "Disponibilitete në Thesar",* me vlerën e tyre të regjistruar në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2025. Akt rakordimi i nënshkruar nga NA dhe ZN dhe Përgj. Degës së Thesarit Skrapar z.D. B. për të ardhurat e vitit 2025 të disponueshme në SIFQ dhe që trashëgohen në vitin 2026 është 93,465,633 lekë.

1. Konstatim:

Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 93,465,633 lekë dhe të llogarisë 466

"Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 21,258,325 lekë. Sipas informacionit kontabël të verifikuar nga auditimi, llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" është nënvlerësuar në vlerën 21,258,325 lekë.

Më konkretisht,

✓ ***Llogaria 85, "Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur"***, është paraqitur në rubrikën C të Pasqyrës së Performancës Financiare 2025 (F2) që në fund të vitit 2025 është 93,465,633 lekë, e barabartë me zërin "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85)", që evidentohet në rubrikën C, të Aktiveve neto/ Fondeve neto në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1).

85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	93,465,633	59,266,118

✓ ***Totali i mjeteve në ruajtje***, sipas akt rakordimit nr.1, datë 16.01.2026 të mbajtur me Degën e Thesarit Skrapar, është 21,256,180 lekë dhe nuk përputhet me shumat e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në pasqyrën F1 të Bilancit Kontabël, që është 21,258,325 lekë, për një diferencë prej 2,145 lekë.

		Viti 2025	Viti 2024
520	Disponibilitete në Thesar	**93,465,633**	**59,266,118**

466	Kreditore për mjete në ruajtje	21,258,325	54,173,860
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	93,465,633	59,266,118
	Shuma (llog 466 + 85):	**114,723,958**	**113,439,978**

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave të pozicionit financiar të kësaj njësie shpenzuese u konstatua që totali i llogarisë (520) "Disponibilitete në thesar" sipas Pasqyrave të Llogaridhënies Vjetore në fund të vitit 2025 është në shumën 93,465,633 lekë.

Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" duhet të ketë kundër parti llogarinë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" e cila paraqitet në shumën 21,258,325 lekë dhe llogarinë. 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës" e cila paraqitet në shumën 93,465,633 lekë.

Për sa më sipër, Llogaria (520) "Disponibilitete në thesar" nuk përputhet me shumat e llogarive 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës" dhe llogarinë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" për vlerën prej 21,258,325 lekë (114,723,958 lekë - 93,465,633 lekë). Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa "dh", si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, paragrafët 49-50, ku përcaktohet që:

Paragrafi 49. Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Paragrafi 50. Tepricat e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitët llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

2. Llogaritë e klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
31	Materiale	10,869,940	11,570,764	(700,824)
32	Inventar i imët	15,292,127	14,772,744	519,383
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0

36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		**26,162,067**	**26,343,508**	**(181,441)**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

Në klasën 3 "Teprica e inventarit qarkullues" të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 26,162,067 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 26,343,508 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -181,441 lekë, e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" dhe paraqitet në të njëjtën vlerë në Formatin F2 "Pasqyra e Performancës Financiare", (grupi VIII, rreshti 120), në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 4.1:

Llogaria 63, "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Kjo kategori ka veçori për sektorin publik, se nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Funksionimi kontabël është si më poshtë: a) Kur blihen, bëhen hyrje materialet: - Debitohet klasa 3, "Gjendje inventari qarkullues"; - Kreditohet 63, "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". b) Kur bëhen dalje materialet: - Debitohet 63, "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"; - Kreditohet klasa 3, "Gjendje inventari qarkullues"

Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:
- Teprica e llogarisë 31 "Materiale" paraqitet paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 10,869,940 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 11,570,764 lekë, me një diferencë për vitin ushtrimor prej - 700,824 lekë, e cila përfaqëson pakësimin e gjendjes së mallrave në fund të vitit 2025.
- Teprica e llogarisë 32 "Inventari i imët" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 15,292,127 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 14,772,744 lekë me një diferencë në shtesë për vitin ushtrimor prej 519,383 lekë, e cila përfaqëson rritjen te inventarit te imët për vitin 2025.

- **Llogaria 31 "Materiale"**, ka vlerën 10,869,940 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2025	11,570,765
Shtesa (D)	17,148,217
Pakësime (K)	17,849,042
Gjendja në 31.12.2025	**10,869,940**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

- **Llogaria 32 "Inventarë i imët"**, ka vlerën 15,292,127 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2025	14,772,744
Shtesa (D)	4,949,332
Pakësime (K)	4,429,949
Gjendja në 31.12.2025	**15,292,127**

Gjendja e llogarive të mësipërme materiale është e kuadruar me tepricëne tabelave të inventarizimit fizik të pasurisë. Për kryerjen procedurave të inventarizimit të pasurisë është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. *Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*".

3. Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	162,985,266	135,702,644	27,282,622
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	22,568,239	37,729,260	(15,161,021)
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit		0	
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)		0	
Totali		**185,553,505**	**173,431,904**	**12,121,601**
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime		0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin		0	
477	Diferenca konvertimi aktive		0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime		0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme		0	
Totali		**0**	**0**	**0**

Klasa 4 "Llogari të arkëtueshme" paraqiten në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 185,553,505 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 173,431,904 lekë, ku rezulton rritja e tepricës duke e krahasuar me vitin paraardhës për 12,121,601 lekë, i cili ka ardhur si rezultat i shtimit të detyrimeve te debitorëve të ndryshëm dhe pakësimeve të llogarisë Operacione me shtetin (Të drejta).

- Gjendja e **llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm"** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2025, më datën 01.01.2025 paraqitet në vlerën 135,702,644 lekë, është shtuar gjatë vitit në vlerën 97,724,568 lekë, pakësuar nga shlyerjet e detyrimeve për 70,441,946 lekë, ndërsa gjendja më 31.12.2025 paraqitet në vlerën 162,985,266 lekë. Në këtë llogari janë evidentuar detyrimet e personave dhe subjekteve të ndryshme ndaj Bashkisë, që kanë lindur sipas raporteve të auditimit të KLSH-së, të NJAB të Prefekturës gjatë periudhave të ndryshme *(duke filluar nga detyrimet e regjistruara për aktkontrollin e datës 06.10.1998 deri në atë të vitit 2022)*, si dhe detyrimet për taksa dhe tarifa vendore të papaguara deri në 31.12.2025.

Analiza e detajuar e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", më datë 31.12.2025 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2025	**135,702,644**
Shtesa (D)	97,724,568
Pakësime (K)	70,441,946
Gjendja në 31.12.2025	**162,985,266**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

2.Konstatim:

a.- Evidentohet një nivel i lartë detyrimeve debitore në Bashkinë Poliçan në fund të vitit 2025, që kanë ardhur në rritje prej + 27,282,622 lekë, ose + 20.1 % më shumë se fundi i vitit të mëparshëm, ku shtesat e llogarisë së debitorëve janë 97,724,568 lekë dhe likuidimet/ shlyerjet për 70,441,946 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet një nivel i lartë i detyrimeve të mbartura e të trashëguara për taksat e tokës bujqësore, të biznesit, të ndërtesave etj., nga vitet e mëparshme (2011-2024), për të cilat nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit administrohen listat e dërguara nga Zyra e Tatim Taksave të Bashkisë dhe Njësive Administrative Vertop dhe Terpan. Rezulton se për dy Njësitë Administrative Terpan dhe Vërtop, detyrimet debitore për mos likuidimin e taksës së tokës dhe të ndërtesës për periudhën 2011-2024 zënë 87 % të detyrimeve gjithsej për këtë kategori.

Specialistët e financës sqarojnë se kjo shumë vjen nga pasqyrat financiare të ish Komunave që nga viti 2015. Në tabelën e mëposhtme jepet dinamika e këtyre debitorëve për periudhën 2011-2025, në lekë:

NJ.A	Periudha 2011-2024	Viti 2025	Gjithsej
Vërtop	33,970,481	4,238,785	38,209,266
Terpan	12,970,929	2,762,176	14,034,176
Shuma në lekë	46,941,410	7,000,961	53,942,371
Pesha specifike e detyrimeve debitore në %	87%	13%	100%

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Ky problem është trajtuar edhe në raportet e mëparshëm të auditimit të KLSH-së, ku është rekomanduar për gjetjen e origjinës nga ka lindur detyrimi, arkëtimin e këtyre vlerave, deri në ngritjen e padive gjyqësore, por mungojnë veprimet korrigjuese për sa më sipër.
Sa më sipër, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar;

g) garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta.

neni 42 pika 1-5, të ligjit nr.67/2017, datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar;

1. Të ardhurat e miratuara në vendimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për buxhetin vjetor përbëjnë kufirin minimal për t'u arkëtuar gjatë vitit buxhetor.
2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.
4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vlerësime sistematike për të identifikuar risqet dhe marrin masa për të shmangur evazionin fiskal.
5. Niveli, kohëzgjatja dhe struktura e detyrimeve tatimore të evidentuara e të paarkëtuara në kohë evidentohen dhe raportohen si pjesë e raporteve periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Ligjin nr.9632, datë 30,10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", Kapitulli II, pika 6: *"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues…".*

Struktura e detyrimeve debitore më datën 31.12.2025 përbëhet nga këto detyrime për arkëtim:
Në këtë llogari janë regjistruar detyrimet e lindura nga 12 (dymbëdhjetë) raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Prefekturës nga viti 1998 e në vijim , por të pa arkëtuara, si vijon:
✓ në 12 raste detyrimet për shumën 504,783 lekë, janë kontabilizuar efektet e përfundimeve të Akt Kontrollit të Prefekturës në datën 06.10.1998, për auditimin e kryer dhe kjo shumë rezulton e pa arkëtuar.
✓ në 4 (katër) raste detyrimet për shumën 16,636 lekë, janë kontabilizuar efektet e përfundimeve të Akt Kontrollit të Prefekturës në datën 03.08.2005, për auditimin e kryer dhe kjo shumë rezulton e pa arkëtuar.
✓ në 1 rast detyrimet për shumën 382,262 lekë, është kontabilizuar efekti i përfundimeve të Akt Kontrollit të Prefekturës në datën 31.12.2009, për auditimin e kryer dhe nuk rezulton asnjë shumë e arkëtuar. dhe kjo shumë rezulton e pa arkëtuar.
✓ në 8 raste detyrimet për shumën 1,098,812 lekë, janë kontabilizuar efektet e përfundieve të auditimeve të KLSH-së, për auditimin e kryer në vitin 2005, shkresa nr.916/25 dhe kjo shumë rezulton e pa arkëtuar.

✓ në 3 (tre) raste detyrimet për shumën 1,381,096 lekë, janë kontabilizuar efektet e përfundimeve të auditimit, sipas shkresës nr.194/7, pa vit për auditimin e dhe kjo shumë rezulton e pa arkëtuar.
✓ në 3 (tre) raste detyrimet për shumën 10,028 lekë, janë kontabilizuar efektet e përfundimeve të auditimeve të Prefekturës, për auditimin e kryer në vitin 2010 dhe pa asnjë shumë të arkëtuar.
✓ në 3 (tre) raste detyrimet për shumën 47,620 lekë, janë kontabilizuar efektet e përfundimeve të auditimeve të KLSH-së, për auditimin e kryer në datën 30.06.2012 dhe kjo shumë rezulton e pa arkëtuar.
✓ në 1 rast detyrimet për shumën 80,230 lekë, janë kontabilizuar efektet e përfundimeve të auditimeve të AB Prefekturës për auditimin e kryer në dt 31.12.2009 dhe kjo shumë rezulton e pa arkëtuar.
✓ në 32 raste detyrimet për shumën 3,173,775 lekë, janë kontabilizuar efektet e përfundimeve të auditimeve të KLSH-së, për auditimin e kryer dhe shkresës nr. 488/12,dt. 02.08.2018, dhe kjo shumë rezulton e pa arkëtuar.
✓ në 6 (gjashtë) raste detyrimet për shumën 3,718,723 lekë, janë kontabilizuar efektet e përfundimeve të auditimeve të KLSH-së, për auditimin e kryer në vitin 2022 dhe kjo shumë rezulton e pa arkëtuar.
✓ në 2 (dy) raste detyrimet për shumën 783,295 lekë janë kontabilizuar efektet e përfundimeve të auditimeve të KLSH-së, për auditimin e dhe dhe kjo shumë rezulton e pa arkëtuar.
✓ në 8 (tetë) raste detyrimet për taksat e ndryshme (taksa e biznesit, të tokës, të pullës, taksa e therjes, taksat e parkimit etj.), në shumën 149,373,927 lekë, me një nivel të ulët arkëtimi.

b. Nga ana e Bashkisë së Poliçanit nuk janë kryer procedurat e kërkimit të detyrimeve në rrugë administrative e gjyqësore, por llogaria "Debitorët e ndryshëm" (llog. 468) në fund të vitit 2025 paraqitet në shumën prej 162,985,266 lekë. Për periudhën 1-vjeçare (1.1.2025 deri më 31.12.2025), niveli i arkëtimit të debitorëve është 70,441,946 lekë, ose vetëm 52 % e totalit të detyrimeve të debitorëve gjendje me datën 01.01.2025 ose rreth 30.1 % e totalit të debitorëve të mbartur dhe shtuar gjatë vitit.

Teprica e llog. më dt 1.1.2024	Shtesat gjatë vitit 2025	Pakësime gjatë viti 2025	Teprica më datë 31.12.2025
135,702,644	97,724,568	70,441,946	162,985,266

Detyrimet në vlera më të larta analizohen sipas subjekteve ekonomike në vijim: (në lekë)

"I.M.T.V."	1,300,000
"R." shpk	1,626,625
"B." shpk	1,324,606
"F. " shpk	409,388
"L. S."	995,000
"R. K."	785,733
"I. T."	496,916
Firma "I."	542,000

Për debitorët e lidhur me raportet e auditimit të Prefekturës dhe KLSH-së nuk është proceduar duke depozituar padi dhe kërkuar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e detyrimit, ndaj këto detyrime rezultojnë të paarkëtushme, pasi bazuar në periudhën e krijimit të detyrimeve, arkëtimi i tyre ka humbur fuqinë ligjore. Kjo, bazuar në nenin 203, pika 1, të Kodit të Punës së R.SH *"Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet",* si dhe neni 115 i Kodit Civil "*Parashkruhen brenda afateve prej:.... dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë"*. Në lidhje me detyrimet e debitorëve, të krijuar që nga viti 1998 dhe paraqitur në raportet e NJAB së Prefekturës dhe të KLSH-së), bazuar në Kodin Civil, neni 114 "Afatet e parashkrimit" ku shprehet se "*Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë"* , për këto detyrime debitore ekziston rreziku i parashkrimit të tyre.
Mosarkëtimi në afat i debitorëve sjell riskun e parashkrimit për arkëtimin e të drejtave dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit dhe veprime në jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë "i*

ndryshuar; nenet 8, 9, 10, 11, 12 dhe 27 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar e Kontrollit, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 26.01.2024 të Ministrit të Financave, (Kreu II, paragrafët 2.4.4 dhe 2.4.6 dhe aneksi nr. 6); Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "*Për nëpunësin zbatues të të gjitha niveleve",* Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 3.12.2024 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike",* neni 7, pika 1/d.

c. Në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" është pasqyruar detyrimi sipas raporteve të KLSH-së për debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukture për vlerën 839,943 lekë, por nuk janë përfshirë vlerat e gjobave të IMTV-së për ndërtime pa leje gjatë periudhës 2024 dhe 2025 që kanë 11 subjekte, në vlerën **15,119,656 lekë.**
Nga auditimi rezulton se tek llog 486 "Debitorë të ndryshëm" është përfshirë vetëm vlera prej 1,300 mijë lekë, për I.M.T.V., sa kërkuar nga KLSH me anë të shkresës nr. 874/13, prot, dt.23.05.2022.
Konkretisht, rezultojnë të ardhura të munguara nga mos kontabilizimi i gjobave të vendosura nga Inspektorati Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë, të lindura gjatë vitit 2024 dhe 2025 në vlerën 15,119,656,5 lekë, duke nënvlerësuar llogarinë 486 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogarinë 7115, e cila më dt 31.12.2025 pasqyrohet për 485,836 lekë, *(trajtuar më hollësisht në trajtimin e të ardhurave të klasës së 7-të në vijim):*

Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	485,836

d. Nuk është pasqyruar në ditarët e kontabilitetit dhe në centralizator ***llogaria 470 "Llogari në pritje - të ardhura për t'u marrë"*** që shërben si kundërparti e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.
Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 7, të Udhëzimit të MF nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"", ku përcaktohet që:

Pika 7. Në rubrikën 2.3 "Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik", paragrafi 21, shtohet pika c me këtë përmbajtje:
c) Për njohjen (me konstatimin) e të drejtave për t'u arkëtuar bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:
Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që njohin të ardhurat në kontabilitet sipas paragrafit 16 (e) administrojnë të drejtat për tu arkëtuar dhe debitorët e njësisë si më poshtë:
✓ ***Për konstatimin paraprak të të drejtave për t'u arkëtuar*** debitohen llogaritë përkatëse të klasës 4 (411/468) "Debitorë të ndryshëm" dhe Kreditohet llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" në analiza shtatëshifrore sipas tipologjisë së të drejtave për tu arkëtuar.
✓***Për arkëtimin e të drejtave*****,** në të njëjtën kohë me veprimet sipas pikës 16 (e) dhe 22, kryhet veprimi i kundërt: debitohet llogaria 470 dhe kreditohet llogaria përkatëse e të drejtave e debituar më parë (411/468).

Pika 16/e: Për të ardhurat e shfrytëzimit, në momentin e njohjes, bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë: Debitohet llogaria përkatëse financiare (klasa 5); dhe Kreditohet llogaria përkatëse e të ardhurave (klasa 7).
Pika 22: Llogaritë përkatëse financiare në klasën 5 funksionojnë si më poshtë vijon: Debitohet llogaria financiare përkatëse; Kreditohet llogaria përkatëse e të ardhurave (klasa 7), "Të ardhurat sipas natyrës ekonomike

Pasqyrimi i llogarive 4342 *"Operacion me shtetin (të drejta)"* dhe 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"* në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore:

- Gjendja e llogarisë ***4342 "Operacion me shtetin (të drejta)***" *(financim i pritshëm nga buxheti),* sipas PFV të depozituara në Degën e Thesarit, paraqitet në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar më datën 01.01.2025 në vlerën 37,729,260 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 22,568,239 lekë, ose me një pakësim në vlerën 15,161,021 lekë ndaj vitit të mëparshëm.

Lekë

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)	
Çelje e vitit 2025	**37,729,260**
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	15,166,421
Gjendja në 31.12.2025	**22,562,839**

Lekë

Operacion me shtetin (të drejta)	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Furnitore e llogari te lidhura me to	18,218,037	309,445,604	325,288,386	2,375,255
Detyrime ndaj personelit	13,950,458	256,806,814	256,670,134	14,087,138
Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	942,141	11,841,352	11,445,527	1,337,966
Sigurime Shoqerore	4,062,908	48,938,132	48,812,549	4,188,491
Sigurime Shendetsore	555,716	6,721,679	6,704,906	572,489
Kreditorë të ndryshëm	0	6,900	0	6,900
Totali	**37,729,260**	**633,760,481**	**648,921,502**	**22,568,239**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

Referuar Planit Kontabël dhe udhëzimeve të MF, kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401, 421, 431, 435, 436, 437 dhe 467 dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit të bashkisë për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara *(grantet korrente a kapitale që merren nga buxheti i shtetit).*

Sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018, llogaria 4342, *"Operacione me shtetin (të drejta)"* është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për ***shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara*** (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla janë zëra si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo detyrimet për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

- Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, "Shpenzime sipas natyrës" dhe Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).

- Në fund të periudhës bëhet veprimi:

Debitohet llogaria 4342, "Operacione me shtetin (të drejta)", Kreditohet llogaria 7206, "Financim i pritshëm nga buxheti".

Kjo llogari e analizuar përbëhet nga detyrimet e papaguara në fund të vitit 2025 për këtë njësi shpenzuese. Konkretisht, detyrimet përbëhen nga:

Nr llog	Emërtimi	**2025**	**2024**
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	2,375,255.0	18,218,037
42	Detyrime ndaj personelit	14,087,138.0	13,950,458
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,337,967.0	942,141
435	Sigurime Shoqërore	4,188,490.0	4,062,908
436	Sigurime Shëndetësore	572,489.0	555,716
466	Kreditore për mjete ne ruajtje	21,258,325.00	54,173,860
467	Kreditore te ndryshëm	6,900.00	6,900

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, përmbledhësja e llogarive 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe llog e klasës 4-rt, janë në vlerën 22,568,239 lekë.;

- Llog 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën 2,375,255 lekë
- Llog 42 "Detyrime nd. aj personelit" në vlerën 14,087,138 lekë;
- Llog 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taks në vlerën 1,337,967 lekë;
- 435 "Sigurime shoqërore" në vlerën 4,188,490 lekë;
- Llog.436 "Sigurime shëndetësore" në vlerën 572,489 lekë;
- Llog.437,438 "Organizma të tjerë shtetërore" në vlerë 0 lekë dhe
- Llog.467 "Kreditorë të ndryshëm" në vlerën 6,900 lekë

Shuma 22,568,239 lekë

Sa më sipër, llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" në vlerën 22,568,239 lekë, ***kuadron*** me shumën e vlerës së llogarive të detyrimeve për detyrimet e konstatuara dhe të rezultuara në fund të vitit prej 22,568,239 lekë,

4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	22,568,239	37,729,260-

si dhe ***kuadron me*** llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit", në Pasqyrën F2 të Poziciont Financiar të kësaj Bashkie.

7206	Financim I pritshe nga buxheti	22,568,239	37,729,260

Sa më sipër, ka një pozicionim të drejtë të llogarisë sipas udhëzimeve të miratuara mbi kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në fund të vitit 2025 të kësaj llogarie, në përputhje me trajtimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, paragrafi 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)" si dhe paragrafi "Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin", si dhe Aneksi 1.

***

Referuar përcaktimeve të Kreut III, nënkreu 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)", pka 8/l, të UMF nr.8, datë 09.03.2018, Llogaria ***4341, "Operacione me shtetin (detyrime)"*** është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit ***<u>për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme</u>***.

Konkretisht, trajtimi kontabël është si më poshtë: Debitohet llogaria 411/468, klientë apo debitorë të ndryshëm për konstatimin e një të ardhure (pavarësisht raportit të pjesëmarrjes (buxhet apo institucion) dhe Kreditohen llogaritë respektive të klasës 7 për të ardhurën e konstatuar.

E ardhura që në fund të periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi: Debitohet llogaria 8424, "Transferime buxheti për debitorë e të ngjashëm", Kreditohet llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)".

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)	
Çelje e vitit 2025	135,702,644
Shtesa (K)	97,724,568
Pakësime (D)	70,441,946
Gjendja në 31.12.2025	**162,985,266**

Lekë

Operacion me shtetin (të drejta)	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Debitorë të ndryshëm	135,704,644	97,724,568	70,441,946	162,985,266
Totali	**135,704,644**	**97,724,568**	**70,441,946**	**162,985,266**

f

Teprica e llogarisë 4341 "Operacion me shtetin (detyrime)" sipas PFV të depozituara në Degën e Thesarit për vitin 2025, paraqitet në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar në fund të v.2025 në shumën 162,985,266 lekë (rreshti 83 në pasiv të bilancit, grupi i Pasiveve Afatshkurtëra). Më datën 01.01.2025 në vlerën 135,702,644 lekë, ose me një shtim në vlerën 27,282,622 lekë ndaj vitit të mëparshëm.

<u>4341</u>	<u>Operacione me shtetin (detyrime)</u>	<u>162,985,266</u>	135,702,644

Nga ana tjetër, shuma e llogarive 411,423-429,468 janë po në të njëjtën shumë, prej 162,985,266 lekë, ku përfshihet vetëm vlerat e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm".

llog	Emërtesa	
411	Klientë e llogari te ngjashme	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	0
468	Debitorë të ndryshëm	162,985,266
	Shuma	162,985,266

Sa më sipër, nuk rezultojnë mospërputhje dhe ka një pozicionim të drejtë të llogarisë sipas udhëzimeve të miratuara mbi kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në fund të vitit 2025 të kësaj llogarie, në përputhje me trajtimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 48 dhe Kreu III, paragrafi 32.

3.Konstatime mbi llogarinë 4341 "Operacion me shtetin (detyrime)",

a. Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2025, konstatohet mospërputhje në paraqitjen dhe klasifikimin e tepricave të llogarive 4341 "Operacione me shtetin (Detyrime)" dhe 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)", sa pasqyruar në rubrikat e Pasqyrave Financiare dhe sa kontabilizuar në Centralizatorin Përmbledhës të Veprimeve Vjetore.

Më konkretisht:

- Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (Detyrime)" paraqitet në Pasqyrat Financiare me tepricë kreditore në vlerën 162,985,266 lekë, e klasifikuar në grupin e pasiveve afatshkurtra, ndërkohë që në centralizatorin përmbledhës të veprimeve vjetore evidentohet me tepricë debitore në vlerën 22,568,239 lekë;
- Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)" paraqitet në Pasqyrat Financiare me tepricë debitore në vlerën 22,568,239 lekë, e klasifikuar në grupin e aktiveve, ndërkohë që në centralizatorin përmbledhës të veprimeve vjetore evidentohet me tepricë kreditore në vlerën 162,985,266 lekë.

Kjo situatë tregon për mospërputhje në rakordimin e të dhënave kontabël dhe pasqyrimin e tyre në raportet financiare, duke ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit financiar të paraqitur.

Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (Detyrime)":			
Bilanc	TK	Cenntralizator	TD
	162,985,266		22,568,239
Llog 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)":			
Bilanc	TD	Cenntralizator	TK
	22,568,239		162,985,266

Më hollësisht, trajtuar si më poshtë vijon:

rreshti	*llog*	*Pasivet aftashkurtëra në bilanc*	*31.12.2025*	*31.12.2024*
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime) (TK)	162,985,266	135,702,644

dhe bilanci në versionin printscreen:

Nr. shti	Referenca e Logarive	EMERTIMI	NE / LEKE Ushtrimi I Mbyllur 2025	Ushtrimi Paraardhes 2024
76	436	Sigurime Shendetsore	572,489.0	555,716
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	21,258,325.00	54,173,860
82	467	Kreditore te ndryshem	6,900.00	6,900
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	162,985,266	135,702,644
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		**2.Te tjera pasive afatshkurtra**	**0**	**0**

Në Centralizatorin përmbledhës të vitit 2025 këto llogari paraqiten përkatësisht në këto pozicione dhe vlera: llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"

Llog.	TD	TK
4341	22,568,239	0

dhe centralizaori në versionin printscreen:

L	M	N	O
466		21,182,275	466
4341	22,568,239		4341
467		6,332,289	467
58	0	0	58

Nga ana tjetër, të dhënat mbi llog.4342 në bilanc evidentojnë në aktiv shumën 22,568,239 lekë¸ vlerë kjo e njëjtë me

rreshti	*llog*	***Aktivet e bilancit***	*31.12.2025*	*31.12.2024*
33	4342	Operacione me shtetin (Të drejta) TD	22,568,239	37,729,260

dhe bilanci në versionin printscreen:

		NE / LEKE	
Referenca e rive	**E M E R T I M I**	**Ushtrimi I Mbyllur 2025**	**Ushtrimi Paraardhes 2024**
411	Kliente e llogari te ngjashme		
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
431	Tatim e Taksa		
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
435	Sigurime Shoqerore		
436	Sigurime Shendetsore		
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
468	Debitore te ndryshem	162,985,266	135,702
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	22,568,239	37,729
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		

Në Centralizatorin përmbledhës të vitit 2025 këto llogari paraqiten përkatësisht në këto pozicione dhe vlera: llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"

Llog	TD	TK
4342	0	162,985,266

dhe centralizatori në versionin printscreen:

81	0	0	81
486	6,325,389		486
4342		162,985,266	4342
24	19,112,725		24
	2,165,385,520	2,165,385,520	

Versioni përmbledhës i centralizatorit të përmbledhjes së llogarive vjetore nga ditarët kontabël:

L	M	N	O
466		21,182,275	466
4341	22,568,239		4341
467		6,332,289	467
58	0	0	58
520	93,465,633		520
5311	0	0	5311
600	0	0	600
601	0	0	601
602	0	0	602
63	0	0	63
604	0	0	604
702	0	0	702
703	0	0	703
710	0	0	710
711	0	0	711
85		93,465,633	85
231	113,635,580		231
841	0	0	841
606	0	0	606
4665		76,050	4665
81	0	0	81
486	6,325,389		486
4342		162,985,266	4342
24	19,112,725		24
	2,165,385,520	2,165,385,520	

Sa më sipër, veprime në kundërshtim me pikën 8, paragrafi 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i Llogarive të të tretëve (klasa 4)" (Aneksi 1), të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe*

raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", dhe pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"; nënpika 28, 29 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar:

"Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet me vete), para evidentimit të dhënave ne pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore".

- Teprica debitore e **Llog.486 "Shpenzimet e periudhave te ardhshme"**, sipas PFV të Bashkisë Poliçan për vitin 2024 dhe 2025 janë evidentuar në vlerën zero lekë. Llogaria 486 përfshihet në grupin e Llogarive rregulluese dhe përfaqëson shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 486 "Shpenzimet e periudhave te ardhshme",	
Çelje e vitit 2025	6,518,819
Shtesa (D)	0
Pakësime (K)	193,430
Gjendja në 31.12.2025	6,325,389

Në Centralizatorin e veprimeve përmbledhëse në fund të periudhës të v.2025, llog 486 rezulton me tepricë debitore për 6,325,389 lekë, kurse llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", për 6,332,289 lekë. Nga ana e NZ janë kryer veprimet sistemuese në kontabilitet duke zbritur nga llog 467 tepricën e llog.486, rezulton: (6,332,289 - 6,325,389)= 6,900 lekë¸ shumë e cila është evidentuar në F1 të PF, rreshti 82:

467	Kreditorë të ndryshëm	6,900.00

Sa më sipër, vepruar në përputhje me përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, Kreu III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të Udhëzimit Nr.5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e veprimeve kontabile në lidhje me *llogarinë nr. 4864, "Shpenzime të periudhave të ardhshme", (mbi ndryshimin e paragrafit 42, pika 3.1, Kreu III" Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"),* ku përcaktohet shprehimisht se:

Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 42 ndryshon si vijon:

…..

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së Llogarisë 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura" në debi të Llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31 Dhjetor 2021.

Të gjitha detyrimet e prapambetura të regjistruara në Llogarinë 4864 deri në fund të periudhës ushtrimore 2021 konsiderohen detyrime të prapambetura të trashëguara nga vitet e kaluara.

-Nga auditimi i të dhënave mbi zërin **"Aktivet Neto"** (rreshti 96, kolona C e Formatit F1) del se është e kuadruar me zërin **"Fondi i Konsoliduar"** të asaj pasqyre për vitin 2025, prej 1,044,928,881 lekë, kurse për v.2024 aktivet neto janë të barazuara me fondin e konsoliduar prej 1,602,743,549 lekë.

C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,044,928,881	1,602,743,549
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,044,928,881	1,602,743,549

Po kështu, totali i aktiveve neto/ fondeve neto në çelje të vitt 2025 në pasqyrën/formatin nr.4,(rreshti 20), është 1,602,743,549 lekë, si dhe në shumën 1,044,928,881 lekë me dt 31.12.2025, vlerë kjo e barabartë me këtë grup të llogarive në Formatin nr.1. Sa më sipër, në përputhje me kërkesat e paragrafit 82, pika 3.6, "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018, i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton se,

Sipas rreshtave, në këtë pasqyrë financiare evidentohen:

- *Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre (Pasqyra financiare individuale e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto), duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar.*

U auditua përputhja e të dhënave mbi totalin e aktiveve, pasiveve dhe aktiveve neto sipas **PFV** të hartuara nga ana e njësisë raportuese Bashkia Poliçan dhe të dorëzuara zyrtarisht në DTH dhe PF të gjeneruara nga Ministria e Financave në **SIFQ**.
Shuma e aktiveve neto sipas PFV për vitin 2024 nga Bashkia është 1,602,743,549 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezulton 1,543,477,293 lekë. *Diferenca prej 59,266,118 lekë është e barabartë me tepricën debitore te llog.520 "Disponibilitete në thesar" për v.2024.*
Shuma e aktiveve neto sipas PFV për vitin 2025 nga Bashkia është 1,044,928,881 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezulton 951,465,392 lekë. *Diferenca prej 93,463,489 lekë është e barabartë me tepricën debitore të llog.520 "Disponibilitete në thesar" për v.2025.*

4.Konstatim:

Në Formatin nr. 5 të PF, "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, viti 2025", në rubrikën "*Diferenca midis pasqyrave financiare të njësisë raportuese dhe PF të gjeneruara nga Ministria e Financave në SIFQ",* nuk ka asnjë shpjegim mbi këto diferenca. Sa më sipër, nuk ka gjetur zbatim pika 14, Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë:

Këto pasqyra iu dërgohen njësive të qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e bilancit vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, *ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësive dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.*

5.Konstatim:

Nga ana e Bashkisë Poliçan nuk janë llogaritur provizione për shpenzime e rreziqe, në një kohë që institucioni është në proces gjyqësor në shkallën e dytë për 3 (tre) vendime gjyqësore dhe vlera e tyre sipas vendimmarrjes së Gjykatave të Shkallës së Parë është 5,542,180.4 lekë. *Më hollësisht*

- Paditës: *z.G. F.*, që sipas Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me nr.1497, dt 22.11.2018, ku është vendosur detyrimi i Bashkisë për pagimin e shumës 2,290,982.4 lekë;
- Paditës: *Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë*, që sipas Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat me nr.818, dt 16.10.2018, ku është vendosur detyrimi i Bashkisë për pagimin e shumës (referuar llogaritjeve të bashkisë) për 2,220,000 lekë;
- Paditës: Kompania *"P." Sh.a.*, që sipas Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me nr.3212, dt 14.05.2021, ku është vendosur detyrimi i Bashkisë për pagimin e shumës 1,031,198 lekë;

Sa më sipër, në kundërshtim me paragrafin 34, të Kreut III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të UMF nr.8,

datë 09.03.2018, i ndryshuar:

Provizionet për shpenzime janë ngjarje të ndodhura, të cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për t'u paguar nga ana e njësisë. Raste të tilla do të konsiderohen të gjitha ***vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit.*** Këto provizione duhet të njihen në kontabilitet dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë nëse:

- Njësia ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv), si rezultat i një ngjarjeje të ndodhur;
- Është e mundur që një dalje e burimeve ekonomike të jetë e nevojshme për të përmbushur detyrimin; si dhe
- Mund të bëhet një parashikim i besueshëm mbi vlerën e detyrimit.

Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për provizionet të bëhen si më poshtë:

a) Në momentin e njohjes së provizionit kryhen këto regjistrime:
- Debitohet llogaria 683, "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit"; dhe
- Kreditohet llogaria 150, "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime".

b) Në momentin e përdorimit apo të pakësimit të provizionit kryhen këto regjistrime:
- Debitohet llogaria 150, "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime"; dhe
- Kreditohet llogaria 785, "Përdorim i shumave të parashikuara për shpenzime të viteve të ardhshme".

-Nga auditimi i **llog. 85 "Teprica ose deficiti i periudhës/ rezultati i veprimtarisë së periudhës**" rezulton se, në fund të v.2024 dhe 2025 të dhënat e llogarisë në F1 dhe F2 përputhen për vlerat e tyre të regjistruara, (përkatësisht 59,266,118 lekë në F2 dhe lekë në F1 në fund të vitit 2024 dhe 93,465,633 lekë në F2 dhe lekë në F1 në fund të vitit 2025),

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 93,465,633lekë, të rakorduara me degën e Thesarit, fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2026 dhe *kuadrojnë* me vlerën e llog.85 "Rezultat i veprimtarisë ushtrimore", në rreshtin 100, grupi D "Fondi i konsoliduar" i Pasqyrës së Pozicionit Financiar.

F1:

85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	93,465,633	59,266,118

F2:

85	Teprica ose deficiti i periudhës *(Rezultati I Veprimtarisë se vitit Ushtrimor)*	93,465,633	59,266,118

Llogaria 85 paraqitet në seksionin C të pasqyrës së pozicionit financiar (F1), si pjesë e grupit të aktiveve neto / fondeve neto. *Sa më sipër*, në përputhje me kërkesat e paragrafit 71, pikës 3.4, "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të performances financiare", Kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018, i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton se,

Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur, i paraqitur në rubrikën C të pasqyrës së performancës financiare, duhet të jetë detyrimisht i barabartë me zërin rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85), që evidentohet në rubrikën C, të aktiveve neto/fondeve neto në pasqyrën e pozicionit financiar.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 "Aktive afatgjata jo materiale", 21 "Aktive afatgjata materiale", 25-26 "Aktive afatgjata financiare" dhe 23 "Investime në proces" përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
	II. Aktive Afatgjata	**946,559,506**	**1,571,314,682**	**-624,755,176**
20	**1. Aktive Afatgjata jo materiale**	**15,452,290**	**18,179,165**	**-2,726,875**
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	
202	Studime dhe kërkime	15,452,290	18,179,165	
203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme	0	0	

21	**2. Aktive Afatgjata materiale**	**817,471,636**	**1,553,135,517**	**-735,663,881**
210	Toka, Troje, Terene	1,188,000	1,188,000	
211	Pyje, Plantacione	3,110,160	3,110,160	
212	Ndërtesa e konstruksione	560,499,869	491,391,244	
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	204,698,763	1,007,044,449	
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	4,385,190	5,258,856	
215	Mjete transporti	23,560,489	28,382,236	
216	Rezerva shtetërore		0	
217	Kafshë pune e prodhimi		0	
218	Inventar ekonomik	16,992,676	13,724,083	
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	3,036,489	3,036,489	
28	Caktime të aktiveve afatgjata		0	
25-26	**3. Aktive Afatgjata Financiare**		**0**	
25	Huadhënie e nënhuadhënie		0	
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet		0	
	4. Investime	**113,635,580**	**0**	**+ 113,635,580**
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	
231	Për Aktive Afatgjata materiale	113,635,580	0	

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan.

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

- **Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"** më datë 01.01.2025, ka qenë në vlerën 22,490,215 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe amortizimi i akumuluar është në vlerën 7,037,925 lekë. Më datë 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 15,452,290 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	**Nr.**	**Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"**	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	**22,490,215**
	2	Amortizim i akumuluar	4,311,050
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**18,179,165**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	2,726,875
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	22,490,215
	5	Amortizim i akumuluar	7,037,925
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**15,452,290**

Analizuar sipas kostos historike, llogaria 202 "Studime dhe kërkime" për 4 zëra paraqitet si vijon:

Lekë

Studime-Projektime (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Projekte te tjera te paidentifikuara	2,704,895	0	0	2,704,895
Studim, hartim projektesh për investimet me objekt "Transferimi i Uzinës nr. 1 (tunelet) të qytetit Poliçan ne muze historike".	6,495,578	0	0	6,495,578
Studim , hartim projektesh për investimet me objekt "Rikonstruksioni i fasadave te qytetit Poliçan".	8,266,546	0	0	8,266,546
Studim , hartim projektesh për investimet me objekt "Ndërtimi i parkimit nëntokësor dhe hapësirave kreative"	5,023,196	0	0	5,023,196
Totali	**22,490,215**	**0**	**0**	**22,490,215**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan.

Në mënyrë analitike llog 202 paraqet:

Nr.	Emërtimi I aktivit	Data e hyrjes	Vlera	NA	Amortizimi akumuluar deri 31.12.2024	Vlera e mbetur deri 31.12.2024	Shtesat e aktivit 2025	Afati I llog. Amortizimit viti 2025	Amortizimi llogaritur per vitin 2025	Kosto historike e AAGJ	Amortizimi akumuluar 31.12.2025	Vlera e mbetur 31.12.2025
1	**Projekte te tjera te paidentifikuara**	para 2015	**2,704,895**	15%	1,837,885	867,010	0	12	130,052	2,704,895	1,967,937	**736,959**
2	Studim , hartim projektesh për investimet me objekt " Transferimi I Uzinës nr. 1 (tunelet) te qytetit Poliçan ne muze historike".	05.02.2024	**6,495,578**	15%	811,947	5,683,631	0	12	852,545	6,495,578	1,664,492	**4,831,086**
3	Studim , hartim projektesh për investimet me objekt " Rikonstruksioni I fasadave te qytetit Poliçan	05.02.2024	**8,266,546**	15%	1,033,318	7,233,228	0	12	1,084,984	8,266,546	2,118,302	**6,148,244**
4	Studim , hartim projektesh për investimet me objekt " Ndërtimi I	05.02.2024	**5,023,196**	15%	627,900	4,395,296	0	12	659,294	5,023,196	1,287,194	**3,736,002**

	parkimit nëntokësor dhe hapësirave kreative											
	Shuma		**22,490,215**		**4,311,050**	**18,179,165**	**0**		**2,726,875**	**22,490,215**	**7,037,925**	**15,452,290**

6.Konstatim:

Nga auditimi u konstatua se në tepricën e llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime**"** në fund të vitit 2025 me kosto historike 22,490,215 lekë që u përket vlerës së 4 projekt-studimeve për investime është përfshirë shuma e projekteve me vlerë sipas kostos historike **2,704,895** lekë me emërtimin *"Projekte të tjera **të paidentifikuara**"* e cila i përket ish-Komunës Vërtop që prej vitit 2015. Për këto aktive nuk ka inventar, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për aktivin, si dhe nuk ka analizë të kësaj llogarie pasi mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projektimeve dhe viti i krijimit të tyre. Kjo situatë është e mbartur që nga viti 2015 nga ndarja e re administrative dhe bashkimi i ish/komunës Vërtop me bashkinë Poliçan.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, paragrafi 26 dhe 35-36, ku përcaktohet që:

Pika 26. Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

Pika 35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a) Dokumente autorizuese, janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.,;

b) Dokumente vërtetuese, vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi;

c) Dokumente të kontabilitetit janë dokumentet përmbledhëse, ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitikë, kartelat e aktiveve, etj.,) të çdo lloj forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

Pika 36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika16/b. d, Kreu III. pika 36, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2;

2. Aktivet Afatgjata Materiale

- **Llogaria 210 "Toka, troje, terrene"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 1,188,000 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,188,000 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	**Nr.**	**Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" Objekte inventari**	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,188,000
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**1,188,000**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0

	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	1,188,000
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**1,188,000**

Lekë

Toka, troje, terrene (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Toka e varrezave të vjetra	1,188,000	0	0	1,188,000
Totali	**1.188.000**	**0**	**0**	**1,188,000**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

7.Konstatim:

a. Në pasqyrat financiare të Bashkisë Poliçan për vitin 2025, sipërfaqet e evidentuara të tokave dhe trojeve si dhe vlera e tyre, nuk rezultojnë të regjistruara në AAGJM. Është evidentuar llogarinë 210 "Toka, troje, terrene" vetëm 1 (një) zë /objekt në vlerën 1,188,000 lekë, përkatësisht artikulli, "*Tokë e varrezave të vjetra publike"*, regjistruar në kontabilitet në vitin 2015, pa specifikuar të dhënat e sipërfaqes në m2. Sipërfaqja totale e tokës që Bashkia ka në pronësi nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Nuk janë hartuar dokumentacionet, planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve që Bashkia Poliçan ka në dispozicion, plani i rilevimit (*kadastral dhe topografik*), plan vendosjet me rrjetin koordinativ me ortofoton përkatëse, planimetritë për secilin objekt dhe për çdo kat se si janë organizuar, si dhe formulari për inventarizimin e pasurive të paluajtshme shtetërore.

-Kjo llogari nuk ka përfshirë në 14 raste në vlerën e truallit (sipas VKM-së Nr. 596, datë 18.10.2017) prej 213,983 lekë, që përfshin shpronësimet për interes publik, e pa analizuar sipas sipërfaqeve të tyre dhe llojit të shpronësimit.

-Nga auditimi dhe analiza e gjendjes së Llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", konstatohet se nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, nuk janë regjistruar në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të;

a) trojeve nën objekt për ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave, kopshteve, qendrave shëndetësore, maternitetit, shkollave, çerdheve, shtëpive të kulturës si dhe të zyrave të Nj.A-ve, etj., sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione";

b) trojeve të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë;

c) trojet e Këndit të Lojërave në qendër të qytetit.

c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Poliçan, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë (210) "Toka, troje terrene" dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të.

Mungesa e informacionit kontabël për këtë llogari ndikon në informacionin që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, me efekt në procesin e inventarizimit fizik të tyre

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet në: Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

Nga auditimi i pasqyrimit të kësaj llogarie sipas pasqyrave individuale konstatohet se nuk ka lëvizje brenda njësive individuale në shtesa dhe pakësim pa pagesë të Llogarisë 210 "Toka, troje, terrene". Nga auditimi i pasqyrës 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" u konstatua që për vitin 2025 nuk ka as shtesa as pakësime, dhe mbetet vlera e trashëguar nga data 01.01.2025, në vlerën 1,188,000 lekë.

b.- Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2025 në **llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene"** nuk janë kontabilizuar vlerat e tokave dhe trojeve, pjesë e 34 pasurive të regjistruara në ASHK dhe që disponohet certifikatë pronësie, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", paragrafi "Njohja e AAGJ në pasqyrat financiare" dhe në kundërshtim me SKK 5 "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale", i përmirësuar" pika 8 dhe 10 në lidhje me përcaktimin e vlerës së drejtë dhe matjen e saj në mënyrë të besueshme:

Toka dhe ndërtesat janë aktive të ndara dhe një njësi ekonomike do t'i trajtojë ato veç e veç edhe kur ato blihen së bashku.


për këto pasuri/aktive të regjistruara:

Nr.	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja (m^2)	Adresa e pronësisë	Pronësi/përdorim	Data e çertifikimit
1	39/162	ARE	3019	1,080	Skrapar Poliçan	Pronesi	05.12.2001
2	12/111-N3	NJESI	3019	55	Skrapar-Poliçan-Lagja Qender	Pronesi	23.06.2005
3	12/111-N5	Ndërtesë	3019	38	Skrapar-Poliçan	Pronesi	23.07.2013
4	12/110-N4	Ndërtesë	3019	28	Skrapar-Poliçan	Pronesi	23.07.2013
5	789/6	ARE	2935	485,000	Komuna Vertop	Pronesi	17.06.2013
6	789/5	ARE	2935	82,000	Komuna Vertop - Berat Peshtan	Pronesi	17.06.2013
7	12/180	RRUGE	3019	280	Skrapar-Poliçan-Lagja Qender	Pronesi	28.06.2016
8	12/186	SHESH	3019	1,325	Skrapar-Poliçan-Lagja Qender	Pronesi	28.06.2016
9	12/95	RRUGE	3019	98	Skrapar-Poliçan-Lagja Pronovik	Pronesi	28.06.2016
10	12/194	SHESH	3019	2,321	Skrapar-Poliçan-Lagja Qender	Pronesi	28.06.2016
11	12/115	SHESH	3019	1,112	Skrapar-Poliçan-Lagja Pronovik	Pronesi	28.06.2016
12	12/81	SHESH	3019	3,918	Skrapar-Poliçan-Lagja Pronovik	Pronesi	28.06.2016
13	12/65	XHADE	3019	518	Skrapar-Poliçan-Lagja Pronovik	Pronesi	28.06.2016
14	12/204	RRUGE	3019	700	Skrapar-Poliçan-Lagja Qender	Pronesi	28.06.2016
15	12/17	SHESH	3019	1170	Skrapar-Poliçan-Lagja Pronovik	Pronesi	29.05.2016
16	12/318	SHESH	3019	4,318	Skrapar-Poliçan	Pronesi	29.06.2016
17	12/114	XHADE	3019	1,740	Skrapar-Poliçan-Lagja Pronovik	Pronesi	29.06.2016
18	12/35	SHESH	3019	3,185	Skrapar-Poliçan-Lagja Pronovik	Pronesi	28.06.2017
19	15/5	Truall	3019	87,600	Poliçan-Skrapar	Pronesi	23.07.2018
20	15/5	Ndertese	3019	3,230.4	Poliçan-Skrapar	Pronesi	23.07.2018
21	15/4	Truall	3019	12,400	Poliçan-Skrapar	Pronesi	23.07.2018
22	15/4	Ndertese	3019	2,310	Poliçan-Skrapar	Pronesi	23.07.2018
23	13/77	Truall	3019	3,110	Skrapar-Poliçan	Pronesi	31.01.2019
24	13/77	Ndertese	3019	814	Skrapar-Poliçan	Pronesi	31.01.2019
25	15/7	Truall	3019	10,600	Poliçan-Skrapar	Pronesi	26.02.2020
26	15/7	Ndertese	3019	1,491	Poliçan-Skrapar	Pronesi	26.02.2020
27	15/6	Truall	3019	1,800	Poliçan-Skrapar	Pronesi	26.02.2020
28	15/6	Ndertese	3019	819	Poliçan-Skrapar	Pronesi	26.02.2020
29	13/102	Ndertese	3019	412	Poliçan-Skrapar	Pronesi	04.05.2023
30	13/102	Truall	3019	700	Poliçan-Skrapar	Pronesi	04.05.2023
31	15/7	Truall	3019	44,830	Bashkia Poliçan	Pronesi	29.04.2025
32	15/7	Ndertese	3019	1,471.82	Bashkia Poliçan	Pronesi	29.04.2025
33	15/7	Truall	3019	42,770	Bashkia Poliçan	Pronesi	29.04.2025
34	15/7	Ndertese	3019	1,758.58	Bashkia Poliçan	Pronesi	29.04.2025

Burimi: Bashkia Poliçan, DFB.


Bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016,"Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për ZK 1420, pasuritë *Godina e Bashkisë, Shkollat, ambulancat, shkolla e mesme, shtëpia e kulturës, e*tj. vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Poliçanit,

(referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet duke filluar nga çmimi 101.5 lekë/m^2 për këtë zonë kadastrale. Kjo çështje konsiderohet materiale për auditimin, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016,"Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 805, Bashkia Poliçan për ZK 1420, vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Poliçanit, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet për token truall duke filluar nga çmimi 539 lek/m^2 (zona kadastrale 3019)



Burimi: Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 807, Bashkia Poliçan

Ndërsa për zonat e tjera kadastrale duke filluar nga çmimi 101.5 lekë/m^2 deri në 206 lek/m^2 për zonat kadastrale të përfshira në juridiksionin e fshatrave të kësaj Bashkie.



Burimi: Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 799, Bashkia Poliçan

Sa më sipër, vepruar jo në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e llogarive, në mospërputhje me përcaktimet e paragrafit 62, pika 3.3,"Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci), Kreu III, të Udhëzimit Nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar, të Ministrit të Financave, që përcakton shprehimisht se,

62.Aktivet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata. Rubrika I e aktiveve, që përfaqëson aktivet afatshkurtra, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.
...Rubrika e II-të e aktiveve, që përfshin aktivet afatgjata, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë:
....-Nënrubrika e aktiveve afatgjata materiale, që përfshin toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj;

"Udhëzuesi për menaxhimin e aseteve në nivel vendor", USAID, Shtator 2010, faqe 24:

Vlerësimi i Tokës: Metoda më e mirë e vlerësimit të tokës do të ishte ajo që bazohej në Vlerën e Tregut. Megjithatë në kushtet e mungesës së informacionit të nevojshëm si dhe kapaciteteve teknike/financiare për të kryerjen e një vlerësimi të tillë, NJQV-të mund të përdorin si bazë vlerësimi aktet e veçanta të Këshillit të Ministrave (KM), të cilat përcaktojnë çmimin minimum për zona të veçanta në çdo bashki.
Vlerësimi i tokave me potencial për qëllime tregu, toka për përdorim të utiliteteve (impiante pastrimi, rrugë etj) dhe veçanërisht toka të cilat kanë potencialin për t'u këmbyer në zona për ndërtime, duhet të marrë në konsideratë rritjen e vlerës që vjen si rezultat i:
(a) investimeve që bëhen për përmirësimin e strukturës, sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve;
(b) rritjen e vlerës së tregut për shkak të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të momentit; dhe
(c) ndryshimet në kushtet e zonimit të cilat sjellin ndryshime të destinacionit apo të kondicioneve urbane. Vlerësimet e ekspertëve të njësive vendore për tokën duhet të rivlerësohen nga ekspertë të pavarur të pasurive të paluajtshme, veçanërisht kur bëhet fjalë për projekte të rëndësishme.

- Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione"

Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione" në datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 3,110,160 lekë me vlerë neto. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime dhe gjendja kontabël e kësaj llogarie më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 3,110,160 lekë, ku përfshihen 4 zëra: Pyll prodhues (gështenja) Zona Kadastarale 3019, me sipërfaqe 135,000 m2; Pyll (pishë e egër) Zona Kadastarale 3019, Nr. pasurisë 112d, sipërfaqe 26,000 m2; fidanë pemë dekorative dhe përmirësim kullote, si vijon:

Lekë

Pyje, kullota, plantacione (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Pyll prodhues (gështenja) Zona kadastarale 3019, nr. pasurise 112a, sipërfaqe 135,000 m^2, mbi rrugën Unaza e Plirezes Poliçan, data e lëshimit të pronësisë 23.06.2010, sipas VKM nr. 896, datë 11.06.2008	0	0	0	0
Pyll (pishe e egër) Zona kadastarale 3019, nr. pasurisë, 112d, sipërfaqe 26,000 m^2, Anës Rrugës Unaza e Plirezes Poliçan, data e lëshimit të pronësisë 23.06.2010, sipas VKM nr. 896, datë 11.6.2008	0	0	0	0
Fidanë pemë dekorative	959,760	0	0	959,760
Përmirësimi i kullotave në fshatin Paraspuar, në parcelën 122/4 në ekonominë pyjore Mali Terpan	2,150,400	0	0	2,150,400
Totali	**3,110,160**	**20**	**0**	**3,110,160**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan.

8.Konstatim:

Nga auditimi mbi saktësinë e ***llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione"*** u konstatua se:
- Në këtë llogari janë të evidentuara vetëm 4 zëra/ objekte në vlerën 3,110,160 lekë, ku për 2 (dy) raste është përcaktuar sipërfaqja që i përket, (Pyll prodhues- gështenja) Zona Kadastarale 3019, me sipërfaqe 135,000 m2 dhe Pyll (pishë e egër), Zona Kadastrale 3019, Nr. pasurisë 112d, sipërfaqe 26,000 m2), por nuk është përcaktuar vlera e tyre në kontabilitet, pasi në Regjistrin e Aktiveve është shënuar sasia 1 (një) dhe çmimi 0 (zero) lekë.
-Në këtë llogari në 2 (dy) raste, përkatësisht në shumë 959,760 lek dhe 2,150,400 lek, (ose në vlerën totale prej 3,110,160 lekë), janë të evidentuara pemë dekorative të llojeve të ndryshme dhe përmirësimi i kullotave, por që nuk janë të analizuara sipas llojit të pemëve dekorative, dhe janë të paraqitura vetëm në vlerë.
- Kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara me VKM nr. 433, dt. 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ ***Bashkive"***, pika 3, shtojca me nr.1, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Poliçan. Lista që shoqëron VKM-në rezulton të jetë me **646 (gjashtëqind e dyzetë e gjashtë) zëra** dhe me një sipërfaqe që transferohet e përbërë prej pyje, kullotë, livadhe, djerrina, bimësi e vepra ujëpirëse etj., të cilat janë të pavlerësuara dhe të pa pasqyruara në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Poliçan të vitit 2025.

Nga të dhënat e mara nga Bashkia Poliçan vetëm për **34 prona** të tilla si ndërtesa, troje, sheshe, xhade, etj në **sipërfaqen 805,002.8 m2,** (ku pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqeje zënë arat e

trojet), ka dokumentacion pronësor (certifikatë pronësie dhe vërtetim pronësie) përgjatë viteve 2001 deri 2025. Për këto prona nuk është kryer verifikim fizik në lidhje me gjendjen e tyre për vitin 2025. Veprime këto në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30. Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi : Znj.F. H., Nëpunës Zbatues Drejtoria e Buxhetit dhe Financës

- **Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione"** më datë 01.01.2025, referuar të dhënave në pasqyrn 7/a të Bilancit Vjetor, ka qenë me kosto historike në vlerën 629,563,444 lekë, kurse pas zbritjes së amortizimit të akumuluar, me dt 1.1.2025 teprica neto e llog.212 është 491,391,244 lekë (kolona nr 3 e formatit 7/b). Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 113,268,085 lekë, pakësime në vlerën 18,000 lekë. Amortizimi i akumuluar në fund të peridhës ustrimore vlerësohet 182,313,660 lekë. Gjendja e kësaj llogarie më datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën neto 560,499,869 lekë.

212	Ndertesa e Konstruksione	560,499,869	491,391,244

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	629,563,444
	2	Amortizim i akumuluar	138,172,200
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	491,391,244
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	113,268,085.00
	5	Amortizim i shtesës	44,151,484
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	18,000.
	7	Amortizim nga pakësimet	10,024
	4	Kosto historike 31.12.25	742,813,529
	5	Amortizim i akumuluar	182,313,660
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**560,499,869**

Analiza e detajuar e llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione", paraqitet në aneksin bashkëidhur materalit.

- Nga auditimi i pasqyrës formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", shtesat pa pagesë brenda sistemit me kosto historike janë në vlerën 19,332,000 lekë ndërsa pakësimet janë 18,000 lekë. Nga krahasimi i pasqyrave të pozicionit financiar të paraqitura për llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione" me të dhënat e llogarive sipas thesarit në fund të vitit 2025 u konstatua që nuk ka diferenca për këtë llogari.

Shtesat gjithsej gjatë vitit për llogarinë 212 janë për 113,268,085 lekë, me këtë analizë:

- Rikonstruksion Shkolla "70 Vjetori" dhe sistemim i jashtëm i kompleksit arsimor, prej 6,100,805 lekë,
- Rikonstruksion Shkolla "70 Vjetori" dhe sistemim i jashtëm i kompleksit arsimor, 38,490,421 lekë.
- Mbikëqyrje "Mbrojtje lumore gjatësore nga lumi Osum, fshati Vodicë, Poliçan" për 1,662,933 lekë;
- Mbrojtje lumore gjatësore nga lumi Osum , fshati Vodicë, Poliçan, për 42,264,862 lekë
- Kolaudim "Mbrojtje lumore gjatësore nga lumi Osum, fshati Vodicë, Poliçan" 207,851 lekë
- Bashkia Poliçan (blerje banese nga A. K.) me vlerë 3,709,253 lekë
- Mbikëqyrje objekt " Rikonstruksion shkolla 70 Vjetori dhe sistemimi i kompleksit arsimor 1,499,960
- Kontabilizimi i "Zonës B" për 19,332,000 lekë.

Pakësimet gjithsej prej 18,000 mijë lekë, ku janë bërë dalje një pjesë e lulishteve të qytetit me vit hyrje si aktiv 2006, (pakësuar nga vlera e përgjithshme e këtij zëri prej 984,625 lekë¸ shuma 18 mijë lekë).

9.Konstatim:

a.- Në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione", Bashkia Poliçan ka të evidentuar një numër të objektesh të cilat janë ***të pa analizuara***. Kështu, zëri "*Përmirësimi i banesave ekzistuese/ndërtimi i ri për komunitetet të varfra dhe të pa favorizuara fatura 32/2021, datë 23.11.2021"* është në vlerën prej 16,192,102 lekë dhe i pa detajuar. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga ish/komunat në periudhat raportuese para vitit 2015 dhe janë të pa shoqëruar me kartelet përkatëse të objekteve. Gjithashtu, vlerat për objektet që janë të kontabilizuara në shumicën e tyre janë të mbartura.

- Nga ana e Bashkisë nuk është bërë një pasqyrim real dhe i drejtë në lidhje me vlerën e objekteve dhe gjendjen e tyre, pasi aty janë pasqyruar vetëm investimet e kryera gjatë viteve të fundit, të cilat janë pasqyruar sipas vlerës së realizimit të tyre.

Tabela nr.____, Elementë të regjistrit të aktiveve për llogarinë 212 Në lekë

Emërtimi i aktivit	Data e hyrjes	Sasia	Çmimi	Amortizimi akumuluar 31.12.2025	Vlera e mbetur 31.12.2025
Zyra e magazinës nr 02 1 kat	Para 2015	1	12,400	5,114	7,286
muri rrethues	Para 2015	1	24,095	9,937	14,158
kapanone	Para 2015	1	2,860	1,180	1,680
Ambulanca Vertop	Para 2015	1	300,000	123,725	176,275
Shtëpi Kulture Mbrakull	Para 2015	1	260,000	107,229	152,771
Shkolla e mesme profesionale	Para 1992	1	635,000	277,027	357,973
Kopshti Bregas	Para 2015	1	200,000	82,483	117,517
Ambulanca Zgerbonje	Para 2015	1	300,000	123,725	176,275
Shkolla Tozhar-Mb	2001	1	150,000	100,749	49,251
Shkolla Begaj Zhi	1980	1	200,000	130,901	69,099
Shkolla Zhitom i Madh	1975	1	300,000	294,854	5,146
Zyrat e Vjetra te pyjores Terpan (pa pagese)	10/5/2017	1	24,000	6,660	17,340
Materniteti Zhitomi i Madh	1970	1	542,510	434,297	108,213
Materniteti Rehove	1975	1	50,000	44,530	5,470
Zyrat e Vjetra te pyjores Terpan (pa pagese)	10/5/2017	1	24,000	6,660	17,340
Shkolla Plashnik	1975	1	150,000	138,606	11,394
Zyra Terpan	1975	1	315,000	265,198	49,802
Shkolla Teman	19780	1	150,000	136,744	13,256
Zyrat e administrates 1 kat	Para 2015	1	23,563	9,718	13,845
depo e helmeve 1 kat	Para 2015	1	3,432	1,416	2,016
Depo pjese këmbimi 1 kat	Para 2015	1	103,366	42,630	60,736
depo e bojërave	Para 2015	1	131,248	54,129	77,119

Burimi: Bashkia Poliçan, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Regjistri i Aktiveve, llog.212.

Në këto kushte, duke qenë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të llogarisë 212 "Ndërtesa e Konstruksione", nga Bashkia Poliçan, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara; saktësimi i objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizimi fizik i objektit, si dhe rivlerësimi për secilin objekt. Për sa më sipër Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione" nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025.

b. Mungesa e pasqyrimit **te vlerave reale** të disa aseteve të Bashkisë Poliçan.

- Bashkia Poliçan, me krijimin e saj, nuk ka trashëguar dokumentacionin e duhur për asetet e ish-Komunave (të tilla si, harta topografike, planimetri të objekteve, koordinata të vendndodhjes së tyre, etj.). Kjo situatë e mungesës së dokumentacionit teknik ka krijuar probleme për administrimin e aseteve të kësaj bashkie. *Bashkimi i aseteve , është realizuar nga bashkimi i vlerave te bilanceve te ish-komunave, në të cilët vlerat e pasqyruara me postet e aktivit dhe pasivit rezultojnë pa analize, pa mbështetje dhe rakordim me inventarë të rregullta të vlerave të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe Aktiveve Qarkulluese* .

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Poliçan rezulton se, **mbi 13 aktive afatgjata/ pasuri që administrohen nga NJVQV**, në fakt janë të kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasin periudhave të ndryshme kohore (shënuar viti 1992) dhe kjo tregon për një pasaktësi në evidentimin e gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me konfirmimin e dokumentacionit financiar dhe se ky informacion kontabël nuk pasqyron gjendjen e vërtetë vlerore të këtyre pasurive. *Kështu p.sh vlera e mbetur neto e objektit Shkolla Tozhar-Mb është 49,251 lekë; Zyra e*

magazinës nr. 02, 1 kat është 7,286 lekë; Shkolla Zhitom i Madh me vlerë neto 5,146 lekë; depo e helmeve 1 kat kontabilizuar për 2,016 lekë, Shkolla Teman për 13,256 lekë; Zyrat e Vjetra të pyjores Terpan me vlerë 17,340 lekë, materniteti Rehovë 5470 lekë; Materniteti Zhitomi i Madh 108,213 lekë; kapanone 1,680 lekë, etj.
Bazuar në legjislacionin në fuqi duhet të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Nga titullari i Bashkisë, Sektori i Menaxhimit të Pronave dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës nuk janë marrë masat e duhura për përmbushjen e kuadrit rregullator ligjor të regjistrimit të pronave dhe evidentimit të saktë në llogaritë përkatëse me vlerën e drejtë të tyre.
Për sa sipër, nuk janë ndërtuar kontrolle dhe procedura të brendshme në përputhje me cilësimet e paragrafit 18, të Standardit Kombëtar Kontabël nr. 5, ku nënvizohet se, *"Njësia ekonomike do të zgjedhë si politikë të saj kontabël modelin e kostos, ose modelin e rivlerësimit dhe do të zbatojë atë model për të gjithë klasën e AAM-ve që vlerësohet",* nisur nga struktura e çdo prone, vlera e tyre efektive sipas çmimeve të tregut dhe masës së amortizimit.

c. Nga auditimi i llogarisë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" janë kontabilizuar teprica të mbartura dhe u verifikuan shtesa për investime në shumën **29,400,695 lekë,** për këto zëra:
o ***"Përmirësimi i banesave ekzistuese / ndërtimi i ri për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara",*** fatura nr.32/2021, data e hyrjes së aktivit 23/11/2021, me kosto historike 11,236,775 lekë dhe vlerë të mbetur 10,471,520 lekë.
o "*Suvatim i fasadave të pallateve",* data e hyrjes së aktivit 19/08/2011, me kosto historike 477,000 lekë dhe vlerë të mbetur 209,073 lekë.
o *"**Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i qendrës në fshatin Mbrakull",*** data e hyrjes së aktivit 1/8/2019, me kosto historike 17,686,920 lekë dhe vlerë të mbetur 12,730,646 lekë.
Aktivet e mësipërme të kontabilizuara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", nuk janë aktive në posedim të Bashkisë Poliçan. Këto zëra shpenzimesh në 3 (tre) janë kryer për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, prandaj ato nuk mund të kapitalizohen pasi nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie, ndaj rezulton mbivlerësim i kësaj llogarie për shumën 29,400,695 lekë. Këto regjistrime nuk plotësojnë kërkesat e pikës 7, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.5 (SKK5) "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale", i përmirësuar, *"Aktivet afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që: (a) përdoren nga njësia ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për t"ua dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, dhe (b) priten të* me *përdoren në më shumë se një periudhë kontabël".*
Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me paragrafin 7, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.5 (SKK5) i përmirësuar dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.

- Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" më datën 01.01.2025, janë kontabilizuar në vlerën neto 1,007,044,449 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 59,029,863 lekë, pakësime 1,152,964,870 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 629,868,083 lekë. Më datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën neto 204,698,763 lekë.
Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,928,501,853
	2	Amortizim i akumuluar	921,457,404
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	1,007,044,449
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	59,029,863
	5	Amortizim i shtesës	45,677,813
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	1,152,964,870
	7	Amortizim nga pakësimet	1,152,964,870
	4	Kosto historike	834,566,846

	5	Amortizim i akumuluar	629,868,083
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	204,698,763

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

- Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën bruto (kosto historike) 834,566,846 lekë dhe me vlerën neto 204,698,763 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në anekset e akt konstatimit.

Lekë

Rrugë rrjete vepra ujore (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Rrugë me kalldrëm	60,000	0	0	60,000
Rrugë natyrale	90,000	0	0	90,000
Rrugë me trotuare	240,000	0	0	240,000
Urë në rrugë	15,000	0	0	15,000
Rrugë të asfaltuara	8,226,625	0	0	8,226,625
Pesetë skeptike	155,000	0	0	155,000
Kapak betoni	47,250	0	0	47,250
Kapak metalik	80,500	0	0	80,500
Kanal deviacioni	324,000	0	0	324,000

Për sa trajtuar më sipër, u konstatua se, në gjendjen e mbetur më datë 31.12.2025, në gjendjen e llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" në vlerën 9,238,375 lekë është përfshirë vlera që i përket disa objekteve, e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendjen fizike.
Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-Komunave Poliçan *(në formë tabelore në programin Excel)* dhe të pa analizuara, ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III, pika 30.

- **Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën neto 5,258,856 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 321,953 lekë, pakësime në vlerën 206,900 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 6,735,319 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën neto 4,385,190 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	**Nr.**	**Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" Objekte inventari**	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	11,005,456
	2	Amortizim i akumuluar	5,746,600
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	5,258,856
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	321,953
	5	Amortizim i shtesës	1,133,774
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	206,900
	7	Amortizim nga pakësimet	145,055
	4	Kosto historike	11,120,509
	5	Amortizim i akumuluar	6,735,319
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	4,385,190

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune", më datë 31.12.2025, paraqitet sipas kostos historike në vlerën 11,120,509 dhe në vlerën neto 4,385,190 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në anekset e akt konstatimit.

- **Llogaria 215 "Mjete transporti"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën neto 28,382,236 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën **932,400** lekë, pakësime në vlerën 0 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 39,768,233 lekë. Më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 23,560,489 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 215 "Mjete transporti" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	62,396,322
	2	Amortizim i akumuluar	34,014,086
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	28,382,236.
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	932,400
	5	Amortizim i shtesës	5,754,147
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	63,328,722
	5	Amortizim i akumuluar	39,768,233
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	23,560,489

Lekë

Mjete transporti (kosto historike) Objekte inventari	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Kamion benz me 3 akse TRG AA....BR	2,640,000			2,640,000
Mercedes Benz AA.... RU	2,160,000			2,160,000
Mjeti ambulance AA .... KR	13,700,625			13,700,625
Mjeti me targe AA.... BT	1,488,000			1,488,000
Mjeti Benz 322	1,000,000			1,000,000
Tojoto TARG AA.... NK	2,160,000			2,160,000
Furgon autoveture AA .... RY	882,000			882,000
Benz TARG AA .... MO	600,000			600,000
Kamjon me vinc AA ....AV	2,112,000			2,112,000
Autovinc AA....GH	1,669,200			1,669,200
zjarrfikëse e tipit kamioçine Ford Ranger me superstrukture Webo	16,903,644			16,903,644
Zjarrfikëse Tip Rreko Barrilla	11,200,853			11,200,853
Blerje fadrome	5,040,000			5,040,000
Blerje kamioçine	840,000			840,000
Blerje auto veturë	0	932400	0	932,400
Totali	**62,396,322**	**932,400**	**0**	**63,328,722**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

- **Llogaria 218 "Inventar ekonomik"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 13,724,083 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 7,764,507 lekë, pakësime në vlerën 4,512,479 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 25,519,963 lekë. Nga auditimi, më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet me kosto historike 42,512,639 lekë dhe në vlerën neto 16,992,676 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 218 "Inventar ekonomik" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	39,260,611
	2	Amortizim i akumuluar	25,536,528
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**13,724,083**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	7,764,507
	5	Amortizim i shtesës	3,720,892
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	4,512,479
	7	Amortizim nga pakësimet	3,737,457
	4	Kosto historike	42,512,639
	5	Amortizim i akumuluar	25,519,963
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	16,992,676

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

- **Llogaria 24 "Aktive të dëmtuara"** më datën 01.01.2025, ka qenë sipas kostos historike 19,112,725 lek edhe sipas vlerës neto 3,036,489 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime. Amortizimi i akumuluar është në vlerën 16,076,236 lekë. Rezulton se më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,036,489 lekë, ose sa 15.9% e kostos historike të këtyre aktiveve. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 24 "Aktive të dëmtuara" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	19,112,725
	2	Amortizim i akumuluar	16,076,236
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	3,036,489
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0

	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	19,112,725
	5	Amortizim i akumuluar	16,076,236
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	3,036,489

Analiza e detajuar e llogarisë inventariale të llogarisë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara" më datën 31.12.2025, (me kosto historike) paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Inventar ekonomik (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Autovetur fuoristrad tip defender AA .... FN	3,120,000			3,120,000
Mjeti fadrome FR....C AA....NT	3,480,000			3,480,000
Rul Ngjeshes	3,600,000			3,600,000
Eskavator me goma	5,400,000			5,400,000
Mjeti kamioçine KV .... B	985,000			985,000
Autozjarrfikëse Skoda RT ****	571,725			571,725
MitcubishTAR AA .... OF	1,668,000			1,668,000
Mjeti zjarrfikës RTO 1139	288,000			288,000
Totali	**19,112,725**			**19,112,725**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

- Llogaritë e aktiveve afatgjata financiare paraqiten në vlerën 0 lekë në fillim dhe në fund të vitit 2025. Nga auditimi i llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", rezulton se më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 lekë.

10. Konstatim:

- Nga auditimi i aktiveve financiare, (**llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta")**, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar gjithsej **në vlerën 458,000 lekë**, e përbërë nga aksionet e Bashkisë në:

- "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a" prej 358 mijë lekë dhe
- "KF Poliçani" shpk, prej 100 mijë lekë.

Në kontabilitet dhe në pasqyrat financare të llogaridhënes vjetore, vlera e llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", në fund të vitit 2025 si dhe në fund të vitit të mëparshëm, është zero lekë.

25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
25	Huadhënie e Nënhuadhenie	0	0
26	*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*	0	0

a. Nga auditimi rezulton se në datën 04.11.2022 është krijuar "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a", e cila është regjistruar me datë 11/11/2022 me 5 aksionerë, 4 prej tyre nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Referuar Statutit të "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a", (protokolluar në AKUM me nr. 2126/1 prot, datë 07.11.2022), kjo shoqëri ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkive, aksionarë të saj. Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkive është:

a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
d) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
e) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Në nenin 3, pika 1 "Kapitali", përcaktohet se Kapitali themeltar i Shoqërisë është **10.000.000** lekë dhe është i ndarë në 100.000 aksione me vlerë nonnale 100 lekë secili"

Pika nr.2 e Statutit përcakton ndarjen e kuotave të aksioneve, "Aksionet zotërohen nga aksionaret:

✓ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë zotëron 51.000 copë aksione me vlerë totale prej 5.100.000 lekë, ekuivalent në masën 51% te kapitalit themeltar;

✓ Bashkia Berat, zotëron 23,010 copë aksione me vlerë totale prej 2,301,000 lekë, ekuivalente në masën 23.01 përqind të kapitalit themeltar; ▪ Bashkia Kuçovë zotëron 12,320 copë aksione me vlerë totale prej 1,232,000 lekë, ekuivalente në masën 12.32 përqind të kapitalit themeltar;
✓ Bashkia Dimal zotëron 5,390 copë aksione me vlerë totale prej 539,000 lekë, ekuivalente në masën se e 5.39 të kapitalit themeltar;
✓ Bashkia Poliçan, zotëron 3,580 copë aksione me vlerë totale prej **358,000 lekë**, ekuivalente në masën 3.58 të kapitalit themeltar;
✓ Bashkia Skrapar, zotëron 4,700 copë aksione me vlerë totale prej 470,000 lekë, ekuivalente në masën 4.70 përqind të kapitalit themeltar;"
Edhe në ekstraktin historik të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a", përqindja e pjesëmarrjes: 3,580.

Vlera e aksioneve të Shoqëria Aksionare Ujësjellës Kanalizime Poliçan me Nipt J.....I është 102,545,000 lekë, pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat me Nipt M.....O. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Poliçan sipas Marrëveshjes "Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sh.a Berat" me nr. 2126 prot., datë 07.11.2022, është 358,000 lekë ose 3.58% (3.58% * 10,000,000 lekë = **358,000 lekë**).

b. Nga të dhënat e administruara gjatë auditimit (ekstraktet e nxjerra nga faqja zyrtare e QKB-së), në lidhje me kontabilizimin e llogarisë 26 "Pjesëmarrje ne kapitalin e vet" u konstatua që:
- Bashkia Poliçan është aksionere në shoqërinë "Klubi i Futbollit Poliçan" me NIPT L.....H, ku Bashkia zotëron 100% të aksioneve të kësaj shoqërie (shpk), e cila është themeluar me datën 19.04.2019 dhe regjistruar më datën 22.05.2019. Sipas ekstraktit të QKB kjo shoqëri ka kapital në vlerën **100,000 lekë,** nga të cilat pjesa takuese e Bashkisë Poliçan është në këtë vlerë: (100,000 *100%). Objekti i veprimtarisë së shoqërisë përfshin: "Shoqëria ka për objekt të promovojë, të organizojë në bashkëpunim me FSHF dhe të disiplinojë aktivitetin e futbollit në qytetin e Poliçanit. Shoqëria zhvillon veprimtari konform ligjeve shqiptare në fuqi që rregullojnë themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin e veprimtarisë së futbollit. Shoqëria organizon në gjirin e saj të gjitha ekipet e futbollit që zhvillojnë aktivitet në qytetin e Poliçanit dhe në bashkëpunim me FSHF dëshirojnë të marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga kjo e fundit. Shoqëria ka si synim anëtar1simin si anëtare e FSHF dhe nëpërmjet kësaj të krijojë mundësi për anëtaret e saj të zhvillojë aktivitet futbollistik". Sipas ekstraktit historik të QKB-së¸ me datë 12.05.2020 është depozituar kërkesa, ku është vendosur pushim i përkohshëm i aktivitetit.

Mos pasqyrimi i aktiveve financiare në kontabilitet, është veprim në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje", pika nr. 17:

Në lidhje me interesin e tij në një aktiv të kontrolluar bashkërisht, një sipërmarrës do të njohë në pasqyrat e tij financiare: ***(a) pjesën e tij në aktivet e kontrolluara bashkërisht, të klasifikuara sipas natyrës së ty****re; (b) të gjitha detyrimet që ai ka krijuar; (c) pjesën e tij në çdo detyrim të krijuar së bashku me sipërmarrësit e tjerë në lidhje me sipërmarrjen e përbashkët; (d) të ardhurat nga shitja ose përdorimi i pjesës së tij në prodhimin e sipërmarrjes së përbashkët, së bashku me pjesën e tij në çdo shpenzim të bërë nga sipërmarrja e përbashkët; dhe (e) shpenzimet që ai ka kryer në lidhje me interesin e tij në sipërmarrjen e përbashkët.*

Kreun I, pika 3.1."Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", paragrafi nr. 31, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, ku përcaktohet që:

31. Aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre. Lidhur me këto aktive, ***njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të analizojnë e të rakordojnë investimet e tyre eventuale që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e ndërmarrjeve të tjera (publike ose jopublike).*** Për këtë qëllim, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme duhet të saktësojë regjistrimet kontabël në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar, si më poshtë vijon: a) Në momentin fillestar të pjesëmarrjes me kapitalin e vet (krahas veprimit për konstatimin dhe pagimin e këstit të pjesëmarrjes) të kryhet edhe regjistrimi kontabël,

ku: - Debitohet llogaria 26, “Pjesëmarrja me kapitalin e vet”; dhe - Kreditohet llogaria 1011, “Shtesa të fondit bazë”.

dhe paragrafi nr.62,

Rubrika II e aktiveve, që përfshin aktivet afatgjata, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: - Nënrubrika e aktiveve afatgjata jomateriale, që përfshin studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme; - Nënrubrika e aktiveve afatgjata materiale, që përfshin toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore etj.; - ***Nënrubrika e aktiveve afatgjata financiare, që përfshin huadhënie dhe pjesëmarrje në kapitalin e vet****;* dhe - Nënrubrika e investimeve, që përfshin aktivet në proces për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale

si dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1.

4. Investimet.

- **Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”** më datën 31.12.2025, ka qenë në vlerën 113,635,580 lekë, kurse teprica e kësaj llogarie në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

231 “Për aktive afatgjata materiale”	
Çelje e vitit 2025	0
Shtesa (D)	271,624,505
Pakësime (K)	157,988,925
Gjendja debitore në 31.12.2025	**113,635,580**

Lekë

Për aktive afatgjata materiale	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
1.Rikonstruksion dhe zgjerimi i ambienteve te Qendrës polivalente (Azili) Polican	0	93,635,580	0	93,635,580
2.Kanali ujitës Mbrakull- Stacioni nr. 2 , Varreza bashkia Poliçan	0	20,000,000	0	20,000,000
Totali				

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

11.Konstatim:

Nga shqyrtimi i analizave të llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale në pasqyrat financiare në mbyllje të vitit 2025 rezultuan disa regjistrime të gabuara kontabël, të cilat ndikojnë në pasqyrimin e pasaktë të gjendjes së këtyre aktiveve në llogaritë respektive:

✓ Në analizën e gjendjes së llogarisë **218** “Inventar ekonomik” është përfshirë pa analizë, në mënyrë të pa detajuar zëri ***“Dosje, libra, televizor”,*** me vlerë fillestare prej 300,000 lekë dhe me datë hyrje në aktive para vitit 2015.

✓ Në analizën e gjendjes së llogarisë **214** “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” është përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 586,763 lekë që i përket 14 artikujve të këtij grupi aktivesh, të cilat sipas klasifikimit kontabël i përkasin llogarisë 218 “Inventar ekonomik”. *Kështu,* artikulli ***“Pajisje kompjuterike”****,* sipas klasifikimit ekonomik kontabël regjistrohet në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” dhe nënllogarinë 7-shifrore 2186000 “Pajisje kompjuterike”. Nga ana tjetër, konstatohet se një numër pajisjesh kompjuterike janë regjistruar në llogarinë 218 dhe një pjesë e tyre në llogarinë 214.

Llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune", 2025

		Emërtimi I aktivit	Data e hyrjes	Sasia	Çmimi	Vlera	Norma e amortizimit
1.	8.	Kompjuter infinity ktc	18.05.2008	1	44339.07	44,339	25%
2.	12	Laptop	2016	1	62877.8	62,878	
3.	15	Monitor 22	para 2015	1	18000	18,000	20%
4.	16	Printer	para 2015	1	28588	28,588	25%
5.	17	Printer	03.02.2009	1	10000	10,000	25%
6.	18	Printer	2001	1	13500	13,500	25%
7.	19	Printer Xerox	26.05.2008	1	14601	14,601	25%
8.	25	UPS 220V	26.05.2008	1	5367.55	5,368	25%

9.	26	Vidjo projektor	Para 2015	1	35731.2	35,731	25%
10.	27	Vidjo projektor	Para 2015	1	40539.6	40,540	25%
11.	28	Vidjo projektor	Para 2015	1	40539	40,539	25%
12.	29	Vidjo projektori	Para 2015	1	40539	40,539	25%
13.	31	Kompjuter	09.10.2020	1	54250	54,250	25%
14.	36	Printer MFP Advanced	22.02.2023	2	88800	177,600	25%
						586,763	

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan, regjistri i aktiveve 2025.

✓ Në analizën e gjendjes së llogarisë të llogarisë **212** "Ndërtesa e Konstruksione" rezulton se është përfshirë ***zëri "Varreza"*** (nr. rendor 127 në Regjistrin e aktiveve) me vlerë fillestare 2,459 mijë lekë dhe vlerë të mbetur më 31.12.2025 prej 813 mijë lekë. Nga ana tjetër, rezulton se edhe në llogarinë ekonomike **213** "Rrugë, mjete, vepra ujore" është përfshirë në numrin rendor 17 zëri i aktivit "Varrezat e reja" me datë regjistrimi 22.12.1999, pa vlerë në kontabilitet. Gjithashtu, në llogarinë **210** "Toka, troje e terrene", është përfshirë zëri "Toka e varrezave te vjetra" në vlerën 1,188 mijë lekë. Sa më sipër, kjo tregon mungesë të qartë standardizimi në ndarjen dhe identifikimin e komponentëve të aktivit dhe klasifikim jo të drejtë sipas nomenklaturës s1 Klasifikimit Ekonomik Kontabël.

✓ Nga auditimi i llogarisë 212 "Ndërtesa e rikonstruksione", është përfshirë dhe artikulli ***"Kontabilizimi i Zonës B",*** sipas VKM nr. 402, datë 04.07.2018, Urdhrit nr.1080 datë 17.07.2018 të Ministrit të mbrojtjes, Akt dorëzimit nr. 922, datë 23.07.2018 midis Kombinatit Mekanik Poliçan dhe Bashkisë Poliçan dhe Akt Marrjes në dorëzim nr.922, datë 23.07.2018. Vlera fillestare e ndërtesave dhe veprave të infrastrukturës është 19,3332,000 lekë, e kontabilizuar e gjitha gabimisht në llogarinë 212. Amortizimi i mbartur deri në fund të vitit 2025 është 13,324,219 lekë duke rezultuar me vlerën e mbetur prej 6,007,781 lekë, *për 25 zëra të aktiveve afatgjata material (depo, reparte, magazina, linja uji, rrugë të brendshme, laboratorë, kaldaja, postbllok, etj), për të cilat është aplikuar norma vjetore e amortizimit 5 %, në një kohë që nga analiza e këtij artikulli del se aty përfshihen edhe rrugë e linja uji (duheshin përfshirë në llogarinë 213 ""Rrugë, rrjete , ujësjellësa"), etj.:*

Emertitimi I aktivit	Data e hyrjes	Sa sia	Çmimi	Norma e amortizi mit	Shtesat e aktivit 2025	Afati I llog. Amortizimit viti 2025	Amortizimi llogaritur per vitin 2025	Kosto historike e AAGJ	Amortizimi i akumuluar 31.12.2025	Vlera e mbetur 31.12.2025
Kontabilizimi I Zones "B"	23.07. 2018	1	19332000	5%	19,332,000	12	13,324,219	19,332,000	13,324,219	6,007,781

Në analizën e gjendjes së llogarisë të llogarisë ***213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"*** rezulton se vlera e pakësimeve është 802,345,686 lekë, pasi nga 1,007,044 mijë lekë tepricë e datës 01.01.2025, është zbritur shuma e transferuar /kalim kapita dhe mbetet shuma prej 204,698 mijë lekë më datën 31.12.2025.

	Llogaria	2025	2024
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	204,698,763	1,007,044,449

Më hollësisht, transferimet kapitale paraqiten në këtë tabelë;

Nr.	Emërtimi aktivit	Data e hyrjes	Vlera e mbetur deri 31.12.2024	**Vlera e AAGJ kalim kapital 2025**	Amortizimi AAGJ kalim kapital 2025	Kosto historike e AAGJ	Amortizimi akumuluar 31.12.2025	Vlera e mbetur 31.12.2025
95	Linja e dërgimit të Ujësjellësit Polican dhe rrjeti shpërndarës fshatrave Pronovik dhe Mbrakull ,Bashkia Polican	25.4.2022	175,338,326	300,646,940	125,308,614	0	0	0
154	"Furnizimi me uje te pijshem te fshatrave Vertop , Vodice-Bregas - Fushe Peshtan "	26.03.2024	96,666,667	100,000,000	3,333,333	0	0	
155	" Furnizimi me uje te pijshëm te fshatrave Vertop , Vodice-Bregas - Fushe Peshtan "	17,10,2024	42,500,000	50,000,000	7,500,000	0	0	0
156	" Furnizimi me uje te pijshem te fshatrave Vertop , Vodice-Bregas - Fushe Peshtan "	31.12.2024	34,721,171	34,721,171	0			
157	Mbikëqyrje ne objektin " Furnizimi me uje te pijshem te fshatrave Vertop , Vodice-Bregas - Fushe Peshtan "	26.03.2024	2,917,957	3,432,890	514,934	0	0	0

159	Furnizimi me uje i fshatrave Vertop - Bregas- Fushe Peshtan -dhe Vodice te Bashkise Poliçan-.fat 294/2021 dt 05.08.2021	03.4.2023	453,553,616	654,163,869	200,610,253	0	0	0
167	*Kanali ujitës Mbrakull- Stacioni nr. 2 , Varreza bashkia Poliçan*	*12/24/2024*	*10,000,000*	*10,000,000*	0			
				1,152,964,870	**337,267,134**			

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan, regjistri i aktiveve 2025.

Nga auditimi i praktikës së transferimit / kalimit kapital në llogarinë 213 u konstatua se:
Referuar shkresës së "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat" Sha me nr. 193, datë 10.02.2026 me lëndë "Kërkesë për dorëzim dokumentacioni", i është kërkuar Bashkisë Poliçan dërgimi i dokumentacionit tekniko-juridik dhe financiar, për marrje në dorëzim të dokumentacionit të objekteve që kanë si qëllim furnizimin me ujë të pijshëm, si më poshtë :

- "Linja e dërgimit të Ujësjellësit Polçan dhe rrjeti shpërndarës i fshatrave Pronovik dhe Mbrakull, Bashkia Poliçan" dhe
- "Furnizimi me ujë i fshatrave Vertop - Bregas- Fushe Peshtan -dhe Vodice te Bashkise Poliçan"

Për sa më sipër, me shkresën nr.449/1 prot, datë 24.03.2026, Bashkia Poliçan ka bërë përcjelljen e dokumentacionit tekniko-juridik dhe financiar për këto objekte, *(në hard copy dhe CD)* për "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat" Sha.
Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe e Buxhetit, janë hartuar këto dokumente si vijon:
✓ Fletëdalja nr.1, nr. serial 17351, datë 19.03.2026, "Linja e dërgimit të Ujësjellësit Polçan dhe rrjeti shpërndarës i fshatrave Pronovik dhe Mbrakull , Bashkia Polican" (investimi) + mbikëqyrja + kolaudimi= 303,448,439 lekë. Kjo fletëdalje është nënshkruar vetëm nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit znj.F. H.
✓ Fletëdalja nr.2, nr. serial 17352, datë 19.03.2026, "Furnizimi me ujë i fshatrave Vertop – Bregas - Fushë Peshtan dhe Vodice te Bashkise Poliçan" (investimi) + mbikëqyrja + kolaudimi = 842,633,685 lekë. Kjo fletëdalje është nënshkruar vetëm nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit znj.F. H.
Shuma e dy fletëdaljeve nr. 1 dhe nr.2, datë 13.03.2026 është **1,146,082,124 lekë**.

12.Konstatim:
a.- Nuk ka Vendim të Këshillit të Bashkisë apo Urdhër të Kryetarit të Bashkisë për kalimin kapital të aktiveve (nga llogaria 213), në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 1, të VKM nr.153, datë 03.04.1993 "Për kalimin e objekteve te mjeteve kryesore te ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore", që ka parashikuar se:

1.Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe këshillat e rretheve, bashkive e komunave, në raste të veçanta dhe pasi të kenë marrë pëlqimin e këshillave drejtues të ndërmarrjeve e institucioneve, bëjnë kalimin kapital (pa pagesë) të objekteve e të mjeteve kryesore, me përjashtim të objekteve dhe të mjeteve kryesore të institucioneve dhe ndërmarrjeve të sistemit të kulturës, rinisë e sporteve që nuk janë në vartësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
2.Ky kalim bëhet:
a) Me urdhër të titullarit të ministrisë e institucionit tjetër qendror për ndërmarrjet e institucionet e varësisë;
b) Me urdhër të përbashkët të titullarëve të ministrive e institucioneve të tjera qendrore, ndërmjet ndërmarrjeve dhe institucioneve të varësisë;
c) Me urdhër të titullarit të ministrisë e institucionit tjetër qendror nga ndërmarrjet e institucionet e vartësisë, në ndërmarrjet e institucionet e tjera, Brenda dhe jashtë sistemit, që janë në vartësi të organeve të pushtetit lokal;
ç) Me vendim të këshillit të rrethit, të bashkisë e të komunës për ndërmarrjet dhe institucionet që kanë në vartësi.

b.- Nuk është ngritur komision për dorëzimin e aktivit dhe të dokumentacionit dhe nuk është mbajtur procesverbali për dorëzim / marrje në dorëzim të dokumentacionit dhe aktivit.
c. Nuk janë pasqyruar në fletëdaljen e shkarkimit të këtyre aktiveve vlera e amortizimit prej 337,267,134 lekë.
d.- Grupit të auditimit nuk iu vendos në dispozicion praktika e kalimit kapital të aktivit "*Kanali ujitës Mbrakull- Stacioni nr. 2, Varreza bashkia Poliçan",* pjesë e llogarisë kontabile 213 "Rruge, rrjete, vepra ujore" më dt 1.1.2025, bërë hyrje me datën 24.12.2024 me vlerën 10,000,000 lekë dhe për të njëjtën vlerë bërë kalimi në llogarinë 231 "Investime në proces" sipas rekomandimeve të auditimit të mëparshëm të KLSH-së, meqenëse objekti nuk është përfunduar dhe objekti *"Kanali ujitës Mbrakull-Stacioni nr. 2, varreza"* kontrata me nr. 2824 prot., datë 20.11.2024, me vlerë 38,188,521 lekë me TVSh, për të cilën OE "*A." SHPK* ka lëshuar Situacionin nr. 1, në vlerën 10,000,000 lekë.

e.- Nga ana e "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat" Sha, për hyrjet e rrjeteve të ujësjellësve që janë bërë pa pagesë, nuk janë përcjellë Akt Konfirmimet e firmosura nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues i njësisë publike pritëse e aktivit për dërguesin Bashkia Poliçan brenda datës 20 të muajit pasardhës, në kundërshtim me përcaktimet e paragrafëve nr. 55-57, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2021, i ndryshuar:

55. Për hyrjet e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësitë e sektorit publik fletë-hyrja e plotësuar nga magazina duhet të ketë bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë dalje mallin; Shkresën e Njësisë për transferimin e aktiveve; Autorizimin për tërheqje malli të firmosur nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues.
56.***Për të gjitha hyrjet që bëhen pa pagesë, njësia publike pritëse e aktivit i përcjell akt konfirmimin dërguesit brenda datës 20 të muajit pasardhës. Akt konfirmimi firmoset nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues i njësisë pritëse***.
57. Për hyrjet e aktiveve të dhuruara dokumentacioni shoqërues përbëhet nga ***Marrëveshja/akti i dhurimit ose letrën zyrtare të njësisë donatore;*** Faturën që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre; Dokumentet e zhdoganimit dhe Certifikatën e origjinës (në rast importi); ***Procesverbali i marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve***. Në rastet kur dhurimet në natyrë të aktiveve nga donatorë të ndryshëm jepen vetëm në sasi (pa çmim apo kosto), ato pranohen nga njësia përfituese dhe titullari autorizon vlerësimin e tyre.

✓ Në llogarinë 212 "Ndërtim e konstruksione" është përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 98,000 lekë që sipas klasifikimit kontabël i përkasin llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune". *Kështu, **zëri "Repetitor"**,* sipas klasifikimit ekonomik kontabël regjistrohet në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune", në nënllogarinë 7-shifrore 2140110 "Pajisje dhe shpenzime instaluese të telekomunikacionit".
✓ Në analizën e gjendjes së llogarisë 218 "Inventar ekonomik" janë përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 688,560 lekë që përfaqësojnë 4 (katër) artikuj të këtij grup aktivesh, të cilat sipas klasifikimit kontabël nuk i përkasin llogarisë 218 "Inventar ekonomik". *Kështu,* artikulli ***"Kondicioner",*** sipas klasifikimit ekonomik kontabël regjistrohet në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente e vegla pune" dhe nënllogarinë 7-shifrore 2140170 "Pajisje dhe instalimi i kondicionerëve".

Llog.218 ""Inventar ekonomik" 2025

	Emërtimi I aktivit	Data e hyrjes	Sasia	Çmimi	Vlera
166	Kondicioner	Para 2015	1	180000	180000
500	Kondicioner	23.08.2021	1	61,200	61200
619	Kondicioner 18 BTU	8/12/2024	1	119640	119640
620	Kondicioner 60 BTU	8/12/2024	1	327720	327720
					688,560

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan, regjistri i aktiveve 2025.

13.Konstatim:

Parregullsi në aplikimin e normave të amortizimit të aktiveve afatgjata materiale

✓ Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)" për llogarinë 218 "Inventar ekonomik" është përllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2025, në vlerën 25,519,963 lekë (kosto historike) ose në masën 60% të kostos së tyre historike. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë **218/6 "Pajisje kompjuterike"** nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimi.

✓ Në llogarinë ***219 "Amortizimi i inventarit ekonomik"***, dhe nënllogarinë 7-shifrore 2198000 rezulton se për të njëjtin artikull të pasqyruar në llogari të ndryshme ekonomike të aktiveve, është aplikuar nivel i ndryshëm i amortizimit, duke sjellë në mënyrë të gabuar mbivlerësim të vlerës së aktivit.

Kështu, ***zëri "Rach",*** në llogarinë ekonomike 218 (rreshti nr. 453 dhe nr.482 i regjistrit të aktiveve për këtë llogari), është amortizuar me normën vjetore 25 %, kurse për të njëjtin artikull, të regjistruar në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente e vegla pune", (rreshti nr. 67 i regjistrit të aktiveve për këtë llogari) është aplikuar në mënyrë të gabuar norma e amortizimit 20 %.

67	RACK	19.12.2023	1	6000	6,000	20%

Nga auditimi i përllogaritjes së normave të amortizimit, rezulton se në llogarinë ekonomike 218 rezulton se në 19 (nëntëmbëdhjetë) aktive është aplikuar në mënyrë të gabuar ***amortizimi i pajisjeve kompjuterike me normën vjetore 20 %,*** në kundërshtim me parashikimet e Ligjit nr. 8438, "Për tatimin mbi të ardhurat" dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar, të Ministrisë së Financave, pajisjet informatike dhe elektronike amortizohen me normën vjetore 25% mbi vlerën e mbetur.

Paragrafi 36. Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

- Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;
- Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softe e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;
- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe
- Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.

Përkatësisht, për këto aktive:

Nr.	Nr regjistri aktiveve	Emërtimi i aktivit	Data e hyrjes	Sasia	Çmimi	Vlera	
1.	348	Tastiera	Para 2015	1	1875	1875	**20%**
2.	349	Maus	Para 2015	1	560	560	**20%**
3.	430	Student pc	Para 2015	5	33181	165,905	**20%**
4.	618	Kompjuter dhe UPS	28.02.2024	1	47000	47,000	**20%**
5.	623	Laptop	12/10/2024	2	60000	120,000	**20%**
6.	646	Printer B8Ë	10/21/2024	1	20400	20400	**20%**
7.	648	Printer MFP	10/21/2024	1	33600	33600	**20%**
8.	658	Skaner	10/21/2024	1	60000	60000	**20%**
9.	659	Studio monitor	12/10/2024	1	18000	18000	**20%**
10.	689	Video projektor	12/10/2024	1	66000	66000	**20%**
11.	694	Printer MPF	31.10.2025	1	51000	0	**20%**
12.	695	Printer BË	31.10.2025	1	24000	0	**20%**
13.	696	Printer Multifunksional me ngjyra	14.4.2025	1	204000	0	**20%**
14.	697	Printer BË	14.4.2025	2	24000	0	**20%**
15.	698	Kompjuter (Deskop 1)	14.4.2025	1	57000	0	**20%**
16.	699	Kompjuter (Deskop 2)	14.4.2025	7	57000	0	**20%**
17.	700	UPS	14.4.2025	2	4800	0	**20%**
18.	703	Kompjuter (Deskop 1)	27.6.2025	1	42000	0	**20%**
19.	759	Kompjuter ZVA	22.12.2025	1	197929	0	**20%**

✓ Nga analiza e gjendjes së llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" rezulton se në regjistrin inventarial të aktiveve, është pasqyruar vlera 6,150,804 lekë, i përket kontabilizimit të apartamenteve të dorëzuara nga Enti Kombëtar i Banesave për qytetarët, (5 familje), vlera e të cilave është në kontabilitet, por për këto aktive *nuk është llogaritur amortizim për vitet 2024 dhe 2025.*

Nr.	Emertitimi I aktivit	Çmimi	Vlera	Amorizimi akumuluar	Vlera e mbetur	Amortizimi llogaritur	Kosto historike e AAGJ	Amortizimi akumuluar 31.12.2025	Vlera e mbetur 31.12.2025

				deri 31.12.2024	deri 31.12.2024	per vitin 2025			
108	Per sa kontabilizohen Apartament te dorëzuara nga Enti Kombëtar I Banesave nga (M. Y.) ,me shkrese 14.8.2011, Tip i baneses 3X83/3, struktura 3+1, Zona kadastarale 3019 ,Nr. pasurise 112/100+1-3, lagja qender Poliçan , vlera 14362352 leke,dt.leshimi i dok. pronesise nga ZVRPP 26.10.2011	1,436,252	1,436,252	0	1,436,252	0	1,436,252	0	1,436,252
109	Per sa kontabilizohen Apartament te dorezuara nga Enti Kombetar I Banesave nga (D. Q.) me shkrese 14.8.2011 ,Tip i baneses 3X83/3, struktura 3+1, Zona kadastarale 3019 ,Nr. pasurise 112/100+3-21, lagja qender Poliçan , vlera 19398444 leke , Sip. 103.7 m2, dt.leshimi i dok. pronesise nga ZVRPP 26.10.2011	1,939,844	1,939,844	0	1,939,844	0	1,939,844	0	1,939,844
110	Per sa kontabilizohen Apartament te dorezuara nga Enti Kombetar I Banesave nga (P. D.)me shkrese 14.8.2011 ,Tip i baneses 93/23, struktura 2+1, Zona kadastarale 3019 ,Nr. pasurise 12/19+2-18 lagja qender Poliçan , vlera 1454680 leke , sip. 81 m2,dt.leshimi i dok. pronesise nga ZVRPP 26.10.2011	1,454,680	1,454,680	0	1,454,680	0	1,454,680	0	1,454,680
111	Per sa kontabilizohen Apartament te dorezuara nga Enti Kombetar I Banesave nga (Sh. H.) me shkrese 14.8.2011,Apart. i dorezuar, struktura 1+1, Zona kadastarale 3019 ,Nr. pasurise 6/68+1-8 lagja Kalluç Poliçan , vlera 408875 leke ,sip. 60 m2,dt.leshimi i dok. pronesise nga ZVRPP 26.10.2011	408,875	408,875	0	408,875	0	408,875	0	408,875
112	Per sa kontabilizohen Apartament te dorezuara nga Enti Kombëtar I Banesave nga (Q. K.)me shkrese 14.8.2011 , struktura 1+1, Zona kadastarale 3019 ,Nr. pasurisë 5/44+2+7/2 lagja qender Poliçan , vlera 412544 leke ,Sip. 43 m2,dt.leshimi i dok. pronesise nga ZVRPP 26.10.2011	412,544	412,544	0	412,544	0	412,544	0	412,544
113	Per sa kontabilizohen Apartament te dorezuara nga Enti Kombëtar I Banesave nga (A. G.)me shkrese 14.8.2011 , struktura 1+1, Zona kadastarale 3019 ,Nr. pasurise 12/215+2-23 lagja qender Poliçan , vlera 498609 leke , sip. 47 m2 , dt.leshimi i dok. pronesise nga ZVRPP 26.10.2011	498,609	498,609	0	498,609	0	498,609	0	498,609
	shuma	6,150,804	6,150,804		6,150,804		6,150,804		6,150,804

kurse për rastet kur janë blerë banesa nga qytetarët amortizimi vjetor është llogaritur rregullisht: (referuar Regjistrit të Aktiveve, llog. 212, viti 2025):

Nr.	Emertitimi I aktivit	Data e hyrjes	Sasia	Çmimi	Vlera	NA	Amorizimi akumuluar deri 31.12.2024	Vlera e mbetur deri 31.12.2024	Amortizimi I llogaritur per vitin 2025	Kosto historike e AAGJ	Amortizimi akumuluar 31.12.2025	Vlera e mbetur 31.12.2025
126	Blerja ndërtese Nj.L. (kolaudim & mbikëqyrje)	11.10.2023	1	2,100,000	2,100,000	5%	121,625	1,978,375	98,919	2,100,000	220,544	1,879,456

Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2/1 gërma (e), Klasa 2, dhe me Nomenklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik .

14.Konstatim*:*

Nga ana e Bashkisë Poliçan nuk është kryer kontabilizimi i të gjithë pronave publike në pronësi të saj dhe të regjistruara në ASHK.

a. Nga ana e Bashkisë Poliçan nga viti 2001 deri në fund të vitit 2025 janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës ***34 (tridhjetë e katër)*** zëra të pasurive të marra në pronësi, me emërtime të ndryshme si, ndërtesa, sheshe, truall, rrugë, tokë arë, etj, por që nuk janë përfshirë në regjistrin e asteve dhe si të tilla, të pa kontabilizuara në inventarin e AAGJ të kësaj bashkie.

Kontabilizimi me vlerë simbolike 1 (një) lek përdoret zakonisht për asete që dhe janë amortizuar plotësisht, por janë ende në përdorim, ose për transferime asetesh me vlerë të papërfillshme materialiteti. *Kjo shënon mbajtjen e asetit në inventar për qëllime kontrolli,* pa ndikuar në pasqyrat financiare, shpesh duke debituar llogarinë e shpenzimeve dhe kredituar arkën/bankën.

b. Nga auditimi ka rezultuar se, nga ***463 objekte inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llog. 210 "Toka troje terrene", llog. 211 "Pyje plantacione", 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", në vlerën 2,562,363,457 lekë,*** për të cilat Bashkia Poliçan ***nuk posedon titull pronësie***, me këtë analizë,

210	Toka ,troje, Terrene	1,188,000
211	Pyje, Kullota Plantacione	3,110,160
212	Ndërtime e Konstruksione	629,563,444
213	Rruge, rrjete ,vepra ujore	1,928,501,853
		2,562,363,457

në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu VI "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme", pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

Sa më sipër, mungesa e kontabilizimit me çmimin simbolik 1 (një) lek i këtyre aktiveve në PF të llogaridhënies vjetore, në kushtet e mungesës së vlerës së tyre reale, ndikon në krijimin e pasaktësive në lidhje me dokumentimin dhe njohjen e vlerës së drejtë aktiveve, duke vepruar në kundërshtim me SKK nr.5 "Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale" i përditësuar, pika 8:

"Njësia ekonomike njeh koston e një zëri të AAM-ve si një aktiv nëse dhe vetëm nëse: (a) aktivi kontrollohet nga njësia ekonomike; (b) është e mundur që nga përdorimi i aktivit do të hyjnë në njësinë ekonomike përfitime të ardhshme ekonomike; (c) kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Standardet e Kontabilitetit për Sektorin Publik, pika 5.2,

"*japin një pikë fillestare për regjistrimin, klasifikimin dhe grumbullimin e të dhënave dhe veprimtarisë ekonomike në një mënyrë që u jep përdoruesve informacione që përmbushin objektivat e raportimit financiar dhe arrijnë karakteristikat cilësore të raportimit financiar duke marrë parasysh kufizimet në informacionin e përfshirë në RFQP-të.*

he Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, Kreu III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", paragrafi 26:

"Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar."

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Poliçan më datën 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.

Lekë

llog.	**Tipologjia e detyrimeve financiare**	**Balanca e vitit 2024**	**Shtuar në vitin 2025**	**Pakësuar në vitin 2025**	**Balanca në fund të vitit 2025**
401	Furnitorë e llogari të lidhura me to, nga këto	**2,221,123.00**	**63,660,702.00**	**63,660,670.00**	**2,221,155.00**
	për mallra	1,123.00	25,108,500.00	25,108,468.00	1,155.00
	për shërbime	2,220,000.00	38,552,202.00	38,552,202.00	2,220,000.00
	Nga këto të prapambetura për mallra				
	Nga këto të prapambetura për shërbime	2,220,000.00	0.00		2,220,000.00
404	Furnitorë për aktive të qëndrueshme	**15,996,914.00**	**261,624,504.00**	**277,467,318.00**	**154,100.00**
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa	**942,141.00**	**11,841,352.00**	**11,445,525.00**	**1,337,968.00**
435	Sigurime shoqërore	**4,062,908.00**	**48,938,131.00**	**48,812,549.00**	**4,188,490.00**
436	Sigurime shëndetësore	**555,716.00**	**6,721,679.00**	**6,704,906.00**	**572,489.00**
4341	Operacione me shtetin (detyrime)- gjoba				
467	Kreditore -	**0.00**	**17,890.00**	**17,890.00**	**0.00**

Burimi: Bashkia Poliçan, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë

Llogaria	**Emërtimi i llogarisë**	**Viti 2025**	**Viti 2024**	**Diferenca/Ndryshimi**
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	2,375,255	18,218,037	-15,842,782
42	Detyrime ndaj personelit	14,087,138	13,950,458	136,680

16,17,18	Hua afat shkurtra		0	
460	Huadhënës		0	
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,337,967	942,141	395,826
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal		0	
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		0	
435	Sigurime shoqërore	4,188,490.0	4,062,908	125,582
436	Sigurime shëndetësore	572,489.0	555,716	
437,438	Organizma të tjerë shtetërore		0	
44	Institucione të tjera publike		0	
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		0	
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë		0	
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	21,258,325.00	54,173,860	
467	Kreditorë të ndryshëm	6,900.00	6,900	
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	162,985,266	135,702,644	
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)		0	
Gjendje në fund të periudhës		**206,811,830**	**227,612,664**	**-20,800,834**

- **Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"** më datë 01.01.2025, është në vlerën 18,218,037 lekë e cila paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Poliçan. Gjatë vitit 2025 ka pasur shtesa në vlerën 309,445,604 lekë dhe pakësime në vlerën 32,288,386 lekë, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,375,255 lekë. Lëvizja e llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqitet në tabelat si më poshtë:

Lekë

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"	
Çelje e vitit 2025	18,218,037
Shtesa (K)	309,445,604
Pakësime (D)	325,288,386
Gjendja kreditore në 31.12.2025	**2,375,255**

Lekë

Nr.	Subjekti	Emërtimi i mallrave	Numri i faturës	Datë	Vlera
1	"K. S."	Blerje ushqime për çerdhen	241/2023 ,	25.1.2023	777
2	"E. L."	Blerje materiale të përgjithshme zyre	4/2023	16,1,2023	180
3	"S. A."	Blerje materiale pastrimi	84/2023	31.3.2023	600
4	"K." SHPK	Blerje karburant	4951/2023 ,	12.4.2023	-402
5	"B." SHPK	5 % Riparimi i rrugëve të fshatrave Peshtan, Drenovë, Lybesh , Tomorr i Madh dhe Tomorr i Vogël	1/2022	23.12.2022	50,000
6	"B." SHPK	5 % Blerje kosha mbeturinash	225 (10129025)	15.4.2014	29,700
7	"E." SHPK	5 % Blerje autoveturë	106 (18038306)	17.3.2015	74,400
8.	"K. S. SH."	Qira objekti	-	15.3.2005	2,220,000
Totali					**2,375,255**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

- **Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"** referuar pasqyrave financiare vlera 14,087,138 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2025 e cila mbetet për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Lekë

Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2025	**13,950,458**
Shtesa (K)	256,806,814
Pakësime (D)	256,670,134
Gjendja kreditore në 31.12.2025	**14,087,138**

Konkretisht sipas dokumenteve të kaluara në Degën e Thesarit gjatë muajit Janar të vitit 2026, konstatohet se janë kryer këto likuidime të detyrimeve për personelin:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
1	9.1.2026	11,018,384
2	9.1.2026	1,944,321
3	9.1.2026	96,012
4	9.1.2026	42,624
5	9.1.2026	60,887
6	9.1.2026	45,629
7	9.1.2026	269,389
14	9.1.2026	22,542
15	9.1.2026	306,000
16	9.1.2026	147,900

17	9.1.2026	110,500
18	9.1.2026	22,950
Totali		**14,087,138**

- Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa", paraqitet në vlerën 1,337,967 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor 2025. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, si më poshtë:

Lekë

Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2025	942,141
Shtesa (K)	11,841,352
Pakësime (D)	11,445,526
Gjendja në 31.12.2025	**1,337,967**

Konkretisht, sipas dokumenteve të kaluara në Degën e Thesarit gjatë muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se janë kryer këto pagesa për këtë kategori detyrimesh:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
13	9.1.2026	914,414
20	12.1.2026	107,628
37	27.1.2026	315,925
Totali		**1,337,967**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan

- Llogaria 435 "Sigurime shoqërore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit 2026 dhe janë përkatësisht në vlerat 4,188,491 lekë

Lekë

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	4,062,908
Shtesa (K)	48,938,132
Pakësime (D)	48,812,549
Gjendja në 31.12.2025	**4,188,491**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
6	13.01.2026	1,593,677
8	13.01.2026	83,916
10	13.01.2026	2,510,898
		0
Totali		**4,188,491**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan, Ditari i Bankës/ Thesarit, v.2026

- Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 572,489 lekë.

Lekë

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	555,716
Shtesa (K)	6,721,679
Pakësime (D)	6,704,906
Gjendja në 31.12.2025	**572,489**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
10	9.1.2026	286,244
11	9.1.2026	286,245
Totali		**572,489**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan, Ditari i Bankës/ Thesarit, v. 2026

- Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Poliçan në fund të vitit 2025 paraqitet në shumën 21,258,325 lekë dhe përfaqëson vlerën e

garancisë së kontratave që zbritet nga situacioni, në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit sipas akt rakordimit nr.1, dt 16.01.2026. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Çelje e vitit 2025	54,173,860
Shtesa (K)	12,437,567
Pakësime (D)	45,352,202
Gjendja debitore në 31.12.2025	**21,259,225**

Lekë

Nr.	**Objekti**	**Subjekti**	**Vlera**	**Ka kaluar afati (Po / Jo)**
1	Blerje konteniere	B. SHPK.	**29,700**	Po
2	???????	R. SHPK.	**91,000**	Po
3	Rik.Rrug.Lagj Çelaj-Lagjia. Zotkaj (Mekam) Teman	T.	**83,951**	Po
4	Ndertimi Ures Bejlit Uji i Zi Vokopol	S. F.	**58,476**	Po
5	Bregu i Bardhe Lagjia Çelaj Fshati Teman	Q.	**86,381**	Po
6	Kthesa Lamaj Lagjja Shehaj Fshati Çorogjaf	Q.	**35,928**	Po
7	Mirëmbajtje e rrugës Teman - Mekam	Q.	**57,089**	Po
8	Riparime dhe mirëmbajtje rrugesh	Q.	**62,830**	Po
9	Shtrim betoni, zgare Mbrakull	E. K.	**6,000**	Po
10	Riparimi i rrugëve fshatrat Peshtan,Drenove &tjera.	A. K.	**147,458**	Po
11	Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare "70 Vjetori i Pavarësisë" dhe sistemimi i jashtem i gjithe kompleksit arsimor	B.	5,810,080	Jo
12	Mbrojtje lumore e tokave bujqësore , Vodice < NJA Vertop	T.	**4,680,278**	Jo
13	Kanali ujitës Mbrakull- Stacioni nr. 2 Varreza, Poliçan	A. SHPK.	**1,000,000**	JO
14	Rikonstruksion i rrugëve te fshtarve Teman , Terpan dhe fshatrave te tjere te NJA Terpan	A. SHPK.	**4,351,325**	Po
15	Rikonstruksioni dhe zgjerimi i ambienteve te Qendres Polivalente te Shërbimeve te Përkujdeset Shoqërore per te moshuarit, Poliçan"	M. SHPK.	**4,681,779**	Jo
	Shuma		21,182,275	
	Taksat e pullës		76,950	
	Gjithsej		**21,259,225**	

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan.

- Për sa trajtuar më sipër, nga gjendja e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" disponohet analiza përkatëse vetëm për vlerën 21,168,225 lekë, ***ndërsa për diferencën në vlerën 91,000 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të kësaj llogarie.***

- Për 11 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Poliçan janë ngurtësuar fonde në vlerën 5,010,138 lekë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Skrapar,

Llog 466	Dt 31.12.2025
Kreditore për mjete ne ruajtje	21,258,325

Analizuar sipas kohës së krijimit, bllokimi i shumave dhe afateve kohore rezultojnë:

- 6 (gjashtë) subjekte janë shtuar në llogarinë 466 nga investimet e kryera gjatë vitit 2025, me shumën totale të ngurtësuar në mjetet monetare në ruajtje prej 16,172,137 lekë;

- Janë likuiduar vetëm 2 (dy) subjekte me vlerën e përgjithshme 45,191,652 lekë, (shumë që u korrespondon përkatësisht dy kompanive "G." SHPK. *dhe "A. K." SHPK.*, përkatësisht për 41,786,073 lekë dhe 3,405,579 lekë, për vlerat e ngurtësuara në mjetet monetare në ruajtje gjatë viteve 2021-2024 dhe 2023);
- 17 subjekte, janë trashëguar nga periudhat para ushtrimore dhe mbartur në bilancin e çeljes me datën 1.1.2025, me shumën totale të ngurtësuar në llogarinë 466 për 54,097,860 lekë, (pa përfshirë shumën 76 mijë lekë që janë taksat e pullës).
- Teprica e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në fund të vitit 2025 është e barabartë me 39.2 % të shumës së mbartur më datën 01.01.2025.
- Gjendja në fund të vitit 2025, teprica e kësaj llogarie është në vlerën 21,258,325 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" sipas pasqyrave financiare të llogaridhënës vjetore 2025, e krahasuar me të dhënat e akt rakordimit të mbajtur me degën e thesarit paraqitet e njëjtë dhe pa diferenca.

Sa mësipër, analiza e llogarisë 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje" evidenton shuma të ngurtësuara që nga viti 2014 e në vijim, pa ndërmarrë veprimet e nevojshme sipas përcaktimeve ligjore në fuq. Këto veprime janë në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kap. II, pika 6:

"6. Zhbllokimi i garancisë së kontratës 10 për qind të bëhet pasi të jetë përfunduar plotësisht kolaudimi i punimeve, ndërsa 5 për qind i garancisë së punimeve për periudhën pas kolaudimit zhbllokohet pas përfundimit të garancisë së objektit".

si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kapitulli III, pika 3.3, pikat 29, 30, 39, 50 dhe ku përcaktohet që:

Pika 29. Më pas, bëhen rakordimet përkatëse të aktiveve dhe të detyrimeve në të dhënat e sistemit të thesarit, duke u mbështetur në dokumentacionin kontabël të prodhuar dhe evidentuar çdo transaksion financiar apo ngjarje të ndodhur për periudhën raportuese.
Pika 30. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjorë, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet.
Pika 39. Këto pasqyra i'u dërgohen njësive të qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit përkatës të degëve të thesarit, me qëllim përgatitjen dhe rakordimin e pasqyrave financiare të 10 njësisë me informacionin që gjendet në SIFQ. Në këtë mënyrë, njësitë e qeverisjes së përgjithshme, rakordojnë të dhënat e tyre në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të vitit ushtrimor që kanë përgatitur me pasqyrat e mësipërme të gjeneruara nga SIFQ-i.

15.Konstatim: Në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2025, gjendja e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", është për vlerën kontabël 21,259,225 lekë. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është e analizuar sipas objekteve për 19 raste ngurtësimesh. Deri në momentin e kryerjes së auditimit nuk është bërë çlirimi i garancive për 11 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Poliçan në vlerën 5,010,138 lekë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës**.** nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Skrapar. Nga analiza e gjendjes së llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" vlera 91,000 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të kësaj llogarie.
Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit. nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me Subjektet Sipërmarrëse, në

kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kap. II, pika 6 dhe 10:

- **Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"** paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2025, janë në vlerën në vlerën 6,900 lekë dhe me po të njëjtën vlerë është më datë 31.12.2025,. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2025	6,900
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	0
Gjendja kreditore në 31.12.2025	**6,900**

Lekë

Nr.	**Subjekti**	**Emërtimi i investimit**	**Fatura**		
			Nr.	**Data**	**Vlera**
1	"S. P. A."	Kuotizacionet e punonjësve te arsimit	Pagat	Maj-shtator 2024	6,900
Totali					**6,900**

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan.

Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm" *(në lekë, dt 31.12.2025)* në lekë

Nr llog.	Emërtimi	v.2025	v.2024
467	Kreditore te ndryshëm	6,900	6,900

Burimi i të dhënave: Bashkia Poliçan, Pasqyrat Financiare 2025

Konkluzion: Teprica e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" në çelje të vitit me datën 01.01.2025 është në vlerën 6,900 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në te njëjtën vlerë. Llogaria 467 " Kreditore te ndryshëm " në datën 31.12.2024 është 6,900 lekë, e cila përbëhet nga vlera e kuotizacioneve sindikale të arsimit parashkollor, sa ndalur nga paga e mësuesve të arsimit parashkollor dhe pa derdhur në llogarinë bankare të Sindikatës së Arsimit. Kjo vlerë nuk është kaluar për llogari të Sindikatës së Arsimit edhe gjatë vitit 2025. Rrjedhimisht, vlera 6,900 lekë është gjendja e llogarisë 467 në datën 31.12.2025.

Në gjendjen e kësaj llogarie është përfshirë vlera e vendimeve gjyqësore, dhe e shpronësimit (për një rast), ndërkohë që gjatë vitit janë kryer kontabilizime për shpenzimet për vendime gjyqësore në momentin e pagesës së detyrimit.

Tabela nr._____. *Likuidimi i vendimeve gjyqësore gjatë vitit 2025, pasqyruar si detyrime për pagesë në llog. 467 në çelje të vitit 2025:*

Në lekë

USh nr	datë	Përshkrimi	Llog. e debituar	Shuma
289	26.05.2025	Zyrës përmbarimore private B. SH. - per Vendimin gjyqësor Nr. 4312. **dt 27.12.2023** - Gjobe AKBN	602	300,000
290	26.05.2025	Tarife përmbarimore per Vendimin gjyqësor Nr. 4312 dt. 27.12.2023 - Zyrës përmbarimore private B. SH. - lik. Fat. Nr.32,33,34/2025 dt. 21.05.2025	602	54,000
349	18.06.2025	Zyrës përmbarimore private "Q. "SHPK.- per Vendimin gjyqësor Nr. 89-2024-**1861/1141 dt 01.10.2024**	602	913,620
350	18.06.2025	Tarife përmbarimore për Vendimin gjyqësor Nr. 89-2024-1861/1141 dt 01.10.2024 - Zyrës përmbarimore private "Q." SHPK. - lik. Fat. Nr.70/2025 dt. 13.06.2025	602	127,200
		Shuma		1,394,820

Burimi: Bashkia Poliçan, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Ditari i Bankës/Thesarit 2025

Shpronësime të vitit 2025, miratuar që nga vitet e mëparshme (2020 e në vijim):

Në lekë

	Viti 2025	Akti I shpronësimit (VKM dhe përfituesi)	Llog.	**Shuma**

132	07.03.2025	**SH. K.** - shpenz. Shpronësimi sipas VKM nr. 596, dt. 18.10.2017	602	**193,430**

Këto detyrime të Bashkia Poliçan janë parashikuar nga VKM nr. 596, datë 18.10.2017 "*Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i fasadave të pallateve në shëtitoren "Miqësia" dhe Rrugës së Tregut, si dhe rehabilitimi i zonës pas pallateve të ish mapos", Poliçan*", (Fletorja Zyrtare nr. 187, datë 24.10.2017), ku në pikën nr 4 dhe 7 të tij është parashikuar se:

"4.Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9,130,543 (nëntë milionë e njëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekësh, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Poliçan. 7. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

Burimi: VKM nr. 596, datë 18.10.2017, Fletorja Zyrtare 187, datë 24.10.2017

Këto vonesa dhe stoku i detyrimeve të mbartura janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu III, kap. 3.1 nënpika 32, 42, Aneksi 1 pika 3.3/c dhe me UMF nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", kap. 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretë", pika 6, faqe 34-35.

DETYRIMET E PRAPAMBETURA 2025.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, vlera e raportuar nga Bashkia Poliçan në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2025, është **6,326,389 lekë**, konfirmuar me shkresën nr. 562 prot., datë 27.02.2026, dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Drejtorisë së Financave Vendore) në kuadër të vetëvlerësimit financiar për 4-mujorin e tretë Shtator - Dhjetor 2025. Referuar përcaktimeve të Kreut II, pikat nr. 6 dhe 13, të Udhëzimit nr.35, dt 29.12.2023 *"Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare të NJQV-të":*

6."Detyrime financiare të prapambetura (të konstatuara dhe të papaguara)" konsiderohen detyrimet financiare të transaksioneve të shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore të cilat rezultojnë të papaguara prej mbi 60 ditë kalendarike që nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik, si edhe ato pas afatit të pagesës të përcaktuar në marrëveshjen apo legjislacionin përkatës. (p.sh marrëdhëniet e punës dhe kontributeve, vendimet gjyqësore, për rimbursimin e TVSH-së etj.).
13. "Gjendje normale financiare", *në kuptimin e këtij udhëzimi quhet rasti kur detyrimi financiar i prapambetur është nën 15% të shpenzimeve vjetore faktike, dhe që është në një afat nën 60 ditë kalendarike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit).*

Gjendja e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Poliçan me dt 31.12.2025 paraqitet si vijon:

Lekë

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	**Borxhe (a+b)**			
a	**Hua afatgjatë**			
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
B	**Hua afatshkurtër**			
b.1	Hua			
b.2	Overdrafte			
b.3	Kredi të furnitorëve			
II	**Detyrimet e prapambetura**			**%**
A	Vendime Gjyqësore	4,106,389		
a.1	Shërbime			
a.2	Energji elektrike			
a.3	Mirëmbajtje			
B	Investime			

b.1	Rimbursim TVSh			
b.2	Mallra			
C	Të tjera			
c.1	Sigurime shoqërore			
c.2	Sigurime shëndetësore			
c,.3	Ardhura personale			
	Tatime të tjera			
	Paga			
	Shpronësime			
	Transferta individ			
	Transferta subjektet	2,220,000		
III	**Totali (I + II)**	**6,326,389**	**375,689,073**	**1.68%**

Burimi: Bashkia Poliçan, Raportimi në MF (Drejtorisë së Financave Vendore)

Tabela e detyrimeve të prapambetura sipas formatit të raportuar në MFE për vitin 2025:

Detyrime pushteti qendror	***Llogaria ekonomike***	***Vlera (në lekë)***
Ministri linje 05	4864100	17,143,282
Ministri linje 06	4864100	1,494
Ministri linje 11	4864100	271,466
FSHZH	0	0
Fonde nga Rindertimi	0	0

Burimi: Bashkia Poliçan

Sipas shënimeve sqaruese ne PF te vitit 2025, në rubrikën *"Informacion për detyrimet e prapambetura, rakorduar me SIFQ"*, evidentohet kjo dinamikë dhe analizë e detyrimeve të prapambetura: (të dhënat në lekë)

Tabela nr.____ *(të dhënat në lekë)*

llog.	**Tipologjia e detyrimeve të prapambetura**	**Balanca në dt 31.12.2024**	**Shtuar në vitin 2025**	**Pakësuar në vitin 2025**	**Balanca në 31.12.2025**
486	***Detyrimet e prapambetura :***	**6,792,779.00**	**96,893,234.00**	**79,943,382.00**	**23,742,631.00**
4864100	Detyrimet për vendimet gjyqësore	4,106,389.00	0.00	0.00	4,106,389.00
4864200	Detyrimet e prapambetura për shërbimet	0.00	691,299.00	691,299.00	0.00
4864201	Detyrimet e prapambetura për energjinë elektrike	0.00	1,213,156.00	1,213,156.00	0.00
4864400	Detyrimet e prapambetura për investimet me grupin 00	0.00	2,559,373.00	2,559,373.00	0.00
	Detyrimet e prapambetura për investimet me ministritë (Grupi 06,11,05)	272,960.00	92,017,806.00	74,874,524.00	17,416,242.00
4864600	Detyrimet e prapambetura për mallra	0.00	411,600.00	411,600.00	
4864902	Detyrimet e prapambetura për transferimet tek individët	193,430.00	0.00	193,430.00	0.00
4864904	Detyrimet e prapambetura për transferimet tek subjektet	2,220,000.00	0.00	0.00	2,220,000.00

Burimi: PF 2025, Bashkia Poliçan.

Bashkia Poliçan në datën 01.01.2025, ka evidentuar si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 6,792,779 lekë. Vlera e detyrimeve të shtuara gjatë vitit është 96,893,234 dhe nga sa më sipër likuiduar shuma prej 79,943,382 lekë. Detyrimet e prapambetura me vlerën e tyre për tu paguar janë raportuar nga ana e bashkisë Poliçan në Degën e Thesarit Skrapar nga ana e NA z. A. Z. dhe NZ znj.F. H. me datën 03.02.2026 dhe janë konfirmuar nga përgjegjësi i Degës së thesarit D. B.

Stoku i detyrimit të mbetur më datën 31.12.2025 dhe raportuar në MF me shkresën e mësipërme, rakordon me vlerën e detyrimeve të pasqyruara me dt 03.02.2026 në sistemin e Thesarit, që i takon periudhës së raportimit 2025, në përputhje me përcaktimet e Kreut II, pika nr.36, të Udhëzimit nr.35, dt 29.12.2023 *"Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare të NJQV-të":*

"Në raportin e vetëvlerësimit financiar për katërmujorin e tretë/raporti i konsoliduar vjetor për vlerësimin e situatës financiare, do të përdoren të dhënat e gjeneruara dhe të rakorduara me degën përkatëse të thesarit për detyrimet financiare të prapambetura dhe shpenzimet vjetore faktike të vitit për të cilin po vlerësohet gjendja financiare (shembull: detyrimet financiare të prapambetura deri në 31 dhjetor, vitit /shpenzimet vjetore faktike, vitit).

dhe me përcaktimet e Kreut IV, pika 12 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.127, datë 19.12.2025 "Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025",

Në zbatim të Udhëzimit nr.37, datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme", të dhënat e detyrimeve të prapambetura (vlera e stokut, e paguar dhe krijuar rishtazi), rakordohen brenda datës 10 Shkurt 2026 midis njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme dhe degëve të thesarit, të cilat menjëherë raportojnë përkatësisht në strukturën përgjegjëse për thesarin pranë ministrisë përgjegjëse për financat sipas formatit të raportit të gjeneruar nga SIFQ për publikim paraprak më datë 13.02.2026 dhe përfundimtar rnë datë 27.02.2026.

16.Konstatim: Nga auditimi i llogarive financiare të detyrimeve të prapambetura rezultoi:

✓ Vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Poliçan me datën 31.12.2025 është rritur krahasuar me të dhënat e stokut në çelje të vitit ushtrimor me datën 01.01.225, për + 16,949,852 lekë, (23,742,631.00 lekë - 6,792,779 lekë), ose 2.4 herë krahasuar me gjendjen e detyrimeve në fillim të periudhës ushtrimore 2025.

✓ Nga shqyrtimi i planit të buxhetit vjetor për vitin 2025, rezultoi se Bashkia nuk ka parashikuar një grafik të detajuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, në vlerën 4,106,389 lekë për dy raste. Gjithashtu, u konstatua se Bashkia ka në inventar detyrime të prapambetura për transferime ndaj subjekteve në shumën 2,220,000 lekë, të cilat përbëjnë detyrime të mbartura nga viti 2024 dhe i përkasin Konfederatës së Sindikatave për qera të papaguar për periudhën Janar 2016 – 31.12.2019.

✓ Referuar dokumentit "Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për tre vitet në vazhdim" (Aneksi nr. 2 i tabelave të vetëvlerësimit financiar për 4-mujorin e tretë të vitit 2024), dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 542, datë 26.02.2025, rezulton se detyrimet e mbetura deri më datë 31.12.2024 janë planifikuar për t'u shlyer deri më datën 31.12.2025.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 52 "Kryerja e shpenzimeve", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" pikat 20-22 dhe 27-29; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 186; Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", pikat 106-110, "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" dhe pikat 81, 148 dhe 148/1 "Raportimi i detyrimeve te prapambetura në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

AKTIVET NETO/FONDET NETO

Lekë

Grupi/llog.	Emërtimi	31.2.2025	31.12.2024
C	**AKTIVET NETO/FONDET (A-B)**	**1,044,928,881**	**1,602,743,549**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR**	**1,044,928,881**	**1,602,743,549**
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	951,463,248	1,543,477,431
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	93,465,633	59,266,118
111	Rezerva		0
115	Nga fondet e veta të investimeve		0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime		0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme		0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja		0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim		0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata		0

Lek

Fndi i konoliduar	Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"	
	Mbyllje më datë 31.12.2025	**Çelje më datë 01.01.2025**

1,044,928,881	Debi		Kredi	
			1,543,477,431	Çelja gjendja e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* i datës 31.12.2024
	1,157,702,249	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	181,316,808	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	103,164,985	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	181,442	Llogaria 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit"*
	4,737,379	Jashtë përdorimit	341,159,670	Amortizimi i pakesimeve (nxj. jashtë përdorimit)
Totali	**1,265,604,613**		**2,066,135,351**	
2,066,135,351– 1,265,604613 = 800,530,738				
800,530,73868 - 951,463,248= -150,932,510				

Burimi: Bashkia Poliçan, PFV, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

- Çelja e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 1,543,477,431 lekë.
- Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* në vlerën 181,316,808 lekë, për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 181,442 lekë sipas llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit"* dhe amortizimin nga vlerat e nxjerra jashtë përdorimit në vlerën 341,159,670 lekë.
- Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* debitohet për pakësimit e vitit në vlerën 1,157,702,249 lekë, amortizimin e vitit ushtrimor 2025 në vlerën 103,164,985 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* dhe vlerën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit prej 4,737,379 lekë.

Formati nr. 2. Pasqyra e Performancës Financiare:

Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiar të kësaj Bashkie u konstatua që janë paraqitur të ardhura 737,251,436 lekë dhe shpenzimet totale për vitin 2025 në vlerën 643,785,803 lekë. Paraqitja e të ardhurave sipas pasqyrës së performancës është si më poshtë vijon:

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

- **Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet",** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 32,650,211 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie është 21,549,435 lekë ose me një pakësim në vlerën 11,100,776 lekë.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
70	**I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME**	**21,549,435**	**32,650,211**
700	**1. Tatimi mbi të ardhurat**	**4,566**	**0**
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale		
7001	Tatimi mbi fitimin		
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	**4,566**	
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat		
702	**2. Tatimi mbi pasurinë**	**13,685,689**	**27,498,310**
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	13,685,689	27,498,310
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme		
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	0	0
703	**3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit**	**7,859,180**	**5,151,901**
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Taksë mbi shërbimet specifike		
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	7,859,180	5,151,901
704	**4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare**		
7040	Taksë doganore për mallrat e importit		

7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit		
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë		
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare		
705	**5. Taksë e rrugës**		
708	**6. Të tjera tatime e taksa kombëtare**		
709	**7. Gjoba e kamatë vonesa**	71,103,782	26,131,117

Burimi: Bashkia Poliçan

2. Të ardhurat jo tatimore:

- Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 45,458,016 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 82,198,903 lekë, ose me një rritje në vlerën 36,740,887 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
71	**III. TË ARDHURA JO TATIMORE**	**82,198,903**	**45,458,016**
710	**1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia**	**71,103,782**	**26,131,117**
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	10,009,219	14,929,073
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	579,066	524,600
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		
711	**2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare**		
7110	Tarifa administrative dhe rregullatorë		
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh		
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale		
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	21,000	19,400
7114	Të ardhura nga biletat		
7115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	485,836	3,853,826
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje		
719	**3. Të tjera të ardhura jo tatimore**	**0**	**0**

Burimi: Bashkia Poliçan

3. Grante korente:

- Llogaria 72 "Grante korente", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 748,349,283 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 633,503,098 lekë ose me një pakësim në vlerën 114,846,185 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
72	**V. GRANTE KORENTE**		
720	**1. Grant korent i brendshëm**	**633,503,098**	**748,349,283**
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	283,072,889	405,420,647
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	322,024,205	297,871,251
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH		
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)		
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	5,837,765	4,842,405
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	22,568,239	37,729,260
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)		2,485,720
7209	Të tjera grante korente të brendshme		
721	**2. Grant korent i huaj**	**0**	**0**
	Nga Qeveri të Huaja		
	Nga Organizata Ndërkombëtare		

4. Të ardhura të tjera:

- **Të ardhura të tjera** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 546,000 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 0. lekë ose me një pakësim në vlerën 546,000 lekë si më poshtë:

5Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2024
	VI. TË ARDHURA TË TJERA	0	546,000
781	Të ardhura nga investimet në ekonomi		
782	Rimarrje shumash të parashikuara për aktive afatshkurtra		
783	Rimarrje shumash të parashikuara për aktive afatgjata	0	546,000
784	Rimarrje shumash për shpenzime të viteve të ardhshme		
787	Tërheqje nga seksioni i investimeve		

Analiza inventariale e llogarisë 115 "Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime".

Pasqyra e Performancës Financiare (f2), datë 31.12.2025

		31.12.2025	31.12.2024
7115	Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	485,836	3,853,826

Burimi: Bashkia Poliçan, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

17.Konstatim:

I. Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Poliçan, gjatë periudhës 2024 dhe 2025 janë vendosur gjoba në 11 (njëmbëdhjetë) raste/subjekte me një vlerë të përgjithshme prej **15,187,032 lekë**, nga e cila arkëtuar shuma 55,900 lekë. Mbetur me datën 31.12.2025 pa arkëtuar shuma prej 15,119,656.5 lekë. Kjo shumë nuk është përfshirë në regjistrimet e llogarisë së debitorëve, llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm". Praktikat e gjobave të IMTV i referohen ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, i ndryshuar", dhe përfshijnë procesverbalin e konstatimit, vendimin e dënimit me gjobë, vendimin e prishjes së objektit të kundërligjshëm, faturën për arkëtim , njoftimin pr prishje objekti, njoftimin për pagesën e gjobës (subjektit, Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtorisë Juridike dhe Drejtorisë së Urbanistikës).

Gjithashtu, vlera e përgjithshme e gjobave prej 15,187,032 lekë nuk është kontabilzuar në llogaritë e klasës së 7-të, nënllogaria 7115 "Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime e zhdëmtime"

duke sjellë nënvlerësim të kësaj llogarie të klasës së 7-të për 15,187,032 lekë

Këto veprime sa më sipër, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 36 pika 2.

"Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjobat, ndihmat ose donacionet", dhe nenin 41, pika c: *"Për qëllime të transparencës e të respektimit të ligjit, buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të përmbajë:*
c.të gjitha fondet e mbartura nga viti i mëparshëm dhe fondet e parashikuara për t'u siguruar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej vetë bashkisë nga çfarëdolloj burimi, përfshirë këtu të gjitha taksat, grantet nga qeverisja qendrore, tarifat, vlerësimet, gjobat, grantet nga burime të niveleve të tjera të qeverisjes;

Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 12 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 4.2 "Të ardhurat në NJQP dhe operacionet që lidhen me to":, ku përcaktohet që:

Sipas rasteve e analizave, funksionimi kontabël i llogarisë 71, "Të ardhura jotatimore", është: - Debitohet 468, "Debitorë të ndryshëm" (kur konstatohen të ardhura, pra kur lind e drejta); - Debitohet 520, 512 e llogarive financiare (kur arkëtohen menjëherë në llogaritë financiare); - Kreditohen grupet e llogarive 71, "Të ardhura jotatimore" (me analiza shtatëshifrore).

II. Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se: Në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" janë pasqyruar debitorët nga kontrata e qirasë të fondit pyjor kullosorë. Subjekte që nuk kanë likuiduar detyrimet për vitin 2025 janë në vlerën **81,955,200 lekë** dhe konkretisht;

- *për kontratën e lidhur me subjektin "X.", vlera e detyrimit të papaguar prej 60,117,600 lekë,*
- *për kontratën e lidhur me subjektin "X.", vlera e detyrimit të papaguar prej 10,560,000 lekë,*
- *për kontratën e lidhur me subjektin "M. S. E.", vlera e detyrimit të papaguar prej 11,227,600 lekë,*

Debitorët në vlerën **81,955,200** lekë janë përfshirë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në rakordimin e bërë me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit.

Marrëdhënia shkresore midis strukturave të bashkisë që ka të bëjë me rakordimet në lidhje me debitorët është bërë sipas shkresës nr.427 prot.datë 11.02.2026**.** Këto shkresa plotësojnë tërësinë e elementeve të përcaktuara ligjërisht në Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat", nenet 11-20

të dokumentit "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor ", miratuar Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Aktivet e ujësjellës kanalizimeve të pa transferuara tek Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime (SHRUK) Berat nga ana e Bashkisë Poliçan.

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve për llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, ujësjellësa", rezultojnë se janë transferuar për llogarit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat nga ana e Bashkisë Poliçan, vetëm 7 (shtatë) zëra të këtij regjistri me kosto historike të aktivit në fund të vitit 1,152,964,870 lekë dhe amortizim të akumuluar prej 337,267,134 lekë, si më poshtë:

Të dhënat në lekë

nr	Emërtimi i aktivit	Data e hyrjes	Vlera e AAGJ kalim kapital 2025	Amortizimi i AAGJ kalim kapital 202
1.	Linja e dërgimit të ujësjellësit Polican dhe rrjeti shpërndarës i fshatrave Pronovik dhe Mbrakull , Bashkia Polican	25.4.2022	300,646,940	125,308,614
2.	"Furnizimi me ujë të pijshëm të fshatrave Vertop, Vodicë -Bregas - Fushë Peshtan "	26.03.2024	100,000,000	3,333,333
3.	" Furnizimi me ujë të pijshëm të fshatrave Vertop, Vodicë -Bregas - Fushe Peshtan "	17,10,2024	50,000,000	7,500,000
4.	"Furnizimi me ujë të pijshëm të fshatrave Vertop, Vodicë -Bregas - Fushe Peshtan "	31.12.2024	34,721,171	0
5.	*Mbikëqyrje në objektin "Furnizimi me ujë të pijshëm të fshatrave Vertop , Vodice-Bregas - Fushë Peshtan "*	26.03.2024	3,432,890	514,934
6.	Furnizimi me ujë i fshatrave Vertop - Bregas- Fushë Peshtan dhe Vodicë të Bashkisë Poliçan-.fat 294/2021 dt 5.08.2021	03.4.2023	654,163,869	200,610,253
7.	Kanali ujitës Mbrakull- Stacioni nr.2 , Varreza bashkia Poliçan	12/24/2024	10,000,000	0

Burimi: Bashkia Poliçan, Regjistri i aktiveve 2025

Nuk janë kryer procedurat e transferimit për 38 zëra të AAGJ të kësaj llogarie, me kosto historike 139,205,450 lekë dhe amortizim të akumuluar 110,026,475 lekë, si vijon:

Të dhënat në lekë

nr	Emërtimi i aktivit	Data e hyrjes	Sasi	Çmimi	Kosto historike e AAGJ	Amortizimi akumuluar 31.12.2025	Vlera e mbetur 31.12.2025
1.	Kanali i ujërave te larta lagja Lulaj	6/6/2001	1	3,663,260	3,663,260	2,961,835	701,425
2.	Kanali i ujërave te zeza	4.7.2001 , 22.6.2003	1	9,642,941	9,642,941	7,785,607	1,857,334
3.	Kanali i ujërave te bardha (Bulevardi kryesor) 2002	13.5.2002	1	5,345,961	5,345,961	4,310,449	1,035,512
4.	Kanali i ujërave te bardha (sheshi i agjensise)	28/12/01 ,	1	9,533,677	9,533,677	7,687,005	1,846,672
5.	Kanali i ujërave te zeza lagja Lavdar 2003	2003	1	3,571,736	3,571,736	2,848,122	723,614
6.	Kanali i ujërave te zeza lagja Plirez 2003	2003	1	4,979,329	4,979,329	3,970,544	1,008,785
7.	K.U.Z. Tubo betoni fi 400	25.01.2004	1	40,000	40,000	32,163	7,837
8.	K.U.Z. Tubo betoni fi 600	25.01.2004	1	100,000	100,000	80,408	19,592
9.	K.U.Z. Tubo betoni fi 500	25.01.2004	1	64,000	64,000	51,461	12,539
10.	K.U.Z. Tubo betoni fi 200	25.01.2004	1	156,000	156,000	125,436	30,564
11.	K.U.Z. Tubo betoni fi 300	25.01.2004	1	27,000	27,000	21,710	5,290
12.	K.U.Z. Tubo betoni fi 700	25.01.2004	1	40,000	40,000	32,163	7,837
13.	K.U.Z. Tubo betoni fi 200	25.01.2004	1	100,000	100,000	80,408	19,592
14.	K.U.Z. Tubo betoni fi 407	25.01.2004	1	50,000	50,000	40,204	9,796
15.	K.U.Z. Tubo betoni fi 300	25.01.2004	1	50,000	50,000	40,204	9,796
16.	Puseta skeptike	25.01.2004	1	155,000	155,000	124,632	30,368
17.	Kanal deviacioni	25.01.2004	1	324,000	324,000	260,521	63,479
18.	KUZ Poligon	25.01.2004	1	2,078,999	2,078,999	1,671,674	407,325
19.	Ndertim KUZ lagja Plirez	26/8/2005	1	238,788	238,788	189,880	48,908
20.	Kanali I Ujrave te Larta	18.12.2010	1	2,949,213	2,949,213	2,302,173	647,040
21.	KUZ Mbrakull	Para 2015	1	9,268,808	9,268,808	7,652,044	1,616,764
22.	KUZ Fushe Peshtan	Para 2015	1	16,453,129	16,453,129	13,583,200	2,869,929
23.	Kuz Vodice	Para 2015	1	9,059,857	9,059,857	7,479,541	1,580,316
24.	Depo Ujesjellesi Vojak	Para 2015	1	808,000	808,000	667,060	140,940
25.	Ujesjellse Peshtan	Para 2015	1	12,498,588	12,498,588	10,318,452	2,180,136
26.	Ndërtim ujësjellësi dhe depo uji Peshtan	Para 2015	1	754,000	754,000	622,479	131,521
27.	Kanali ujitës fshati Mbrakull	13.09.2018	1	26,178,654	26,178,654	21,326,976	4,851,678
28.	Ujësjellësi Tozhar	Para 2015	1	4,969,992	4,969,992	4,103,073	866,919

29.	Ujësjellësi Tozhar	Para 2015	1	5,000,000	5,000,000	4,127,847	872,153
30.	Ngritje uji Depo Paraspua Tepan	Para 2015	1	2,623,352	2,623,352	2,165,759	457,593
31.	Ndërtim rrjeti shpernd.Parasp,Terpan	Para 2015	1	1,718,178	1,718,178	1,418,475	299,703
32.	Blerje Pompa Stac,Depove.Terpan	Para 2015	1	1,269,600	1,269,600	1,048,143	221,457
33.	Depo uji Lagja Selenic (ZH.V)	Para 2015	1	270,000	270,000	222,904	47,096
34.	Depo Paraspuar	Para 2015	1	9,521	9,521	7,860	1,661
35.	***Kolaudim "Kanali ujitës Mbrakull- Stacioni nr. 2 , Varreza bashkia Poliçan***	***15.8.2025***	***1***	***126,071***	***126,071***	***8,405***	***117,666***
36.	***Mbikëqyrje "Kanali ujitës Mbrakull- Stacioni nr. 2 , Varreza bashkia Poliçan***	**15.8.2025**	**1**	**841,128**	**841,128**	**56,075**	**785,053**
37.	***Pastrimi I kanalit vaditës Vodicë, NJA Vertop***	**14.08.2024**	**1**	**2,374,668**	**2,374,668**	**601,583**	**1,773,085**
38.	***Pastrimi i kanalit vaditës***	***21.7.2025***	***1***	***1,872,000***	***1,872,000***	***0***	***1,872,000***

Burimi: Bashkia Poliçan, Regjistri i aktiveve 2025

18.Konstatim:

Në inventarin e llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore"* rezultojnë 38 zëra të AAGJ të kësaj llogarie, me kosto historike 139,205,450 lekë dhe amortizim të akumuluar 110,026,475 lekë, të cilat janë asete të ujësjellësit. Nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në "Shoqërinë Rajonale UK Berat .Sha" , në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimi e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" Kreu II, pika 14; me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, si vijon:

Emërtimi aktivit	***viti***	***sasi***	***çmim***
Ujesjellsa Tozhar	Para 2015	1	4,969,992
Kanali i ujrave te larta lagja Lulaj	6/6/2001	1	3,663,260
Kanali i ujrave te zeza	4.7.2001 , 22.6.2003	1	9,642,941
Kanali i ujrave te bardha (Bulevardi kryesor) 2002	13.5.2002	1	5,345,961
Kanali i ujrave te bardha (sheshi i axhensise)	28/12/01 ,	1	9,533,677
Kanali i ujrave te zeza lagja Lavdar 2003	2003	1	3,571,736
Kanali i ujrave te zeza lagja Plirez 2003	2003	1	4,979,329
Ujesjellsa Tozhar	Para 2015	1	5,000,000
Rezervuar Terpan -	Para 2015	1	1,247,680
Rezervuar Paraspuar	Para 2015	1	627,030
Rezervuar Vokopol	Para 2015	1	4,323,000
Nritje uji Depo Paraspua Tepan	Para 2015	1	2,623,352
Ndert, rjeti shpernd.Parasp,Terpan	Para 2015	1	1,718,178
Blerje Pompa Stac,Depove.Terpan	Para 2015	1	1,269,600
Depo uji Lagja Selenic (ZH.V)	Para 2015	1	270,000
Depo Paraspuar	Para 2015	1	9,521
K.U.Z. Tubo betoni fi 400	25.01.2004	1	40,000
K.U.Z. Tubo betoni fi 600	25.01.2004	1	100,000
K.U.Z. Tubo betoni fi 500	25.01.2004	1	64,000
K.U.Z. Tubo betoni fi 200	25.01.2004	1	156,000
K.U.Z. Tubo betoni fi 300	25.01.2004	1	27,000
K.U.Z. Tubo betoni fi 700	25.01.2004	1	40,000
K.U.Z. Tubo betoni fi 200	25.01.2004	1	100,000
K.U.Z. Tubo betoni fi 407	25.01.2004	1	50,000
K.U.Z. Tubo betoni fi 300	25.01.2004	1	50,000
Puseta skeptike	25.01.2004	1	155,000

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" kreu II pika 14,

14. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat, me vullnet të lirë, lidhin marrëveshje bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, sipas pikës 1, të këtij vendimi, marrin ***masa për transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike të shoqërive aksionare ekzistuese te SKP-ja e krijuar me marrëveshje, në përputhje me legjislacionin në fuqi*** *për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe planin kombëtar të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve për riorganizimin e shoqërive ujësjellës kanalizime. Transferimi i veprimtarisë së parashikuar në këtë pikë bëhet me akt noterial, sipas formatit të parashikuar në*

lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i cili, pas nënshkrimit nga shoqëritë përkatëse, ***bëhet pjesë e pasqyrave financiare dhe mbahet nga pala që i ka kaluar transferimi****.*

dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 e 85; Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

19.Konstatim: Nga auditimi mbi rakordimin dhe kryqëzimi e informacionit konabël që regjistrohet në Pasqyrën e Performancës Financiare (Formati 2) dhe Pasqyrës së Flukseve Monetare (cash floë) në Formatin nr. 3, rezultoi se vlerat në zërat analitikë të pasqyruara, në disa raste nuk janë të sakta, si:

- Tek rubrika 3 *"Pagesa për detyrime e shpenzime korrente"të* Pasqyrës së Flukseve Monetare, pagesa për detyrime nga vitet e kaluara dhe detyrime e shpenzime të vitit ushtrimor, në mbyllje të vitit 2025 janë 442,339,430 lekë, ndërsa nga krahasimi me pagesat e kryera efektivisht për shpenzimet dhe detyrimet sipas tabelës së analizës së detyrimeve janë në vlerën 694,467,133 lekë, pra me një diferencë prej **252,127,703 lekë**, e cila është keqklasifikuar në zërin "Pagesa për detyrime e shpenzime të vitit" të kësaj rubrike.

Më hollësisht,

Pasqyra e Flukseve Monetare:

		31.12.2025	31.12.2024
Rubrika 3	**Pagesa për Detyrime e Shpenzime Korente**	**-442,339,430**	**-382,791,799**
	Për detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)	-19,511,223	-15,734,554
	Për detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-377,636,555	-361,206,085
	Pagesat për mjetet ne ruajtje(-)	-45,191,652	-5,851,160
	Interesi i paguar(-)	0	0
	Tatime te paguara(-)	0	0
	Te tjera te paguara (-)	0	0

Burimi: Bashkia Poliçan, Pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore 2025.

Nga ana tjetër, likuidimet sipas përgjigjeve të pyetësorit "Kërkesë për dokumentacion" të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Poliçan pagesat për shpenzime dhe detyrime sipas llogarive kontabël janë:

		31.12.2025
Nr.	**Pagesa për Detyrime e Shpenzime Korente sipas përgjigjeve të pyetësorit financiar**	**694,467,133**
1.	Likuidime llogaria 401-408 "Furnitorë dhe llogari të lidhura"-	325,288,386
2.	Pagesat për llog 42 "Personeli"	256,670,134
3.	Pagesat për llog 431 "Tatime e taksa"	11,445,526
4.	Pagesat për llog 435 "Sigurime shoqërore"	48,812,549
5.	Pagesat për llog 436 "Sigurime shëndetësore"	6,704,906
6.	Pagesat per llog 466 mjetet ne ruajtje	45,352,202
7.	Pagesa për shpronësime llog 4864	193,430

Burimi: Bashkia Poliçan, Përgjigjet e pyetësorit mbi pasqyrat financiare

- Tek rubrika 3 "*Të ardhurat jotatimore"*(llogaria 71) në rreshtin 34 të Pasqyrës së Performancës Financiare (Formati 2) në mbyllje të vitit 2025 është 82,189,903 lekë, ndërsa në Pasqyrës së Flukseve Monetare (cash floë) në Formatin nr. 3, janë në vlerën 86,900,433 lekë, pra me një diferencë prej **-4,701,530 lekë**, e cila është e pa rakorduar në zërin e të ardhurave të kësaj kategorie.

Më konkretisht,

Pasqyra e Performancës Financiare:

Nr llogarisë	*Emërtimi*	31.12.2025	31.12.2024
71	*III.TE ARDHURA JO TATIMORE*	82,198,903	45,458,016

Pasqyra e Flukseve Monetare:

Rubrika 6	*Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)*	86,900,433	44,912,016

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar me UMF nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III, pika 24.

20. Konstatim: Nga auditimi i *Pasqyrës së Pozicionit Financiar* u konstatua se teprica e llogarisë 231 "Për aktive afatgjata materiale" me datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën 113,635,580 lekë, ku sipas analizës dhe lëvizjeve në këtë llogari *pakësimet* janë në vlerën 157,988,925 lekë.
Në Pasqyrën nr.6 "Investime dhe burime e financimit" shuma *në kredi* të llogarisë 231 "Shpenzime për investime materiale" zëri shpenzimet e vitit paraqitet në kredi për 147,998,925 lekë, pra me një diferencë prej -9,990,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, kap 1.1, kap 2.1, kap.3.1 dhe Aneksi 1.

TË ARDHURAT

Për vitin 2025 totali i buxhetit është planifikuar në vlerën 768,020 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 658,772 mijë lekë në masën 85.8 %, ose me një mosrealizim në vlerën -109,248 mijë lekë.
Ky buxhet faktik përbëhet nga të ardhurat e veta në vlerën 114,016 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 170,104 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 91,568 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 97,029 mijë lekë dhe nga transferta e kushtëzuar për investimet në vlerën 186,053 mijë lekë. Nga auditimi i evidencave mbi realizimin e të ardhurave *(taksa e tarifa vendore)* për periudhën nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, konfirmuar nga Dega e Thesarit Skrapar u konstatua se të dhënat rakordojnë me ato të dhëna që janë të pasqyruara në formatin nr. 2, "Pasqyra e Performancës Financiare", të llogaridhënies vjetore. Në mënyrë të detajuar planifikimi dhe realizimi nga taksat dhe tarifat vendore paraqitet në aneksin nr. 1 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Analizuar sipas artikujve të shpenzimeve:
- Artikulli 600 "*Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli"* është planifikuar në vlerën 203,125, mijë lekë dhe realizuar në vlerën 197,537 mijë lekë ose në masën 97.2.% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 30,088 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 91,019 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 71,617 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 4,812. mijë lekë.
- Artikulli 601 *"Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore"* është planifikuar në vlerën 36,127 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 32,598 mijë lekë ose në masën 90.2% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 825 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 19,566 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 11,615 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 590 mijë lekë.
- Artikulli 602 "Mallra dhe shërbime të tjera" + Fondi Rezervë është planifikuar në vlerën 101,030 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 76,096 mijë lekë ose në masën 75.3 %; e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 26,654 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 43,725 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar specifike në vlerën 5,005 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 711 mijë lekë.
- Artikulli 604 "*Emergjencat civile"* është planifikuar në vlerën 2,998 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 2,998 mijë lekë ose në masën 100% nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 2,998 mijë lekë.
- Artikulli 606 "*Transferime për buxhete familjare dhe individë"* është planifikuar në vlerën 88,347 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 87,916 mijë lekë ose në masën 99.5 % nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 87,916 mijë lekë.
- Artikulli 230-231 *"Investime"* është planifikuar në vlerën 33 6,390mijë lekë dhe realizuar në vlerën 261,624 mijë lekë ose në masën 78% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 56,448 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 15,792 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar

specifike në vlerën 3,330 mijë lekë; nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 186,053 mijë lekë.
Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9 pika 1.3 gërma "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore"; UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe VKB përkatëse.

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

- **Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve"** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 167,522,396 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie është 198,087,276 lekë ose me një rritje në vlerën + 30,564,880 lekë.
- **Llogaria 601 "Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore"**, në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 28,959,597 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet për 32,724,016 lekë ose me një rritje në vlerën + 3,764,419 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Skrapar me të njëjtën vlerë.

2. Blerje mallra dhe shërbime: Kjo Llogari regjistron në debi të saj të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

- **Llogaria 602 "Blerje mallra dhe shërbime"**, në datë 31.12.2024, ka qenë në vlerën **84,455,648** lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 56,693,718 lekë ose me pakësim në vlerën -27,761,930 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Skrapar me të njëjtën vlerë.

3. Subvencionet (llog.603):

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Poliçan nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2025 deri më 31.12.202.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 "Transferime të brendshme"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 2,998,717 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.
Gjendja e llogarisë së fondeve **606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 91,476,130 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Për vitin 2025 totali i të ardhurave në vlerë është 737,251,436 lekë dhe totali shpenzimeve është lekë. Diferenca e tyre në vlerën 643,785,803 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 "Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor" në vlerën 93,465,633 lekë, (në reshtin 132 të F2 "Pasqyra e performancës financiare *(Klasifikimi sipas natyrës ekonomike)* dhe në reshtin 100 të F1 "Pasqyra e pozicionit financiar".

- **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Hartimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, kontrata, fatura të furnitorit, preventiva dhe situacione, fletëhyrje, listëpagesa, deklarimet mujore të tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.,. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.
Nga auditimi rezultoi se totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronte me regjistrimet e ditart kontabël. Nga verifikimi me zgjedhje i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore konstatohet se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të vitit ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë sistemi i duhur me artikull kontabël për llogaritë që nuk paraqiten në bilancin vjetor të Bashkisë.

22.Konstatim:

Nga auditimi i mbajtjes së kontabilitetit dhe funksionimit të sistemit të kontrollit dhe auditimi të brendshëm, nga shqyrtimi i ditarëve të bankës/thesarit për ana e Bashkisë Poliçan ***gjatë vitit 2025 janë 33 raste të anulimit të urdhër-shpenzimeve dhe 64 raste në vitin 2024***, duke ndikuar në vlerësimin e performances nga ana e MF si pjesë e sistemit të KB, ku performanca vjetore e këtij instituconi ka rënë me (- 6) pikë, ndryshimi në rankim krahasuar me vitin e mëparshëm, si në tabelë:

44	↓	(-2)	Bashkia Tropojë	28
45	↓	(-6)	Bashkia Poliçan	26
45	↑	(+1)	Bashkia Belsh	26
47	↓	(-26)	Bashkia Skrapar	25
48	↑	(+4)	Bashkia Delvinë	21
49		(-)	Bashkia Konispol	20

Burimi: MF, Raporti vjetor per SKNBFP, *Tabela 6. Rankimi i Bashkive të tjera sipas treguesve të performancës*

➢ **Veprimet nëpërmjet magazinës:**

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje konstatohet se veprimet ishin kontabilizuar saktë.
- Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga titullari i institucionit.
- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të m, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 30.bajtjes së ditarëve dhe partitarëve të kontabilitetit.
- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve,

të dëmtimeve apo humbjeve. Nga anan e Drejorisë së Financës dhe Buxhetit dhe magazinës janë kryer rakordimet periodike dhe janë kundërfirmuar vlerat e tepricave të llogarive materiale.

MBAJTJA E REGJISTRIT TË AKTIVEVE.

U auditua evidenca kontabël dhe mbajtja e të dhënave lidhur me aktivet afatgjata materiale e jomateriale, si dhe ato afatshkurtra rezultoi se, nga ana e Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ishte hartuar dhe depozituar në dosjen e PFV të v.2025. Në këtë dokument janë regjistruar të dhënat mbi emërtimin e aktivit, vitin e hyrjes së aktivit (në shumicën e radteve është vendosur shënimi para vitit 2015, pa saktësuar vitin e hyrjes së aktivit) , kosotn fillestare dhe amortizimin vjetor e progresiv, vlerën e mbetur të aktivit me dt. 31.12.2025, kalimet kapitale apo daljet nga përdorimi, normën dhe masën e amortizimit vjetor si dhe vlerën e mbetur të aktivit.

23.Konstatim:

a.- Regjistri i aktiveve nuk ka përfshirë të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale e jomateriale dhe afatshkurtra (**vlerën e plotë të tokës, pyjeve dhe kullotave, apo llogaritë e pjesëmarrjes në kapital)** dhe nuk. është i plotësuar me sipas kërkesave të Paragrafit nr.30, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Paragrafi 30

"*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia*.

Paragrafi 109

Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/ mbeturina/ materiale të ricikluesshme, *hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë* (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur.

*Në regjistrin e aktiveve mungojnë të dhënat mbi vlerën fillestare të aktivit në momentin e blerjes, data e hyrjes në përdorim***,(në shumë raste vendosur shënimi para vitit 2015),** *vlera e* ***shpenzimeve kapitale që i shtojnë vlerën aktivit dhe koha e kryerjes së këtij shpenzimi, datën e skadencës, vendndodhjen, personin përgjegjës etj.***

b. Nga analiza e gjendjes së llogarisë 218, konstatohet se në disa zëra, ***regjistri i aktiveve nuk paraqitet i detajuar me zëra analitike (nënllogari).*** Nga verifikimi i regjistrit të aktiveve konstatohet se ai nuk paraqitet në mënyrë të standardizuar, *pasi evidentohen përsëritje të emërtimeve të aktiveve si "Laboratori i Biologjisë", "Laboratori i Fizikës" dhe "Laboratori i Kimisë", pa sqarim nëse bëhet fjalë për aktive të ndryshme apo për ndarje të të njëjtit aktiv.* Gjithashtu, emërtimet e aktiveve *nuk janë të unifikuara dhe mungon përshkrimi i detajuar i përbërjes së tyre.* Kjo situatë krijon paqartësi në identifikimin unik të aktiveve dhe procesin e inventarizimit të aktiveve afatgjata.

Tabela nr.___Regjistri i Aktiveve, llogaria 218, viti 2025, *Në lekë*

Nr.	Emërtimi i aktivit	Data e hyrjes	Sasia	Çmimi	Norma e amortizimit	Shtesat e aktivit 2025
754	Kabineti Fizikës	15.04.2025	1	871,920	20%	871920
755	Laboratori I Biologjisë	15.04.2025	1	599,508	20%	599508
756	Laboratori I Kimisë	15.04.2025	1	128,588	20%	128588
757	Laboratori I Kimisë	15.04.2025	1	255,180	20%	255180

758	Laboratori I Biologjisë	15.04.2025	1	663,018	20%	663018
760	Laboratori I Fizikes	30.04.2025	1	1279740	20%	1279740

Burimi: Bashkia Poliçan, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

INVENTARIZIMI I PRONËS SHTETËRORE

Procesi i inventarizimit:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, neni 74, parashikojnë se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet invetarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)", Pasqyrën nr. 7/b, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)", kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjesimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.,

Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë z. A. Z., me nr. 457, datë 03.12.2025, të është ngritur *komisioni i inventarizimit të aktiveve materiale* për vitin 2025, me këtë përbërje:

- për NJA Poliçan i përbërë nga znj. K. R.- kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. G. F., z. I. B.
- për NJA Vërtop i përbërë nga z. K. K.- kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. L. H., z. I. B.
- për NJA Terpan i përbërë nga z. M. D.- kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. S. Q., z. I. B.

Me Urdhrin e Kryetarit Bashkisë nr. 248, datë 30.06.2025, të z. A. Z. është ngritur *komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të dëmtuara* për Bashkinë Poliçan i përbërë nga znj. F. H., kryetar i komisionit dhe anëtarët z. I. B. dhe znj. G. F.

Ky proces vlerësim aktivesh i përket aktiveve të rezultuara të dëmtuara në vitin 2024, por është realizuar përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2025. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, komisioni i sipërpërmendur ka hartuar raportin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, drejtuar titullarit të Bashkisë me shkresën nr. 1587/1 prot., datë 09.10.2025. Referuar të dhënave të raportit të vlerësimit janë evidentuar aktive të dëmtuara në vlerën totale prej 6,599,761 lekë dhe vlerë amortizimi 3,892536 lekë të klasifikuara sipas llogarive kontabël si më poshtë:

- Llogaria 327 "Inventar i imët" në vlerën 1,862,382 lekë;
- Llogaria 212 "Ndërtes" në vlerën 18,000 lekë;
- Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" në vlerën 206,899 lekë;
- Llogaria 218 "Inventar ekonomik" në vlerën 4,512,480 lekë;
- Llogaria 219 "Amortizim i AAGj i akumuluar" në vlerën 3,892,536 lekë.

Raporti është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Poliçan.

U verifikua përbërja e komisioneve të inventarizimit të pasurisë dhe vlerësimin e aktiveve materiale e jo materiale për vitin 2024 (miratuar me Urdhrin nr. 545, datë 11.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë z. A. Z. dhe përbërja e komisioneve të inventarizimit të pasurisë dhe vlerësimin e aktiveve materiale e jo materiale për vitin 2025 dhe rezultoi si në tabelën e mëposhtme:

Komisioni i Inventarizimit të aktiveve materiale për vitet 2024 dhe 2025:

Urdhri nr.545, datë 11.12.2024	Urdhri nr. 457, datë 03.12.2025
▪ Për Njësinë Administrative Poliçan:	Për Njësinë Administative Poliçan:
znj. G. F., kryetar i komsionit;	znj. K. S.-kryetar i komsionit
z. I. B., anëtar;	znj., G. F. anëtar,

znj. K. S., anëtar;
- Për Njësinë Administrative Vërtop:

z. F. XH., kryetar i komisonit;
z. K. K., anëtar;
z. A. SH., anëtar;
- Për Njësinë Administrative Teroan:

z. M. D., kryetar i komisionit;
znj. M. K., anëtar;
z. P. T., anëtar

z. I. B., anëtar;
Për Njësinë Administrative Vërtop:
z. K. K. kryetar i komisonit;
znj. L. H., anëtar;
z. I. B., anëtar;
Për Njësinë Administrative Teroan:
z. M. D., kryetar i komisionit;
znj. S. Q., anëtar;
z. I. B., anëtar

Me Urdhrin Kryetar i Bashkisë z. A. Z. me nr. 249, datë 30.06.2025, është krijuar *komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të rezultuara të dëmtuara nga inventarizimi i vitit 2024,* i përbërë nga z. E. B.- Kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M. XH., z. N. SH., z.R. B., znj. K. A. Ky proces i nxjerrjes nga përdorimi i aktiveve, lidhet me aktivet që kanë rezultuar të dëmtuara nga inventarizimi i vitit 2024. Pra nuk ka nxjerrje nga përdorimit të aktive e të dëmtuara sipas inventarit të vitit 2025.

Me shkresën nr. 1588/1 prot., datë 12.11.2025, nga komisioni i asgjësimit është hartuar raporti për procesin e asgjësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të dëmtuara drejtuar titullarit të institucionit. Në këtë dokumentacion citohet se: "Në bazë të procesverbaleve të komisionit ë inventarizimit dhe vlerësimit të materialeve të dëmtuara nga komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 248, datë 30.06.2025, të Kryetarit të Bashkisë Poliçan, komisioni pa në vend të gjitha aktivet e dëmtuara në prani të përgjegjësve material. Komisioni në përfundim të procesit të nxjerrjes nga përdorimi vendosi:
1. Materialet e dëmtuara prej druri i copëtoi dhe vendosi të përdoren për dru zjarri për kopshtet dhe çerdhet e bashkisë. Sasia e materialeve të kthyera është 7 m3".
2. Materialet e tjera i copëtoi, i theu dhe i groposi në vendin e hedhjes së mbeturinave të qytetit.

Në përfundim rezultoi se vlera e materialeve të dala jashtë përdorimit është në total **6,599,760 lekë** dhe amortizimin e akumuluar 3,892,536 lekë". Në pasqyrën nr. 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në rubrikën nxjerrje jashtë përdorimit është kryer pakësimi i llogarisë 212, 214, 218 në vlerën 4,737,379 lekë dhe llog. 327 për 1,862,382 lekë.

25.Konstatim:
a.-Procesi inventarizimit fizik të aktiveve, ka evidentuar disa mangësi të evidentuara në zbatimin e proceseve dhe procedurave të inventarizimit të pasurisë, lidhur me saktësinë dhe rregullshmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm.
- Përbërja e komisioneve të inventarizimit në dy vitet pa ndryshuar, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kapitulli IV, paragrafi 84, "Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision".

Urdhri nr.545, datë 11.12.2024
- Për Njësinë Administrative Poliçan:

znj. G. F., kryetar i komisionit;
z. I. B., anëtar;
znj. K. S., anëtar;
- Për Njësinë Administrative Vërtop:

z. F. XH., kryetar i komisionit;
z. K. K., anëtar;
z. A. SH., anëtar;
- Për Njësinë Administrative Terpan:

Urdhri nr. 457, datë 03.12.2025
Për Njësinë Administrative Poliçan:
znj. K. S.-kryetar i komisionit
znj., G. F. anëtar,
z. I. B., anëtar;
Për Njësinë Administrative Vërtop:
z. K. K. kryetar i komisonit;
znj. L. H., anëtar;
z. I. B., anëtar;
Për Njësinë Administrative Terpan:

z. M. D., kryetar i komisionit; znj. M. K., anëtar; z. P. T., anëtar	z. M. D., kryetar i komisionit; znj. S. Q., anëtar; z. I. B., anëtar

- Nuk ka gjetur dokumentim paragrafi nr.83 i UMF nr. 30, " Para fillimit të inventarit fiksohet *numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës.* Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material."
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk disponon të dhëna mbi kryerjen e inventarizimit fizik për Aktivet Afatgjata Materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214 përkatësisht për: Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtesa e konstruksione, rrugë, rrjete e vepra ujore, instalime teknike, makineri e pajisje, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. Nuk i janë nënshtruar inventarizimit zërat ***Ndërtesa dhe Rrugë, rrjete e ujësjellës***, por vetëm janë përfshirë si një zë i vetëm në përmbledhësen e inventarëve të vitit 2025, pa u zbërthyer analitikisht në zëra të veçantë.
- Nuk është kryer inventarizimi i Aktiveve Afatgjata Jomateriale, ***(llogaria 203 "Koncesione, licenca, patenta e të ngjashme")***, që paraqitet në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare me vlerën 18,179,165 lekë në fillim të vitit 2025 dhe 15,452,290 lekë në fund të kësaj periudhe). Nuk është hartuar dhe miratuar urdhri i titullarit të Bashkisë për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Jo materiale. Nuk janë bërë pjesë e procedurës së inventarizimit të nënshkruar nga ana e Komisionit të Inventarizimit të ***Aktiveve llogaria 231*** me vlerë 113,635,580 lekë, ku përfshihen zërin "Rikonstruksion dhe zgjerimi i ambienteve te Qendrës polivalente (Azili) Poliçan", me vlerë 93,635,580lekë dhe artikulli "Kanali ujitës Mbrakull- Stacioni nr.2, varreza Bashkia Poliçan", me vlerë 20,000,000 lekë.

b.- Nuk janë përfshirë në procesin e inventarizimit për vitin 2025, aktivet e kontabilizuara si inventarë të "Zonës B", që përfshin Kombinatin Mekanik Poliçan, transferuar sipas VKM nr 515, datë 19.09.2023 dhe marrë në dorëzim sipas akt dorëzimit nr 922 datë 23.07.2018.
Në përfundim të procedurës së inventarizimit të aktiveve të njësisë, në Bashkinë Poliçan nuk është hartuar nga Nëpunësi Zbatues dhe miratuar nga Nëpunësi Autorizues ***Regjistri i unifikuar i aktiveve të Bashkisë.*** Nga DFB, është hartuar vetëm regjistri elektronik i cili përfshin informacionin e plotë sipas kërkesave ligjore, mosveprime këto në kundërshtim me kreun II, Paragrafi III, pika 26, 27, 28 dhe Paragrafi IV pika 81, të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*" i ndryshuar;

*Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël t**ë të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim,** përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. **Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.***

-Nuk janë përfshrë në regjistrin e aktiveve, ***aktivet të cilat gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital***, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualit MFK*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 *"Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike",* Kreu III, paragrafi 28;

*28. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe **ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital.***

dhe Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 4/c:

*. Të gjitha aktivet e dhëna me qera, enfiteozë, koncesion, **nga pjesëmarrja në kapitalin e shoqërive tregetare, apo forma të tjera të përcaktuara** me ligj të përdorimit të pronës publike e të cilat krijojnë të ardhura.*

c.- Nga ana e Bashkisë së Poliçanit nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin e ***Strategjisë së menaxhimit të pronave publike vendore***, dhe "**Rregullores për menaxhimin e aktiveve"** si një dokument që miratohet nga Këshilli i Bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore për një periudhë afatmesme, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar.

d.- miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit; ç) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave neni 8, "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 8/ç:

ç*) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave;*

Manualit të MFK-së*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 *"Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike",* Kreu II, pika 17-25;

*5.Titullari i njësisë publike është përgjegjës për **miratimin e rregullave specifike dhe procedurave** për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.*
6.Mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari i njësisë publike, përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga Nëpunësi Autorizues në njësinë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh ***me rregulla të qarta dhe të dokumentuara.*** Çdo individ duhet të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivet e njësisë.

dhe pika 119:

*119. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të kritereve të mësipërme, **caktojnë rregulla të hollësishme për nxjerrjen nga përdorimi të llojeve të ndryshme të aktiveve...***

Kreu I, Pika 16 "Përgjegjësite e Grupit të Menaxhimit Strategjik":

16. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në lidhje me menaxhimin e aktiveve të njësisë dhe riskut të lidhur me to, të evidentuara gjatë takimeve periodike midis manaxherëve, i parashtrohen Grupit për Menaxhimin Strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe ***miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre***.

Nga ana e Komisionit të vlerësimit paraprak të aktiveve janë mbajtur proces verbalet për çdo njësi të strukturës e përfshirë në procesin e inventarizimit, në zbatim te pikës 85/a të Udhëzimit nr. 30/2011, por ka hartuar vetëm Relacionin përmbledhës mbështetur mbi shënimet tek kartela kontabël e vënë në dispozicion nga zyra e financës.

Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për : a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjëndjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe <u>pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në proçesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit..</u>

e.-. Nuk janë kërkuar dh administruar të dhënat brenda muajit Qershor të vitit 2025, nga shoqëritë tregtare në të cilat Bashkia zotëron kuota apo të drejta si dhe nga shoqëritë koncesionare me të cilat ka kontrata koncesioni, kopje të pasqyrave financiare vjetore të vitit paraardhës si dhe të vendimit të asamblesë se përgjithshme për miratimin e pasqyrave financiare, rezultatit vjetor dhe destinacionin e fitimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualit MFK*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu III, pika 32 dhe 33:

*32. Për nevoja të plotësimit të të dhënave në regjistër, njësia publike, brenda muajit Qershor të çdo viti, i kërkon **shoqërive tregtare në të cilat shteti zotëron kuota apo të drejta të tjera** e që janë*

në administrim të njësisë publike, kopje të pasqyrave financiare vjetore të vitit paraardhës si dhe të vendimit të asamblesë se përgjithshme për miratimin e pasqyrave financiare, rezultatit vjetor dhe destinacionin e fitimit.
*33. Për nevoja të plotësimit të të dhënave në regjistër, dhe analizës njësia publike, brenda muajit Qershor të çdo viti, i kërkon **shoqërive koncesionare** me të cilat ka kontrata koncesioni, të depozitojnë në autoritetin kontraktor një kopje të pasqyrave financiare vjetore, pasqyrën e llogaritjes dhe shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit, të shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pagesën si dhe llogaritjen e parashikimit të detyrimeve për vitin ushtrimor në vazhdim.*

Përfundime:

Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin e përgjithshëm të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në Bashkinë e Poliçanit, sipas kërkesave të legjislacionit mbi menaxhimin e sistemit buxhetor dhe atij financiar e të kontrollit dhe kontabilitetit, etj. ka rezultuar se përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në këtë njësi shpenzuese buxhetore, në përgjithësi është realizuar në mbështetje të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara edhe shoqërohen me relacion shpjegues. (*pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare*).

Nga ana tjetër, krahas punës së bërë kanë rezultuar disa mangësi dhe parregullsi, të identifikuara në aktin e konstatimit, në lidhje me mos kontabilizimin e vlerës së truallit, apo kreditorëve të lidhura me shlyerjen në afat të detyrimeve të prapambetura; risku i parashkrimit të të drejtave për arkëtim nga debitorët; mangësi në hartimin e regjistrit të aktiveve apo procedurave të inventarizimit të pasurisë, etj., qëduhet të jenë në vëmendjen e strukturave menaxheriale të institucionit për përmirësimet e nevojshme në të ardhmen.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. Z. Kryetar i Bashkisë Poliçan në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. F. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare.

4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

-Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me VKB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2023 – 31.12.2025), janë realizuar gjithsej **30** procedura me vlerë të lartë me fond limit 680,710 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur pa TVSh 651,397 mijë lekë, me një diferencë prej 29,313 mijë lekë ose 4%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Lloji i procedurës	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
Procedurat e zhvilluara për vitin 2023					
Procedurë e hapur;	4	190,804,134	188,206,515	2,597,619	1%
E hapur e thjeshtuar	6	15,182,670	14,021,145	1,161,525	8%
Prokurim me vlerë të vogël.	41	19,105,609	15,975,417	3,130,192	16%
SHUMA	**51**	**225,092,413**	**218,230,007**	**6,889,326**	**3%**
Procedurat e zhvilluara për vitin 2024					
Procedurë e hapur;	**5**	216,668,749	201,439,968	15,228,781	**7%**
E hapur e thjeshtuar	**7**	20,670,567	19,946,868	723,699	**4%**
Prokurim me vlerë të vogël.	**40**	15,600,949	13,660,665	1,940,284	**12%**
SHUMA	**52**	**252,940,265**	**235,504,501**	**17,892,764**	**7%**
Procedurat e zhvilluara për vitin 2025					
Procedurë e hapur;	**3**	225,260,034	216,044,547	9,215,487	**4%**
E hapur e thjeshtuar	**5**	12,124,806	11,738,224	386,582	**3%**
Prokurim me vlerë të vogël.	**44**	20,238,099	17,085,045	3,153,054	**16%**
SHUMA	**52**	**257,622,939**	**244,867,816**	**12,755,123**	**5%**

Nga grupi mbi bazën e materialitetit janë vlerësuar për auditim 8 procedura nga 30 të realizuara me vlerë të fondit limit 565,780 mijë lekë ose 83 % e fondit të prokuruar. Nga 8 procedura të audituara janë konstatuar problematika në kritere, në 7 rast kriteret e vendosura nuk janë argumentuar në procedurën me objekt: "Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare "70 Vjetori i Pavarësisë" dhe sistemimi i jashtëm i gjithë kompleksit Arsimor" me vlerë kontrate 98,417,338 lekë pa TVSh; “Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i rrugëve të varrezat e vjetra, lagjia Kalluç dhe pallati katër katësh Poliçan” me vlerë kontrate 16,540,770 lekë pa TVSh;"Mbrojtje lumore gjatësore e tokave bujqësore nga lumi Osum, fshati Vodice, Polican ” me vlerë kontrate 56,760,640 lekë pa TVSh;“Rikonstruksioni i rrugeve te fshatrave Terpan, Teman dhe fshatrave te tjera ne Njesinë Administrative Terpan” me vlerë kontrate 77,638,308 lekë pa TVSh;"Mbrojtje lumore gjatësore e tokave bujqësore nga lumi Osum, fshati Vodice, Polican” me vlerë kontrate 78,004,950 lekë pa TVSh; “Asfaltimi i Rrugës Tërpan- Teman, Njësia Administrative Tërpan” me vlerë kontrate 64,644,800 lekë pa TVSh si dhe "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i ambienteve të Qendrës

Polivalente të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për të moshuarit Polican" me vlerë kontrate 137,219,747 lekë pa TVSh; si dhe në 2 procedura u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Poliçan, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kritereve të vendosura në DT, *si më poshtë vijon:*

1. Auditimi i procedurës me objekt: Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "70 Vjetori i Pavaresise" dhe sistemimi i jashtem i gjithe kompleksit Arsimor 2023

<table>
<tr><td colspan="4">a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "70 Vjetori i Pavaresise" dhe sistemimi i jashtem i gjithe kompleksit Arsimor</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
“Procedure e hapur ”
REF-74346-07-05-2023
Urdhri nr.31 prot., datë 04.07.2023</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit jane hartuar nga njesia e prokurimit
Urdhri nr.31 datë 04.07.2023
F. A.
K. R.
S. S.</td><td>2 Njësia e Prokurimit
Urdhri nr.31 datë 04.07.2023.

F. A.-inxhinier
K. R. -ekonomiste
S. S.-juriste (p.p)</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr.1829 prot., datë 04.07.2023
I. G.
O. N.
G. F.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa tvsh) 100,000,000 Lekë pa TVSH.</td><td colspan="2">5. Oferta fituese, vlera fituese:
Operatori Fitues: Bashkimin e operatoreve ekonomik “B. “ shpk NIPT dhe “Z.” shpk NIPT J.....K , 98,417,338 lekë pa tvsh</td><td>6. Diferenca me fondin limit
1,582,662 lekë pa tvsh</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:
Data 28.07.2023
07.08.2024</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi Financimit
bashkëfinancim nga buxheti i shtetit me vlerë financimi 2023-2024 dhe buxheti i bashkisë 2024-2025 si me poshte: Shuma 85,000,000 lekë pa tvsh dhe 102,000 000 (njëqind e dy milion) lekë me tvsh nga të cilat 51,000,000 (pesëdhjetë e një milion lekë me tvsh në vitin 2023 dhe 51,000,000 (pesëdhjete e një milion) lekë me tvsh në vitin 2024 sipas shkresës së MAS nr 3124/5 prot ,datë 09.06.2023.
Shuma 15,000,000 (pesëmbedhjete milion) lekë pa tvsh dhe 18,000,000 (tetëmbedhjetë milion) lekë me tvsh nga buxheti i bashkisë Poliçan me cikël financimi 10,000,000 (dhjetë milion lekë me tvsh) në vitin 2024 dhe 8,000,000 (tetë milion lekë) në vitin 2025 sipas VKB nr. 08 datë 26.06.2023.</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike
a)Pjesëmarrës në tender, 4(kater) OE
b) S’kualifikuar 3 (tre) B/OE,
c) Kualifikuar 1(një)B/OE</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime AK-s’ka/ka; S’ka APP–s’ka/ka; S’ka KPP-s’ka/ka S’ka</td><td colspan="2">11. Data e lidhjes të kontratës:
Nr. 1828/16 prot., datë 07.09.2023</td><td>12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK</td></tr>
</table>

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përllogaritjen e Fondit Limit” :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur komisioni me urdhrin nr.31 datë 04.07.2023“Për verifikimin dhe kontrollin e vlerës së preventivit e dokumentacionit teknik të dhuruar nga shoqëria projektuese “N. S.” SHPK. si dhe hartimi i kritereve teknike dhe ekonomike”, i përbërë nga F. A. inxhinier, K. R. –ekonomiste, S. S. –juriste (personi pergjegjës). Sipas procesverbalit nr 1828/2 dhe procesverbalit nr 1828/3 datë 04.07.2023, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike i është referuar dokumentacioni teknik të dhuruar nga shoqeria “N. S.” SHPK. për investimin e objektit : **Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "70 Vjetori i Pavaresise" dhe sistemimi i jashtem i gjithe kompleksit Arsimor**, i cili pasi është verifikuar nga ing Z. F. A. duke përllogaritur si fond limit vlerën e preventivit të hartuar nga shoqëria dhuruese, e cila rezulton të jetë **100,000,000** lekë pa TVSH.

Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":
Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej z. F. A.-inxhinier (specialist fushe) znj. K. R. –ekonomiste dhe znj. S. S. –juriste (personi përgjegjës) për vijimin e procedures në SPE, janë evidentuar në procesverbalin nr. 1828/4 prot të datës 04.07.2023.
Më datë 11.07.2023, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Poliçan, rezulton se: Për procedurën me **REF-74346-07-05-2023**, me objekt "**Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "70 Vjetori i Pavaresise" dhe sistemimi i jashtem i gjithe kompleksit Arsimore**" me fond limit **100,000,000** lekë pa Tvsh, ka sygjeruar disa kritere të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.
Me shkresën nr. 1828/8 datë 13.07.2023, nga NjP është mbajtur procesverbali për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, ku është hartuar shtojca në DT .

Nga auditimi i procesverbalit nr 1828/4 prot të datës 04.07.2023 konstatohet se:
Në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *"Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë),* - 1 (një) Arkitekt dhe 1 (një) Inxhinier Ndertimi
Në lidhje me kërkesën për arkitekt, sqarojmë se në dokumentet e procedurës së prokurimit AK ka publikuar njëherazi "Preventivin e punimeve", "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit", duke i vënë në dispozicion, informacionin operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi projektin të cilët këto të fundit do të zbatojnë në rast të fitimit të kontratës. Disponueshmëria si pjesë e stafit teknik të një arkiktekti në fazën e zbatimit të punimeve, ku ndër të tjera autoriteti kontrakor ka kërkuar referuar kritereve të veçanta të kualifikimit pjesë të stafit teknik, inxhinierët, si ndërtimi, hidroteknik, mekanik, gjeodet, elektrik, mjedisi, shkon përtej synimit të AK dhe njëherazi nuk është në proprocion me natyrën dhe volumin e kontratës. Disponueshmëria e një arkitekti referuar natyrës së punimeve dhe duke marrë në konsideratë faktin se AK ka parashikuar në mënyrë të detajuar projektin e zbatimit, specifikimet teknike, nuk shfaqet e nevojshme në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve.
Në pikën 2.3.8 të DST, është kërkuar nga Operatori Ekonomik që të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë, ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi/me subjekte të specializuara për këtë qellim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë.
Sipas grupit të auditimit: *konstatohet se nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kritereve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Ispektorati i Punës etj.,) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.*
- Në vendosjen e këtij kriteri nuk është të mbajtur në konsideratë VKM nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: F. A.-inxhinier (specialist fushe) dhe S. S. –juriste (personi pergjegjes).

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4(kater) OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 1828/10 Prot, të datës 07.08.2023 KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	Bashkimin e operatoreve ekonomik "B. " shpk NIPT J.....Q dhe Z. SHPK. NIPT J.....K ,	98,417,338 lekë pa tvsh	Kualifikuar
2	Shoqërisë "2." shpk NIPT L.....L	*76,000,000* lekë pa tvsh	S'kualifikuar Shoqeria "2." nuk ploteson kriterin teknik te DST pika 2.3.1 dhe 2.3.2 pervoje e sukseshme ne pune te ngjashme, pasi vlera monetare totale e punëve të kryera, te marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet si dhe nuk ka asnje pune te ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë me te madhe se 50 000 000 (pesedhjete milion) leke pa tvsh . *2.*Per disa pune te ngjashme te cilat kane plotesuar afatin e garancise 5% nuk eshte ngarkuar cerifikata perfundimtare e marrjes ne dorezim te punimeve . 3. Kontrata me nr. rendor 3 Pune_e_ngjashme LERE UJI BASHKIA_DIBER me vlere 1.000.000 lekë pa tvsh , dhe kontrata me nr. Rendor 4 Pune_e_ngjashme Kanalet Ujitese Diber me vlere 3.643.795 pa tvsh , kane metodologji te ndërtimit të tyre te ndryshme, dhe nuk jane kontrata te ngjashme me objektin e rikonstruksion shkolle , pasi nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës nëse ajo është një kontratë pune publike, por nuk ka asnje zë konkretë të punimeve të kryera. Në rastin konkret, pavarësisht se kontratat janë punë publike me objekte të gjëra veprimtarie, në zbatimin e këtyre kontratave, lere uji dhe kanal vadites , nuk ka patur punime të ngjashme me një pjesë të rëndësishme të punimeve objekt prokurimi. Ne keto kushte , keto dy kontrata nuk mund të konsiderohen aspak si kontrata të ngjashme, por edhe nese i pranojme si pune te ngashme, perseri nuk përmbushet vlerën prej 2 fish i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
3	Bashkimi i operatoreve ekonomik Shoqërisë "E. K." SHPK. NIPT K.....I dhe C. SHPK. NIPT J.....E	*77 010 256.05 (*shtatëdhjetë e shtatë milion e dhjetë mijë e dyqindë e pesëdhjetë e gjashtë pikë zero pesë	S'kualifikuar; Në zbatim të nenit 84 pika 2 të ligjit 162/2020 " Per prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 90 "*Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera*" , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, mungon Marrëveshja e Angazhimi midis palës mbështetëse "O. B. K." SHPK. dhe palës së mbështetur "E. K. " SHPK. . **2.** Nuk ploteson kriterin 2.3.10 te DST pasi mungojne raportet e testimit te pllakave dhe bordurave te betonit te kontrates noteriale të furnizimit me beton dhe pllaka betoni me nr. 3724 Rep dhe 969 kol datë 04.08.2023 me furnizues GJ. **3.** Nuk ploteson kriterin 2.3.10 te DST pasi kontrata noterialee qirase nr.1336 rep dhe 355 kol datë 17.03.2023 , kontrata noteriale e qirase nr.12373 rep

			dhe 633/3kol datë 7.06.2023, kontrata noteriale e qirase nr.670 rep dhe 504 kol datë 26.03.2023, kontrata noteriale e qirase nr.931 rep dhe 683 kol datë 30.04.2023 , kontrata noteriale e qirase nr.803 rep dhe 596 kol datë 13.04.2019. nuk plotësojne afatin e vlefshmërisë për gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve Per mjetin Greider 1 COPE nuk jane specifikuar të dhënat në formularin e vetdeklarimit. **4.** Nuk ploteson kriterin e vecante nr.2.3.1 dhe 2.3.2 të punës së ngjashme të cilat rezultojnë më mangësira si më poshtë: - Puna e ngjashme me objekt " Rikonstruksion godine 11-12" , marrëveshja e bashkimit të përkohshëm dhe prokura e posacme nuk janë dokumenta origjinale apo të noterizuara si dhe mungon detajimi i zërave të punimeve sipas përqindjes që ka marr përsipër shoqëria "E. K.". Për këtë objekt nuk është paraqitur në SPE certifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve në përfundim të afatit të garancisë 12 mujore . Faturat tatimore nr.92129259 e situacionit përfundimtar nr.5 nuk përputhet data e faturës 2.12.2020 me datën e përfundimit të punimeve dhe procesverbalin e përfundimit të punimeve 31.08.2020, si dhe gjithë faturat e tjera janë të padëshifruara , nuk dallohet saktë data, numri dhe shuma në lek e faturës . - Puna e ngjashme me objekt " Ndërtim shkollës 9 vjecare "Kosovë" Tiranë " , mungon detajimi i zërave të punimeve sipas përqindjes që ka marr përsipër shoqëria "E. K." Për këtë objekt nuk është paraqitur në SPE certifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve në përfundim të afatit të garancisë 24 mujore . Faturat tatimore janë të padëshifruara , nuk dallohet saktë data, numri dhe shuma në lek e faturës - Puna e ngjashme me objekt " Godinë banimi dhe shërbimi 7-9 kate plus 2 kate parkim nëntokësor " , mungon kontrata e sipërmarrjes . - Puna e ngjashme me objekt "Rehabilitimi dhe vitalizimi I korpusit dhe I terreneve sportive shkolles "H.Tasini, Sarande " , nuk është paraqitur në SPE certifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve në përfundim të afatit të garancisë 12 mujore . Faturat tatimore nuk janë dokumenta origjinale apo të noterizuara , janë të padëshifruara , nuk dallohet saktë data, numri dhe shuma në lek e faturës . - Puna e ngjashme me objekt "Rikonstruksioni i shkollës mesme Leonik Tomeo" . Për këtë objekt nuk është paraqitur në SPE certifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve në përfundim të afatit të garancisë 24 mujore . - Puna e ngjashme me objekt "Rikonstruksioni I shkollës 9 vjecare Vllahin + shtesë kati' Për këtë objekt nuk është paraqitur në SPE certifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve në përfundim të afatit të garancisë 12 mujore. **5.** Referuar shtojces 8 te formularit te vetëdeklarimit eshte vetdeklaruar kontrata nr.1242 rep dhe 533 kol datë 21.05.2020 me furnizues shoqëria "F.H." me objekt impiant betoni (vetdeklaruar bashkëlidhur në SPE) . Nga verifikimi i sistemit ky dokument nuk është

			bashkëlidhur në SPE dhe nuk eshte vene ne dispozicion KVO per njohje te përmbajtjes se documentit kontratës së furnizimit, lejes mjedisore (QKL) etj . Bashkimi i operatoreve ekonomik nuk ka paraqitur dokument provues prane AK pas sqarimit te kerkuara nga kjo e fundit .Per rrjedhoj ky ofertues skualifikohet pasi nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.1, 2.3.2, 2.3.10 të Kapaciteti teknik"në dokumentat standarte të tenderit, për procedurën e prokurimit , dhe ne referim te VKM-se nr.285 date 19.05.2021.
4.	"F. C." SHPK.	0;	S'kualifikuar; Nuk ka ngarkuar ne SPE anje dokumentacion te pergjithshem dhe te vecante ligjor, ekonomik, Teknik dhe per rrjedhoj nuk ploteson asnje kriter te pergjithshem dhe te vecante te dokumentave standarte te tenderit.

Nga auditimi rezultoi se:

KVO referuar shkresës nr. 2143 prot., datë 09.08.2023 ka njoftuar OE "2." SHPK. "Për sqarim dhe njohje me dokumentacionin provues" pas verifikimit të shtojcës 8 të formularit të vetëdeklarimit. Shoqëria "2." SHPK. ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 2143/1 prot datë 14.08.2023 dukë dhënë sqarim për pikat e kërkuara nga KVO.

KVO me shkresën nr. 2148 prot., datë 10.08.2023 ka njoftuar BOE "E. K." dhe "C." SHPK. "Për sqarim dhe njohje me dokumentacionin provues" pas verifikimit të shtojcës 8 të formularit të vetëdeklarimit i cili nuk ka reaguar.

KVO me shkresën nr. 2155 prot., datë 11.08.2023 ka njoftuar BOE B. dhe "Për sqarim dhe njohje me dokumentacionin provues" pas verifikimit të shtojcës 8 të formularit të vetëdeklarimit. BOE "B." dhe "Z. " SHPK. kan kthyer përgjigje me shkresën nr. 2155/1 prot datë 16.08.2023 dukë dhënë sqarim për pikat e kërkuara nga KVO. Procedura e ndjekur dhe vlersimi I dokumentacionit të paraqitu nga OE dhe BOE janë pasqyruar në procesverbalin e vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave me shkresën nr. 1828/11 prot., datë 17.08.2023 Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 29.08.2023., në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 (katër) operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 3 (tre) OE, dhe kualifikuar 1(një) OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 05.05.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë Bashkimin e operatoreve ekonomik "B. " shpk NIPT J.....Q dhe Z. SHPK. NIPT J.....K , për të cilën është lidhur kontrata datë **07.09.2023** për vlerën 98,417, lekë pa tvsh dhe vlera 118,100,806 lekë me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nnshrimit të kontratës.

2. Auditimi i procedurës me objekt: Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i rrugëve të varrezat e vjetra,lagjia Kalluç dhe pallati katër katësh Poliçan.2023

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i rrugëve të varrezat e vjetra,lagjia Kalluç dhe pallati katër katësh Poliçan.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Procedure e hapur " **REF -60334-02-24-2023** Urdhri nr.11 prot., datë 21.02.2023	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Urdhri nr.372 datë 30.12.2022 1. F. A. 2. K. R. 3. S. S.	**2 Njësia e Prokurimit** • F. A.-inxhinier • K. R. -ekonomiste • S. S.-juriste (p.p)	**3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr.78 prot., datë 21.02.2023 • I. G. • O. N. • G. F.

4. Fondi Limit (pa tvsh) **16 666 407** leke()Lek pa TVSH.	**5. Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: "Z." SHPK. 16,540,770 () lekë pa TVSH	**6. Diferenca me fondin limit** 125 637 () lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 28.03.2023	**8. Burimi Financimit** Nga te ardhurat e bashkise	**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender, **4(kater) OE** b) S'kualifikuar **3 (tre) B/OE,** c) Kualifikuar 1(një)**B/OE**
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës		
10.Ankimime AK-s'ka/ka**; S'ka APP–**s'ka/ka**; S'ka KPP**-s'ka/ka **S'ka**	**11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 1284 prot., datë 10.05.2023**	**12.**P**ërgjigje** Ankesës nga APP, AK apo **KKP: AK**

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përllogaritjen e Fondit Limit" :
Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur komision paraprak me urdhrin nr. 372 datë 30.12.2022 "Për verifikimin dhe kontrollin e vlerës së preventivit e dokumentacionit teknik të dhuruar nga shoqëria projektuese "XH. M." SHPK si dhe hartimi i kritereve teknike dhe ekonomike ", i përbërë nga F. A. inxhinier, K. R. – ekonomiste , S. S. –juriste (personi përgjegjës).
Sipas procesverbalit nr 544/2 dhe procesverbalit nr 544/3 datë 21.02.2023 , konstatohet se komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike i është referuar dokumentacioni teknik të dhuruar nga shoqëria "XH. M." SHPK për investimin e objektit :*Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i rrugëve të varrezat e vjetra, lagjia Kalluç dhe pallati katër katësh Poliçan*, i cili është kontrolluar dhe verifikuar nga ing Z.F. A. nëse është konformë akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, duke përllogaritur si fond limit në vlerën **16,666,407** lekë pa TVSH.

Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":
Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (kriteret teknike nga F. A.-inxhinier (specialist fushe), kriteret ekonomike K. R. –ekonomiste dhe kriteret juridike znj. S. S. –juriste (personi përgjegjës) të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 21.02.2023, si dhe janë argumentuar dhe miratuar përmes procesverbalit nr 544/4 prot të datës 21.02.2023.
Më datë 01.03.2023, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Poliçan, rezulton se: Për procedurën me REF -60334-02-24-2023, me objekt "Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i rrugëve të varrezat e vjetra, lagjia Kalluç dhe pallati katër katësh Poliçan." me fond limit 16,666,407 lekë pa Tvsh, ka sygjeruar disa kritere të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.
Me shkresën nr. 798/1 datë 16.03.2023, nga NjP është mbajtur procesverbali për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, për të cilën është hartuar një shtojcë në DT
Për sa trajtuar më sipër, kriteret e aplikuara në DT sipas shkresës nr 544/4 prot të datës 21.02.2023, ndryshuar me shtojcat e sipërcituara janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.
Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4(kater) OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 544/9 Prot, të datës 05.04.2023 KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	"Z. "SHPK.., me NUIS J.....K	16,540,770 lekë pa TVSH	Kualifikuar
2		*0*	S'kualifikuar

	1. “F. “SHPK., NUIS K.....C		• Nuk ka paraqitur ne SPE asnje dokumentacion ligjor, ekonomik, teknik
3	L. “K. “ SHPK., NUIS K.....H	13,149,766 lekë pa TVSH	S’kualifikuar; • Nga momenti që ofertuesit i është dërguar kërkesa për *dorëzimin e dokumenteve provuese, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar* operatori ekonomik “L. K.” SHPK., me NUIS K.....H, nuk i është përgjigjur kërkesës së KVO-së dhe nuk ka dorëzuar dokumentacionin provues pranë Autoritetit Kontraktor.
3.	A. “C.” SHPK.. NUIS K.....C	13,707,400 lekë pa TVSH;	S’kualifikuar; • Nga momenti që ofertuesit i është dërguar kërkesa për *dorëzimin e dokumenteve provuese, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar* operatori ekonomik “A. C.” SHPK. me NUIS K.....C nuk i është përgjigjur kërkesës së KVO-së dhe nuk ka dorëzuar dokumentacionin provues pranë Autoritetit Kontraktor.

<u>Nga auditimi rezultoi se</u>:

Së pari: Nga KVO është mbajtur procesverbal me nr. 644/9 prot., datë 05.04.2023 për hapje dhe vlerësim procedure, sipas afateve ligjore, të përcaktuara në nenin 80 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 për “RrPP”, i ndryshuar; ku janë kualifikuar 3 OE (“L. K.” SHPK me vlerë oferte 13,149,766 lekë pa TVSH, “A. C.“ SHPK. me vlerë oferte 13,707,400 lekë pa TVSH dhe “Z.” SHPK.. me vlerë oferte 16,540,770 lekë pa TVSH) si dhe ka skualifikuar Operatorin ekonomik “F.” SHPK. pasi nuk ka paraqitur ofert.

Së dyti Mbas përfundimit të vlersimit KVO referuar procesverbalit nr. 644/9 prot., datë 05.04.2023 ka njoftuar OE “L. K.” SHPK i renditur i pari për paraqitjen e dokumentacionit fizik sipas shkresës nr 974 prot datë 05.04.2023 dhe postës elektronike brenda 5 ditve pas përfundimit të vlersimit të ofertave i cili deri më 13.04.2023 nuk i është përgjigjur ofertës. Në përfundim të afateve dhe mozdorzimit të dokumentacionit KVO ka mbajtur procesverbalin nr. 644/10 prot datë 13.04.2023 në të cilën ka pershkruar të gjithë procedurën dhe ka vazhduar me shpalljen e fituesit të OE “A. C.” SHPK. sipas shkresës nr. 1047 prot datë 13.04.2023 dhe deri më datë 24.04.2023 nuk i është përgjigjur ofertës. KVO ka mbajtur procesverbalin nr. 644/11 prot datë 24.04.2023 në të cilën ka pershkruar të gjithë procedurën dhe ka vazhduar me shpalljen e fituesit të ka vazhduar me njoftimin e OE “Z.” SHPK.., sipas shkresës nr. 1118 prot., datë 24.04.2023.

Së Treti nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 05.05.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas Raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 (katër) operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 3 (tre) OE, dhe është kualifikuar 1(një) OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 05.05.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “Z.” SHPK.., me NUIS J.....K, me të cilën është lidhur kontrata datë 10.05.2023 për vlerën 16,540,770 lekë pa TVSH dhe vlera 19,848,924 (Nentembedhjete milion e teteqind e dyzete e tete mij e nenteqind e njezet e kater lekë me TVSH dhe me afat 6 (gjashtë) muaj nga data e nnshrimit të kontratës

Konkluzion: *Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

<u>3. Auditimi i procedurës me objekt: " Mbrojtje lumore gjatesore nga lumi Osum , fshati Mbrakull, Poliçan”</u>

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Mbrojtje lumore gjatesore e tokave bujqesore nga lumi Osum, fshati Vodice, Polican ”

1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Procedure e hapur" REF-72471-06-14-2023 Urdhri nr. 26 prot., datë 14.06. 2023	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 274, datë 25.05.2023 • F. A. (sp fushe)	2 Njësia e Prokurimit • F. A. (inxhinier specialist fushe) • S. S. -juriste • K. R.-ekonomiste	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 297 prot., datë 02.07.2024, i ndryshuar • O. N.-ing • I. G.-ark • G. F.-ekonomist
4. Fondi Limit (pa tvsh) 57,567,958 lekë pa TVSH.	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: "*A. K." SHPK.*, me NUIS J.....R, 56,760,640 lekë pa TVSH.		6. Diferenca me fondin limit 807,318 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 06.07.2023 7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 4 muaj nga hyrja ne kantierin e ndertimit	8. Burimi Financimit Burimi i financimit:Nga buxheti i shtetit		9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) S'kualifikuar-1 (nje) c) Kualifikuar 1(nje)
10.Ankimime AK-s'ka/ka; S'ka APP–s'ka/ka; S'ka KPP-s'ka/ka S'ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.2117 prot., datë 07.08.2023		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përllogaritjen e Fondit Limit" :
Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur urdheri nr. 274 datë 25.05.2023 ku është caktuar z. F. A., Drejtor i Dreitorisë së Planifikimit të Territorit për marrjen në dorëzim të gjithë dokumentacionit teknik të hartuar nga shoqëria projektuese Shoqëria "A. M." për objektin "*Mbrojtje lumore gjatësore nga lumi Osum, fshati Mbrakull,Poliçan"* si, projekt preventive, grafik punime, specifikime teknike, relacioni teknik, analizat teknike, ka dokumentuar me procesverbal të posaçëm verifikimin dhe kontrollin e vlerës se preventivit se bashku me zerat e punimeve bazuar në VKM-ne nr 629 date 15.07.2015 "Per Miratimine Manualeve Teknike të Cmimeve të Ndertimit dhe analizat teknike tëe tyre" i ndryshuar duke argumentuar vleren e preventivit në vlerën 57,567,958 lekë pa TVSH e cila sherben edhe si fond limit i procedurës së prokurimit.
Specifikimet teknike, perllogaritja e fondit limit; kerkesave për kualilikim, lidhur me kapacitetin teknik i jane dorezuar personit pergjegjes S. S. nga specialist i fushes inxhinieri F. A. me procesverbalin nr 1434/2 prot date 25.05.2023 dhe kriteret e veçanta ekonomike jane hartuar nga ekonomisti, K. R.

Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":
Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (kriteret teknike nga F. A.-inxhinier (specialist fushe), kriteret ekonomike K. R.-ekonomiste dhe S. S. –juriste (personi pergjegjes) të cilat janë evidentuar në procesverbalin nr 1434/2 e datës 25.05.2023 si dhe jane argumentuar dhe miratuar permes procesverbalit nr 1608/2 të datës 14.06.2023
Nga auditimi i procesverbalit nr 1608/2 të datës 14.06.2023 konstatohet se:
Në pikën 2.3.7 të DST, është kërkuar nga Operatori Ekonomik që të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë, ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi/me subjekte të specializuara për këtë qellim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret

e VKM Nr. 742 date 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit .

Sipas grupit të auditimit: *konstatohet se nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kritereve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Ispektorati i Punës etj.,) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.*

- Në vendosjen e këtij kriteri nuk është të mbajtur në konsideratë VKM nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Në pikën 2.3.9 të DST, është kërkuar total prej 4 ekskavatorësh, nga të cilët 2 me goma, 2 me zinxhirë me krahë mbi 15 m, janë kërkesa të paargumentuara. Sipas projekt preventivit, vlera e gërmimeve është përrreth 8187 m^3 gërmime. Referuar vlerës dhe volumit, kërkesa për 4 ekskavatorë rezulton relativisht e lartë dhe e paargumentuar. Gjithashtu specifikimet për mjetet ekskavator me zinxhir me krahë mbi 15 metër, si dhe kërkesa për dy Autopompa betoni janë specifikime të cilat nuk argumentohen me me zërat e preventivit në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", **neni 78, pika 2** "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

*- **Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.*". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "*Kriterei për shpalljen e ofertës fituese*". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "*Për prokurimin publik*", sipas të cilit: " *4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese...*".

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: F. A.-inxhinier (specialist fushe) dhe S. S. –juriste (personi pergjegjes).

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2(dy) OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 1542/11 të datës 29.07.2024, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	"A. K." SHPK.	56,760,640 lekë pa TVSH.	Kualifikuar

2	BOE “A. C.” SHPK. & “F.” SHPK.	49,414,155 lekë pa TVSH;	S’kualifikuar; Nga momenti që ofertuesit i është dërguar kërkesa për *dorëzimin e dokumenteve provuese, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,*bashkimi i operatoreve ekonomik BOE “A. C. “ SHPK. NUIS K.....Cdhe F. SHPK. me NUIS K.....C nuk i janë përgjigjur kërkesës së KVO-së dhe nuk ka dorëzuar dokumentacionin provues pranë Autoritetit Kontraktor. BOE“A.C.”SHPK.NUIS K.....C dhe “F.” SHPK. me NUIS K.....C nuk ploteson kriterin sipas pikes2.3.1te DST për përvojën e mëparshme të ngjashme **te punes** “F.” SHPK. me NUIS K.....C rezulton me detyrime te pashlyera ndaj Bashkise Polican.

<u>Nga auditimi rezultoi se</u>:

- Nga KVO është mbajtur procesverbal me nr. 1608/7 prot., datë 06.07.2023 për hapje dhe vlerësim procedure, sipas afateve ligjore, të përcaktuara në nenin 80 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 për “RrPP”, i ndryshuar; KVO me shkresën nr. 1880 prot., datë 11.07.2023 i ka kërkuar sqarim BOE “F.” & “A. C.” ShPK në lidhje me plotësimin e kriterit të pikës 2.3.9 si dhe referuar marveshjes së bashkëpunimit të datës 05.07.2023 i cili nuk ka reaguar. Në vijim KVO ka mbajtur Raporti përmbledhës më datë 19.07.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës është s’kualifikuar 1 OE, dhe kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 19.07.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “*A. K.” SHPK.*, me NUIS J.....R, me të cilën është lidhur kontrata datë **07.08.2023** për vlerën 56,760,640 lekë pa TVSH dhe vlera 68,112,768 lekë me TVSH, dhe me afat 4 muaj nga hyrja në kantierin e ndertimit.

Konkluzion: *Arrihet në përfundimin se skualifikimi i OE është i drejt dhe se operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

<u>4. Auditimi i procedurës me objekt: Rikonstruksioni i rrugeve të fshatrave Terpan, Teman dhe fshatrave të tjera ne Njesinë Administrative Terpan 2024</u>

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *“Rikonstruksioni i rrugeve te fshatrave Terpan, Teman dhe fshatrave te tjera ne Njesinë Administrative Terpan*			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedure e hapur ” REF-**03787-05-07-2024** Urdhri nr.19 prot., datë 03.05.2024	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Urdhri nr.175, datë 03.05.2024 4. F. A. 5. XH. M. 6. A.C. 7. G. F.	**2 Njësia e Prokurimit** • F. A. • XH. M. • A.C. • G. F. • D. Z.	**3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr.176 prot., datë 03.05.2024. • O. N. • S. S. • R. Z. • A. S.

	8. D. Z.		• K. R.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 88,333,333 **lekë pa TVSH.**.	**5. Oferta fituese, vlera fituese:** "A." SHPK. Operatori Fitues: 77,638,308 lekë pa tvsh.		**6. Diferenca me fondin limit** 10,695,025 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 10.06.2024	**8. Burimi Financimit** Nga te ardhurat e bashkise		**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender, **3(tre) OE** b) S'kualifikuar **1 (nje) B/OE,** c) Kualifikuar 2(dy)**B/OE**
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga hyrja ne kantier			
10.Ankimime AK-s'ka/ka**; S'ka APP–**s'ka/ka**; S'ka KPP-**s'ka/ka **S'ka**	**11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 1600 prot., datë 08.07.2024**		**12.Përgjigje** Ankesës nga APP, AK apo **KKP: AK**

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përllogaritjen e Fondit Limit" :
Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 175 datë 03.05.2024 "Për krijimin e komisionit të hartimit të kritereve teknike , ekonomike , specifikimeve teknike pjese e se ciles është edhe llogaritja e fondit limit", i përbërë nga F. A.(specialist fushe), XH. M. (anetare), A.C.- ekonomiste (anetare), G. F.-ekonomiste (anetare), D. Z.-Juriste (person Pergjegjes)
Sipas procesverbalit të datës 1030/1 , datë 03.05.2024, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike i është referuar dokumentacioni teknik të hartuar nga shoqeria "N. S." SHPK. & "A. M." SHPK. për investimin e objektit " *Rikonstruksioni i rrugeve të fshatrave Terpan, Teman dhe fshatrave te tjera në Njesinë Administrative Terpan* " i cili pasi është kontrolluar dhe verifikuar nga ing Z.F. A. nëse është konformë akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, së bashku me XH. M.(drejtoreshe e Sherbimeve Publike) kanë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, duke përllogaritur si fond limit vlerën e preventivit të hartuar nga shoqëria "N. S." SHPK. & "A. M. " SHPK., e cila rezulton të jetë 88,333,333 leke pa TVSH.

Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":
Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (kriteret teknike nga F. A.-inxhinier (specialist fushe) dhe XH. M.(drejtoreshe e Drejtorise se Sherbimeve Publike), kriteret ekonomike A.C.-ekonomiste dhe G. F. –ekonomiste, dorezuar D. Z.-juriste (personi përgjegjës) për vijimin e procedures në SPE, të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 03.05.2024, si dhe jane argumentuar dhe miratuar permes procesverbalit nr 1031/2 prot të datës 07.05.2024 si më poshtë;

Nga auditimi i procesverbalit nr. 1608/2 të datës 14.06.2023 konstatohet se:
Në pikën 2.32 të DST*, ndër të tjera janë kërkuar kategori licence NS-18 C Punime topogjeodezike. Sipas grupit të auditimit dhe në konsultim me inxhinierin e grupit, këto kategori licence nuk përputhen me tipologjinë e procedurës, kjo për faktin se referuar zërave të preventivit nuk ka asnjë zë që argumentin këto linesa, ku kategoria N.S – 18/c- Punime topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*
Në pikën 2.3.6/d të DST, është kërkuar nga Operatori Ekonomik që të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë, ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi/me subjekte të specializuara

për këtë qellim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr. 742 date 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit .

<u>Sipas grupit të auditimit:</u> *konstatohet se nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kritereve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Ispektorati i Punës etj.,) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.*

- Në vendosjen e këtij kriteri nuk është të mbajtur në konsideratë VKM nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Në pikën 2.3.9 të DST, është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të disponoje në pronesi, qira ose kontratë bashkepunimi impiantet si me poshte vijon:

a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte

b. 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit te inerteve/betonit, ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) .Ne rast se impianti i prodhimit te inerteve/betonit, eshte me qera ose kontrate bashkepunimi duhet te paraqitet kontrata e qerase/bashkëpunimit e vlefshme per periudhen tone te zbatimit te punimeve .

Kriteret e vendosura në kërkesat e pikes 2.3.9 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërisht pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave nuk janë në pronësi të ofertuesit rezulton se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, per te cilen duhet te paraqesin dokumentcionin e pronesise/kontraten e qerase/kontraten e furnizimit shoqeruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, <u>u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurent në këtë procedur prokurimi.</u> Nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar i cili përcakton se:

"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës" .

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: z. F. A.-inxhinier (specialist fushe) XH. M.(drejtoreshe e Drejtorise se Sherbimeve Publike) dhe znj. D. Z. –juriste (personi përgjegjës)

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3(tre) OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 1031/10 Prot, të datës 12.06.2024, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	"A. " K.....P & "U." J.....O	*72,545,200* lekë pa tvsh	Kualifikuar
2	"L. "	77,638,308 lekë pa tvsh	Kualifikuar
3	"Sh." K.....N		S'kualifikuar; Nuk ka paraqitur formularin e ofertes ekonomike ne dokumentacionin e ngarkuar ne sistem.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 03.07.2024, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3 (tre) operatorë pjesëmarrës është s'kualifikuar 1 (një) OE, janë kualifikuar 2 (dy) OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 03.07.2024 ka shpallur fituese BOE "A." SHPK. me NUIS K.....P dhe U. SHPK me NUIS J.....O, me të cilën është lidhur kontrata datë 08.07.2024 për vlerën 72,545,200 lekë pa TVSH dhe vlera 87,054,240 lekë me TVSH, dhe me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj.
Konkluzion: *Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

5. Mbrojtje lumore gjatesore e tokave bujqesore nga lumi Osum, fshati Vodice, Polican "2024

<table>
<tr><td colspan="4">a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Mbrojtje lumore gjatesore e tokave bujqesore nga lumi Osum, fshati Vodice, Polican "</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"Procedure e hapur"
REF-11893-07-02-2024
Urdhri nr. 26 prot., datë 02.07.2024</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Urdhri nr. 296, datë 02.07.2024
• F. A.(sp fushe)
• A. C.(ekonomiste)
• D.Z.(juriste Person përgjegjës
• S. S. -juriste
• K. R.-ekonomiste</td><td>2 Njësia e Prokurimit
• F. A.(inxhinier specialist fushe)
• A.C. (ekonomiste)
• D. Z.(juriste Person përgjegjës
• S. S. -juriste
• K. R.-ekonomiste</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 297 prot., datë 02.07.2024, i ndryshuar
• O. N.-ing
• A. I.-juriste
• S. GJ.-ekonomist
• A. S.-ing
• M. XH.-juriste</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa tvsh)
80,133,019 lekë pa TVSH</td><td colspan="2">5. Oferta fituese, vlera fituese:
Operatori Fitues: BOE "T." SHPK. me NIPT ;K.....G dhe "M." SHPK. 78,004,950 lekë pa tvsh.</td><td>6. Diferenca me fondin limit
2,128,069 lekë pa tvsh</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:
Data 18.07.2024
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj nga hyrja ne kantierin e ndertimit</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Burimi i financimit: nga buxheti i shtetit me cikel financimi 2024-2025. Vlera e financimit për vitin 2024 është 42,783,993 (Dyzete e dy milion e shtateqind e tetedhjete e tre mijë e nenteqind e nentedhjete e tre) lekë pa tvsh dhe vlera e financimit për vitin 2025 është 37,349,026 lekë pa tvsh.</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a)Pjesëmarrës në tender, 2 OE
1.BOE "A. C." SHPK. & "2. K." SHPK. &"N." SHPK.
2. BOE "T." SHPK. & "M." SHPK.
b) S'kualifikuar 1 BOE,</td></tr>
</table>

		1.BOE "A. C. "SHPK. & "2. K. "SHPK. &"N." SHPK. c) Kualifikuar 1 **BOE 1. BOE** "T." SHPK. & "M. " SHPK.
10.Ankimime AK-s'ka/ka**; S'ka APP**–s'ka/ka**; S'ka KPP**-s'ka/ka **S'ka**	**11. Data e lidhjes të kontratës:** **Nr. 1903 prot., datë 15.08.2024**	**12.P<u>ë</u>rgjigje** Ankesës nga APP, AK apo **KKP: AK**

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përllogaritjen e Fondit Limit" :
Sipas procesverbalit të datës 02.07.2024, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe për përllogaritjen e fondit limit i është referuar dokumentacioni teknik te dhuruar nga N. M. për investimin e objektit "Mbrojtje lumore gjatësore e tokave bujqësore nga lumi Osum, fshati Vodice, Polican " i cili pasi është kontrolluar dhe verifikuar nga ing Z.F. A. nëse është konformë akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, duke përllogaritur si fond limit vlerën e preventivit të hartuar nga dhuruesja , i cila rezulton të jetë 80,133,019 (tetëdhjetëmilion e njëqind e tridhjete e tre mijë e nëntëmbedhjetë lekë) pa TVSH
Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 296 datë 02.07.2024 " Për ngritjen e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike , kritereve teknike dhe kritereve ekonomike dhe perllogaritjes se fondit limit", i përbërë nga F. A. inxhinier (specialist fushe), A.C. -ekonomiste , K. R.-ekonomiste, D. Z.-juriste (personi pergjegjes) S. S. -juriste.

Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":
Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (kriteret teknike nga F. A.-inxhinier (specialist fushe), kriteret ekonomike A.C.-ekonomiste, K. R.-ekonomiste kriteret juridike nga S. S. –juriste dhe D. Z.-juriste (personi përgjegjës) të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 1541/1, si dhe janë argumentuar dhe miratuar përmes procesverbalit të datës 02.07.2024 të cilat janë si më poshtë.

<u>Nga auditimi i procesverbalit nr. 1608/2 të datës 14.06.2023 konstatohet se:</u>
Në pikën 2.3.6/b të DST, është kërkuar nga Operatori Ekonomik që të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë, ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi/me subjekte të specializuara për këtë qellim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr. 742 date 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit .
<u>Sipas grupit të auditimit:</u> *konstatohet se nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kritereve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Ispektorati i Punës etj.,) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.*
- Në vendosjen e këtij kriteri nuk është të mbajtur në konsideratë VKM nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, "Për aftësitë që duhet të

plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Në pikën 2.3.7 të DST, është kërkuar total prej 6 autobetoniere, 2 autopompa të cilat janë kërkesa të paargumentuara nga OE me preventivin. Sipas projekt preventivit, vlera e betonit në preventive është përrreth 2030 m^3. Referuar vlerës dhe volumit, kërkesa për 6 kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton, rezulton relativisht e lartë dhe e paargumentuar. Gjithashtu specifikimet për mjetet ekskavator me zinxhir me krahë mbi 18 metër janë specifikime të cilat nuk argumentohen me me zërat e preventivit në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", **neni 78, pika 2** "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*
- ***Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.*". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "*Kriteri për shpalljen e ofertës fituese*". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "*Për prokurimin publik*", sipas të cilit: " *4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese...*".
Në pikën 2.3.9 të DST, është kërkuar **2.3.9** Operatori ekonomik duhet te disponoje ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi impiantet si me poshte vijon:
a. 1 (nje) Impiant prodhimi Inerte
b. 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni
Për impiantin e prodhimit te inerteve/betonit, ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) .Ne rast se impianti i prodhimit te inerteve/betonit, eshte me qera ose kontrate bashkepunimi duhet te paraqitet kontrata e qerase/bashkëpunimit e vlefshme per periudhen tone te zbatimit te punimeve.
Kriteret e vendosura në kërkesat e pikes 2.3.9 nuk janë të argumentuar teknikisht dhe ligjërisht pasi në rastet kur fabrika e betonit - elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave nuk janë në pronësi të ofertuesit rezulton se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, per te cilen duhet te paraqesin dokumentcionin e pronesise/kontraten e qerase/kontraten e furnizimit shoqeruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurent në këtë procedur prokurimi. Nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar i cili përcakton se:

"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës" .

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: z. F. A.-inxhinier (specialist fushe) znj S. S. –juriste dhe znj. D. Z. –juriste (personi përgjegjës).

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.
Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2(dy) OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 1542/11 të datës 29.07.2024, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	BOE "*T." SHPK. & "*M." SHPK.	78,004,950 leke pa tvsh	Kualifikuar
2	**BOE** "A. C." SHPK. &"2. K. " SHPK. &"N." SHPK.	66,188,000 leke pa tvsh	S'kualifikuar; 1-Kriteri I punes se ngjashme sipas *Pika 2.3.1. b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet* nuk plotesohet nga BOE e operatoreve ekonomik pasi mbledhja e puneve te vleshme te ngjashme eshte ne vleren 133.287.669 leke pa tvsh kur ne DST eshte kerkuar te jete 160 266 038 leke pa tvsh. 1/a-Gjithashtu ky kriter nuk plotesohet as nga operatori ekonomik "A. C." SHPK.sipas perqindjes se punimeve do te kryej 45.8 % dhe punen e ngjashme nuk e ka sa dyfishi i kesaj vlere. 2.*Kriteri i percaktuar ne piken 2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e kontratës objekt prokurimi,* nuk perputhet pasi operatori ekonomik 2Z Konstruksion nuk ka ngarkuar ne sisten xhiro vjetore per asnje vit te kerkuar.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 08.08.2024, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 1 OE, janë kualifikuar 1OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 08.08.2024 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë BOE "*T."* dhe "M." për të cilën është lidhur kontrata datë **15.08.2024** për vlerën 78,004,950 (shtatëdhjetë e tetë milion e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH dhe vlera 93,605,940 (nëntëdhjet e tre miljon e gjashtëqind e pesë mijë e nëntëqind e dyzetë) lekë me TVSH, dhe me afat 6 (gjashte) muaj nga hyrja në kantier.

Konkluzion: *Arrihet në përfundimin se skualifikimi i OE është i drejt dhe se operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.*

6. Auditimi i procedurës me objekt: "Blerje materiale ndërtimi për nevojat e bashkisë Polican

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Blerje materiale ndërtimi për nevojat e bashkisë Polican*

1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Procedure e hapur " **REF:96223-02-23-2024** Urdhri nr.12 prot., datë 19.02.2024	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit** Urdhri nr.25, datë 23.01.2024 9. F. A. 10. A.C. 11. D. Z.	**2 Njësia e Prokurimit** • F. A. • A.C. • D. Z.	**3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr.70 prot., datë 20.02.2024. • O. N. • XH. M. • S. GJ.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 18,813,755 lekë pa TVSH.	**5. Oferta fituese, vlera fituese:** Operatori Fitues: "M." me nipt J.....V *17,677,650* lekë pa tvsh		**6. Diferenca me fondin limit** 1,136,105 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 13.03.2024 **7/2 Kohëzgjatja e** kontratës: 12 muaj nga hyrja ne kantier	**8. Burimi Financimit** Nga te ardhurat e bashkise		**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender, **3(tre) OE** b) S'kualifikuar **1 (nje) B/OE,** c) Kualifikuar 2(dy)**B/OE**
10.Ankimime **AK-**s'ka/ka**; S'ka** **APP–**s'ka/ka**; S'ka** **KPP-**s'ka/ka **S'ka**	**11. Data e lidhjes të kontratës:** **Nr. 912 prot., datë 18.04.2024**		**12.P<u>ë</u>rgjigje** Ankesës nga APP, AK apo **KKP: AK**

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përllogaritjen e Fondit Limit" :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me Urdhrin nr.25, datë 23.01.2024"Për krijimin e komisionit të përllogaritjes se fondit limit, hartimit te kritereve teknike , ekonomike , specifikimeve teknike ". i përbërë nga z. F. A. – specialist fushe, inxhinier (ka detyren e përllogaritjes së fondit limit, kritereve teknike dhe specifikimeve teknike) znj. A.C.-ekonomiste (ka detyrë të hartoj dhe argumentoj kriteret ekonomike), znj. D. Z.-juriste (personi përgjegjës i prokurimeve). Sipas procesverbalit nr. 195/1 të datës 23.01.2024 të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e "*hartimit të preventivit me çmim analize"* i cili rezulton të jetë 18,813,755 (tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë lekë pa tvsh referuar specifikimeve teknike të mallrave .

Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (kriteret teknike nga z. F. A.-inxhinier (specialist fushe), kriteret ekonomike znj. A.C.-ekonomiste dhe znj. D. Z.-juriste (personi përgjegjës) për vijimin e procedurës në SPE , janë evidentuar në procesverbalin e datës 23.01.2024, si dhe janë argumentuar dhe miratuar përmes procesverbalit nr. 446/2 prot të datës 23.02.2024.

Referuar dokumentacionit në dosje, në lidhje me aplikimin e kritereve kualifikuse, konstatohet se kriteret janë në përputhje me dispozitat e LPP, dhe me nenin 78, pika 2 VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3(tre) OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 446/8 Prot, të datës 25.03.2024, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	"M." J.....V	*17,677,650* lekë pa tvsh	Kualifikuar

2	"F." K.....C	18,526,200 lekë pa tvsh	Kualifikuar
3	"K." J.....H	18,632,520 lekë pa tvsh	S'kualifikuar; 1. OE nuk ploteson kriterin e shtojces 8 te kritereve te vecanta. 2. OE nuk ploteson kriterin e vecante sipas pikes 1.b) pasi nuk ka paraqitur formularin e sigurimit te ofertes. 3. OE nuk ploteson kriterin 2.2.1 pasi nuk ka paraqitur vertetim për xhiron vjetore te tre viteve .4. OE nuk ploteson kriterin 2.2.2 pasi nuk ka paraqitur bilancet vjetore te tre viteve . 5. OE nuk ploteson kriterin 2.2.3 pasi nuk ka paraqitur vertetim per njesia vendore per taksat vendore te vitit 2023 6. OE nuk ploteson kriterin 2.3.1 pasi nuk ka paraqitur deshmi per furnizime te meparshme te ngjashme. 7. OE nuk ploteson kriterin 2.3.2 pasi nuk ka paraqitur vertetim per disponim te mjeteve . 8. OE nuk ploteson kriterin 2.3.3 pasi nuk ka paraqitur deklarate qe merr persiper transportin e mallrave . 9. OE nuk ploteson kriterin 2.3.4 pasi nuk ka paraqitur deklarate qe merr persiper transportin e mallrave sipas standarteve CE/ekuvailente .

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 15.04.2024, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 3 (tre) operatorë pjesëmarrës është s'kualifikuar 1 (një) OE, janë kualifikuar 2 (dy) OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 15.04.2024 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "M." për të cilën është lidhur kontrata datë 18.04.2024 për vlerën *17,677,650* lekë pa tvsh dhe vlerën 21,213,180 *me TVSH* dhe afat nga data e nënshkrimit të kontrates deri në perfundimin e sasise totale të mallit, me levrimeve pjesore të mallerave sipas kerkesave të AK .

*Në lidhje me vlerësimin e OE fitues "*M." *ShPK, nga auditimi konstatohet se vlerësimi i KVO-së është i saktë dhe në zbatim të dispozitave të LPP, pasi OE i shpallur fitues është në plotësim të kritereve të DST, dhe me ofertë më të leverdishme se OE e tjerë në pjesmarrës.*

7. Auditimi i procedurës me objekt: "Asfaltimi I Rrugës Tërpan- Teman, Njësia Administrative Tërpan", Bashkia .

<table>
<tr><td colspan="4">a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Asfaltimi I Rrugës Tërpan- Teman, Njësia Administrative Tërpan", Bashkia</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"Procedure e hapur "
REF: 71939-12-12-2025
Urdhri nr. 55 prot. , datë 09.12.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Urdhrinr.459datë 09.12.2025
• F. A.
• A. S.</td><td>2 Njësia e Prokurimit
• F. A.
• A. S.
• A.C.
• K. R.
• D. Z.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 460 prot., datë 09.12.2025.
• O. N.
• I. C.
• A. I.
• G. F.
• M. XH.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa tvsh)
67,664,493 lekë pa tvsh</td><td colspan="2">5. Oferta fituese, vlera fituese:
Operatori Fitues: "A." SHPK. & "E. K.' SHPK
Oferta fituese <u>64,644,800</u> lekë pa tvsh.</td><td>6. Diferenca me fondin limit
3,019,693 lekë pa tvsh</td></tr>
</table>

7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 30.12.2025 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 2 muaj nga data e nenshkrimit te kontrates**	**8. Burimi Financimit** buxheti I Bashkise dhe në bashkëfinancim me Keshillin e Qarkut për prokurimin me objekt: "Asfaltimin e Rrugës Tërpan- Teman, Njësia Administrative Tërpan", Bashkia . -Fondi i përllogaritur për vitin buxhetor 2025 është : 33,161,940 lekë pa TVSH, nga te cilat nga financuar nga Keshilli i Qarkut ne buxhetin e bashkise ne vleren 24,383,779 lekë pa tvsh dhe nga buxheti I bashkise Polican ne vleren 8,778,161leke pa tvsh. -Fondi i përllogaritur për vitin buxhetor 2026 është: 19,669,582 lekë pa TVSH, nga te cilat nga financuar nga Keshilli i Qarkut ne buxhetin e bashkise ne vleren 4,063,963 lekë pa tvsh dhe nga buxheti i Bashkisë Polican në vlerën 15,605,619 leke pa tvsh. -Fondi i përllogaritur për vitin buxhetor 2027 është: 14,832,971 lekë pa TVSH, nga të cilat nga financuar nga Keshilli i Qarkut ne buxhetin e bashkise në vlerën 5,386,348 lekë pa tvsh dhe nga buxheti i Bashkisë Polican në vleren 9,446,623 lekë pa tvsh.	**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender, 1.BOE "A." SHPK. & "K." SHPK 2. "G." SHPK J....V 3. BOE " L." SHPK & "V. "SHPK 4. "S." SHPK J.....G 5. "S." SHPK K.....N b) S'kualifikuar 1 "G." SHPK , NUIS J.....V 2 BOE " L." SHPK & "V." SHPK 3. "S." SHPK Nuis. J.....G 4." S." SHPK , NUIS K.....N c) Kualifikuar 1.BOE "A." SHPK. &"E. K. " SHPK
10.Ankimime **AK**-s'ka **APP–**s'ka **KPP**-s'ka	**11. Data e lidhjes të kontratës:** **Nr. 563 prot., datë 27.02.2026**	**12.P<u>ë</u>rgjigje** Ankesës nga APP, AK apo **KKP: AK**

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përllogaritjen e Fondit Limit" :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 459 datë 09.12.2025 "Për ngritjen e komisionit për kontrollin e dokumentacionit teknik te dhuruar , hartimit te kritereve teknike dhe kritereve ekonomike", i përbërë nga F. A.- inxhinier, A. S.-inxhinier, A.C.-ekonomiste , K. R.-ekonomiste, D. Z.-juriste. Sipas procesverbalit të datës 3012/2, datë 09.12.2025, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përllogaritjen e fondit limit i eshte referuar dokumentacioni teknik te dhuruar nga shoqeria " N. S." SHPK. për investimin e objektit "Asfaltimi i Rrugës Tërpan- Teman, Njësia Administrative Tërpan", Bashkia " i cili pasi është kontrolluar dhe verifikuar nga ing Z.F. A. dhe ing Z.A. S. nëse është konformë akteve ligjore dhe nënligjore ne fuqi , janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, duke përllogaritur si fond limit vlerën e preventivit të hartuar nga shkoqëria dhuruese, e cila rezulton të jetë **67,664,493** lekë pa tvsh.

Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision me Urdhri nr. 55 prot., datë 09.12.2025"Për krijimin e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike", i përbërë prej,

- F. A.-inxhinier (specialist fushe)
- A. S.-inxhinier
- A.C.-ekonomiste
- K. R. -ekonomiste
- D. Z.-juriste (personi përgjegjës)

Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (kriteret teknike nga F. A.-inxhinier (specialist fushe) dhe A. S.-inxhinier, kriteret ekonomike A.C.-ekonomiste dhe K. R. – ekonomiste dorezuar D. Z.-juriste (personi përgjegjës) të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 09.12.2025, si dhe jane argumentuar dhe miratuar permes procesverbalit te dates 12.12.2025 si më poshtë;

<u>Nga auditimi i procesverbalit të datës 09.12.2025 konstatohet se:</u>

Në pikën 2.32 të DST*, ndër të tjera janë kërkuar kategori licence NS-18 A Punime topogjeodezike. Sipas grupit të auditimit dhe në konsultim me inxhinierin e grupit, këto kategori licence nuk përputhen me tipologjinë e procedurës, kjo për faktin se referuar zërave të preventivit nuk ka asnjë*

zë që argumentin këto linesa, ku kategoria N.S – 18/A- Punime topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Në pikën 2.3.6/d të DST, është kërkuar nga Operatori Ekonomik që të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë, ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi/me subjekte të specializuara për këtë qellim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr. 742 date 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit .

<u>Sipas grupit të auditimit:</u> *konstatohet se nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kritereve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Ispektorati i Punës etj.,) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.*

- Në vendosjen e këtij kriteri nuk është të mbajtur në konsideratë VKM nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Në pikën 2.3.7 të DST, është kërkuar total prej 5 Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes nga 10 deri mbi 20 ton, të cilët nuk janë argumentuar sipas zërave të punimeve. Gjithashtu janë kërkuar 2 Autobetoniere e me kapacitet mbajtes 2-4 m3 (mjet teknologik me goma), 1 Damper me kapacitet mbajtes mbi 30 t (mjet teknologik me goma), 1 Autopompe Betoni, 1 Batipal si dhe Minidumper me kapacitet mbajtës 2-4 m3 (mjet teknologik me goma) janë kërkesa specifikime të cilat nuk argumentohen me me zërat e preventivit në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", **neni 78, pika 2** "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, <u>kriteret për shpalljen e ofertës fituese</u> ... bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*

*- <u>**Në çdo rast**, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.</u>*". Konstatohet se nuk ka asnjë argumentim në lidhje me kriterin kryesor të procedurës së prokurimit, i cili është "*Kriterei për shpalljen e ofertës fituese*". Janë konstatuar shkelje të **nenit 87 pika 2 dhe 4**, të Ligjit nr. 162/2020, "*Për prokurimin publik*", sipas të cilit: " *4- Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese...*".

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: F. A.-inxhinier (specialist fushe)
A. S.-inxhinier dhe D. Z.–juriste (personi përgjegjës).

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.
Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 3017/7, të datës 15.01.2026, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	**BOE:** "A." sh.p.k" K.....P "E. K." sh.p.k K.....I	64,644,800	Kualifikuar
2	"G." sh.p.k J.....V	49,895,100	S'kualifikuar; ➢ Operatori ekonomik "**G."** **S**HPK **nuk përmbush kërkesat e kriterit 2.3.7 të Dokumenteve Standarde të Tenderit**, lidhur me disponueshmërinë e mjeteve teknologjike.Konkretisht: • Damper me kapacitet mbajtes mbi 30 t(mjet teknologik me goma) • Minidumper me kapacitet mbajtës 2-4 m3(mjet teknologik me goma
3	**BOE:** "L." sh.p.k" L.....F "V. " sh.p.k J61902509S	57,670,050.6	S'kualifikuar; BOE "L." SHPK, me NUIS L.....F dhe "V." SHPK me NUIS J.....S nuk ploteson kriteret e pergjithshme dhe te vecanta teknike, ekonomike, ligjore pasi bazuar në **pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021** "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ky operator nuk i është përgjigjur kërkesës së KVO-së dhe nuk ka dorëzuar dokumentacionin provues fizik pranë Autoritetit Kontraktor. Në kushtet kur afati në dispozicion të ofertuesit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar sipas detyrimeve ligjore, është tejkaluar, eshte s'kualifikua oferta e paraqitur nga BOE .
4	"S. " sh.p.k J.....G	55,500,000	S'kualifikuar; OE "S." SHPK me NUIS **J**.....**G** nuk ploteson kriterin e ofertes ekonomike sipas shtojces perkatese ne DST pasi nuk ka perllogaritur saktë preventivin e dorezuar ne SPE duke shtuar fondin rezerve. Në përfundim oferta vlersohet e pavlefshme.
5	"S. " sh.p.k K.....N	66,000,000	S'kualifikuar; Operatori ekonomik "**S." SHPK me NUIS K**.....**N** nuk plotëson pikën *2.3.7 të kritereve të veçanta të DST-ve, pasi* konstatohen mungesa te mjeteve në formularin përmbedhës sipas shtojcës 8 të dorëzuar nga ky operator ekonomik si me poshte: - Autobetoniere e me kapacitet mbajtes 2-4 m3(mjet teknologik me goma), (Cope 1) - Koke terheqese (Cope 1) - Autobot Uji (Cope 1) - Minidumper me kapacitet mbajtës 2-4 m3(mjet teknologik me goma) (Cope 1) - Rrul gome-gome (Cope 1) - Autobitumatrice (Cope 1)

Nga verifikimi i procesverbalit nr. 3017/7, të datës 15.01.2026, KVO-ja ka kualifikuar 3 operator ekonomik "G." SHPK me vlerë oferte 49,895,100 lekë pa tvsh, BOE "L." SHPK & "V." SHPK me vlerë oferte 57,670,050 lekë pa tvsh dhe BOE "A." SHPK. &"E. K." SHPK me vlerë oferte

64,644,800 lekë pa tvsh si dhe ka sualifikuar 2 operator ekonomik respektivisht "S." SHPK me vlerë oferte 55,500,000 lekë pa tvsh dhe "S." SHPK me vlerë oferte 66,000,000 lekë pa tvsh.

Në vijim të procedurave KVO me shkresën nr. 3017/8 prot., datë 15.01.2026 i është drejtuar OE "G." SHPK me vlerë oferte 49,895,100 lekë pa tvsh për dorzimin e dokumentacionit. Referuar procesverbalit nr. 3017/10 datë 21.01.2026 për rivlersimin e ofertave së paraqitura nga Operatori Ekonomik "G." SHPK rezulton se nuk janë përmbushur të gjitha kriteret e kualifikimit KVO ka vijuar procedurën duke renditur në vendin e parë BOE "L." SHPK & "V." SHPK me vlerë oferte 57,670,050 lekë pa tvsh. Në vijim të procedurave KVO me shkresën nr. 3017/11 prot., datë 21.01.2026 i është drejtuar BOE "L." SHPK & "V." SHPK për dorësimin e dokumentacionit fizik. Referuar procesverbalit nr. 3017/12 datë 27.01.2026 për rivlersimin e ofertave së paraqitura nga BOE "L." SHPK & "V." SHPK rezulton se nuk i është përgjigjur kërkesës për paraqitjen e dokumentacionit. KVO ka vijuar procedurën duke renditur në vendin e parë BOE "A." SHPK. &"E. K." SHPK me vlerë oferte 64,644,800 lekë pa tvsh. Ku me shkresën nr. 3017/13 është njoftuar BOE "A." SHPK. &"E. K." SHPK për paraqitjen e dokumentacionit fizik.

Në përfundim të procesit të vlerësimit KVO ka mbajtur Raporti përmbledhës më datë 19.02.2026, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 5 (pesë) operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 4 (katër) OE, janë kualifikuar 1 (një) OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 19.02.2026 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "BOE "A. " shpk me NIPT K.....P &" E." shpk me NIPT K.....I për të cilën është lidhur kontrata datë 27.02.2026 me vlerën **64,644,800** lekë pa tvsh dhe vlera 77,573,760 lekë me TVSH, dhe me afat 2 (dy) muaj nga data e hyrjes ne kantier .

Nga auditimi i dokumentacionit të *BOE "A." SHPK. & "E." SHPK* **të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:**

Për disponibilitetin e kërkesës për mjetin *Autobot Uji* nga OE "A. " Shpk është paraqitur mjeti me targë AB...TC me numër shasie ËDB67603215460879 me Kod Karrocerie J.1 "Për transportin e mallrave të rrezikshme", referuar të dhënave të Përmbajtjes të Lejes së Qarkullimit me nr. FRF02162225. Ky mjet nuk i përket Kodeve të Karrocerisë J.2 "Çisterna për transportin e mallrave jo të rrezikshëm dhe jo ushqimore".

Për disponibilitetin e kërkesën për mjetin Rul Vibrues Gome-Hekur me kapacitet mbi 10 ton, është paraqitur Deklarata Doganore nr. R18552 datë.14.03.2009, për mjetin Rul Vibrues Gome-Hekur me kapacitet mbi 18 ton është paraqitur Deklarata Doganore nr. R1293 datë 20.03.2012, Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet 10 ton është paraqitur Deklarata Doganore nr. Nr: R4185 DT:18.06.2007, për mjetin Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet 10 ton është paraqitur Deklarata Doganore nr. R4146 datë 23.01.2009 si dhe Rrul gome-gome është paraqitur Deklarata Doganore nr .510 datë 30.10.2019. Këto mjete nuk janë të regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, por vetëm deklaratën/vërtetimin e zhdoganimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike".

Për sa trajtuar më sipër OE "A. " Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimet dhe kriteret e veçanta të vendosura në DT. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" pika 2.

Për veprime dhe mosveprime ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i vlersimit të ofertave i përbër nga znj. O. N., z. I. C., znj. A. I., znj. G. F. dhe znj.M. XH.

8. Auditimi i procedurës me objekt: Rikonstruksioni dhe zgjerimi i ambienteve të Qëndrës Polivalente të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për të moshuarit Polican ; REF : 39314-02-26-2025

<table>
<tr><td colspan="4">a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i ambienteve të Qëndrës Polivalente të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për të moshuarit Polican"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
“Procedure e hapur
REF : 39314-02-26-2025
Urdhri nr. 11 prot., datë 25.02.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit
Urdhri nr. 64, datë 25.02.2025
-F. A.-ing (hartim kritere teknike)
-A.C.-ekonomiste-(hartim kritere ekonomike)
-D. Z.-Juriste-personi pergjegjes (merr ne dorezim kriteret)</td><td>2 Njësia e Prokurimit

1.F.A.-ing (specialist fushe)
2.A.C.ekonomiste-
3.D.Z.-Juriste-personi pergjegjes</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 65 prot., datë 25.02.2025

1. O. N.-ing
2. A. I.-juriste
3.K. S.-ekonomiste</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa tvsh)
141,601,288 lekë pa tvsh</td><td colspan="2">5. Oferta fituese, vlera fituese:
Operatori Fitues:
<u>137,219,747 lekë pa TVSH</u>.</td><td>6. Diferenca me fondin limit
4,381,541 lekë pa tvsh</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:Data 19.03.2025
7/2 Kohëzgjatja e kontratës:
12(dymbedhjete) muaj</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Burimi i financimit: bashkefinancim nga buxheti i shtetit me vite financimi 2025-2026 si me poshte:
Shuma 79,409,621 leke pa tvsh dhe 95,291,545 leke me tvsh, ne vitin 2025 sipas shkresës së 353/4 prot date 12.02.2025 të Ministrise se Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale. Shuma 62,191,667 leke pa tvsh dhe 74,630,000 leke me tvsh. Në vitin 2026 sipas shkresës së 353/4 prot date 12.02.2025 të Ministrise së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale.</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a)Pjesëmarrës në tender, 7(shtate) OE
1. “A.” SHPK
2. "M."SH.p.k
3. “B.” SHPK
4. “F.”SHPK
5. “I.” SHPK
6. “S.” SHPK
7. “S.” SHPK
b) S’kualifikuar 5(pese) B/OE,
1.”A. C. “ SHPK. , K.....C
2 “B.” SHPK J.....1
3. “F.”SHPK M.....Q
4.”I.” SHPK J.....E
5 “S.” SHPK J.....Q
6.”S.” SHPK L.....R
c) Kualifikuar 1(nje) B/OE
"M."SH.p.k L.....C</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime
AK-s’ka/ka; ka
APP–s’ka/ka;
KPP-s’ka</td><td colspan="2">11. Data e lidhjes të kontratës:
Nr. 979 prot., datë 18.04.2025</td><td>12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK</td></tr>
</table>

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përllogaritjen e Fondit Limit” :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 64 datë 25.02.2025 “Për ngritjen e komisionit për kontrollin e dokumentacionit teknik te dhuruar, hartimit te kritereve teknike dhe kritereve ekonomike”, i përbërë nga F. A. inxhinier (specialist fushe), A.C. -ekonomiste , D. Z.-juriste (personi përgjegjës). Sipas procesverbalit të datës 25.02.2025, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përllogaritjen e fondit limit i eshte referuar dokumentacioni teknik te dhuruar nga shoqeria “A.” SHPK për investimin e objektit " **Rikonstruksioni dhe zgjerimi i ambienteve të Qëndrës Polivalente të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për të moshuarit Polican** " i cili pasi është kontrolluar dhe verifikuar nga ing Z. F. A. nëse është konformë akteve ligjore dhe nënligjore ne fuqi , janë përgatitur specifikimet

teknike në lidhje me objektin e prokurimit, duke përllogaritur si fond limit vlerën e preventivit të hartuar nga shkoqëria dhuruese, e cila rezulton të jetë **141,601,288** lekë pa tvsh.

Në lidhje me "Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve":
Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (kriteret teknike nga F. A.-inxhinier (specialist fushe), kriteret ekonomike A.C.-ekonomiste dhe kriteret juridike nga D. Z.-juriste (personi përgjegjës) të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës 25.02.2025, si dhe jane argumentuar dhe miratuar permes procesverbalit te dates 25.02.2025 si më poshtë;

Nga auditimi i procesverbalit të datës 25.02.2025 konstatohet se:
Në pikën 2.3.2 të DST*, ndër të tjera janë kërkuar kategori licence* NP–7 A Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje, NP–11-A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë, NP–12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit dhe *NS-18 A Punime topogjeodezike.Sipas grupit të auditimit dhe në konsultim me inxhinierin e grupit, këto kategori licence nuk përputhen me tipologjinë e procedurës, kjo për faktin se referuar zërave të preventivit nuk ka asnjë zë që argumentin këto linesa, ku kategoria N.S – 18/A- Punime topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*
Në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *"Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë),* - 1 (një) Arkitekt dhe 1 (një) inxhinier Mjedisi
Në lidhje me kërkesën për arkitekt, sqarojmë se në dokumentet e procedurës së prokurimit AK ka publikuar njëherazi "Preventivin e punimeve", "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit", duke i vënë në dispozicion, informacionin operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi projektin të cilët këto të fundit do të zbatojnë në rast të fitimit të kontratës. Disponueshmëria si pjesë e stafit teknik të një arkiktekti në fazën e zbatimit të punimeve, ku ndër të tjera autoriteti kontrakor ka kërkuar referuar kritereve të veçanta të kualifikimit pjesë të stafit teknik, inxhinierët, si ndërtimi, hidroteknik, mekanik, gjeodet, elektrik, mjedisi, shkon përtej synimit të AK dhe njëherazi nuk është në proprocion me natyrën dhe volumin e kontratës. Disponueshmëria e një arkitekti referuar natyrës së punimeve dhe duke marrë në konsideratë faktin se AK ka parashikuar në mënyrë të detajuar projektin e zbatimit, specifikimet teknike, nuk shfaqet e nevojshme në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve.

Në pikën 2.3.8 të DST, është kërkuar nga Operatori Ekonomik që të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë, ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi/me subjekte të specializuara për këtë qellim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr. 742 date 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit .
Sipas grupit të auditimit: *konstatohet se nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për mjek. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik ti vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kritereve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Ispektorati i Punës etj.,) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.*

- Në vendosjen e këtij kriteri nuk është të mbajtur në konsideratë VKM nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP, me përbërje si vijon: F. A.-inxhinier (specialist fushe) A.C.-ekonomiste dhe kriteret juridike nga D. Z.*–juriste (personi pergjegjes).*

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 7 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 529/10 të datës 27.03.2025, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	"M.".Sh.p.k me NIPT L.....C	*137 219 747*	Kualifikuar
2	**"A. "SHPK. K.....C**	138,765,360	S'kualifikuar; ❖ (Operatori ekonomik "**A. C." SHPK. , K**.....**C**nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertes sipas Shtoices 3 te kerkuar e piken 1/b te Kritereve te vecanta te Kualifikimit ne DST ❖ Operatori ekonomik "**A. C." SHPK. , K**.....**C**ne formularin permbledhes te vetedeklarmit sipas Shtoces 8, nuk ka deklaruar 1 mjet Autobetoniere 2-3 m^3 ❖ Operatori ekonomik "**A. C." SHPK. , K**.....**C** nuk ka paraqitur, certifikaten e cilésisé ose raportet e testimit nga laborator te akredituar per materialin dyer druri, hidroizoluesin si dhe tek materialet e llojit tuba nuk ka paragitur certifikaten e cilesise ose raportet e testimit nga laborator te akredituar, certifikat/deklarat konformiteti CE, katalogun te kerkuara ne pikën2.3.4 te DST-ve ❖ Operatori ekonomik "**A. C." SHPK. , K**.....**C** nuk la plotesuar plotesisht rubriken D te Pieses se II DEKLARAT "Per zbatimin e dispozitave ligiore ne mardheniet e punes Shtoices 8,duke mos dhene asnie indicie per institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazen e te cilit do te kryhet verifikimi, (Vendimit ne 209/2025 i KPP-së)
3	**"B." SHPK J.....V**	*139,920,942*	S'kualifikuar; ❖ Operatori ekonomik "**B." SHPK , J**.....**V** nuk ka paraqitur Formularin Permbledhes te Vetdeklarimit sipas Shtojces 8 te kerkuar ne piken 1/a të Kritereve te vecanta te Kualifikimit né DST ❖ Operatori ekonomik "**B. " SHPK , J**.....**V** nuk ploteson piken 2.3.2 te DST, per lishencat profesionale lidhur me egzekutimin e punëve te kontrates per kategorin e lisences NP2C(ka lishencen NP2A) dhe NS12B (ka lishencen NS12A) ❖ Operatori ekonomik "**B." SHPK , J**.....**V** nuk ka paragitur asnjeautorizim,katalog, certifikaten e cilesise ose raportet e testimit nga laborator teakredituar per materialet e kerkuara ne piken 2.3.4 te DST-ve ❖ Operatori ekonomik "**B." SHPK , J**.....**V** nuk ploteson piken 2.3.1 te Kapacitetit Teknik per pune te ngjashme te ndryshuar me shtojcên 7
4	**"F." SHPK M.....Q**	*0 (zero lekë)*	S'kualifikuar; ❖ peratori ekonomik "**F." SHPK , M**.....**Q nuk ka ngarkuar dokumentacion ne SPE.**
5		*108 049 619*	S'kualifikuar;

	“I.” SHPK J.....Ë		❖ Operatori ekonomik “**I.” SHPK, J**.....**E**nuk ka paraqitur bilancin e vitit 2023 te kerkuar ne piken 2.2.2 te DST-ve ❖ Operatori ekonomik “**I.” SHPK, J**.....**E**ka deklaruar mbeshtetjen ne staf Teknik ne kundershtim me piken 2.16 te DST-ve ❖ Operatori ekonomik “**I.” SHPK, J**.....**E**nuk ka paraqitur autorizim,katalog, certifikaten e cilesise ose raportet e testimit nga laborator te akredituar, certifikat/deklarat konformiteti CE per materialin dyer druri dhe hidroizoluesin te kerkuara ne piken 2.3.4 te DST-ve ❖ Operatori ekonomik. “I.” nuk ka plotesuar plotesisht rubriken D te Pjeses se II DEKLARAT 'Per zbatimin e dispozitave ligiore ne mardheniet e punes duke mos dhene asnje indicie per institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazen e cilit do te kryhet verifikimi, (Vendimit nr. 209/2025 i KPP-se) ❖ Operatori ekonomik Ina nuk ka plotesuar plotesisht formularin e vetdeklarimit, Shtojca 8, pika C sipas kerkesave ne DST pasi ne formular mungone te dhenat e targave te mjetit per mjetet a) Minidumper (mjet teknologjik me goma) cope 2 b)Minifadrome (mjet teknologjik me goma) cope 2 Keto mjete jane deklaruar pa targa nga ky operator.
6	**“S.” SHPK J.....Q**	*131,681,865*	S’kualifikuar; ❖ Operatori ekonomik **S. SHPK , J.....Q**nuk ka plotesuar plotesisht rubriken D te Pjeses se II DEKLARAT "Per zbatimin e dispozitave ligjore ne mardheniet e punes, Shtojca 8 duke mos dhene anje indicie per institucionin apo dokumentacionin konkret mbi bazen e cilit do te kryhet verifikimi, (Vendimit nr. 209/2025 i KPP-së) ❖ Operatori ekonomik “**S.” SHPK , J**.....**Q**per materialet e llojit tuba nuk ka paraqitur katalogun e prodhuesit ose skeda teknike te kerkuara ne dokumentat standarte te tenderit. Per materialet e llojit dyer druri nuk ka paraqitur autorizimin e prodhuesit, katalogun e produkteve si dhe mungone certifikate/deklarate konfirmiteti CE ose ekuivalente,certifikata cilesie ose raporte testime dokumentacion, per materialet e llojit hidroizoluese dokumentacioni eshte ne giuhe te huaj, dhe nuk eshte ngarkuar perkthimi ne guhen shipe, ne kundershtim me kriteret e kerkuarane DST ❖ Operatori ekonomik “**S.” SHPK , J**.....**Q**nuk ka plotesuar plotesisht formularin e vetdeklarimit shtojca 8, pika C pasi ne formular mungone te dhenat e targave per mjetet si me poshte; a- Minifadrome (mjet teknologjik me goma) cope 2 b- Autobetoniere me kapacitet 2.3-3.5 m^3 (mjet teknologjik me goma) cope 2 c- Minidumper (miet teknologjik me goma) cope 2 Mjetet e siperpermendura te paraqitur nga OE nuk jane sipas kerkesave ne DST, pasi jane deklaruar pa targa.,
7	**“S.” SHPK L.....R**	*0 (zero lekë)*	S’kualifikuar; Operatori ekonomik “**S.” SHPK, L.....R nuk ka ngarkuar dokumentacion ne SPE.**

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 09.04.2025, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 7 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 6 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 09.04.2025 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “M." Sh.p.k me NIPT L.....C” për të cilën është lidhur kontrata datë 18.04.2025 për vlerën 137,219,747 lekë pa TVSH dhe vlera 164,663,696 lekë me TVSH, dhe me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave, nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit sstemin SPE, dhe dokumentacionit të OE fitues, rezultoi se:
1- Skualifikimin i OE nga KVO-ja **është bërë në përputhje me dispozitat e LPP**, pasi OE pjesëmarrës nuk plotësonin kërkesat kualifikuse të DT, të evidentuara nga KVO;
b.2- Në lidhje me OE "M." ShPK, me vlerë kontrate pa TVSh prej 137,219,747 lekë, të shpallur fitues **nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve të DT** (sipas vlerësimit të grupit të auditimit), duke mos plotësuar kriteret si vijon:
Referuar dokumentacionit të subjektit dhe sistemin SPE, dhe dosjen fizike, rezultoi se OE "M." ShPK për realizmin e kontratës është mbështetur nga OE "C." SHPK.
Mbështetja nga OE të tjerë bien ndesh me dispozitat e LPP, pasi në DT nuk është miratuar ose përcaktuar operator mbështetës për realizimin e kontratës. Gjithashtu referuar kushteve të mbështetjes, konstatohet se shoqëria "C." SHPK. e mbështet për certifikatat ISO, kjo e papranueshme, pasi mbështetja është për kapacitet teknike (*makineri/pajisje dhe volume pune*), dhe jo për dokumentacion ligjorë, siç është certifikata ISO, veprime në kundërshtim me nenin 84 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 90.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi komisioni i vlersimit të ofertave i përbërë nga znj. O. N.-inxhiniere, znj. A. I.-juriste dhe znj. K. S.-ekonomiste.

4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Në përfundim të auditimit të zbatimit të kontratave për punë publike, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, dhe shqyrtimit të observacioneve të subjektit të audituar Bashkia Poliçan, **po pasqyrojmë në mënyrë të detajuar problematikat e konstatuara,** si vijon:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "***Rikonstruksioni i shkollës "70 vjetori" dhe sistemim i jashtëm i të gjithë kompleksit arsimor***" viti 2024, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

a. Zbatimi i Kontratës së Punimeve *"Rikonstruksioni i shkollës "70 vjetori" dhe sistemim i jashtëm i të gjithë kompleksit arsimor"*		
14.Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatim punimesh me nr. 1828/16 prot., datë 07.09.2023, midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit BOE "Z." & "B." shpk, përfaqësuar nga "B." shpk, nr. 3931 rep. dt. 05.08.2023	**15.Vlera e kontratës (me Tvsh):** 118,100,805 lekë	**16. Leje Infrastrukture për punimet e objektit-po** Vendimi Bashkisë Poliçan nr. 2228 datë 24.08.2023
17- Situacioni Përfundimtar/ Faturë Pune me volume sipas faktit Vlera 118,100,805 lekë me TVSH	**18.Afati i kontratës në muaj** Parashikuar: 12 muaj nga fillimi i punimeve Fillimi punimeve: 19.09.2023 Përfundimi faktik i punimeve: 20.09.2024	**19. Zgjatja e kontratës-Jo** Brenda afateve kontraktuale - Garancia e punimeve: 2 vite nga certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim (neni 10 i kontratës)
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** Kontratë mbikëqyrje nr. 245 prot., datë 18.09.2023 midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit "N.M." & "I." shpk, përfaqësuar nga "N. M." shpk, dt. 01.09.2023	Liçensa MK...../3	Procedurë e Hapur, me TVSH. Vlera 1,499,960 lekë
21. **Kolaudatori i punimeve** "X." shpk, Ing. X. D.	Liçensa MK..../9	Procedurë "Blerje e vogël"
22. Akt Kolaudimi	11.10.2024	
23. Akt marrje në dorëzim-po	2244/2 prot., datë 22.10.2024	

I. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1828/16 prot., datë 07.09.2023, midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit BOE "Z." & "B." shpk, përfaqësuar nga "B." shpk, sipas kontratës së bashkëpunimit të përkohshëm nr. 3931 rep. dt. 05.08.2023. Vlera e kontratës është 118,100,805 lekë me Tvsh. Financimi i projektit është realizuar me mbështetjen e MAS me shkresë 3124/5 datë 09.06.2023 dhe Buxhetit të Bashkisë Poliçan. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 11 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku Kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Leja e Infrastrukturë është miratuar me Vendimin nr. 376 datë 10.08.2023 të Bashkisë Poliçan dhe afatu i zbatimit të lejes është 12 muaj. Projekti parashikon rikonstruksion të shkollës "70 vjetori" Poliçan, ku përfshihen punime prishjeje, punime catije, punime shtresash, punime në fasadën e shkollës, dyer e dritare, sinjalistikë, suvatimi dhe punime të jashtme kompleksit. Gjithashtu parashikohet ndërtimi i palestrës së shkollës bashkë me instailimet elektrike dhe mekanike.
- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata nr. 245 prot., datë 18.09.2023 midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit "N. M." & "I." shpk, përfaqësuar nga "N. M." shpk, sipas kontratës së bashkëpunimit dt. 01.09.2023 me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. .../3.
- Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është "X." shpk, me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. **….**/9.
- Njoftimi i fillimit të punimeve nga kontraktori dhe mbikëqyrësi është realizuar me shkresën nr. 2452 prot., Datë 19.09.2023. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët datë 19.09.2023. Procesverbali i fillimit të punimive është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi datë 19.09.2023. Akti i piketimit të objektit është**e**alizuar më datë 19.09.2023. Njoftimi i përfundimit dhe procesverbali i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi është me nr. 2244/1 prot., datë 20.09.2024, *brenda afateve kontraktuale*. Akti i kolaudimit është realizuar më datë 11.10.2024 dhe Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar me nr. 2244/2 prot., datë 22.10.2024.

-Kontrata përbëhet nga 3 situacione pjesore progresive, të cilat nuk janë shoqëruar me libreza masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*" Kreu II, pika 8.1; "*Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori*" dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 "*Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave"*. Në dosjen teknike administrohet vetëm libreza e masave përfundimtare e cila nuk korrespondon plotësisht me situacionin përfundimtar.
- Me kërkesën e mbikëqyrësit nr. 1120 prot., datë 17.05.2024 dhe të sipërmarrësit, konstatohen se gjatë punimeve të zbatimit rezultuan ndryshime në zëra dhe volume të punimeve. Konkretisht janë konstatuar zbritje dhe shtesa të volumeve të preventivit, të cilat janë pasqyruar në tabelën e lëvizjeve të volumeve. Me kërkesën e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit nr. 1157/1 prot., datë 21.05.2024, kërkohet përdorimi i fondit rezervë pas hartimit të librezës së masave dhe azhornimit të projektit. Me procesverbalin nr. 1157 prot., datë 21.05.2024, nga Investitori miratohet tabela e levizjes së volumeve.

II. Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit, situacionit përfundimtar, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave, u konstatua parregullsi në deklarime të punime të realizuara me faktin, si më poshtë vijon:

1. Në kapitullin e punimeve të prishjeve, zëri nr. 1 "*Prishje suvatimi*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 2,590.3 m^2 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë ndryshe nga situacioni përfundimtar në sasinë prej 2,563 m^2 . Pra, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar më tepër në pagesën e situacionit se në llogaritjet e dimensioneve në librezën e masave sasinë prej 2,590 m^2-2,563 m^2 = 27 m^2 dhe me cmimin përkatës 600 lekë/m^2, *rezulton vlera 16,200 lekë pa TVSH.*

2. Në kapitullin e punimeve të prishjeve, zëri nr. 18 "*Transport dheu me auto deri 5 km*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 382.8 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit 382.8 m^3. Në llogaritjet në librezën e masave pasqyrohet llogaritja e volumit të pishjeve të suvatimeve me **5 cm** trashësi suvatimi (2,563.15 m^2 x 0.05 m =128.16 m^3). Referuar kushteve teknike të zbatimit, manualit teknik suvatimi realizohet me trashësi nga 2 cm deri në 2.5 cm. Rrjedhimisht konstatohet një pasaktësi në llogaritjen e këtij zëri ku duhet të ishte volumi prej (2,563.15 m^2 x 0.025 m = 64 m^3), me një diferencë prej 128m^3- 64 m^3= <u>64 m^3</u>. Gjithashtu në llogaritjet në librezën e masave pasqyrohet llogaritja e volumit të pishjeve të suvatimeve të fasadës me **5 cm** trashësi suvatimi (1,136.28 m^2 x 0.05 m =57 m^3). Rrjedhimisht konstatohet një pasaktësi në llogaritjen e këtij zëri ku duhet të ishte volumi prej (1,136.28 m^2 x 0.025 m = 28 m^3), me një diferencë prej 57m^3- 28 m^3= <u>28 m^3</u>.
Në total në zëri nr. 18 "*Transport dheu me auto deri 5 km*" është përfituar padrejtësisht sasia 92 m^3 dhe me cmimin përkatës 600 lekë/m^3, *rezulton vlera 55,200 lekë pa TVSH*.

3. Në kapitullin e punimeve të catisë, zëri nr. 3 "*Kaseta shkarkimi llamarine xingat*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 8 copë dhe në librezën e masave pasqyrohet realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit 8 copë. Referuar kushteve teknike të zbatimit (*nëse ekziston ulluk horizontal dhe verikal, nuk vendoset kasetë për shkak të lidhjes së tyre me njëri-tjetrin pa kasetë shkarkimi*) dhe verifikimit në objekt, u konstatua se në shkollën 70 vjetori, nuk janë vendosur kasetat e shkarkimit llamarinë xingat dhe me cmimin përkatës 1,500 lekë/copa, *rezulton vlera 12,000 lekë pa TVSH*.

4. Në kapitullin e punimeve suvatimeve dhe bojatisjes zëri nr. 5 "*F.V bojë akrilike cilësia e parë fasada*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 1,221.1 m^2 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë 1,221.1 m^2. Nga verifikimi i librezës së masave shpesh nuk ekziston përputhshmëria e volumeve të njëjta duke specifikuar përmasa të ndryshme në volumet e zbritjeve të volumeve të dritareve dhe vetë veshjes së fasadës me polisterol dhe suvatim. Zëri i "veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rrjetë+suva" është në sipërfaqen e llogaritur në L.B. prej 1,136.3 m^2. Pra me difernecë në lyerje prej (1,221.1 m^2 - 1,136.3 m^2 = **84.8 m^2**. Sasia prej 84.8m^2 është llogaritur dhomat e zhveshjes së palestrës në zërin e suvatimeve të brendshme dhe lyerjeve të brendshme. Rrjedhimisht sasia prej 84.8 m^2 e zërit nr. 5 "*F.V bojë akrilike cilësia e parë fasada*", është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve dhe me cmimin përkatës prej 400 lekë/m2, *rezulton vlera 33,920 lekë pa TVSH*.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet vlera e likuiduar më tepër tepër **117,320 lekë pa Tvsh** (*<u>33,920 + 12,000 + 55,200 + 16,200)</u>* ose 140,784 me Tvsh**, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi,** për mos llogaritje të sakta të volumeve dhe për punime të pa realizuara.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
-Mbikqyrësi i punimeve Ing. N. M. nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të kontratës nr. 245 prot., datë 18.09.2023 dhe Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: *Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.*

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "***Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Muhamed Kondi***" Poliçan viti 2023, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

a. Zbatimi i Kontratës së Punimeve *"Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Muhamed Kondi", Poliçan*		
14.Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatim punimesh me nr. 2600 prot., datë 25.10.2022, midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit BOE "Z." & "B." shpk, përfaqësuar nga "Z." shpk, nr. 3367 rep. dt. 27.09.2022	**15.Vlera e kontratës (me Tvsh):** 53,923,930 lekë	**16. Leje Infrastrukture për punimet e objektit-po** Nuk disponohet në dosjen teknike
17- Situacioni Përfundimtar/ Faturë Pune me volume sipas faktit Vlera 53,922,346 lekë me TVSH	**18.Afati i kontratës në muaj** Parashikuar: 6 muaj nga fillimi i punimeve Fillimi punimeve: 01.11.2022 Përfundimi faktik i punimeve: 03.04.2023	**19. Zgjatja e kontratës-Jo** Brenda afateve kontraktuale - Garancia e punimeve: 1 vit nga certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim (neni 10 i kontratës)
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** Kontratë mbikëqyrje nr. 2427 prot., datë 03.10.2022 midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit "A.", përfaqësuar nga "N. M." shpk	Liçensa MK...../3	Procedurë e Hapur, me TVSH. Vlera 547,268 lekë
21. **Kolaudatori i punimeve** "G." shpk, Ing. L. H.	Liçensa MK...../8	Procedurë "Blerje e vogël"
22. Akt Kolaudimi	Nr. 1447 prot., date 26.05.2023	
23. Akt marrje në dorëzim-po	1447/1 prot., datë 29.05.2023	1677 prot., date 18.07.2024

I. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2600 prot., datë 25.10.2022, midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit BOE "Z." & "B." shpk, përfaqësuar nga "Z." shpk, sipas kontratës së bashkëpunimit të përkohshëm nr. 3367 rep. dt. 27.09.2022. Vlera e kontratës është 53,923,930 lekë me Tvsh. Financimi i projektit është realizuar nga buxheti i Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Poliçan. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 11 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku Kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Projekti parashikon rikonstruksion të shkollës së mesme "Muhamed Kondi" Poliçan, ku përfshihen punime prishjeje, punime catije, punime shtresash, punime në fasadën e shkollës dhe dyer e dritare.

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata 2427 prot., datë 03.10.2022 midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit "A.", përfaqësuar nga "N. M." shpk me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. .../3.
- Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata nr. 1382 prot., datë 19.05.2023 "G." shpk, përfaqësuar nga Ing. L. H., me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK...../8.
- Njoftimi i fillimit të punimeve nga kontraktori dhe mbikëqyrësi është realizuar më me nr. 2656 prot., Datë 01.11.2022. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët datë 01.11.2022. Procesverbali i fillimit të punimive është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi datë 01.11.2022. Akti i piketimit të objektit është realizuar më datë 01.11.2022.

Njoftimi i përfundimit dhe procesverbali i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi është me nr. 962 prot., datë 03.04.2023, *brenda afateve kontraktuale*. Akti i kolaudimit është realizuar më datë 26.05.2023 dhe Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar me nr. 1447/1 prot., datë 29.05.2023. Certifikata e përhershme e marrjes në dorëzim është realizuar me nr. 1677 prot., date 18.07.2024.

-Kontrata përbëhet nga 2 situacione pjesore progresive, të cilat nuk janë shoqëruar me libreza masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*" Kreu II, pika 8.1; "*Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori*" dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3

"*Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave"*. Në dosjen teknike administrohet vetëm libreza e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.

- Me kërkesën e mbikëqyrësit nr. 679 prot., datë 07.03.2023 dhe të sipërmarrësit, konstatohen se gjatë punimeve të zbatimit rezultuan ndryshime në zëra dhe volume të punimeve. Konkretisht janë konstatuar zbritje dhe shtesa të volumeve të preventivit, të cilat janë pasqyruar në tabelën e lëvizjeve të volumeve. Me kërkesën e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit, kërkohet përdorimi i fondit rezervë pas hartimit të librezës së masave dhe azhornimit të projektit. Me procesverbalin nr. 679/1 prot., datë 09.03.2023, nga Investitori miratohet tabela e levizjes së volumeve.

II. Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit, situacionit përfundimtar, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave, u konstatua parregullsi në deklarime të punime të realizuara me faktin, si më poshtë vijon:

1. Në kapitullin e punimeve të gërmimit dhe murature, zëri nr. 2, nr. Anal. 2.64/2 "*Ndërtim mure tulle*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 46.3 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 46.3 m^3 . Sipas llogaritjeve në librezën e masave janë llogaritur muret me tullë 25 cm në katin përdhe (korridor 2 x 22.88 m x 0.25m x 2.96m =33.86 m^3 dhe më pas janë zbritur sipërfaqet e dyerve). Përllogaritja e mureve të tullës vazhdon edhe në katin I, katin II dhe taracë. Nga verifikimi i librezës së masave për këtë zë punimi, konstatohet se nuk janë përllogaritu zbritjet e volumit të "Brezit betoni M-200" (zëri nr. 2, kap. Punime betoni dhe b/a e hekuri). Llogaritja e brezave të betonit M-200 është në të gjitha përmasat e mureve në katin përdhe (korridor 2 x 22.88 m x 0.25m x 0.2 m =2.29 m^3 dhe më pas janë zbritur sipërfaqet e dyerve, *njësoj si llogaritjet e mureve*). Përllogaritja e brezit të betonit vazhdon edhe në katin I, katin II dhe taracë me një volum total prej 7.9 m^3, *e cila duhej zbritur nga sasia 46.3 m^3*, e zëri nr. 2, nr. Anal. 2.64/2 "*Ndërtim mure tulle*". Rrjedhimisht sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht volumin prej **7.9 m^3** "*Ndërtim mure tulle*" dhe me cmimin përkatës 15,000 lekë/m^3, *rezulton vlera 118,500 lekëpa TVSH*.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet vlera e likuiduar më tepër tepër **118,500 lekë pa Tvsh** ose 142,200 lekë me Tvsh**, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi,** për mos llogaritje të sakta të volumeve dhe për punime të pa realizuara.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
-Mbikqyrësi i punimeve Ing. N. M. nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të kontratës nr. 2427 prot., datë 03.10.2022 dhe Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: *Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.*

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "***Mbrojtje lumore gjatësore e tokave bujqësore nga lumi Osum, fshati Vodice***" Poliçan viti 2024, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

a. Zbatimi i Kontratës së Punimeve *"Mbrojtje lumore gjatësore e tokave bujqësore nga lumi Osum, fshati Vodice ", Poliçan*		
14.Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatim punimesh me nr. 1903 prot., datë 15.08.2024, midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit BOE "T." & "M." shpk, përfaqësuar nga "T." shpk	**15.Vlera e kontratës (me Tvsh):** 93,605,940 lekë	**16. Leje Infrastrukture për punimet e objektit-po** Vendimi Bashkisë Poliçan nr. 14 datë 30.07.2024

17- Situacioni Përfundimtar/ Faturë Pune me volume sipas faktit Vlera 93,605,653 lekë me TVSH	**18.Afati i kontratës në muaj** Parashikuar: 4 muaj nga fillimi i punimeve Fillimi punimeve: 19.08.2024 Përfundimi faktik i punimeve: 19.12.2024	**19. Zgjatja e kontratës-Jo** *Brenda afateve kontraktuale* - Garancia e punimeve: 1 vit nga certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim (neni 9 i kontratës)
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** Kontratë mbikëqyrje nr. 1932 prot., datë 19.08.2024 midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit "A.", përfaqësuar nga "E. M." shpk	Liçensa MK..../8	Procedurë e Hapur, me TVSH. Vlera 1,662,933 lekë
21. **Kolaudatori i punimeve** "G." shpk, Ing. G. S.	Liçensa MK...../8	Procedurë "Blerje e vogël"
22. Akt Kolaudimi	Nr. 775 prot., date 25.03.2025	
23. Akt marrje në dorëzim-po	775/1 prot., datë 27.03.2025	

I. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1903 prot., datë 15.08.2024, midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit BOE "T." & "M." shpk, përfaqësuar nga "T." shpk. Vlera e kontratës është 93,605,940 lekë me Tvsh. Financimi i projektit është realizuar nga buxheti i Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Poliçan. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 11 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku Kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Projekti parashikon mbrojtje nga lumi Osum në tokat bujqësore me struktura betoni dhe gabiona me rrjetë teli me gjatësi rreth 700m.
- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata 21932 prot., datë 19.08.2024 midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit "A.", përfaqësuar nga "E. M." shpk shpk me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. .../8.
- Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata publike me "G." shpk, përfaqësuar nga Ing. G. S., me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK...../8.
- Njoftimi i fillimit të punimeve nga kontraktori dhe mbikëqyrësi është realizuar më me nr. 1933 prot., datë 19.08.2024. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët nr. 1933/1 prot., datë 19.08.2024. Procesverbali i fillimit të punimive është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi datë 1933/2 prot., datë 19.08.2024. Akti i piketimit të objektit është realizuar më datë 1933/3 prot., datë 19.08.2024.
Njoftimi i përfundimit dhe procesverbali i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi është me nr. 3048 prot., datë 19.12.2024, *brenda afateve kontraktuale*. Akti i kolaudimit është realizuar me nr. 775 datë 25.03.2025 dhe Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar me nr. 775/1 prot., datë 27.03.2025.

-Kontrata përbëhet nga 4 situacione pjesore progresive, të cilat nuk janë shoqëruar me libreza masash pjesore, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*" Kreu II, pika 8.1; "*Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori*" dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 "*Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave"*. Në dosjen teknike administrohet vetëm libreza e masave përfundimtare e cila korrespondon me situacionin përfundimtar.

- Me kërkesën e mbikëqyrësit nr. 2018 prot., datë 02.09.2024 dhe të sipërmarrësit, konstatohen se gjatë punimeve të zbatimit rezultuan ndryshime në zëra dhe volume të punimeve. Konkretisht janë konstatuar zbritje dhe shtesa të volumeve të preventivit, të cilat janë pasqyruar në tabelën e

lëvizjeve të volumeve. Me procesverbalin e datës 02.09.2024 dhe nr. 2018/1 prot., datë 10.09.2024, nga Investitori miratohet tabela e levizjes së volumeve.

II. Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit, situacionit përfundimtar, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave, u konstatua parregullsi në deklarime të punime të realizuara me faktin, si më poshtë vijon:

1. Në zërin nr. 1, nr. Anal. 3.89/a "*Gërmim dheu me eskavator goma 0.25m^3, në kanale gjerësi deri 2m, tok e zak. Kat III, me shkark mjet*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 8,938 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 8,938 m^3. Nga verifikimet e projektit të azhornuar në piketën 7-8 konstatohet gjatësi 112 m, ndërsa në librezën e masave kjo gjatësi pasqyrohet në llogaritje në gjatësinë 115m (*115m x 5m x 2.5m = 1,437.5* m^3). Nga përllogaritja e piketës 7-8 sipas projektit të azhornuar, rezulton volumi 1,400 m^3 (112m x 5m x 2.5m). Pra sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht volumin prej 37.5 m^3 (1,437.5 m^3 - 1,400 m^3) dhe me çmimin përkatës prej 510 lekë/m^3, *rezulton vlera 19,125 lekë pa TVSH.*

2. Në zërin nr. 3, nr. Anal. 3.352 "*Mbushje me gur kave për skolierë*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 7,150 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 7,150 m^3. Nga verifikimet e projektit të azhornuar në piketën 7-8 konstatohet gjatësi 112 m, ndërsa në librezën e masave kjo gjatësi pasqyrohet në llogaritje në gjatësinë 115m (*115m x 5m x 2m = 1,150*). Nga përllogaritja e piketës 7-8 sipas projektit të azhornuar, rezulton volumi 1,120 m^3 (112m x 5m x 2m). Pra sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht volumin prej 30 m^3 (1,150m^3 - 1,120 m^3) dhe me çmimin përkatës prej 1,210 lekë/m^3, *rezulton vlera 36,300 lekë pa TVSH.*

3. Në zërin nr. 4, nr. Anal. 3.396/1 "*Mbushje me gur kave pas mureve*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 3,285 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 3,285 m^3. Nga verifikimet e projektit të azhornuar në piketën 7-8 konstatohet gjatësi 112 m, ndërsa në librezën e masave kjo gjatësi pasqyrohet në llogaritje në gjatësinë 113m (*113m x 2.2m x 2.1m = 522.06*). Nga përllogaritja e piketës 7-8 sipas projektit të azhornuar, rezulton volumi 517.44 m^3 (112m x 2.2m x 2.1m). Pra sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht volumin prej 4.62 m^3 (522.06 m^3 – 517.44 m^3) dhe me çmimin përkatës prej 800 lekë/m^3, *rezulton vlera 3,696 lekë pa TVSH.*

4. Në zërin nr. 5, nr. Anal. 3.332 "*Gabiona me rrjetë teli të zinguar 1x1x1.5m*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 2,137 m^3 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 2,137 m^3. Nga verifikimet e projektit të azhornuar në piketën 7-8 konstatohet gjatësi 112 m, ndërsa në librezën e masave kjo gjatësi pasqyrohet në llogaritje në gjatësinë 112.2m (*112.2m x 3m x 1m = 336.6*). Nga përllogaritja e piketës 7-8 sipas projektit të azhornuar, rezulton volumi 336 m^3 (112m x 3m x 1m). Pra sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht volumin prej 0.6 m^3 (336.6 m^3 – 336 m^3) dhe me çmimin përkatës prej 9,500 lekë/m^3, *rezulton vlera 5,700 lekë pa TVSH.*

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet vlera e likuiduar më tepër tepër **64,821 lekë pa Tvsh** (*5,700 + 3,696 + 36,300 + 19,125)* ose 77,785 lekë me Tvsh**, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi,** për mos llogaritje të sakta të volumeve dhe për punime të pa realizuara. Në lidhje me zërin nr. 6 "*Gërmim dheu me eskavator goma 0.25m^3, në kanale gjerësi deri 2m, prani uji, Kat III, me shkark në tokë, për devijim lumi*", nuk disponohet asnjë relacion apo matje topografike për llogaritjet e sakta të gërmimeve dhe volumeve për gërmimet e devijimit të lumit në sasinë prej 6,500 m^3. Gjithashtu në zërin nr. 7 "Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5 km", nuk disponohet asnjë llogaritje në librezën e masave për volumin 4,334 m^3.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

-Mbikqyrësi i punimeve Ing. E. M. nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të kontratës nr. 1932 prot., datë 19.08.2024 dhe Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: *Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.*

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "***Mbrojtje lumore gjatësore nga lumi Osum, fshati Mbrakull***" Poliçan viti 2023, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

a. Zbatimi i Kontratës së Punimeve *" Mbrojtje lumore gjatësore nga lumi Osum, fshati Mbrakull ", Poliçan*		
14.Lidhja e kontratës bazë: Kontratë zbatim punimesh me nr. 2117 prot., datë 07.08.2023, midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit OE "A. K." SHPK..	**15.Vlera e kontratës (me Tvsh):** 68,112,768 lekë	**16. Leje Infrastrukture për punimet e objektit-jo** Nuk gjendej në dosjen teknike
17- Situacioni Përfundimtar/ Faturë Pune me volume sipas faktit Vlera 68,111,580 lekë me TVSH	**18.Afati i kontratës në muaj** Parashikuar: 4 muaj nga fillimi i punimeve Fillimi punimeve: 08.08.2023 Përfundimi faktik i punimeve: 07.12.2023	**19. Zgjatja e kontratës-Jo** *Brenda afateve kontraktuale* - Garancia e punimeve: 1 vit nga certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim (neni10 i kontratës)
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** Kontratë mbikëqyrje nr. 2123 prot., datë 08.08.2023 midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit "A.", përfaqësuar nga "N. M." shpk	Liçensa MK..../8	Procedurë e Hapur, me TVSH. Vlera 1,431,945 lekë
21. **Kolaudatori i punimeve** "X." shpk, Ing. X. D.	Liçensa MK..../8	Procedurë "Blerje e vogël"
22. Akt Kolaudimi	Nr. 3316 prot., date 18.12.2023	
23. Akt marrje në dorëzim-po	3321 prot., datë 19.12.2023	

I. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2117 prot., datë 07.08.2023, midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit OE "A. K." SHPK.. Vlera e kontratës është 68,112,768 lekë me Tvsh. Financimi i projektit është realizuar nga buxheti i Shtetit. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar nenit 11 të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku Kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Projekti parashikon mbrojtje nga lumi Osum, duke pare humbjen e tokës prej 12 ha pranë lagjes Cepan, Mbrakull dhe rrezikimit të tokave nga përmbytja në segment rreth 700ml. Kontrata parashikon me ndërtimin e strukturave të betonit dhe gabiona me rrjetë teli

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata nr. 2123 prot., datë 08.08.2023 midis AK Bashkisë Poliçan dhe Kontraktorit "A.", përfaqësuar nga "N. M." shpk shpk me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. .../8.
- Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata publike me "X." shpk, përfaqësuar nga Ing. X. D., me liçensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. ..../8.
- Njoftimi i fillimit të punimeve nga kontraktori dhe mbikëqyrësi është realizuar më me nr. 2126 prot., datë 08.08.2023. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, miratohet nga palët më datë 08.08.2023. Procesverbali i fillimit të punimive është mbajtur nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi më datë 08.08.2023. Akti i piketimit të objektit është realizuar më datë 08.08.2023.

Njoftimi i përfundimit dhe procesverbali i përfundimit të punimeve nga mbikëqyrësi është me nr. 3261 prot., datë 13.12.2023, ku njoftohet se punimet kanë përfunduar më datë 07.12.2023 sipas procesverbalit të palëve, *brenda afateve kontraktuale*. Akti i kolaudimit është realizuar me nr. 3316 prot., date 18.12.2023dhe Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është realizuar me nr. 3321 prot., datë 19.12.2023.

- Me kërkesën e mbikëqyrësit nr. 2126/2 prot., datë 03.11.2023 dhe të sipërmarrësit, konstatohen se gjatë punimeve të zbatimit rezultuan ndryshime në zëra dhe volume të punimeve. Konkretisht janë konstatuar zbritje dhe shtesa të volumeve të preventivit, të cilat janë pasqyruar në tabelën e lëvizjeve të volumeve, të cila miratohen nga Investitori tabela e levizjes së volumeve dhe preventivi i ripunuar datë 03.11.2023.

II. Nga kontrolli i dokumentacionit tekniko-ligjor i dosjes së objektit, situacionit përfundimtar, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave, u konstatua parregullsi në deklarime të punime të realizuara me faktin, si më poshtë vijon:

1. Në zërin nr. 5, nr. Anal. 3.193/b "*Shtresë zhavori lumi t=20 cm, rruga*", në situacionin përfundimtar pasqyrohet sasia prej 2,964 m^2 dhe në librezën e masave pasqyrohet përllogaritja ose realizimi i punimit në sasisë sipas situacionit përfundimtar në sasinë prej 2,964 m^2. Nga verifikimet e projektit, konstatohet se rruga është në gjatësinë 700 ml sipas projektit dhe përllogaritjeve në librezën e masave dhe në volumet e gërmimeve. Në librezën e masave kjo gjatësi pasqyrohet në llogaritje në gjatësinë 780m (*780m x 3.8m = 2,964 m2).* Nga përllogaritja sipas projektit, rezulton volumi 2,660 m^2 (700m x 3.8m). Nga auditimi i dosjes teknike nuk disponohet asnjë projekt të azhornuar për përllogaritje të sakta të volumeve, nuk disponohet asnjë prerje tërthore dhe gjatësore të gabioneve, rrugës etj Pra sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht volumin prej 304 m^2 (2,964 m^2-2,660 m^2) dhe me çmimin përkatës prej 400 lekë/m^2, *rezulton vlera 121,600 lekë pa TVSH.*
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet vlera e likuiduar më tepër tepër **121,600 lekë pa Tvsh** ose 145,920 lekë me Tvsh**, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi,** për mos llogaritje të sakta të volumeve dhe për punime të pa realizuara.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
-Mbikqyrësi i punimeve Ing. N. M. nuk ka zbatuar rigorozisht përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të kontratës nr. 2123 prot., datë 08.08.2023 dhe Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: *Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat me kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.*

5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
Bashkia Poliçan ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor me Vendimin e KKT-së Nr 04. datë 08.02.2017 dhe Rregulloren Vendore që shërben si bazë për shqyrtimin e lejeve të ndërtimit, si dhe në referencë të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, për "*Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", të ndryshuar, të Ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014, për "*Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", të ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, " *Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar.

Auditimi konsiston në këto fusha:
1.Dhënia e lejes së zhvillimit dhe përputhshmëria me kondicionet urbane të përcaktura sipas Planit të Përgjithshme Vendore dhe Planeve të Detajuara Vendore;
2.Dhënia e lejes së ndërtimit, plotësimi i të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejes, përputhshmëria me kondicionet urbane të përcaktura dhe me lejen e zhvillimit;
3.Saktësia e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë;
4.Dhënia e çertifikatës së përdorimit;

<u>Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit të miratuara për përiudhën 2023 – 2025</u>
Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës së Bashkisë Poliçan dhe në bazë të sistemit e-leje, gjatë periudhës 01.01.2024 deri më 31.12.2025 janë miratuar **3 leje** ndërtimi (ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2), **10 leje** ndërtimi

(ndërtim të ri me siperfaqe deri në 250 m^2), **1 leje** ndërtimi (shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2), **7 leje** infrastrukture, **13 deklarata** paraprake për kryerje punimesh, **15 leje** zhvillimi dhe **10 çertifikata përdorimi**, të pasqyruara në tabelën nr. 1, si vijon.

Tabela nr. 1. *Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025 nga sistemi e-Leje*

Periudha 01.01.2023-31.12.2023			
Nr.	**Përshkrimi i lejes**	**Aplikuar**	**Miratuar**
1	Certifikatë përdorimi	8	**6**
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	2	**1**
3	Leje infrastrukture	4	**4**
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	2	**2**
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	-	**-**
6	Leje për ndryshim funksioni	-	**-**
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	2	**1**
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	-	**-**
9	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	-	**-**
10	Leje rindërtimi/rikonstruksioni/riparimi të ndërtesave të dëmtuar pa shtim/ndryshim funksioni	-	**-**
11	Leje zhvillimi	6	**4**
12	Njoftim për fillim punimesh	6	**6**
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	-	**-**
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2	-	**-**
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	1	**1**
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sip. më të madhe se 250 m^2	-	**-**
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	-	**-**

Periudha 01.01.2024-31.12.2024			
Nr.	**Përshkrimi i lejes**	**Aplikuar**	**Miratuar**
1	Certifikatë përdorimi	3	**2**
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	12	**7**
3	Leje infrastrukture	3	**3**
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	7	**7**
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	1	**1**
6	Leje për ndryshim funksioni	-	**-**
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	-	**-**
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	-	**-**
9	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	1	**1**
10	Leje rindërtimi/rikonstruksioni/riparimi të ndërtesave të dëmtuar pa shtim/ndryshim funksioni	-	**-**
11	Leje zhvillimi	8	**8**
12	Njoftim për fillim punimesh	4	**4**
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	-	**-**
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2	-	**-**
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	-	**-**
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sip. më të madhe se 250 m^2	-	**-**
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	-	**-**

Periudha 01.01.2025-31.12.2025			
Nr.	**Përshkrimi i lejes**	**Aplikuar**	**Miratuar**
1	Certifikatë përdorimi	4	**2**
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	9	**5**
3	Leje infrastrukture	-	**-**
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	1	**1**
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	4	**4**
6	Leje për ndryshim funksioni	1	**1**
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	2	**1**

8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	-	**-**
9	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	2	**2**
10	Leje rindërtimi/rikonstruksioni/riparimi të ndërtesave të dëmtuar pa shtim/ndryshim funksioni	1	**1**
11	Leje zhvillimi	4	**3**
12	Njoftim për fillim punimesh	6	**6**
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	-	**-**
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m^2	1	**1**
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	2	**2**
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sip. më të madhe se 250 m^2	-	**-**
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	-	**-**

***Burimi**:Të dhënat të vendosura në dispozicion nga drejtoria e urbanistikës e Bashkisë Poliçan.*

Në bazë të analizës së riskut, vlerës më të lartë të preventivit/ investimit, referuar sipërfaqes më të madhe të ndërtimit, si edhe tipologjisë së ndërtimit janë përzgjedhur **3 raste** të lejeve të ndërtimit për tu audituar, 1 leje ndërtimi për secilën periudhë dhe **1 certifikatë përdorimi**, të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:


Nr.	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi i lejes së ndërtimit	Preventivi sipas subjektit
1	Magazinë në funksion të kantinës së verës 2 kat	L. N.	Nr.6, Datë 12/03/2025	123, 066, 782 lekë
2	Ambiente argetuese sportive	S. T.	Nr. 12, Datë 13/06/2024	6,203,191 Lekë
3	Fabrikë vaji 1 kat	A. M.	Nr. 8, Datë 23/06/2023	11,542,823 lekë
4	Magazinë për përdorim blegtoral, (stallë vicash)	X. M.	Nr. 04, Datë 30/09/2024	Certifikatë përdorimi

<u>Nga auditimi i dokumentacionit në dosje dhe të dhënat e sistemit e-leje, rezultoi se</u>:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin "*e-Leje*" të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Poliçan, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt ***"Magazinë në funksion të kantinës së verës 2 kat"***, për të cilën është marrë vendimi **Nr. 06, datë 12/03/2025**, referuar Ligjit 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 04, datë 08.02.2017, si dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar, etj., u konstatua si vijon:

Të dhëna të përgjithshme mbi lejen e ndërtimit:

Objekti i lejes së ndërtimit: *"Magazinë në funksion të kantinës së verës 2 kat"*





1. Njësia Strukturore: **ZU.4.2**	2. Zhvilluesi: Znj. L. N.	3. Adresa e realizimit të punimeve: Fshati Fushë Peshtan, Nj.A.Vërtop, Bashkia Poliçan	4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2: PO/JO-PO

5. Data e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi: Data: 07/02/2025	6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi: Nr. 06, datë 12/03/2025	4/1. Lloji i objektit: Magazinim/ Prodhim
5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës: 23 ditë	7. Vlera e preventivit referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti: 123, 066, 782 lekë	10/1. Nga auditimi është konstatuar diferencë apo përllogaritje e gabuar e TNI-së: Po/Jo- PO

- *Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes:*

Nga dokumentacioni i audituar dhe nga të dhënat e përgjithshme lidhur me detajet e aplikimit të pasqyruara në sistemin e-leje, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për leje ndërtimi për **39 ditë**, në respektim të afateve të përcaktuara nenin 44, pika 2, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", dhe përcaktimet e nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar.

-Në lidhje me zbatimin e kushteve të zhvillimit të përcaktuara për miratimin e lejes:

Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr. 07, datë 23.05.2023. Parcelat në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore *ZU.4.2*, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Të dhënat mbi kushtet bazë të zhvillimit, referuar Njësië Strukturore: ZU.4.2, në të cilën do të zhvillohet ndërtimi:

Kondicionet referuar dokumentit	***PPV***	***Leje ndërtimi***
Kategoria e përdorimit të tokës / Përdorime të lejuara	A.Banim 100% Shërbime (S), Institucione (IS), Industri dhe ekonomi (IE), Aktivitete sociale dhe rekreative (AR), Arsim (AS), Shëndetësi (SH), Infrastruktura teknike (IN)	Magazinim/ Prodhim
Parcela minimale për zhvillim	K1=350 m²	8950 m²
Lartësia në kate	3 kate + çati deri në 1.50m	2 kate
Lartësia në metra	10.00m + çati deri 1.50m	7.8 metra
Intesiteti i ndërtimit	1	0.12
KSHT	60 %	39.5 %

Grupi i auditimit ka konstatuar se leja e ndërtimit, është miratuar në mospërputhje me disa nga kushtet e zhvillimit (kondicionet), konkretisht si vijon:

- Referuar të dhënave të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.04, datë 08.02.2017, lartësia në kate/ lartësia në metra e objektit të propozuar është brenda parametrave dhe kondicioneve të lejuara.

-Në raport me respektimin e distancave, nga shqyrtimi i planvendosjes së miratuar, për objektin në lartësinë e dy kateve është respektuar distanca prej 2 metër nga kufiri i pronës, nga 3 metra që duhej respektuar, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 35,të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.

Situata e sipërcituar është në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1, të nenit 14, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit "*Leja e ndërtimit lëshohet në përputhje me përcaktimet e lejes së zhvillimit, dokumenteve të planifikimit, të rregulloreve të zhvillimit e ndërtimit, si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë ndërtimore në Republikën e Shqipërisë*" si dhe pikës 1, të nenit 32, e cila, ndër të tjera, citon se: "*Kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie përcaktohen nga autoriteti i planifikimit në PPV...*".

Si konkluzion, miratimi i lejes së ndërtimit në kundërshtim me disa nga kushtet e zhvillimit (kondicionet) cënon apo mund të cënojnë lirinë e përdorimit të pronës, hapësirat publike dhe funksionale të nevojshme për shërbimet si dhe sigurinë individuale dhe shëndetësore të komunitetit.

-Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi:

-Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet rilevimi topografik dhe plani i vendosje së objektit të propozuar mbi fragmentin e hartës ekzistuese, në të cilën të pasqyrohen pozicioni i saktë i vendosjes së objekteve, paraqitja e objekteve me të cilat kufizohet dhe infrastruktura rrugore. Në mungesë të paraqitjes së gjendjes ekzistuese të parecëlës në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, nuk mund të merret në konsideratë saktësia e vendosjes së njollës së objektit mbi hartën e treguese të pasurisë dhe distancat e shënuara nga kufiri i pronës. Gjithashtu nuk paraqiten objektet me të cilat objekti kufizohet dhe distancat ndërmjet tyre. Po ashtu edhe distanca ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës. Në lidhje me respektimin e distancave nuk mund të përcaktohet nëse janë respektuar, pasi nuk paraqitet një plan i saktë mbi të cilën të verifikohen. Në planvendosje nuk pasqyrohet as harta treguese e pasurisë dhe pozicioni i objektit në ortofoto. Në raport me të dhënat e treguesve të zhvillimit, koecienti dhe intensiteti i ndërtimit nuk janë reflektuar saktë, ndonëse nuk tejkalojnë të parametrat e lejuar të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor. Për sa më sipër, në kundërshtim me gërmën c, të pikës 1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, sipas të cilit "....*dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi janë: Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese*".

Nga dokumentacioni i audituar, është konstatuar se autoriteti përgjegjës nuk ka marrë masa për njoftimin e kërkuesit me qëllim plotësimin e mangësive të sipërcituara. Kjo situatë përbën një mosveprim të autoritetit përgjegjës, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 20, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, e cila, ndër të tjera, citon se: "*Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda 15 ditëve, të kryejë plotësimin e dokumentacionit:...*".

Si konkluzion, pranimi dhe miratimi i dokumentacionit shoqërues në lidhje me kërkesën për leje ndërtimi, në kushtet kur ky i fundit nuk është i plotë, përveç efektit "miratim në heshtje" (pika 5, neni 20, VKM nr. 408, datë 13.05.2015), mund të shkaktojnë problematika apo efekte negative gjatë fazës së zbatimit dhe zhvillimit të lejes së ndërtimit.

-Në lidhje me paraqitjen nga aplikuesi të dokumentave që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta:

Referuar pikës 1/ "b", të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar (pjesë e dokumentave që duhet të dorëzojë aplikuesi), si kusht për pajisjen e leje ndërtimi, ndër të tjera janë edhe "*dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta*". Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, grupi i auditimit ka konstatuar paraqitjen e dokumentacionit shoqërues si vijon:

-Certifikatë pronësie për pasuritë që marrin pjesë në zhvillim:

Nr. rendor	*Nr. pasurie*	*ZK nr.*	*Lloji*	*Sipërfaqe totale/m2*	*Truall m2*	*Ndërtesë m2*	*Data e lëshimit të dokumentit*
1	145/13	1678	Arë +Truall	8950	200	120	20.12.2024

Nga verifikimi i dokumentave të pasurisë që merr pjesë në zhvillim, sipërfaqja totale e pasurisë që do të zhvillohen objektet është **8950 m^2**.

Në lidhje me sa më sipër trajtuar, grupi i auditimit ka konstatuar se në dokumentacionin e pronësisë, nuk paraqitet certifikata e pronësisë, ndonëse kartela e pasurisë dhe harta treguese janë ngarkuar në dosje. Për sa më sipër trajtuar, hartat treguese dhe kartelat e pasurisë nuk janë të rifreskuara mbi statusin juridik të pronës *brenda 3 muajve të fundit*, referuar periudhës së paraqitjes së aplikimit për pajisjen me leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "*Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar*".

- Në lidhje me përcaktimin e të gjitha kushteve në dokumentit të lejes:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të pasurive që marrin pjesë në zhvillim, rezulton se, mbi pasurinë me nr. 145/13, në zonën kadastrale nr.1678, gjendet një ndërtesë me sipërfaqe 120 m^2. Për prishjen e objekteve ekzistuese, pjesë e lejes së ndërtimit është edhe leja për prishjen e objekteve sipas VKM nr.408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", të ndryshuar, neni 11, pika "ç", në të cilën citohet se "*Punimet për të cilat kërkohet pajisja me leje ndërtimi, sipas nenit 39 të Ligjit, janë ato që:... kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri. Nëse prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes*". Sa më sipër miratimi i kësaj leje është bërë në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, të ndryshuar, neni 11.

-Në lidhje me kërkesën apo mendimet e shprehura nga autoritetet publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, për miratimin e lejes:

Nga autoriteti përgjegjës janë marrë paraprakisht mendimet nga disa prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka kërkuar dhe marrë paraprakisht mendimin nga: Drejtoria Vendore ASHK Berat dhe Drejtoria Rajonale OSHEE Berat.

Nga dokumentacioni i audituar, konstatohet se nga autoriteti përgjegjës nuk janë marrë të gjitha mendimet e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Përkatësisht nuk është marrë mendim nga: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia për Eficencën e Energjisë, Operatori i Sistemit te Transmetimit, PMNZSH Kamëz, Ujësjellës Kanalizime, UPT-IGJEUM. Sa më sipër, nga autoriteti përgjegjës, ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 6, të nenit 21, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit "*Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.*".

Si konkluzion, nga zhvillimi apo realizimi i punimeve të përcaktuara në një leje ndertimi, për miratimin e së cilës nuk janë marrë paraprakisht të gjitha mendimet e autoriteteve që duhet të shprehen, mund të rezultojë që objektet e ndërtuara të ndikojnë negativisht apo të cënojnë lirinë e përdorimit të pronës, hapësirat publike dhe funksionale si dhe sigurinë individuale dhe shëndetësore të komunitetit.

- Në lidhje me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI):

Konstatohet se në Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) evidentohen pasaktësi në llogaritjen e saj referuar pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, përcakton se: "*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore*". Gjithashtu, në pikë 3/a të nenit 27, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore*", i ndryshuar, përcaktohet se: "*Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 përqind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është 2 deri në 4 për qind e saj*" dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.69, datë 23.12.2024, "*Për nivelin e taksave-tarifave vendore dhe administratimin e tyre për vitin 2025*", pika 6, tabela a, kategoria III. Tipologjia e ndërtimit bën pjesë në ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e industrisë/ bujqësisë. Niveli i taksës për ndërtime të tjera që nuk përfshihen në dy kategoritë e para, është **2%** e vlerës së investimit referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Poliçan.

Vlera e preventivit sipas subjektit: 123,066,782 lekë x 2% (*niveli i taksës sipas paketës fiskale për objekte të tjera*) = **2,461,336 lekë.**


Konkretisht, vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e autoritetit përgjegjës është **1,491,132.5 lekë**, ndërkohë që, sipas përllogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, vlera e TNI-së

duhet të ishte **2,461,336 lekë**. Përllogaritja jo e saktë e taksës nga autoriteti përgjegjës ka ndodhur për shkak të mosllogaritjes në nivelin e duhur të taksës, sipas destinacionit të propozuar. Për sa më sipër, grupi i auditimit arrin në përfundimin se vlera prej **970,203 lekë**, **përbën të ardhura të munguara për Bashkinë e Poliçan.**

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:*1.Z.A. Z., *Kryetar i Bashkisë Poliçan*; 2.Z.F. A., *me pozicion drejtor në Drejtorinë e Planifikimi të Territorit, Emergjencave Civile, Bujqësisë dhe Veterinarisë;* 3.Znj.L. T. , *me pozicion topografe në Drejtorinë e Planifikimi të Territorit, Emergjencave Civile,Bujqësisë dhe Veterinarisë;* 4.Znj.G. F., *me pozicion specialiste në Sektorin e Menaxhimit Finaciar dhe Aseteve;* 5.Znj.A.C., *me pozicion drejtor në Drejtorinë e Tatim-Taksave.*

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin "*e-Leje*" të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Poliçan, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt ***"Ambiente argetuese sportive"***, për të cilën është marrë vendimi **Nr. 12, datë 13/06/2024**, referuar Ligjit 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 04, datë 08.02.2017, si dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar, etj., u konstatua si vijon:

Të dhëna të përgjithshme mbi lejen e ndërtimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Objekti i lejes së ndërtimit: "Ambiente argetuese sportive"</td></tr>
<tr><td colspan="2">
</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td>1. Njësia Strukturore:
MMN.2.3</td><td>2. Zhvilluesi:
Z. S. T.</td><td>3. Adresa e realizimit të punimeve: Fshati Kapinov, Njësia Administrative Vërtop, Bashkia Poliçan</td><td>4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2:
PO/JO-JO</td></tr>
<tr><td>5. Data e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi:
Data: 19/04/2024</td><td colspan="2">6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi:
Nr. 12, datë 13/06/2024</td><td>4/1. Lloji i objektit:
Sport/ Rekreacion</td></tr>
<tr><td>5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës:
23 ditë</td><td colspan="2">7. Vlera e preventivit referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti: 6,203,191 lekë</td><td>10/1. Nga auditimi është konstatuar diferencë apo përllogaritje e gabuar e TNI-së:
Po/Jo- PO</td></tr>
</table>

- *<u>Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes</u>**<u>:</u>***

Nga dokumentacioni i audituar dhe nga të dhënat e përgjithshme lidhur me detajet e aplikimit të pasqyruara në sistemin e-leje, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për leje ndërtimi për **40 ditë**, në respektim të afateve të përcaktuara nenin 44, pika 2, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", dhe përcaktimet e nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar.

*<u>-Në lidhje me zbatimin e kushteve të zhvillimit të përcaktuara për miratimin e lejes</u>**<u>:</u>***

Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr.04, datë 27/04/2024. Parcelat në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe në zonat me përparësi në zhvillimin e turizmit malor, përkatësisht në njësinë strukturore ***MMN.2.3***, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Të dhënat mbi kushtet bazë të zhvillimit, referuar Njësië Strukturore: MMN.2.3, në të cilën do të zhvillohet ndërtimi:

Kondicionet referuar dokumentit	***PPV***	***Leje ndërtimi***
Kategoria e përdorimit të tokës / Përdorime të lejuara	N. Tokë Natyrore Bujqesi (B), Aktivitete sociale dhe rekreative (AR), Infrastruktura (IN),Zona ushtarake (ZU),Trashegimi dhe monumente kulture dhe historike(M), Ujera (U)	Sport/ Rekreacion
Kushte të tjera	Lejohen ndërtesa te vogla druri te parafabrikuara (pa themele)	
Kufizimet ligjore	Në të gjitha më lart mbizotërojnë kushtet e Vendimit 472, datë 18.07.2012 'Për Shpalljen "Park Kombëtar" të ekosistemit natyror Mali I Tomorrit, me sipërfaqe të zgjeruar', të cilat kanë përparësi mbi këtë Rregullore.	

Grupi i auditimit ka konstatuar se leja e ndërtimit, është miratuar në mospërputhje me disa nga kushtet e zhvillimit (kondicionet), konkretisht si vijon:

- Referuar të dhënave të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.04, datë 08.02.2017, njësia strukturore në të cilën zhvillohet objekti i përket sistemit N-Natyror dhe zonë e shpallur në Park Kombëtar. Për përdorimin e tokës lejohen vetëm zhvillime të cilat nuk cënojnë dhe dëmtojnë zonën, që të jenë në përputhje me PPV dhe kufizimet ligjore.

-Në raport me tipologjinë e ndërtimit dhe konstruksionin, objekti i propozuar përbëhet me strukturën druri dhe me skelet mbeshtetes. Ndërsa në lidhje me destinacionin e ndërtimit, objekti parashikon aktivitete sportive dhe rekreative.

-Në raport me respektimin e distancave, nga shqyrtimi i planvendosjes së miratuar, për objektin në lartësinë e 1 kati është respektuar distanca minimale prej 2 metër nga kufiri i pronës, në përputhje me pikën 1, të nenit 35, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.

Situata e sipërcituar është në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 14, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit "*Leja e ndërtimit lëshohet në përputhje me përcaktimet e lejes së zhvillimit, dokumenteve të planifikimit, të rregulloreve të zhvillimit e ndërtimit, si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë ndërtimore në Republikën e Shqipërisë*" si dhe pikës 1, të nenit 32, e cila, ndër të tjera, citon se: "*Kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie përcaktohen nga autoriteti i planifikimit në PPV...*".

*-Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi**:***

-Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet plani i vendosje së objektit të propozuar mbi fragmentin e hartës ekzistuese (mbi rilevimin topografik), në të cilën të pasqyrohen pozicioni i saktë i vendosjes së objekteve, paraqitja e objekteve me të cilat kufizohet dhe infrastruktura rrugore. Në mungesë të paraqitjes së gjendjes ekzistuese të parecëlës në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, nuk paraqitet saktë pozicioni i vendosjes së objektit dhe distancat nga kufiri i pronës. Gjithashtu nuk paraqiten objektet me të cilat objekti kufizohet (nëse ka të tilla në zonë) dhe distancat ndërmjet tyre. Po ashtu edhe distanca ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës, si dhe mënyra e aksesit në objekt. Për sa më sipër, në kundërshtim me gërmën c, të pikës 1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, sipas të cilit "*....dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi janë: Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese*".

Gjithashtu, nga dokumentacioni i audituar, është konstatuar se autoriteti përgjegjës nuk ka marrë masa për njoftimin e kërkuesit me qëllim plotësimin e mangësive të sipërcituara. Kjo situatë përbën një mosveprim të autoritetit përgjegjës, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 20, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i

ndryshuar, e cila, ndër të tjera, citon se: "*Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda 15 ditëve, të kryejë plotësimin e dokumentacionit:...*".
Si konkluzion, pranimi dhe miratimi i dokumentacionit shoqërues në lidhje me kërkesën për leje ndërtimi, në kushtet kur ky i fundit nuk është i plotë, përveç efektit "miratim në heshtje" (pika 5, neni 20, VKM nr. 408, datë 13.05.2015), mund të shkaktojnë problematika apo efekte negative gjatë fazës së zbatimit dhe zhvillimit të lejes së ndërtimit.
-Në lidhje me paraqitjen nga aplikuesi të dokumentave që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta:
Referuar pikës 1/ "b", të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar (pjesë e dokumentave që duhet të dorëzojë aplikuesi), si kusht për pajisjen e leje ndërtimi, ndër të tjera janë edhe "*dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta*". Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, grupi i auditimit ka konstatuar paraqitjen e dokumentacionit shoqërues si vijon:
-Certifikatë pronësie për pasuritë që marrin pjesë në zhvillim:

Nr. rendor	*Nr. pasurie*	*ZK nr.*	*Lloji*	*Sipërfaqe totale/m2*	*Truall m2*	*Ndërtesë m2*	*Data e lëshimit të dokumentit*
1	2134	2080	Arë	1584	-	-	22.11.2019

Nga verifikimi i dokumentave të pasurisë që merr pjesë në zhvillim, sipërfaqja totale e pasurisë që do të zhvillohen objektet është **1584 m^2**.
Në lidhje me sa më sipër trajtuar, grupi i auditimit ka konstatuar se hartat treguese dhe kartelat e pasurisë nuk janë të rifreskuara mbi statusin juridik të pronës *brenda 3 muajve të fundit*, referuar periudhës së paraqitjes së aplikimit për pajisjen me leje ndërtimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2018, për "*Kadastrën*", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4, në të cilën përcaktohet se: "*Certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kadastrale dhe hartës përkatëse kadastrale. Pas çdo ndryshimi të pronësisë mbi pasurinë, bashkimi apo ndarjeje të saj, lëshohet certifikatë, kartelë dhe hartë e re, sipas gjendjes së përditësuar*".
-Në lidhje me kërkesën apo mendimet e shprehura nga autoritetet publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, për miratimin e lejes:
Nga autoriteti përgjegjës janë marrë paraprakisht mendimet nga disa prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka kërkuar dhe marrë paraprakisht mendimin nga: Drejtoria Vendore ASHK Berat dhe Drejtoria Rajonale OSHEE Berat.
Referuar kufizimit ligjor që ka njësia që propozohet të zhvillohet objekti, Vendimit 472, datë 18.07.2012 "*Për Shpalljen "Park Kombëtar" të ekosistemit natyror të Malit të Tomorrit*", ka përparësi mbi Rregulloren e Planin të Përgjithshëm Vendor.
Nga dokumentacioni i audituar, konstatohet se nga autoriteti përgjegjës nuk janë marrë të gjitha mendimet e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Përkatësisht nuk është marrë mendim nga: Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia për Eficencën e Energjisë, Operatori i Sistemit te Transmetimit, PMNZSH Kamëz, Ujësjellës Kanalizime, UPT-IGJEUM. Sa më sipër, nga autoriteti përgjegjës, ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 6, të nenit 21, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit "*Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.*".
Si konkluzion, nga zhvillimi apo realizimi i punimeve të përcaktuara në një leje ndertimi, për miratimin e së cilës nuk janë marrë paraprakisht të gjitha mendimet e autoriteteve që duhet të shprehen, mund të rezultojë që objektet e ndërtuara të ndikojnë negativisht apo të cënojnë lirinë e

përdorimit të pronës, hapësirat publike dhe funksionale si dhe sigurinë individuale dhe shëndetësore të komunitetit.

- Në lidhje me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI):

Konstatohet se në Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) evidentohen pasaktësi në llogaritjen e saj referuar pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, përcakton se: "*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore*". Gjithashtu, në pikë 3/a të nenit 27, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore*", i ndryshuar, përcaktohet se: "*Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 përqind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është 2 deri në 4 për qind e saj*" dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.58, datë 22.12.2023, "*Për nivelin e taksave-tarifave vendore dhe administratimin e tyre për vitin 2024*", pika 6, tabela a, kategoria III. Niveli i taksës për ndërtime të tjera që nuk përfshihen në dy kategoritë e para, përkatësisht objekti me destinacion rekracioni është **2%** e vlerës së investimit referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Poliçan.

Vlera e preventivit sipas subjektit: 6,203,191 lekë x 2% (*niveli i taksës sipas paketës fiskale për objekte të tjera*) = **124,064 lekë**


Konkretisht, vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e autoritetit përgjegjës është **468, 000 lekë**, ndërkohë që, sipas përllogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, vlera e TNI-së duhet të ishte **124,064 lekë**. Përllogaritja jo e saktë e taksës nga autoriteti përgjegjës ka ndodhur për shkak të mosllogaritjes në nivelin e duhur të taksës, sipas destinacionit të propozuat. Për sa më sipër, grupi i auditimit arrin në përfundimin se vlera prej **343,936 lekë**, është likujduar më shumë sesa vlera që subjekti kishte detyrim për të paguar.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:*1.Z.A. Z., *Kryetar i Bashkisë Poliçan*; 2.Z.F. A., *me pozicion drejtor në Drejtorinë e Planifikimi të Territorit, Emergjencave Civile, Bujqësisë dhe Veterinarisë;* 3.Znj.L. T. , *me pozicion topografe në Drejtorinë e Planifikimi të Territorit, Emergjencave Civile,Bujqësisë dhe Veterinarisë;* 4.Znj.G. F., *me pozicion në specialiste Sektorin e Menaxhimit Finaciar Dhe Aseteve;* 5.Znj.A.C., *me pozicion drejtor në Drejtorinë e Tatim-Taksave.*

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin "*e-Leje*" të lejeve të ndërtimit në Bashkinë Poliçan, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt ***"Fabrikë vaji 1 kat"***, për të cilën është marrë vendimi **Nr.08, datë 23/06/2023**, referuar Ligjit 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 04, datë 08.02.2017, si dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar, etj., u konstatua si vijon:

Të dhëna të përgjithshme mbi lejen e ndërtimit:

Objekti i lejes së ndërtimit: *"Fabrikë vaji 1 kat"*





1. Njësia Strukturore: **ZB.1**	2. Zhvilluesi: A. M.	3. Adresa e realizimit të punimeve: Fshati Mbrakull, Njësia adminstrative Vërtop, Bashkia Poliçan	4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2: PO/JO-PO
5. Data e dorëzimit të kërkesës për leje ndërtimi: Data: 08/06/2023	6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi: Nr.08, datë 23/06/2023		4/1. Lloji i objektit: Prodhim
5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës: 12 ditë	7. Vlera e preventivit referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti: 11,542,823 lekë		10/1. Nga auditimi është konstatuar diferencë apo përllogaritje e gabuar e TNI-së: Po/Jo- PO

- *<u>Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes</u>**:**

Nga dokumentacioni i audituar dhe nga të dhënat e përgjithshme lidhur me detajet e aplikimit të pasqyruara në sistemin e-leje, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për leje ndërtimi për **12 ditë**, në respektim të afateve të përcaktuara nenin 44, pika 2, të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", dhe përcaktimet e nenit 20 dhe 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar.

*<u>-Në lidhje me zbatimin e kushteve të zhvillimit të përcaktuara për miratimin e lejes</u>**:**

Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin Nr.06, datë 04/05/2023. Parcelat në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë strukturore *ZB.1*, në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas kondicioneve urbane të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Të dhënat mbi kushtet bazë të zhvillimit, referuar Njësië Strukturore: ZB.1, në të cilën do të zhvillohet ndërtimi:

Kondicionet referuar dokumentit	***PPV***	***Leje ndërtimi***
Kategoria e përdorimit të tokës/ Përdorime të lejuara	B_ Bujqësor Lejohen objektet blegtorale vetëm në zona ku ka kanale e ujitjes, lejohen industritë e lehta për përpunimin e qëndrueshëm të produkteve bujqësore, pas marrjes së lejes mjedisore (B.1), në menyrë të qëndrueshme dhe kur të jëpet leja mjedisore (IN.1).	Prodhim
Parcela minimale për zhvillim	3000 m2	6525 m²
Lartësia në kate	2 kate + çati deri në 1.20m	1 kat
Lartësia në metra	7.00m + çati deri në 1.20m	6.2 metra
Intesiteti i ndërtimit	0.2	0.07
KSHT	30 %	7.03 %

<u>Grupi i auditimit ka konstatuar se leja e ndërtimit, është miratuar në mospërputhje me disa nga kushtet e zhvillimit (kondicionet), konkretisht si vijon:</u>

-Parcela në të cilën zhvillohet ndërtimi është 6525 m^2, me një sipërfaqe më të madhe se parecela minimale e lejuar për zhvillim.

- Referuar të dhënave të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.04, datë 08.02.2017, lartësia në kate/ lartësia në metra e objektit të propozuar është brenda parametrave dhe kondicioneve të lejuara.

-Në raport me respektimin e distancave, nga shqyrtimi i planvendosjes së miratuar, për objektin në lartësinë 6.2 metra është respektuar distanca prej 8.3 metër nga kufiri i pronës, në kundërshtim

me pikën 12, të nenit 34,të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.
Situata e sipërcituar është në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 14, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit "*Leja e ndërtimit lëshohet në përputhje me përcaktimet e lejes së zhvillimit, dokumenteve të planifikimit, të rregulloreve të zhvillimit e ndërtimit, si dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë ndërtimore në Republikën e Shqipërisë*" si dhe pikës 1, të nenit 32, e cila, ndër të tjera, citon se: "*Kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie përcaktohen nga autoriteti i planifikimit në PPV dhe/ose PDV...*".
-Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi:
-Në lejen e ndërtimit të miratuar, në treguesit e zhvillimit, nuk pasqyrohen të dhënat në lidhje me sipërfaqen e përgjithshme të truallit.
-Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet plani i vendosje së objektit të propozuar mbi fragmentin e hartës ekzistuese (mbi rilevimin topografik), në të cilën të pasqyrohen pozicioni i saktë i vendosjes së objekteve, paraqitja e objekteve me të cilat kufizohet dhe infrastruktura rrugore. Në mungesë të paraqitjes së gjendjes ekzistuese të parecëlës në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, nuk paraqitet saktë pozicioni i vendosjes së objektit dhe distancat nga kufiri i pronës. Gjithashtu nuk paraqiten objektet me të cilat objekti kufizohet dhe distancat ndërmjet tyre. Po ashtu edhe distanca ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës. Për sa më sipër, në kundërshtim me gërmën c, të pikës 1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, sipas të cilit "*....dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi janë: Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese*".
Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 1, të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit "*dokumentet që duhet të dorëzojë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi janë:...*".
Gjithashtu, nga dokumentacioni i audituar, është konstatuar se autoriteti përgjegjës nuk ka marrë masa për njoftimin e kërkuesit me qëllim plotësimin e mangësive të sipërcituara. Kjo situatë përbën një mosveprim të autoritetit përgjegjës, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 20, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, e cila, ndër të tjera, citon se: "*Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda 15 ditëve, të kryejë plotësimin e dokumentacionit:...*".
Si konkluzion, pranimi dhe miratimi i dokumentacionit shoqërues në lidhje me kërkesën për leje ndërtimi, në kushtet kur ky i fundit nuk është i plotë, përveç efektit "miratim në heshtje" (pika 5, neni 20, VKM nr. 408, datë 13.05.2015), mund të shkaktojnë problematika apo efekte negative gjatë fazës së zbatimit dhe zhvillimit të lejes së ndërtimit.
-Në lidhje me paraqitjen nga aplikuesi të dokumentave që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta:
Referuar pikës 1/ "b", të nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar (pjesë e dokumentave që duhet të dorëzojë aplikuesi), si kusht për pajisjen e leje ndërtimi, ndër të tjera janë edhe "*dokumentet që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta*". Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri, nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, grupi i auditimit ka konstatuar paraqitjen e dokumentacionit shoqërues si vijon:
-Certifikatë pronësie për pasuritë që marrin pjesë në zhvillim:

Nr. rendor	*Nr. pasurie*	*ZK nr.*	*Lloji*	*Sipërfaqe totale/m2*	*Truall m2*	*Ndërtesë m2*	*Data e lëshimit të dokumentit*
1	263/31	2632	Arë	6525	-	-	10.04.2023

Nga verifikimi i dokumentave të pasurisë që merr pjesë në zhvillim, sipërfaqja totale e pasurisë që do të zhvillohen objektet është **6525 m^2**.

Sa më sipër trajtuar, grupi i auditimit ka konstatuar se harta treguese dhe kartela e pasurisë janë të rifreskuara mbi statusin juridik të pronës brenda 3 muajve të fundit, referuar periudhës së paraqitjes së aplikimit për pajisjen me leje ndërtimi, në zbatim të Ligjit nr. 111/2018, për "Kadastrën", datë 7.2.2019, në nenin 17, pika 4.

-Në lidhje me kërkesën apo mendimet e shprehura nga autoritetet publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, për miratimin e lejes:

Nga autoriteti përgjegjës janë marrë paraprakisht mendimet nga disa prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka kërkuar dhe marrë paraprakisht mendimin nga: Drejtoria Vendore ASHK Berat dhe Drejtoria Rajonale OSHEE Berat.

Nga dokumentacioni i audituar, konstatohet se nga autoriteti përgjegjës nuk janë marrë të gjitha mendimet e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Përkatësisht nuk është marrë mendim nga: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia për Eficencën e Energjisë, Operatori i Sistemit te Transmetimit, PMNZSH Kamëz, Ujësjellës Kanalizime, UPT-IGJEUM. Sa më sipër, nga autoriteti përgjegjës, ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 6, të nenit 21, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit "*Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.*".

Si konkluzion, nga zhvillimi apo realizimi i punimeve të përcaktuara në një leje ndertimi, për miratimin e së cilës nuk janë marrë paraprakisht të gjitha mendimet e autoriteteve që duhet të shprehen, mund të rezultojë që objektet e ndërtuara të ndikojnë negativisht apo të cënojnë lirinë e përdorimit të pronës, hapësirat publike dhe funksionale si dhe sigurinë individuale dhe shëndetësore të komunitetit.

- Në lidhje me Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI):

Konstatohet se në Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) evidentohen pasaktësi në llogaritjen e saj referuar pikës 1 të nenit 46 të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, përcakton se: "*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore*". Gjithashtu, në pikë 3/a të nenit 27, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore*", i ndryshuar, përcaktohet se: "*Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 përqind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është 2 deri në 4 për qind e saj*" dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.54, datë 23.12.2022, "*Për nivelin e taksave-tarifave vendore dhe administratimin e tyre për vitin 2023*", pika 6, tabela a, kategoria III. Tipologjia e ndërtimit bën pjesë në ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e industrisë/ bujqësisë. Niveli i taksës për ndërtime të tjera, që nuk përfshihen në dy kategoritë e para, është **2%** e vlerës së investimit, referuar Paketës Fiskale të Bashkisë Poliçan.


Vlera e preventivit sipas subjektit: 11,542,823 lekë x 2% (*niveli i taksës sipas paketës fiskale për objekte të tjera*) = **230,856 lekë**

Konkretisht, vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e autoritetit përgjegjës është **895,050 lekë**, ndërkohë që, sipas përllogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, vlera e TNI-së duhet të ishte **230,856 lekë**. Përllogaritja jo e saktë e taksës nga autoriteti përgjegjës ka ndodhur për shkak të një lapsusi në llogaritjen e nivelit të taksë. Për sa më sipër, grupi i auditimit arrin në përfundimin se vlera prej **664,194 lekë**, është likujduar më shumë sesa vlera që subjekti kishte detyrim për të paguar.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:*1.Z.A. Z., *Kryetar i Bashkisë Poliçan*;2.Z.F. A., *me pozicion drejtor në Drejtorinë e Planifikimi të Territorit, Emergjencave Civile, Bujqësisë dhe Veterinarisë;* 3.Znj.L. T. , *me pozicion topografe në Drejtorinë e Planifikimi të Territorit, Emergjencave Civile,Bujqësisë dhe Veterinarisë;* 4.Znj.G. F., *me pozicion specialiste në Sektorin e Menaxhimit Finaciar Dhe Aseteve;* 5.Znj.A.C., *me pozicion drejtor në Drejtorinë e Tatim-Taksave;*

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin "*e-Leje*" të certifikatave të përdorimit në Bashkinë Poliçan, lidhur me auditimin e përputhshmërisë së miratimit të procedurës me objekt ***"Magazinë për përdorim blegtoral, (stallë vicash)",*** për të cilën është marrë vendimi **Nr. 04, datë 30/09/2024**, referuar Ligjit 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores Vendore, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 04, datë 08.02.2017, si dhe në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, "*Për inspektimin e ndërtimit*", i ndryshuar., u konstatua si vijon:

Të dhëna të përgjithshme mbi certifikatën e përdorimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Objekti i çertifikatës së përdorimit: "Magazinë për përdorim blegtoral, (stallë vicash)"</td></tr>
<tr><td colspan="4">
</td></tr>
<tr><td>1. Leja e ndërtimit:
Nr.4, Datë 03.04.2024</td><td rowspan="2">2. Zhvilluesi:
X. M.</td><td rowspan="2">3.Adresa e realizimit të punimeve: Fshati Bregas, Bashkia Poliçan</td><td rowspan="2">4. Ndërtim i ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2:
PO/JO- PO</td></tr>
<tr><td>1/2. Afati i lejes së ndërtimit:
Datë 12 muaj</td></tr>
<tr><td>5. Data e dorëzimit të kërkesës për certifikatë përdorimi: 21/08/2024</td><td colspan="2">6. Numri dhe data e Vendimit të miratimit të kërkesës për leje certifikatë përdorimi:
Nr. 04, datë 30/09/2024</td><td>4/1. Lloji i objektit:
Objekt në funksion të blektorisë</td></tr>
<tr><td>5/1. Kohëzgjatja e shqytimit të kërkesës: 29 ditë</td><td colspan="2">7.Vlera e preventivit sipas lejes së ndërtimit:
5,012,923 lekë</td><td></td></tr>
</table>

*-Në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara për miratimin e lejes**:***

Nga dokumentacioni i audituar dhe nga të dhënat e përgjithshme lidhur me detajet e aplikimit të pasqyruara në sistemin e-leje, konstatohet se autoriteti përgjegjës ka shqyrtuar kërkesën për certifikatë përdorimi për **29 ditë**, në respektim të afateve të përcaktuara në bazë të legjislacionit në fuqi, në përputhje me përcaktimet e pikës 5, të nenit 42, të ligjit 107/2014 "*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*",i ndryshuar, sipas të cilit "*Autoriteti përgjegjës vendos për lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda 55 ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës për leje ndërtimi...*" dhe përcaktimet e pikës 6 dhe 7, të nenit 27, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar.

*-Në lidhje me zbatimin e kushteve të përcaktuara në miratimin e lejes së ndërtimit**:***

Nga dokumentacioni i shqyrtuar për aplikimin e certifikatës së përdorimit, në raport me plotësimin e kushteve të përcaktuara në lejen e ndërtimit të miratuar, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohen si vijon:

- Leja e ndërtimit është miratuar në datën 03.04.2024 dhe është e vlefshmërinë për 12 muaj, referuar lejes së ndërtimit të miratuar. Data e fillimit të punimeve është 27.05.2024. Punimet e objektit kanë përfunduar me datë 09.07.2024, brenda vlefshmërisë së lejes.
Kërkesa për certifikatë përdorimi është realizuar pas përfundimit të punimeve, në datën 21/08/2024. Në raport me destinacionin e zhvillimit të strukturës së realizuar është në përputhje me lejen e ndërtimit.
-*Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi për t'u pajisur me certifikatë përdorimi**:***
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-leje, u konstatua që kryesisht ka mangësi në përmbajtje dhe në saktësimin e dokumentacionit të paraqitur. Në projektin "as build" paraqitet projekti kontruktiv, i njëjtë me projektin e ngarkuar në aplikimin për lejen e ndërtimit dhe nuk pasqyrohet projekti i realizuar gjatë fazës së zbatimit. Përsa më sipër, në kundërshtim me pikën g, të 27/2, të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar.
-Në dokumentacionin e ngarkuar, situacioni përfundimtar i punimeve është i njëjtë me preventivin e punimeve dhe nuk janë reflektuar punimet të cilat nuk janë kryer plotësisht, në kundërshtim me pikën 1/e), të nenit 27/2, të VKM-në 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar.
- Në dosjen e shqyrtuar nuk paraqitet "*Projekti për mirëmbajtjen e objektit*", i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve, në kundërshtim me VKM-në 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, referuar gërmës gj, të pikës 1, të nenit 27/2.
*-Në lidhje me miratimin e certifikatës së përdorimit**:***
- Nga verifikimi i përfundimit të punimeve të ndërtimit, referuar fotove të ngarkuara në sistem, u konstatuan disa punime të papërfunduara në realizimin e objektit, përkatësisht vendosja e dritareve përgjatë fasadave. Këto ndryshime pasqyrohen në imazhet e mëposhtme, pjesë e fasadave të miratuara në lejen e ndërtimit dhe foto të realizimit në terren:





- Në bazë të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, Neni 42, në pikën 3, përcaktohet se certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor. Ndërsa në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi.
-Bazuar në Neni 27/1, mbikëqyrja e punimeve, pika 3, të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, përcaktohet se: "Në çdo rast, verifikimi dhe konfirmimi i akteve të kontrollit , sipas shkronjave "ç" dhe "dh", të këtij neni, janë të detyrueshme." *Në rast se konstatohet mospërputhje e faktit me aktkontrollet e mbajtura, ai merr*

masat e nevojshme kundrejt subjektit ndërtues, si dhe subjekteve të licencuara që janë shprehur në aktkontrolle.". Autoriteti vendor nuk ka kryer të gjithë verifikimet e nevojshme përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, duke sjellë si pasojë certifikimin e objektit të papërfunduar me të gjitha detajet e parashikuara në projektin e ndërtimit të miratuar në lejen e ndërtimit.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi strukturat e ngritura për miratimin e lejes së ndërtimit:*1. Z. A. Z., *Kryetar i Bashkisë Poliçan*; 2. Z.F. A., *me pozicion drejtor në Drejtorinë e Planifikimi të Territorit, Emergjencave Civile, Bujqësisë dhe Veterinarisë;* 3.Znj.L. T. , *me pozicion topografe në Drejtorinë e Planifikimi të Territorit, Emergjencave Civile,Bujqësisë dhe Veterinarisë;* 4.Znj.G. F., *me pozicion specialiste në Sektorin e Menaxhimit Finaciar dhe Aseteve;* 5.Znj.A.C., *me pozicion drejtor në Drejtorinë e Tatim-Taksave.*

6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore.

6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

6.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

6.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërin e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit Territorit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Inspektoriati i mbrojtjes së territorit kryen aktivitetin e tij në zbatim të Ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", si edhe në zbatim të Ligjit Nr.107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar.

Struktura e Inspektoratit së Mbrojtjes se Territorit Vendor të Bashkisë Poliçan (IMTV) është miratuar me Urdhër Kryetari, i përbërë nga 3 punonjës, 1 k/inspektor, 2 inspektorë terreni që në formë tabele paraqitet si vijon:

Nr.	**Emër Mbiemër**	**Funksioni sipas strukturës**	**Lloji i arsimit/dega**	**Data emërimit në detyrë**	**Aktualisht në punë apo larguar, data**
1	A. H.	Kryeinspektor	Jurist/M.Shkencor	01.04.2024	PO
2	R. B.	Inspektor	Ekonomik/M.Profesional	01.06.2021	PO
3	Z. B.	Inspektor	Ekonomik M.Shkencor	01.02.2025	PO

Burimi Bashkia Poliçan

Sa më sipër konstatohet se Struktura Organizative e IMTV e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak, nuk është e plotë dhe kjo gjë con në mospërmbushjen e detyrave të kësaj Drejtorie.

Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se, dy nga punonjësit e IMTV Bashkia Poliçan plotëson kriteret e arsimimit të përcaktuara në Ligjin nr. 9780, datë 16/07/2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, të nenit 11 "Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit" ku citohet: " *Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit*".

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale IMTV Bashkia Poliçan, sipas evidencave të vëna në dispozicion për periudhën objekt auditimi rezulton se janë mbajtur procesverbalet e konstatimit të shkeljeve në punimet e ndërtimit të hartuara nga IMTV, vendimet e marra nga kryeinspektori për pezullimin e punimeve të ndërtimit, vendimet e gjobave dhe vendimet e prishjeve për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi.
Në formë tabele paraqiten vendimeve të marra nga IMTV për vitin 2024 -2025 *si vijon:*

Pasqyra e vendimeve të marra .

Nr.	Lloji i aktit	2024	2025
1	PV/Akte kontrolli	5	6
2	PV/Akte konstatimi	5	6
3	Vendime gjobe	5	6
4	Vendime pezullimi	5	6
5	Vendime prishje	5	5
6	PV ekzekutimi të prishjeve	–	–
7	Kallëzime penale		
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	–	–
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	PO	PO
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	JO	JO
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	PO	PO

2. Mbi planifikimin e inspektimeve dhe raportimin periodik:

2.1 Mbi planifikimin e inspektimeve:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet t'i ushtrojë detyrat e tij funksionale në bazë të planeve mujore, tri-mujore dhe/ose vjeçare të punës, sipas planifikimit, i cili hartohet nga kryeinspektori i IMTV-së, në zbatim të VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore",* nënpika b.ii. Nga grupi i auditimit është kërkuar dokumentacion dhe informacion mbi hartimin e tyre, në mënyrë periodike dhe përcjelljen tek strukturat e varësisë.
Nga IMTV janë hartuar planet e punës mujore të miratuara nga kryeinspektori me shkresat respektive, por nuk ka miratuar planet vjetore të punës.

2.2 Mbi raportimin periodik:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor nuk ka paraqitur informacion periodik sipas përcaktimit të ligjit çdo tre muaj pran Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit me qëllim pasqyrimin e punës së bërë për masat e marra, si p.sh. vendimet e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara (pezullim, gjobë, prishje të objektit të kundërligjshëm), kallëzimet penale, si dhe kërkesat për heqje të licencave profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, sipas përcaktimeve të nenit 5 të Ligjit nr.9780, datë 16/07/2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f). *"përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit* ***çdo tre muaj*** *për masat e marra, sipas shkronjave "b", "c", "ç", "d", "dh", të këtij neni"*.

3. Mbi dokumentimin e kundërvajtjeve dhe proceseve të prishjeve me evidenca fotografike:

3.1 Mbi dokumentimin e kundërvajtjeve dhe procesit të prishjes së objekteve të kundërligjshëm:

Në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të proceseve të punës, në këtë rast të procesit të prishjes së objektit të kundërligjshëm, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë.
Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se për 9 raste për të cilat kryeinspektori i IMTV ka nxjerrë vendimin e prishjes,

vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar nga IMTV në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a). Në nënyre të detajuar paraqiten si vijon:

Nr.	Emër mbiemër	Lloji objektit	Vendim prish		Urdhër Ekz		Procesverbal ekzekutimi vendimi për prishje objekti
			Nr.	datë	Nr.	datë	
1	V.	Devijim projekti	03	15.04.2024			
2	B. L.	Tenda pa leje	04	24.07.2024			
3	L. S.	Mur rrethues	05	09.09.2024			
4	K. M.	Mur mbajtës	05	13.02.2025			
5	S. H.	Mur mbajtës	05	13.02.2025			
6	P. B.	Mur mbajtës	06	13.02.2205			
7	A. K.	Shtim kati	07	24.10.2025			
8	K. L.	Ndërtim pa leje	08	27.11.2025			
9	G. Ç.	Ndërtim pa leje	09	04.01.2026			

4. Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të pezullimit të punimeve:

Vendimi për pezullimin e punimeve në ndërtim nxirret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak, për marrjen e vendimit, për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës, ose për marrjen e vendimit për prishjen e objektit. Pezullimi i punimeve në ndërtim ka afat deri në 60 ditë. Një vendim i tillë merret në rastet kur:

- subjekti i kontrolluar mungon në objekt ose nuk i paraqet grupit të inspektimit dokumentacionin teknik e/ose ligjor të punimit/ndërtimit;
- mungojnë masat e sigurimit teknik në objekt dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve;
- plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor kërkon proces miratimi nga autoriteti përgjegjës i planifikimit;
- vendimi i pezullimit të punimeve të ndërtimit për plotësimin e dokumentacionit teknik e/ose ligjor ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe subjekti ndërtues kërkon zgjatjen e afatit, duke e argumentuar në mënyrë zyrtare.

Nga ana e kryeinspektorit për vitin 2024 janë nxjerrë 5 vendime për pezullimin e punimeve, dhe për vitin 2025 janë nxjerrë 6 vendime për pezullimin e punimeve, në lidhje me kundërvajtje si: *"Shkelja e lejes së ndërtimit, pa krijuar shtim volumi"; "Shkelje e deklaratës paraprake"; "Mungesë e dokumentacionit tekniko-ligjor".*

5. Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të dënimit me masë administrative gjobë:

Vendimi për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë merret për të gjitha rastet kur konstatohen shkelje në veprimtarinë ndërtimore. Ky vendim bashkë-shoqëron gjithmonë vendimin për pezullimin e punimeve dhe vendimin për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Vlera e masës administrative përcaktohet sipas dispozitave ligjore, ndërsa për objektet e ndërtuar pa marrë paraprakisht miratimin e autoriteteve vendore ose qëndrore, gjoba përcaktohet në raport të drejtë me vlerën e investimit.

Nga ana e kryeinspektorit të IKMT, Bashkia Poliçan rezulton se janë nxjerr në total 11 vendime për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë, me vlerë totale 15,119,656 lekë nga e cila arkëtuar shuma 55,900 lekë, janë në proces gjyqësor 4 masa në vlerën 8,179,635 lekë si dhe nuk është ndërmarr asnjë masë për 6 subjekte në vlerën 6,884,121 lekë

Nga auditimi i dosjeve për shkeljet e konstatuara është gjenden gjurmë që të jenë mbajtur akt verifikime në terren dhe mbi to të përcaktohet vlera e gjobës në raport të drejtë me vlerën e investimit. Në të gjitha rastet e konstatuara IMTV ka nxjerrë vendimin e dënimit me masë administrative gjobë.

Pra llogaritja e gjobës është bërë sipas përcaktimeve të Nenit 52, pika 1, germa "e", të ligjit Nr.107/2014, Datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar me Ligjin nr. 119/2020 në të përcaktohet që: *e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.*
pika 2. *Vlera e punimeve të kryera pa leje, sipas pikës 1, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij neni, llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit, të përcaktuar me udhëzim të Këshillit të Ministrave.*

6. Mbi nisjen e procedurave për të kallëzuar penalisht kundërvajtësit:

Në respektim të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika dh), si dhe nenit 52 i Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, pika 7, kryeinspektori i IMTV ka detyrimin e përgatitjes së kallëzimit penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe të paraqitjes së tij pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi. Duke marrë në konsideratë informacionin e vendosur në dispozicion nga ana e IMTV, Bashkia Poliçan, si dhe nga auditimi i dokumentacionit, është konstatuar se:
- Nga 9 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Poliçan, në 4 raste nga ana e subjekteve është bërë ankimim në gjykatë për të shfuqizuar vendimet e IMTV, ose kundërvajtësi i pretenduar ka marrë masë sigurie për vendiminn e prishjes.
- Në 9 procedura të mbajtura nga ana e IMTV, Bashkia Poliçan, të cilat përbëjnë vepër penale sipas përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal, dhe IMTV do të duhej të kishte përgatitur kallëzim penal për kundërvajtësin. Sipas punonjësve të IMTV një pjesë e kundërvajtjes janë referuar për ndjekje penale nga policia e shtetit por nuk ka një të dhënë të saktë se sa prej tyre. Nga ana e IMTV duhej të bëhëj një rakordim me policinë e shtetit që asnjë rast të mos lihet pa u referuar për kallzim penal.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. A. H., në cilësinë e Kryeinspektori të IMTV për periudhën 01.04.2024-31.12.2025
- Z. R. B., në cilësinë e Inspektor të IMTV për periudhën 01.01.2024-31.12.2025
- Z. Z. B., në cilësinë e Inspektor të IMTV për periudhën 01.02.2025-31.12.2025

7. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

7.1.*Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe rregjistrimit në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës.*

Për trajtimin e pikës 7.1. nga grupi i auditimit është shqyrtuar dokumentacioni me zgjedhje i vënë në dispozicion nga zyra e menaxhimit financiar dhe aseteve pranë Bashkisë Poliçan, në lidhje me listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim në Bashkinë Poliçan si dhe procedurat e ndjekur për inventarizimin dhe regjistrimin në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Berat dhe Skrapar, konkretisht:

- Lista përfundimtare të pronave, **Pyjeve dhe Kullota**, që janë transferuar në pronësi të Njësisë së Qeverisjes Vendore në **Bashkinë Poliçan**, të Qarkut të Beratit" të përfituara me VKM nr. 896, datë 11.06.2008.
- Lista përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim, në **Komunën Tërpan,** të Qarkut Berat", të përfituara me VKM nr. 735, datë 01.09.2010
- Lista përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim, më **Bashkinë Poliçan**, të Qarkut Berat", të përfituara me VKM nr. 207, datë 09.03.2011

- VKM nr. 476, datë 30.05.2013 "Për një ndryshim në VKM nr. 207, datë 09.03.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Poliçan, të Qarkut Berat".
- Listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të Komunës Vërtop, të Qarkut Berat" të miratuar me VKM nr. 916, datë 29.12.2007.
- VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive" (Bashkia Poliçan, janë sipas shtojcës 5, bashkëlidhur këtij vendimi, e cila përmban listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 646 (gjashtëqind e dyzet e gjashtë).
- VKM-në nr. 451, datë 15.06.2016 "Për kalimin në pronësi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror të Bashkia Poliçan, të Qendrës Polivalente për Shërbime të për kujdesit Shoqërore, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1324, datë 1.10.2008 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të shërbimit social shtetërorë të ndërtesës së ish-Spitali, Poliçan".
- VKM-në nr. 402, datë 04.7.2018 ""Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Poliçan, të pronës nr. 1069, me emërtim "Kombinati Mekanik Zona B", me ve ndodhje në Poliçan.
- Kërkesat e bëra nga Bashkia Poliçan drejtuar drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Berat, për regjistrim të pasurive të përfituara më VKM-të përkatëse.
- Kërkesë drejtuar Ministrisë së Brendshme për miratimin e listës të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të Njësisë Administrative Vërtop, të Qarkut Berat" të miratuar me VKM nr. 916, datë 29.12.2007.
- Dy Urdhëratë e Kryetarit të Bashkisë Poliçan për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e VKM-në nr. 451, datë 15.06.2016 dhe VKM-në nr. 402, datë 04.7.2018 .
- Kërkesa nga Bashkia Poliçan, drejtuar DV ASHK Berat dhe Skrapar, për regjistrim pasurie.
- Fletë regjistri i pasurive të paluajtshme të regjistruar në emër të Bashkisë Poliçan.

7.1/a. Inventarizimi dhe transferimi pronave të paluajtshme publike në juridiksionin e Bashkinë Poliçan:

Bashkia Poliçan, përbëhet nga dy Njësi Administrative, Tërpan dhe Vërtop. miratimi i listës të pronave të paluajtshme publike me VKM, është vetëm për Bashkinë Poliçan e cila është e miratuar me VKM nr. 207, datë 09.03.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Poliçan, të Qarkut Berat" dhe e ish-Komunës Tërpan, e miratuar me VKM nr. 735, datë 01.09.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Komunës Tërpan**,** të Qarkut Berat", **ndërsa Njësia Administrative Vërtop që varet nga Bashkia Poliçan është vetëm me listë inventari të miratuar me** VKM nr. 916, datë 29.12.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të Komunës Vërtop, të Qarkut Berat".

Nga verifikimi i listës të pronave të paluajtshme publike të miratuar me VKM, si dhe procedura në kryejnë e përditësimit të plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në Bashkinë Poliçan rezultoi se në juridiksionin e Bashkinë Poliçan janë gjithsej 1623 pasuri të transferuar në pronësi ose në përdorim të miratuar me VKM.

Numri i pronave të Bashkisë Poliçan dhe i Njësisë Administrative Tërpan të miratuar me VKM janë gjithsej 1623 pasuri, ndërsa 2294 pasuri që janë në inventarë të Njësisë Administrative Vërtop nuk janë të miratuar me VKM.

Numri i pronave të Bashkisë Poliçan dhe i Njësive Administrative:

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar/lista	Nr. Pronave në Inventar të transferuara dhe të miratuara me VKM	Nr. Praktikave të Certifikuara 2023	Nr. Praktikave të Certifikuara gjithsej	Prona të pa Regjistruara
1	Poliçan	940	940	-	43	897
2	Tërpan	683	683	10	10	673

3	Vërtop	2294	--	-	-	-
	TOTALI	**3917**	**1623**	**10**	**53**	**1570**

Burimi: Bashkia Poliçan

1. Lista e pronave të paluajtshme të Bashkisë Poliçan, të transferuara me VKM nr. 896, datë 11.06.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, Pyjeve dhe Kullota, që do të transferohen në pronësi të Njësisë së Qeverisjes Vendore Bashkia Poliçan, të Qarkut të Beratit" vijon me listën me 1 (një) fletë që përfundon me numrin rendor 2 (dy) ***gjithsej 2 pasuri*.**

2. Lista e pronave të paluajtshme të Bashkisë Poliçan, të transferuara me VKM nr. 207, datë 09.03.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Poliçan, të Qarkut Berat" (shoqëruar me 3 formular inventarizimi), vijon me listën me 31 (tridhjetë e një) fletë dhe përfundon me numrin rendor 88 (tetëdhjetë e tetë) ***gjithsej 88 pasuri***.

Vendimi i sipërcituar shoqërohet me 3 formular:

-Formularin nr. 1 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme" ka lidhje me "inventarin e pronave të veçanta" të tipit "truall ndërtese", "rrugë" dhe "sheshe", me fushë përdorimi "arsim" "shëndetësi", "zhvillim ekonomik" "shërbime funerale", "infrastrukturë"

-Formularin nr. 2 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme" ka lidhje me "inventarin e pronave të veçanta të tipit Pyje, kullota, Livadhe, Shkëmbore"

-Formularin nr. 3 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme" ka lidhje me "inventarin e pronave që inventarizohet si klasa të veçanta të tipit, përrenj, lumë, kanal, are, pemëtore, vreshtë etj." Në formularin nr. 3 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme" ka lidhje me "inventarin e pronave që inventarizohet si klasa të veçanta të tipit, përrenj, lumë, kanal, are, pemëtore, vreshtë reparte ushtarake, magazina, depo etj."

3. Lista e pronave të paluajtshme të Bashkisë Poliçan, të transferuara me VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive" (Bashkia Poliçan, vijon me listën me numrin rendor 1 (një) deri 646 (gjashtëqind e dyzet e gjashtë) ***gjithsej 646 pasuri.***

4. Lista e pronave të paluajtshme të shtuara Bashkisë Poliçan, me VKM nr. 476, datë 30.05.2013 "Për një ndryshim në VKM nr. 207, datë 09.03.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Poliçan, të Qarkut Berat" shtohet prona me nr. 89-293 (tetëdhjetë e nëntë-dyqind e nëntëdhjetë e tre) gjithsej 29 (njëzet e nëntë) fletë, ***gjithsej 204 pasuri*.**

5. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme të ***Njësisë Administrative Tërpan***, të transferuara me VKM nr. 735, datë 01.09.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Komunës Tërpan, të Qarkut Berat", (shoqëruar me 3 formular inventarizimi), vijon me listën me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 798 (shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë), ***gjithsej 683 pasuri.***

Vendimi i sipërcituar shoqërohet me 3 formular:

-Formularin nr. 1 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme" ka lidhje me "inventarin e pronave të veçanta" të tipit "truall ndërtese", "rrugë" dhe "sheshe", me fushë përdorimi "arsim" "shëndetësi", "zhvillim ekonomik" "shërbime funerale", "infrastrukturë"

-Formularin nr. 2 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme" ka lidhje me "inventarin e pronave të veçanta të tipit Pyje, kullota, Livadhe, Shkëmbore"

-Formularin nr. 3 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme" ka lidhje me "inventarin e pronave që inventarizohet si klasa të veçanta të tipit, përrenj, lumë, kanal, are, pemëtore, vresht etj." Në formularin nr. 3 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme" ka lidhje me "inventarin e pronave që inventarizohet si klasa të veçanta të tipit, përrenj, lumë, kanal, are, pemëtore, vresht reparte ushtarake, magazina, depo etj."

6. Lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Njësisë Administrative Vërtop, të miratuara me VKM nr. 916, datë 29.12.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të Komunës Vërtop, të Qarkut Berat", vijon me listën me 346 (treqind e

dyzet e gjashtë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 2640 (dymijë e gjashtëqind e dyzet) ***gjithsej 2294 pasuri***.
Lista e pronave të inventarizuara janë të klasifikuara:
Në përdorim
- Prona të lira dhe hapësira të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji;
Në pronësi
-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile,
-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social,
-Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive,
-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik,
-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik,
-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e programeve arsimore,
-Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike),
-Shërbime funerale,
-Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (toka bujqësore joproduktive dhe kanale të treta).

Në lidhje me mos miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim ***të Njësisë Administrative Vërtop*** në Bashkinë Poliçan të Qarkut Berat" për të cilën është miratuar vetëm lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore me VKM nr. 916, datë 29.12.2007 rezulton se:
Nga Bashkia Poliçan me shkresën nr. 1369 prot. datë 21.05.2018 i është drejtuar Agjencisë së Inventarizimit dhe transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore pranë Ministrisë së Brendshme, ku kërkohet miratimi i listës paraprake të pronës të paluajtshme të shtetit që janë brenda juridiksionit të **Njësisë Administrative Vërtop**, Bashkia Poliçan, bashkëlidhur shkresës është dërguar lista e inventarit të pronave të paluajtshme të shtetit, vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 18.01.2018 si dhe kopje e shkresës së Prefekturës së Qarkut Berat me të cilën është konfirmuar vendimi.
Përsëri Bashkia Poliçan me anë të shkresës nr. 3276 prot. datë 15.11.2019 i është drejtuar Ministrisë së Brendshme, Sekretarit të Përgjithshëm, për miratimin e listës paraprake të pronës të paluajtshme të shtetit që janë brenda juridiksionit Bashkia Poliçan.
Në përgjigje të shkresës nr. 3276 prot. datë 15.11.2019, Ministria e Brendshme, ka kërkuar informacion pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, mbi procedurën e ndjekur nga ish-Agjencia e Inventarizimit dhe transferimit të Pronave Publike për kalimin në pronësi të Bashkisë Poliçan të disa pasurive ku nga Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ku me shkresën nr. 20017/1 prot. datë 06.12.2019 drejtuar Kryetarit të Bashkisë Poliçan është sqaruar se:
Me hyrjen në fuqi të ligjit 111/2018 "Për Kadastrën" ish-Agjencia e Inventarizimit dhe transferimit të Pronave Publike është shkrirë dhe praktikat në proces të ndjekura prej saj nuk kanë vijuar. Bazuar në pikën 3 të nenit 67 të ligjit 111/2018 "Për Kadastrën" kompetencat e Agjencisë së sipërcituar i janë ngarkuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si rrjedhojë për vijimin e procedurës, kërkohet nga ana juaj si më poshtë vijon (në seri dokumentesh) për të cilën për disa prej kërkesave nga Bashkia Poliçan është e pamundur nga ana financiare që të plotësohen, për faktin se për çdo informacion që kërkohet nga Bashkia Poliçan për statusin juridik për të gjithë pronës e kërkuara nga DV ASHK Berat, kërkohet pagesa e tarifës së shërbimit, që do të thotë se që nga viti 2018 e deri në vitin 2024 nuk është bërë e mundur transferimi i 2294 pasuri dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme të shtetit që janë brenda juridiksionit të **Njësisë Administrative Vërtop**, Bashkia Poliçan, në kundërshtim me pikën 3 i nenit 67 të ligjit 111/2018 "Për Kadastrën".

Neni 67
Pika 3. Pas krijimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe ***Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike i ngarkohen ASHK-së***

Me shkresën nr. 227 prot., datë 22.01.2020, Drejtori i Drejtorisë i Planifikimit të Territorit në Bashkinë Poliçan Ing. F. A., i është drejtuar Drejtorisë Juridike dhe Marrëdhënieve me Publikun për dijeni Kryetarit të Bashkisë, me një kërkesë "Për hartimin e planeve të rilevimit për pronat shtet".
Bazuar në pikën 3 të nenit 67 të ligjit 111/2018 "Për Kadastrën" kompetencat e Agjencisë të Inventarizimit dhe transferimit të Pronave Publike i janë ngarkuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, ardhur me shkresën nr. 20017/1 prot. datë 06.12.2019.
Si pasojë e ndryshimeve ligjore "Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Administrimit të Pyjeve" po përgatit materialin tekniko-ligjorë të pronave publike sipas ligjeve në fuqi (hartimi i listave të pasurive për çdo zonë kadastrale pranë NJA Vërtop), një ndër pikat ligjore për vazhdimin e procedurës për transferimin e pronave publike në pronësi të Bashkisë Poliçan është: Hartimi i hartave kadastrale (plan rilevimet për çdo pronë publike) të pasurive mbështetur në ligjit 111/2018 "Për Kadastrën" dhe VKM nr. 669, datë 9.8.2013 "Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH-2010)" i ndryshuar.
Për sa më sipër vijon në shkresë, kërkojmë nga ana juaj të merrni masat për vazhdimin e procedurës për hartimin e planeve të rilevimit, sipas e nenit 37 të Ligjit 20/20 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 669, datë 9.8.2013 "Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH-2010)" i ndryshuar, për çdo pasuri sipas listës bashkëlidhur.
-Lidhur me sa sipër nga drejtoritë përkatëse dhe nga Kryetari i Bashkia Poliçan nuk janë marrë masat për hartimin e planeve të rilevimit verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për të bërë të mundur transferimin e 2294 pasuri dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme të shtetit që janë brenda juridiksionit të **Njësisë Administrative Vërtop**, Bashkia Poliçan, në kundërshtim me pikën 3 i nenit 67 të ligjit 111/2018 "Për Kadastrën" dhe në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të Ligjit 20/20 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" datë 05.03.2020.

Neni 37
"*Përditësimi nga institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore*
1. Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Procedura e përditësimit mbështetet në:
a) verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së;
b) verifikimin e gjendjes juridike të pronës .Institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj.
3. Në përfundim të këtyre verifikimeve, institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet për shqyrtim ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, pjesë e detyrueshme e së cilës është dokumentacioni hartografik".

Konkluzion:
-Bashkia Poliçan (Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Administrimit të Pyjeve) nuk ka përgatitur dokumentacionin tekniko-ligjorë për 2294 pasuri, (pronave publike), evidentimin e pasurive për çdo zonë kadastrale pranë NJA Vërtop), si dhe hartimin e hartave kadastrale (plan rilevimet për çdo pronë) për të bërë të mundur transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, mbështetur në pikën 3 të nenit 67 ligjit 111/2018 "Për Kadastrën" dhe në zbatim të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të

informacionit gjeohapësinor në RSH", dhe në zbatim të VKM nr. 782, datë 7.10.2020 "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale".
-Bashkia Poliçan (Sektori i Financës) nuk ka parashikuar dhe përllogaritur në buxhet kostot e nevojshme për kryerjen e plan rilevimeve për 2294 pasuri pronë publike si dhe aplikimet për regjistrim dhe pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK Berat dhe Skrapar, për regjistrimin e pronave të paluajtshme në pronësi ose në përdorim në emër të Bashkisë Poliçan, me qëllimin e hapjes rrugë për zhvillim në shumë aspekte në territorin e kësaj Bashkie dhe ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, veprime këto në kundërshtim me piken 1.2/a të nenit 9 dhe me piken 5 të nenit 27, të Ligji nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

Në 2 raste kemi kalim pronësie për objekte të veçanta në Bashkinë Poliçan, konkretisht:
-Në lidhje me VKM-në nr. 451, datë 15.06.2016 "Për kalimin në pronësi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror të Bashkia Poliçan, të Qendrës Polivalente për Shërbime të për kujdesit Shoqërore, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1324, datë 1.10.2008 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të shërbimit social shtetërorë të ndërtesës së ish-Spitali, Poliçan", rezultojë se nga Kryetari i Bashkisë Poliçan me Urdhër nr. 186, datë 22.6.2016 është urdhëruar që të ngrihet grupi i punës për ndjekjen e procedurave dhe marrjen në dorëzim të ndërtesës, fondeve, pajisjeve, inventarin personelin dhe gjithë dokumentacionin përkatës sipas VKM-në nr. 451, datë 15.06.2016.
-Në lidhje me VKM-në nr. 402, datë 04.7.2018 "Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Poliçan, të pronës nr. 1069, me emërtim "Kombinati Mekanik Zona B", me vendodhje në Poliçan, rezultojë se nga Kryetari i Bashkisë Poliçan me Urdhër nr. 218, datë 08.7.2018 është urdhëruar që të ngrihet grupi i punës për zbatimin e menjëhershëm të VKM-në 402, datë 04.7.2018, në vijim të urdhrit është lënë si detyrë drejtorive përkatëse që të kryen të gjitha veprimet për regjistrimin e pronës në pronësi të bashkisë Poliçan pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Skrapar, referuar aktit të marrjes në dorëzim të objekteve dhe truallit funksional brenda territorit të pronës nr. 1969 me emërtimin "Kombinati Mekanik Zona B", me ve ndodhje në Poliçan, së bashku me plan vendosjen e objekteve dhe truallit funksional të tyre.
Nga auditimi rezulton se, për pasuritë të kaluara me VKM është aplikuar pranë ish-ZRPP-së Skrapar për regjistrim, dhe me datë 23.07.2018 është pajisur me certifikatë pronësie për sip.87,600 m^2 në llojin e pasurisë "Truall ndërtese" bazuar në VKM-në nr. 402, datë 04.7.2018 "Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Poliçan, të pronës nr. 1069, me emërtim "Kombinati Mekanik Zona B".
Me datë 31.01.2019 është pajisur me certifikatë pronësie për sip.3110 m^2 në llojin e pasurisë "Truall ndërtese" bazuar në VKM-në nr. 451, datë 15.06.2016 "Për kalimin në pronësi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror të Bashkia Poliçan, të Qendrës Polivalente për Shërbime të për kujdesit Shoqërore.
Gjithashtu nga auditimi rezulton se, në Bashkinë Poliçan, në strukturën aktuale organizative nuk ka Drejtori të Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, detyrat e të cilës i kryen Përgjegjës i Menaxhimit Financiar dhe e Aseteve dhe Sektori Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në evidence të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira.

7.1/b. Regjistrimi i pronave të paluajtshme publike në emër të Bashkisë Poliçan, në DV ASHK Berat dhe Skrapar.
Për periudhën janar-dhjetor 2023 nga 1582 pasuri që janë në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim, brenda juridiksionit të Bashkisë Poliçan, janë regjistruar dhe pajisur me certifikatë pronësie pranë DV ASHK Berat vetëm 10 pasuri, konkretisht:

Nr.	Lloji i Pronës	Z.K.	Nr. Pasurisë	Sipërfaqja e Pronës M2	Vendndodhja e Pronës	Lëshimit i dokumentit të Pronësisë nga ASHK, data	Përfitimi i pronës
1	Kullote	3584	974/2	626252	Terpan	18.07.2023	Me VKM
2	Kullote	3584	974/3	240090	Terpan	18.07.2023	-II-
3	Kullote	3584	958/1	1011091	Terpan	31.07.2023	-II-
4	Kullote	3619	1378/1	353510	Tozhar	18.07.2023	-II-
5	Kullote	3619	1378/2	1112904	Tozhar	18.07.2023	-II-
6	Kullote	3572	1888	222668	Terpan	31.07.2023	-II-
7	Kullote	3572	1889	2168039	Teman	31.07.2023	-II-
8	Kullote	3572	1890	6400	Teman	18.07.2023	-II-
9	Kullote	3572	1890/2	651603	Teman	18.07.2023	-II-
10	Kullote	3584	957/1	417082	Terpan	31.07.2023	-II-

Burimi: Bashkia Poliçan

-Lidhur me sa sipër edhe pse ka kaluar mbi 4 vjet nga dalja e ligjit, nga Bashkia Poliçan nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara përgatitja e dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të Ligjit 20/20 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" datë 05.03.2020.

Neni 37

"*Përditësimi nga institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore*

1. Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Konkluzion: Në juridiksionin e Bashkinë Poliçan **janë gjithsej 1623 pasuri** të transferuar në pronësi ose në përdorim të miratuar me VKM, nga këto të regjistruar në regjistrat kadastral (DV ASHK Berat dhe Skrapar) dhe pajisur me dokument pronësie në emër të Bashkisë Poliçan **janë 48 pasuri**, ndërsa **1575 pasuri vijojnë të pa regjistruar**, që do të thotë që për këto pasuri të pa regjistruar nga Bashkia Poliçan nuk është përgatitur dokumentacioni hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokument pronësie, që do të thotë se nuk është aplikuar për regjistrim dhe pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK Berat dhe Skrapar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të Ligjit 20/20 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në R.Sh.".

7.1/c. Krijimi i regjistrit kontabël të pronave publike që ka në administrim Bashkia Poliçan.

Bashkisë Poliçan së bashku me Njësinë Administrative Tërpan i kanë kaluar në pronësi gjithsej 1623 prona me VKM, të cilat nuk janë pajisur me dokumentin e pronësisë të regjistruar në ish-ZVRPP-në Berat dhe Skrapar sot DV ASHK, ku procedura e pajisjes me certifikatë pronësie nga ASHK shoqërohet edhe me vlerësimin e secilit objekt, vlerë e cila pas regjistrimit në ASHK regjistrohet në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e saj kontabël si dhe kontabilizohet në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, kullota, plantacione", 212 "Ndërtime e konstruksione". Pra këto objekte duke mos patur një vlerë kontabël, nuk janë pasqyruar në kontabilitet në llogaritë e tyre përkatëse të mësipërme. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar; Ligji nr. 8743/2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu III regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, Regjistri i aktiveve të njësive të sektorit publik ku citohet;

26. Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoje një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

27. Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit. 28. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet

afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë.
30. Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale te mëpasshme qe sjellin rritje te vlerës se aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar te amortizimit, kohen e shërbimeve te mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar te shpenzimeve te mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
31. Njësia publike e qeverisjes se përgjithshme duhet te mbaje një regjistër të veçante për secilën nga pronat e dhëna me qira, shoqëritë tregtare në të cilat shteti zotëron aksione dhe kontratat e koncesionit dhe enfiteozës.

Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar; Ligji nr. 8743/2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu III regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, Regjistri i aktiveve të njësive të sektorit publik.
1. Znj. K. R., me detyrë Përgjegjës Sektori i Menaxhimit Financiar dhe Aseteve.
2. Znj. G. F., me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit Financiar dhe Aseteve.

8 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
8.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.
8.2. Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.
8.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit", Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 734/6 prot., datë 13.10.2025 i ka dërguar Bashkinë Polican, "Raportin përfundimtar", për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar zbatimin e masave të mëposhtme:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Me shkresën nr. 1637/10 prot., datë 27.10.2025, Bashkia Poliçan ka dërguar pranë KLSh-së planin e masave mbi zbatimin e rekomandimeve, duke respektuar kështu edhe afatin 20 ditor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, gërma "j".

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Duke marrë në konsideratë faktin që Raporti Përfundimtar i Auditimit është përcjell nga KLSH-ja në Bashkinë Poliçan me shkresën nr. 734/6 prot., datë 13.10.2025 si dhe referuar Programit të Auditimit nr. 294/1 prot., datë 17.03.2026, në të cilën është përfshirë edhe Pika nr. 9, "Mbi verifikimin e ecurisë së ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve", edhe pse nuk ka përfunduar afati 6 mujor mbi raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, Grupi i Auditimit ka kryer verifikimet mbi statusin e tyre deri më datë 22.05.2026.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Poliçan administruar në KLSh me nr. 734/6 prot., datë 13.10.2025, janë rekomanduar gjithsej:

- **14** masa organizative;
- **1** masë disiplinore;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	**14**	14	0
Masa disiplinore	**1**		1
Totali	**15**	**14**	**1**

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e Bashkisë Poliçan:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	**14**	2	1	5	6
Totali në %	**100%**				

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Bashkisë Poliçan u konstatua se institucioni nuk ka ngritur një sistem funksional dhe të dokumentuar të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konkretisht: Mungon një kuadër i plotë rregullash dhe procedurash të shkruara; Nuk evidentohet puna e anëtarëve të GMS, përfshirë dokumentimin e mbledhjeve dhe takimeve për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së; Nuk është hartuar një strategji për trajnimin e personelit apo për menaxhimin e riskut, ndërsa regjistri i riskut është i paplotë dhe jo në përputhje me formatet standarde, për më tepër nuk ka hartuar strategjinë e riskut; Nuk ka hartuar dhe arkivuar gjurmët e auditimit dhe mungojnë procedurat për dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe masave korrigjuese; Nuk janë ndërtuar manualet apo harta e proceseve të punës, duke ndikuar negativisht në transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin institucional. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 4, pikat 19-20, neni 8, gërma *"a"*, neni 16, pikat 1-3, nenet 20-22, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*, pika 2.2.1, gërmat *"a-d"*, pika 2.3.1, pika 3.2.1, pika 5.2.3, pika 5.2.7, dhe *"Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108/2016, datë 17.11.2016, Kapitulli III. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-23 të Raport të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Menaxhimi i lartë i Bashkisë Poliçan të marrë masa konkrete për analizimin dhe adresimin e mangësive të konstatuara, si dhe të sigurojë ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të përshtatshëm të rregullave dhe procedurave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të përmirësimit të veprimtarisë institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezulton se: Bashkia Polian ka hartuar planin e veprimeve përcjell në KLSH me shkresn nr. 1637/10 prot datë 27.10.2025. Me urdhrin nr. 95 , datë 06.03.2026 është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik i cili po vijon punën me mbledhjeve dhe takimeve për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së.

Ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi. Më hollësisht situata është trajtuar në akt konstatimin nr 5 mbajtur në bashkinë polican më datë 22.05.2026.

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, auditimi i brendshëm në Bashkinë Poliçan është siguruar si shërbim auditimi nëpërmjet Kontratës së Punës me nr. 1812 prot., datë

01.08.2024, të nënshkruar ndërmjet Kryetarit të Bashkisë dhe një personi fizik në rolin e ekspertit të jashtëm. Afati i kontratës është nga nënshkrimi i saj deri më datë 02.08.2025, me vlerë mujore 17,460 lekë. Kjo marrëveshje nuk ka marrë miratimin paraprak nga Ministri i Financave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar, neni 10, gërma *"b"* dhe VKM-ja nr. 83, datë 03.02.2016, *"Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin publik"*, pika 6, gërma *"a". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-23 të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan të paraqesë pranë Ministrisë së Financave marrëveshjen për shërbimin e auditimit të brendshëm, duke marrë miratimin nga ministri i kësaj ministrie, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së auditit të brendshëm në përputhje me kuadrin rregullator ligjor përkatës.

Menjëherë

Nga verifikimi rezulton se: Me shkresen nr. 1929/2 prot., date 07.08.2025 është derguar në Ministrine e Financave njoftimi për kontraktimin e audituesit në Bashkinë Poliçan**.**

Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Poliçan së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2024, kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2024 totali i buxhetit është planifikuar në vlerën 843,214 mijë dhe realizuar në vlerën 772,156 mijë lekë në masën 91.6% ose me një mosrealizim në vlerën 71,058 mijë lekë. Mosrealizimi i të ardhurave, do të thotë se nga Bashkia Poliçan në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 39, i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 9, pika 1.3, gërma *"c"* dhe *"ç"*, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, VKB përkatëse. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-53 të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Poliçan, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezulton se: Bashkia Poliçan ka hartuar planin e veprimeve përcjell në KLSH me shkresn nr. 1637/10 prot datë 27.10.2025. Për vitin 2025 planifikimi i investimeve është bë rë mbi planifikimin e të ardhurave.

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Poliçan në datën 01.01.2024, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 26,997,426 lekë. Në planin e buxhetit vjetor 2024 nuk ka planifikuar një grafik për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura por është likuiduar vlera prej 25,041,840 lekë. Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2024), është ulur (26,997,426 lekë - 6,519,825 lekë), me 20,477,601 lekë, ose në masën prej 75.8%. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* neni 55, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, pika 153-162 dhe nenin 52 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014, *"Për shlyerjen e detyrimeve të*

prapambetura", pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-53 të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezulton se: Nga auditimi i llogarive financiare të detyrimeve të prapambetura rezultoi:Vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Poliçan me datën 31.12.2025 është rritur krahasuar me të dhënat e stokut në çelje të vitit ushtrimor me datën 01.01.225, për + 16,949,852 lekë, (23,742,631.00 lekë - 6,792,779 lekë), ose 2.4 herë krahasuar me gjendjen e detyrimeve në fillim të periudhës ushtrimore 2025.

Pa zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2024 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 126,422 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 91,353 mijë lekë ose në masën 72% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 35,069 mijë lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore rezulton se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave"* Kreu IV, pika 200. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-53 të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezulton se: Bashkia Polian ka hartuar planin e veprimeve përcjell në KLSH me shkresn nr. 1637/10 prot datë 27.10.2025. Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 183,103 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 145,600 mijë lekë ose në masën 79.5 % me ***një diferencë mos realizimi*** në vlerën - 37,503 mijë lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore duhet të kishte kryer një analizë të detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme**.**

Në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Llogaria 520 *"Disponibilitete në thesar"* paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 98,314,455 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 59,266,118 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 *"Rezultati i veprimtarisë ushtrimore"* në vlerën 59,266,118 lekë dhe llogarisë 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* në vlerën 54,173,860 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 520 *"Disponibilitete në thesar"*

është nënvlerësuar në vlerën 39,048,337 lekë. Kjo situatë ka ndodhur për arsye të mos përfshirjes së vlerës së 5% të garancive të punimeve të ngurtësuara nga institucioni, në gjendjen e llogarisë 520 *"Disponibilitete në thesar"*. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pikat 49-50. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-53 të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 *"Disponibilitete në thesar"* me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2026

Nga verifikimi rezulton se: ky rekomandim nuk është zbatuar pasi është e njëjta situatë edhe në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të Klasës 20, konkretisht aktiveve afatgjata jomateriale konstatohet se, në gjendjen e llogarive 202 *"Studime dhe kërkime"* në vlerën 22,490,215 lekë kosto historike është përfshirë vlera 2,704,895 lekë; 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* në vlerën 629,562,444 lekë kosto historike është përfshirë vlera 97,265,379 lekë dhe 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në vlerën 1,928,501,853 lekë kosto historike është përfshirë vlera 629,563,444 lekë të pa analizuara si në kontabilitet ashtu edhe në gjendjen fizike. Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-Komunave Poliçan të paanalizuara, duke ndikuar në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-53 të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë analizë të detajuar të dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogaritë e aktiveve afatgjata të Klasës 20, *(202, 212 dhe 213)*, për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më datë 31.03.2026

Nga verifikimi rezulton se: Në rregjistrin e aktive janë të rregjistruara aktivet afatgjatal(212, 213) të transferuara nga ish -komunat me të dhenat , data e hyrjes , vlera historike , amortizimi i akumuluar , amortizimi vjetor dhe vlera neto , të cilat jane të pasqyruara në bilancin e vitit 2025. Për llogarinë 202 nuk ka të dhëna per projketet e transferuara nga ish – komunat.

Zbatuar pjesërisht

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"*, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 358,000 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjellës Kanalizime Poliçan me NIPT J.....I është 102,545,000 lekë, e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat me NIPT M.....O. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Poliçan sipas Marrëveshjes *"Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sh.a Berat"* me nr. 2126 prot., datë 07.11.2022, është 358,000 lekë ose 3.58%. Ndërkohë që llogaria 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 31, gërmat *"a, b"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-53 të Raportit të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Deri më datë 31.03.2026

Nga verifikimi rezulton se: ky rekomandim nuk është zbatuar pasi është e njëjta situatë edhe në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Pa zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 231 *"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"* në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezultoi se, për vitin 2024 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likujdimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesat, për vlerën prej 93,340,692 lekë, që i përkasin llogarisë 213 *"Rrugë rrjete vepra ujore"* objekti *"Mbrojtja lumor gjatësore e tokave bujqësore nga lumi Osum, fshati Vodicë"* kontrata me nr. 1903 prot., datë 05.08.2024, me vlerë 93,605,839 lekë me TVSh, për të cilën OE *"T."* ShPK ka lëshuar Situacionin nr. 1, 2 dhe 3 në vlerën totale 51.340,692 lekë; *"Rikonstruksioni i rrugëve të fshatrave Terpan, Teman dhe fshatrat e tjerë të NjA Terpan"* kontrata me nr. 1600 prot., datë 08.07.2024, me vlerë 87,054,240 lekë me TVSh, për të cilën OE "*A." SHPK* ka lëshuar Situacionin nr. 1 dhe 2 në vlerën totale 32,000,000 lekë; objekti *"Kanali ujitës Mbrakull-Stacioni nr. 2, varreza"* kontrata me nr. 2824 prot., datë 20.11.2024, me vlerë 38,188,521 lekë me TVSh, për të cilën OE "*A." SHPK* ka lëshuar Situacionin nr. 1, në vlerën 10,000,000 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 231 *"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"* është nënvlerësuar në vlerën 93,340,692 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1, Klasa 23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-53 të Raportit të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të merren masa për kontabilizimin e vlerës 93,340,692 lekë në llogarinë 231 *"Për aktive afatgjata materiale",* që i përket likuidimeve të situacioneve pjesore të kontratave të investimeve të cilat janë në proces zbatimi punimesh.

Deri më datë 31.03.2026

Nga verifikimi rezulton se: Kontabilizimi i investimeve në proces është berë me ditarin e veprimeve të ndryshme në muajin muaji Tetor 2025 (nr. Veprimi 9), Nëntor 2025 (nr. 11) dhe Dhjetor 2024 (nr. 48).

Zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Në juridiksionin e Bashkinë Poliçan janë gjithsej 1,623 pasuri të transferuar në pronësi të miratuar me VKM-të përkatëse, nga këto të pajisur me dokument pronësie në emër të Bashkisë Poliçan janë vetëm 53 pasuri, ndërsa për 1,570 pasuri nuk është aplikuar. Bashkia Poliçan nuk ka përgatitur dokumentacioni hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokument pronësie, që do të thotë se nuk është aplikuar për pajisje me çertifikatë pronësie pranë DV ASHK, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37, të Ligjit nr. 20/2020, *"Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-53 të Raportit të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masa të aplikoj për pajisje me çertifikatë pronësie pranë DV ASHK (Berat dhe Skrapar), për pasuri që kanë prioritet në investime dhe në ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, ku pas pajisjes me çertifikatë pronësie nga ASHK-ja këto pasuri të regjistrohen në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e saj kontabël si dhe të kontabilizohen në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezulton se: Për vitin 2025 janë certifikuar 4 objekte të cilat janë pajisur me certifikat pronësie në datën 29.04.2025.

Në proces zbatimi

11. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Poliçan në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 54,173,860 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%.
- Nga gjendja e llogarisë 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* disponohet analiza përkatëse vetëm për vlerën 54,082,860 lekë, ndërsa për diferencën në vlerën 91,000 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të kësaj llogarie.
- Për 8 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Poliçan janë ngurtësuar fonde në vlerën 505,355 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Skrapar, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 505,355 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kapitulli III, pika 3.3, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-53 të Raportit të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë detajimin e dokumentacionit financiar e ligjor për vlerën 91,000 lekë të pa analizuar në kontabilitet, që i përket llogarisë 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"*, për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

11.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Deri më datë 31.03.2026

Nga verifikimi rezulton se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar. Me hollësisht është trajtuar në akt konstatimin e pasqyrave financiare të datës 22.05.2026.

Pa zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 1,431,811,075 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 406,363,804 lekë, për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 8,425,291 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" dhe amortizimin nga vlerat e nxjerra jashtë përdorimit në vlerën 27,499,991 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimit e vitit në vlerën 36,040,839 lekë, amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 279,650,488 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" dhe vlerën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit prej 343,191,238 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" është nënvlerësuar në vlerën 20,993,879 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 17. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-53 të Raportit të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/deficiti i akumuluar"* me qëllim dhënien e informacionit kontabël.

Deri më datë 31.03.2026

Nga verifikimi rezulton se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar. Me hollësisht është trajtuar në akt konstatimin e pasqyrave financiare të datës 22.05.2026.

Pa zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Poliçan administruar në KLSh me nr. 896/6 prot., datë 16.01.2025, dhe protokolluar në Bashkinë Poliçan me nr. 1550/10 prot., datë 20.01.2025, ku janë lënë për zbatim **16 masa** organizative, **1** masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të tyre në vlerën **2,652,382 lekë, 2** masa të ardhura të munguara në vlerën **401,440 lekë** dhe **11** masa disiplinore.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara 3 masa janë zbatuar plotësisht, 4 masa janë zbatuar pjesërisht, 6 masa janë në proces zbatimi dhe 3 masa nuk janë zbatuar.

b. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet të tyre është rekomanduar 1 masë në vlerën 2,652,382 lekë e cila është pranuar plotësisht, dhe është në proces zbatimi.

c. Të ardhura të munguara janë rekomanduar 2 masa në vlerën 401,440 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara 2 masa janë në proces zbatimi.

d. Masa disiplinore janë rekomanduar 11 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuara11 masa janë të zbatuara plotësisht. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 53-61 të Raportit të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe atyre në proces zbatimi si më poshtë:

Masa të lëna në auditimin e mëparshëm sipas shkresës nr. 896/6 prot., datë 16.01.2025.

A. MASA ORGANIZATIVE

5.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Poliçan të marren masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë, në përputhje me formën dhe kodifikimin e përcaktuar në Udhëzimin përkatës të Ministrit të Financave.

6.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Poliçan, të marrë masa për krijimin e bazës së të dhënave për tatimet dhe taksat që mblidhen sipas agjentëve tatimorë, të shqyrtojë informacione dhe nga institucione të tjera, të kryejë rakordime mujore të rregullta, si dhe për evidentimin e për diferencat e pa mbledhura nga ana e tyre, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj, të fillojë procedurat për penalizmin e agjentëve tatimorë.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave vendore të marri masat përkatëse duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të taksave në vlerën **80,517,731** lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me sektorin e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale", të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **778,015 lekë.**

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën lidhur me dhënien e me qira, fondi pyjor, kullosor, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, të forcojë monitorimin gjatë zbatimit të kontratave, si dhe të marrë masat e nevojshme për parandalimin e shfaqjes së rasteve të tilla.

14.1. Rekomandimi: Bashkia Poliçan të aplikoj për pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK (Berat dhe Skrapar) për pasuri që kanë prioritet në investime dhe në ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, ku pas pajisjes me certifikatë pronësie nga ASHK-

ja këto pasuri të regjistrohen në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e saj kontabël si dhe të kontabilizohen në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse.

15.1. Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marr masa për hartimin e planeve të rilevimit, verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për të bërë të mundur transferimin e 2294 pasurive që janë brenda juridiksionit të Njësisë Administrative Vërtop, Bashkia Poliçan.

16.1. Rekomandimi: Bashkia Poliçan Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit të parashikoj dhe të përllogarisë në buxhetin e ardhshëm kostot e nevojshme për përgatitjen e plan rilevimit për të gjithë pasuritë pronë publike që do të dorëzohen pranë DV ASHK, që kjo e fundit ti dërgoj për miratim në Këshillin e Ministrave.

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Poliçan të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **190,240 lekë**, me qëllim eleminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim-Taksave të njoftoje qiramarrësin shoqërinë "X." shpk i përfaqësuar nga administratori z. Ç. I., për likuidimin e shumën prej **211,200** lekë, shuma e cila ka lidhje me mos përllogaritjen e kamatë vonesës prej 0,01 % në ditë, në lidhje me kontratën e lidhur në datë 30.08.2023 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin "X." shpk.

b) Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Polian ka hartuar planin e veprimeve përcjell në KLSH me shkresn nr. 1637/10 prot datë 27.10.2025. Referuar planit të veprimit rekomandimi i sipërcituar nuk është perfshirë në planin e veprimit si dhe statusi i rekomandimeve është trajtuar në auditimin aktual.

Në proces zbatimi

C. MASA DISIPLINORE

C. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja *"c"*, Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013, *"Për nëpunësin civil"* i ndryshuar nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"* dhe VKM-në nr. 115, datë 05.3.2014, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil"*, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Poliçan, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. "Vërejtje", për punonjësin e mëposhtëm:

1. Znj. F. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare, për shkeljet:
- Për nënvlerësimin e llogarisë 520 *"Disponibilitete në thesar"* në vlerën 39,048,337 lekë;
- Për nënvlerësimin e llogarisë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* në vlerën 358,000 lekë;
- Për nënvlerësimin e llogarisë 231 *"Shpenzime në proces për rritjen e AQT"* në vlerën 93,340,692 lekë;
- Për nënvlerësimin e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* në vlerën 20,993,879 lekë;

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Polian ka hartuar planin e veprimeve përcjell në KLSH me shkresn nr. 1637/10 prot datë 27.10.2025. Referuar planit të punës masa ndaj znj. **F. H.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare nuk është pranuar.

- <u>Konkluzione dhe rekomandime</u>:
Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Poliçan për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr. 734/6 prot., datë 13.10.2025, për masat të cilat janë cilësuar në proces zbatimi rikërkohet vazhdimi i procedurave dhe për masat e pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht KLSH rikerkon zbatimin e plotë të rekomandimeve, si vijon:

B. MASA ORGANIZATIVE
<u>10.1. Rekomandimi:</u> Bashkia Poliçan të marrë masa të aplikoj për pajisje me çertifikatë pronësie pranë DV ASHK (Berat dhe Skrapar), për pasuri që kanë prioritet në investime dhe në ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, ku pas pajisjes me çertifikatë pronësie nga ASHK-ja këto pasuri të regjistrohen në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e saj kontabël si dhe të kontabilizohen në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse.
<u>11.1. Rekomandimi:</u> Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë detajimin e dokumentacionit financiar e ligjor për vlerën 91,000 lekë të pa analizuar në kontabilitet, që i përket llogarisë 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"*, për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.
<u>11.2. Rekomandimi:</u> Kryetari i Bashkisë Poliçan, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

IV REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se komponentët e MFK janë të implementuara në shkallë të pa mjaftueshme, pasi në rregulloren e brendshme, rregullat apo proceset kryesore të përfshira nuk përshkruajnë me detaje proceset e punës dhe procedurat, fillimin dhe mbarimin e procesit, informimin dhe raportimin, dhe vendimmarrjen individuale, me qëllim parandalimin e risqeve dhe përgjigjen ndaj tyre.
Strukturat e bashkisë nuk raportojnë periodikisht, në mënyrë sistematike, risqet e identifikuara dhe aktivitetet e ndërmarra në përgjigje të risqeve. Gjithashtu risqet e brendshme nuk janë të lidhur me planifikimin, proceset operacionale, burimet njerëzore, anën ligjore të mbikëqyrjes (ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive për punën e secilit punonjës) etj.
Menaxhimi i Riskut nuk funksionon mjaftueshëm. Nëpunësi Autorizues nuk ka deleguar një pjesë të përgjegjësive të tij si, emërimin e personave përgjegjës, për përditësimin e regjistrit të riskut,

nuk ka një praktikë komunikimi për risqet e identifikuara dhe aktivitetet e ndërmarra në përgjigje të risqeve.
"Mjedisi i kontrollit" nuk ka përfshirë rregulla dhe procedura të qarta, dhe si pasojë aktivitetet e kontrollit rezultojnë të pamjaftueshme për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. mungojnë kontrollet drejtuese, urdhra, udhëzime apo hartimi i planeve vjetore, objekti i të cilave janë përcaktimi i qartë i politikave, apo procedurave për përcaktimin e masave që duhet të merren për parandalimin e risqeve.
Mungesa e gjurmëve të auditimit, sipas strukturës së miratuar, ka sjellë një proces monitorimi jo efektiv, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 8 pika 8 gërma "a" neni 9, pika 4 "b", neni 11 pika 2, neni 16 pika 2, neni 21, neni 22, neni 24 pika 1, si dhe me nenin 27 pika "1", si dhe "Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.4 datë 26.01.2024. Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.4. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe .11-25 të Raportit të Auditimit*).
1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me trupën e menaxhimit të lartë të marrin masa për përcaktimin e përgjegjësive dhe të detyrimeve të çdo strukturë funksionale, funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut, planin e minimizimit të riskut. Vendosjen e një sistemi komunikimi dhe caktimin e përgjegjësive për funksionimin me efektivitet të këtyre sistemeve në të gjitha strukturat organizative të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Poliçan, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.70 datë 23.12.2024 është parashikuar Njësia/Sektori i Auditimit të Brendshëm me 1 përgjegjës dhe 2 specialist, e cila nuk është plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve dhe për rrjedhojë, nuk ka funksionuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik. Në kushtet e mosfunksionimit të strukturës së miratuar, Bashkia Poliçan ka siguruar shërbimin e auditimit të brendshëm nëpërmjet kontraktimit të një eksperti të jashtëm, bazuar në Kontratën e Punës nr. 1812 prot., datë 01.08.2024, të lidhur ndërmjet Kryetarit të Bashkisë dhe ekspertit të jashtëm për kryerjen e auditimit të brendshëm, marrëdhënie e cila i është përcjellë Ministrisë së Financave me shkresën nr. 1929/2 prot., datë 07.08.2025 sipas nenit 10 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditin e brendshëm në sektorin publik".
Për sa më sipër sektori i auditit të brendshëm nuk ka funksionuar sipas përcaktimeve ligjore ku kërkohet jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë, në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", pika 3. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe .11-25 të Raportit të Auditimit*).
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin dhe vënien në funksionim të Njësisë së Auditimit të Brendshëm sipas strukturës së miratuar dhe numrit minimal të punonjësve të kërkuar, si dhe të rishikohet marrëdhënia ekzistuese e kontraktimit të ekspertit të jashtëm, duke e vijuar, ndryshuar ose përfunduar atë në varësi të formës së organizimit të shërbimit të auditimit të brendshëm që rezulton e zbatueshme sipas kërkesave ligjore dhe nënligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Bashkisë së Poliçanit nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin e Strategjisë së menaxhimit të pronave publike vendore, dhe të Rregullores për menaxhimin e aktiveve, si një dokument që miratohet nga Këshilli i Bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore për një periudhë afatmesme, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 8, "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 8/ç; Udhëzimit nr. 30/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar; Kreun IV, të Manualit të MFK-së miratuar me urdhrin e

Ministrit të Financave nr.4, datë 26.1.2024; Udhëzimit nr. 30/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6, Kreu II, pika 17-25; (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe .25-38 të Raportit të Auditimit*).

3.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Poliçan, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të marrë masat për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Pronave Publike Vendore dhe të Rregullores për Menaxhimin e Aktiveve, si dokumente bazë për administrimin, mbrojtjen, inventarizimin, vlerësimin dhe përdorimin me efektivitet të aktiveve publike të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Këto dokumente të miratohen nga Këshilli i Bashkisë Poliçan në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e nënligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin, me qëllim forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe garantimin e një menaxhimi efektiv, ekonomik dhe transparent të aktiveve vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer rezultoi se nga 20 programe buxhetore të miratuara nga MF për përgatitjen e PBA 2025-2027 nga ana e Bashkisë Poliçan janë planifikuar për buxhetim 16 programe; dhe ka funksione/nënfunksione të cilat nuk kanë program buxhetimi, të tilla si:

-Funksioni "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike" (neni 23): nënfunksioni 13: "Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të kujdesit të shëndeti publik"; dhe nënfunksioni 14 "Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj".

-Funksioni "Në fushën e mbrojtjes së mjedisit" (neni 26) nënfunksioni **:** 1.Sigurimi, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja**.** 2**.** Sigurimi, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. 3. Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit, në papajtueshmëri me igjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" përfshihet në një program të caktuar buxhetor të përcaktuar në Udhëzimin nr.7, datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe .25-38 të Raportit të Auditimit*).

4.1.Rekomandimi: Bashkia Poliçan, nëpërmjet strukturave përgjegjëse për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), të marrë masa për rishikimin dhe plotësimin e programeve buxhetore, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me funksionet dhe nënfunksionet që i janë përcaktuar njësisë së vetëqeverisjes vendore nga legjislacioni në fuqi.

Në këtë kuadër, të vlerësohet nevoja për përfshirjen në planifikimin buxhetor të programeve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, planifikimin dhe kontrollin e territorit, si dhe mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit publik, të cilat aktualisht nuk janë pasqyruar në PBA.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Poliçan së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025 kanë diferenca me vlerën e planifikuar. Për vitin 2025 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 402,178 mijë lekë; buxheti i rishikuar ka vlerën 494,421 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 375,689 mijë lekë ose në masën 76 %. Nga analiza sipas zërave rezultoi se:

- Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 237,014 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 224,733 mijë lekë ose në masën 94.8 %, me një mosrealizim në shumën -12.3 milionë lekë.
- Zëri shpenzime operative (602) dhe Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 90,583 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 75,385 mijë lekë ose në masën 83.2 %, me një mosrealizim në shumën -15.2 milionë lekë.

- Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 (artikulli 230-231) është planifikuar në vlerën 166,823 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 75,571 mijë lekë, me një mosrealizim të këtyre fondeve prej -91,252 mijë lekë, ose realizimi në nivelin 45.3.%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Poliçan në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim ndonëse korrigjohet gjatë vitit, nuk ka koordinuar nivelin e shpenzimeve buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9, pika 1.3, gërma "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" nenet 2 dhe 3 pika 3, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe VKB përkatëse. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe .25-38 të Raportit të Auditimit*).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të merrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit buxhetor, duke bazuar parashikimin e të ardhurave vendore në analiza reale dhe mbi kapacitetin faktik të arkëtimit të taksave, tarifave dhe burimeve të tjera financiare. Strukturat përgjegjëse të Bashkisë të marrin masa për realizimin e investimeve publike të programuara, nëpërmjet planifikimit real të burimeve financiare, përgatitjes në kohë të projekteve të investimeve dhe monitorimit të vazhdueshëm të ecurisë së tyre, në funksion të përmirësimit të shërbimeve ndaj komunitetit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar", u konstatua se totali i kësaj llogarie sipas pasqyrave të llogaridhënies vjetore në fund të vitit 2025 e regjistruar në shumën 93,465,633 lekë, nuk kuadron me llogarit në kundër parti për vlerën 33,356,856 lekë, konkretisht me llogaritë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 93,465,633 lekë dhe 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" që sipas akt rakordimit të mbajtur me Degën e Thesarit është në shumën 33,356,856 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa "dh", si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, paragrafët 49-50. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të analizojë dhe rakordojë diferencën prej 21,258,325 lekë ndërmjet llogarisë 520 "Disponibilitete në Thesar", llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/Teprica e periudhës" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"; të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm, duke kryer sistemimet përkatëse kontabile, në mënyrë që pasqyrat financiare të paraqesin në mënyrë të saktë, të plotë dhe të besueshme gjendjen financiare të njësisë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe udhëzimeve në fuqi.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" u konstatua se,

a. Paraqitet një nivel i lartë i detyrimeve debitore në Bashkinë Poliçan në fund të vitit 2025 prej 162,985,266 lekë, që kanë ardhur në rritje për 27,282,622 lekë, ose 20.1 % më shumë në krahasim me vitin e mëparshëm. Rezulton se për dy Njësitë Administrative Terpan dhe Vërtop, detyrimet

debitore për mos likuidimin e taksës së tokës dhe të ndërtesës për periudhën 2011-2024 zënë 87 % të detyrimeve gjithsej për këtë kategori, shuma të mbartura nga pasqyrat financiare të ish Komunave që nga viti 2015. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar edhe gjendja e debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të regjistruar nga 12 (dymbëdhjetë) raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Prefekturës nga viti 1998 e në vijim, por të pa arkëtuara, duke filluar nga viti 1998, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkimit.
b. Në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk janë kontabilizuar vlerat e gjobave të IMTV-së për ndërtime pa leje gjatë periudhës 2024 dhe 2025 për 11 subjekte, në vlerën 15,119,656 lekë.
c. Nuk është pasqyruar në ditarët e kontabilitetit dhe në centralizator llogaria 470 "Llogari në pritje - të ardhura për t'u marrë" që shërben si kundërparti e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.
Këto veprime janë në kundërshtim Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 36 pika 2; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 12 dhe me pikën 7, të Udhëzimit të MF nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 4.2 "Të ardhurat në NJQP dhe operacionet që lidhen me to". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).
7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të analizojë gjendjen e debitorëve në shumën 162,985,266 lekë bazuar në dokumentacionin e nevojshëm kontabël e ligjor mbi origjinën e krijimit të tyre dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë duke përfshirë debitorët e IMTV për vlerën 15,119,656 lekë. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi, të cilat janë të parashkruara dhe të paarkëtueshme dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitore, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2026

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2025, konstatohet mospërputhje në paraqitjen dhe klasifikimin e tepricave të llogarive 4341 "Operacione me shtetin (Detyrime)" dhe 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)", të cilat janë kontabilizuar dhe pasqyruar në vlera të ndryshme të pa rakorduara në Pasqyrat Financiare dhe në Centralizatorin Përmbledhës të Veprimeve Vjetore. Më konkretisht:
- Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (Detyrime)" paraqitet në Pasqyrat Financiare me tepricë kreditore në vlerën 162,985,266 lekë, e klasifikuar në grupin e pasiveve afatshkurtra, ndërsa në centralizatorin përmbledhës të veprimeve vjetore evidentohet me tepricë debitore në vlerën 22,568,239 lekë;
- Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)" paraqitet në Pasqyrat Financiare me tepricë debitore në vlerën 22,568,239 lekë, e klasifikuar në grupin e aktiveve, ndërsa në centralizatorin përmbledhës të veprimeve vjetore evidentohet me tepricë kreditore në vlerën 162,985,266 lekë.

Sa më sipër, evidentohen mospërputhje në rakordimin e të dhënave kontabël dhe pasqyrimin e tyre në raportet financiare, duke ndikuar në saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit financiar të paraqitur. Veprime këto në kundërshtim me pikën 8, paragrafi 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i Llogarive të të tretëve (klasa 4)" (Aneksi 1), të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika

3.1, dhe pika 3.1; nënpika 28, 29. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që të kryejë analizimin, sistemimin dhe rakordimin e tepricave të llogarive 4341 "Operacione me shtetin (Detyrime)" dhe 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)", me qëllim eliminimin e mospërputhjeve ndërmjet të dhënave të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare, si dhe sigurimin e klasifikimit dhe paraqitjes së tyre në përputhje me kërkesat e kuadrit normativ në fuqi.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2026

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në tepricën e llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime" në fund të vitit 2025 me kosto historike 22,490,215 lekë që u përket vlerës së 4 projekt-studimeve për investime është përfshirë edhe shuma e projekteve me vlerë sipas kostos historike **2,704,895** lekë me emërtimin "Projekte të tjera të paidentifikuara", e cila i përket ish-Komunës Vërtop që prej vitit 2015. Për këto aktive nuk ka inventar, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për aktivin, si dhe nuk ka analizë të kësaj llogarie pasi mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projektimeve dhe viti i krijimit të tyre. Kjo situatë është e mbartur që nga viti 2015 nga ndarja e re administrative dhe bashkimi i ish/komunës Vërtop me bashkinë Poliçan. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, paragrafi 26 dhe 35-36. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë inventarizimin fizik të studim-projektimeve të blera, gjendje në llogarinë 202 "Studime dhe Kërkime", nëse është e mundur të bëjë shpërndarjen e vlerës së tyre, si vlerë e shtuar sipas llojit të aktivit të kapitalizuar, të përllogarisë amortizimin për to sipas normës dhe metodës së miratuar, duke i kryer veprimet sistemuese kontabël në llogaritë përkatëse dhe të reflektohen edhe në tabelën shoqëruese përkatëse.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të Klasës 20-të, "Aktivet afatgjata materiale" rezultoi se:

a. Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" në pasqyrat financiare të Bashkisë Poliçan për vitin 2025, nuk pasqyron sipërfaqet e tokave e trojeve si dhe vlerën e tyre. Është evidentuar në llogarinë 210 "Toka, troje, terrene" vetëm 1 (një) zë /objekt në vlerën 1,188,000 lekë, regjistruar në kontabilitet në vitin 2015, pa specifikuar të dhënat e sipërfaqes në m^2. Sipërfaqja totale e tokës që Bashkia ka në pronësi nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari. Kjo llogari nuk ka regjistruar në 14 raste vlerën e truallit (sipas VKM-së nr. 596, datë 18.10.2017) prej 213,983 lekë, që përfshin shpronësimet për interes publik. Gjatë vitit 2025 në llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene" nuk janë kontabilizuar vlerat e tokave dhe trojeve, pjesë e 34 pasurive të regjistruara në ASHK dhe që disponohet certifikatë pronësie, si dhe, nuk janë regjistruar në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të trojeve nën objekt për ndërtesat e godinave që Bashkia ka në pronësi si, të shkollave, kopshteve, qendrave shëndetësore, maternitetit, çerdheve, shtëpive të kulturës si dhe të zyrave të Nj.A-ve, etj., si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre.

b. Në llogarinë 211 "Pyje, kullota, plantacione" janë të evidentuara vetëm 4 zëra/ objekte në vlerën 3,110,160 lekë, ku për 2 (dy) raste janë pemë dekorative të llojeve të ndryshme dhe përmirësimi i kullotave, por që nuk janë të analizuara dhe të paraqitura vetëm në vlerë. Kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara me VKM nr. 433, dt. 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive", pika 3, shtojca me nr.1, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Poliçan. Lista që shoqëron VKM-në rezulton të jetë me 646 (gjashtëqind e dyzetë e gjashtë) zëra .

c. Në gjendjen e llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" Bashkia Poliçan ka të evidentuar një numër të objektesh të cilat janë **të pa analizuara**, të trashëguara dhe të mbartura nga ish/komunat në periudhat raportuese para vitit 2015 dhe të pa shoqëruara me kartelet përkatëse të objekteve. Nga ana e Bashkisë nuk është bërë një pasqyrim real dhe i drejtë në lidhje me vlerën e objekteve dhe gjendjen e tyre, pasi në disa raste, si aktive të llog.212 janë pasqyruar vetëm investimet e kryera gjatë viteve të fundit sipas vlerës së realizimit të tyre.

-**Mbi 13 aktive afatgjata/ pasuri që administrohen nga NJVQV**, vlerat kontabël të tyre rezultojnë të mbartura nga periudha të ndryshme kohore, përfshirë aktive të evidentuara me vit referues 1992. Kjo situatë tregon për pasaktësi në evidentimin dhe vlerësimin kontabël të gjendjes faktike të pasurive shtetërore, pasi informacioni i pasqyruar në kontabilitet nuk siguron paraqitjen e vlerës reale të këtyre aktiveve.

-Në llogarinë 212 "Ndërtesa e rikonstruksione", është përfshirë dhe artikulli **"Kontabilizimi i Zonës B",** sipas VKM nr. 402, datë 04.07.2018, Urdhrit nr.1080 datë 17.07.2018 të Ministrit të Mbrojtjes, Akt dorëzimit nr. 922, datë 23.07.2018 midis Kombinatit Mekanik Poliçan dhe Bashkisë Poliçan dhe Akt Marrjes në dorëzim nr.922, datë 23.07.2018. Vlera fillestare e ndërtesave dhe veprave të infrastrukturës është 19,3332,000 lekë, e kontabilizuar e gjitha gabimisht në llogarinë 212. Për 25 zëra të aktiveve afatgjata materiale (depo, reparte, magazina, linja uji, rrugë të brendshme, laboratorë, kaldaja, postbllok, etj.), është aplikuar norma vjetore e amortizimit 5 %, në një kohë që nga analiza e këtij artikulli del se aty përfshihen edhe rrugë e linja uji (duheshin përfshirë në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, ujësjellës"), etj.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30 e 36,si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë veprimet e nevojshme për identifikimin, analizimin dhe dokumentimin e plotë të objekteve të evidentuara në llogarit 210 "Toka, troje, terrene", 211"Ndërtesa e konstruksione" dhe llogarinë 212 "Ndërtesa e rikonstruksione" për pasuritë e trashëguara nga ish-komunat dhe të mbartura nga periudhat para vitit 2015, të kryejë analizë të detajuar të dokumentacionit financiar e ligjor të të dhënave për llogaritë e aktiveve afatgjata të Klasës 20, duke saktësuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet, bazuar dhe në rezultatet e inventarizimit fizik të këtyre pasurive.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

10.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për vlerat e regjistruara pa analiza kontabile, të rishikojë dokumentacionin financiar të trashëguar dhe të identifikojë aktivet që përfshijnë këto vlera. Gjithashtu të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2026, për kalimin e vlerave të aktiveve sipas llojit përkatës, duke i evidentuar në llogaritë e përshtatshme sipas klasifikimit të Nomenklaturës së Llogarive të Planit Kontabël Publik, si dhe të bëhen korrektimet e nevojshme në llogaritjen e amortizimit.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" janë kontabilizuar teprica të mbartura dhe u verifikuan shtesa për investime në shumën **29,400,695 lekë,** për këto tre zëra:

-"Përmirësimi i banesave ekzistuese / ndërtimi i ri për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara", data e hyrjes së aktivit 23/11/2021, me kosto historike 11,236,775 lekë dhe vlerë të mbetur 10,471,520 lekë.

-"Suvatim i fasadave të pallateve", data e hyrjes së aktivit 19/08/2011, me kosto historike 477,000 lekë dhe vlerë të mbetur 209,073 lekë.

-"Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i qendrës në fshatin Mbrakull", data e hyrjes së aktivit 1/8/2019, me kosto historike 17,686,920 lekë dhe vlerë të mbetur 12,730,646 lekë.

Aktivet e mësipërme të kontabilizuara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", nuk janë aktive në posedim të Bashkisë Poliçan. Këto zëra shpenzimesh në 3 (tre) raste janë kryer për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, prandaj ato nuk mund të kapitalizohen pasi nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie, ndaj rezulton mbivlerësim i kësaj llogarie për shumën 29,400,695 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30 e 36,si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Poliçan të marrë masa të kryejë një analizë të detajuar të dokumentacionit financiar dhe ligjor që lidhet me aktivet e regjistruara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", si dhe për sistemimin dhe trajtimin e tyre të saktë kontabël, ku për 3 (tre) rastet e audituara, me vlerë sipas kostos historike prej **29,400,695 lekë**, të kryhet verifikimi dhe sistemimi kontabël i aktiveve që nuk plotësojnë kriteret e njohjes si aktive të njësisë, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

11.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Poliçan, për projektet që do të zbatohen në kuadër të programeve sociale, të sigurojë klasifikimin korrekt të shpenzimeve në përputhje me natyrën e tyre ekonomike, duke i njohur ato si shpenzime/transferta dhe jo si aktive afatgjata, kjo në koordinim me Ministrinë përgjegjëse për financat. Ky trajtim kontabël synon të garantojë paraqitjen e drejtë dhe të besueshme të pasqyrave financiare, të shmangë mbivlerësimin e aktiveve dhe të sigurojë përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i përllogaritjes së amortizimit për vitin 2025 për grupaktivet afatgjata materiale në formatin 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" u konstatua se, për dy grupaktivesh janë **aplikuar norma të gabuara amortizimi**, duke sjellë ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe konkretisht, për elementë të caktuar të grupaktive të llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" dhe për grupaktivet e llogarisë 218 "Inventar ekonomik" në formatin 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)".

- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)" rezulton se nuk ka një ndarje të **llogarisë 218/6 "Pajisje kompjuterike"** nga aktivet e llogarisë bazë 218 "Inventar ekonomik" e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimi paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar,
- Në llogarinë **219 "Amortizimi i inventarit ekonomik"**, dhe nënllogarinë 7-shifrore 2198000 rezulton se për të njëjtin artikull të pasqyruar në llogari të ndryshme ekonomike të aktiveve, është aplikuar nivel i ndryshëm i amortizimit, duke sjellë në mënyrë të gabuar mbivlerësim të vlerës së aktivit. Kështu, zëri "Rach", në llogarinë ekonomike 218 është amortizuar me normën vjetore 25 %, kurse për të njëjtin artikull, të regjistruar në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente e vegla pune", është aplikuar në mënyrë të gabuar norma e amortizimit 20 %.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu III, pika 36,54. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që në llogaritjen e amortizimit për aktivet afatgjata të aplikojë normat e amortizimit të miratuara sipas gupaktiveve përkatëse dhe me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2026 të bëjë sistemimet e nevojshme për saktësimin e vlerave të aktiveve të llogarive 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" dhe 218 "Inventar ekonomik".

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktiveve financiare, llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", rezulton se kjo llogari është nënvlerësuar gjithsej në vlerën 458,000 lekë, e përbërë nga aksionet e Bashkisë Poliçan në "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a" prej 358 mijë lekë dhe në "KF Poliçani" shpk, prej 100 mijë lekë. Në kontabilitet dhe në pasqyrat financare të llogaridhënes vjetore, vlera e llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", në fund të vitit 2025 si dhe në fund të vitit të mëparshëm, është zero lekë.

a. Nga auditimi rezulton se në datën 04.11.2022 është krijuar "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a", e cila është regjistruar me datë 11/11/2022 me 5 aksionerë, 4 prej tyre nga organet e vetëqeverisjes vendore. Referuar Statutit të "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a", (protokolluar në AKUM me nr. 2126/1 prot, datë 07.11.2022), kjo shoqëri ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkive, aksionarë të saj. Pika nr.2 e Statutit përcakton ndarjen e kuotave të aksioneve, ku Bashkia Poliçan, zotëron 3,580 copë aksione me vlerë totale prej **358,000 lekë**, ekuivalente në masën 3.58 të kapitalit themeltar.

b. Nga të dhënat e administruara gjatë auditimit (ekstraktet e nxjerra nga faqja zyrtare e QKB-së), në lidhje me kontabilizimin e llogarisë 26 "Pjesëmarrje ne kapitalin e vet" rezulton që Bashkia zotëron 100% të aksioneve të kësaj shoqërie (shpk),themeluar me datën 19.04.2019 dhe regjistruar më datën 22.05.2019. Sipas ekstraktit të QKB kjo shoqëri ka kapital në vlerën **100,000 lekë,** nga të cilat pjesa takuese e Bashkisë Poliçan është në këtë vlerë: (100,000 *100%). Mos pasqyrimi i aktiveve financiare në kontabilitet, është veprim në kundërshtim Kreu III, pika 3.1, paragrafi nr. 31, të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).

13.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë veprimet sistemuese kontabël për pjesën e kapitaleve të Bashkisë Poliçan në "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a." prej 358 mijë lekë dhe në "KF Poliçani" shpk, prej 100 mijë lekë në llogaritë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" dhe në llog. 1011, "Shtesa të fondit bazë".

Deri me datë 31.12.2026

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i analizës së gjendjes së llogarisë **213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"** rezulton se, nuk është zbritur vlera me kosto historike 139,205,450 lekë dhe amortizim të akumuluar 110,026,475 lekë, për 38 zëra të AAGJ të kësaj llogarie, të cilat janë asete të ujësjellësit. Nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në "Shoqërinë Rajonale UK Berat Sha", në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimi e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" Kreu II, pika 14; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 8; Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).

14.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Bashkinë Poliçan dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa që të kryejnë procedurat ligjore për transferimin e aktiveve që i përkasin ujësjellësve të rrjetit shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji në "Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Berat" dhe më pas të kryhen veprimet sistemuese kontabël në llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore".

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Bashkisë Poliçan nuk është kryer kontabilizimi i të gjithë pronave publike në pronësi të saj dhe të regjistruara në ASHK.

a. Nga ana e Bashkisë Poliçan nga viti 2001 deri në fund të vitit 2025 janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës **34 (tridhjetë e katër)** zëra të pasurive të marra në pronësi, me emërtime

të ndryshme si, ndërtesa, sheshe, truall, rrugë, tokë arë, etj, por që nuk janë përfshirë në regjistrin e aseteve dhe si të tilla, të pa kontabilizuara në inventarin e AAGJ të kësaj bashkie. Kontabilizimi me vlerë simbolike 1 (një) lek i aseteve të pavlerësuara ose të amortizuara plotësisht, por që janë ende në përdorim, shënon mbajtjen e asetit në inventar për qëllime kontrolli, pa ndikuar në pasqyrat financiare.

b. Nga auditimi ka rezultuar se, për **463 objekte inventari** të pasurive të paluajtshme me kosto historike në vlerën 2,562,363,457 lekë, që i përkasin llogarisë 210 "Toka troje terrene", llogarisë 211 "Pyje plantacione", 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", Bashkia Poliçan nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu VI "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme", pika 1 e 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).

15.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Bashkinë Poliçan të hartojnë dhe zbatojnë një plan veprimi për inventarizimin, regjistrimin dhe kontabilizimin e plotë të të gjitha pasurive në administrim dhe pronësi të saj, duke siguruar përfshirjen në regjistrin e aseteve dhe në kontabilitet të të gjitha pasurive të regjistruara në ASHK, por të pa kontabilizuara; kryerjen e vlerësimit sipas kërkesave të standardeve kontabël dhe dokumentimin e plotë të tyre në kartelat e aseteve.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se llogaria 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje" në pasqyrat financiare paraqitet në fund të vitit ushtrimor 2025 në vlerën kontabël 21,258,325 lekë, e rakorduar me Degën e Thesarit Skrapar. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se është e analizuar sipas objekteve për 19 raste ngurtësimesh të fondeve, të cilat i përkasin ngurtësimeve të garancinë te punimeve për periudha të ndryshme kohore. Nuk është bërë çlirimi i garancive për 11 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Poliçan në vlerën 5,010,138 lekë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Skrapar. Nga analiza e gjendjes së llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" konstatohet se vlera 91,000 lekë është e pa analizuar, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësimin e vlerave të kësaj llogarie. Bashkia Poliçan nga ana e saj nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për ç'bllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve për interes publik, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kap. II, pika 6 dhe 10. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit në Bashkinë Poliçan, të marrin masa duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshme që për punimet e përfunduara dhe të marra në dorëzim konformë përcaktimeve në kontratës, të bëjnë njoftimet e subjekteve për tërheqjen e garancive të punimeve. Në rast mos plotësimi të kushteve ose refuzimit nga subjektet në zbatim të dispozitave ligjore të bashkëpunohet me Degën e Thesarit Skrapar për kalimin e këtyre fondeve në favor të autoritetit kontraktor, si e ardhur për mospërmbushje të rregullt të kushteve të kontratës.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive financiare të detyrimeve të prapambetura rezultoi:

-Vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Poliçan me datën 31.12.2025 është rritur krahasuar me të dhënat e stokut në çelje të vitit ushtrimor me datën 01.01.225, për 16,949,852 lekë, ose 2.4 herë krahasuar me gjendjen e detyrimeve të vitit të mëparshëm.
-Nga shqyrtimi i planit të buxhetit vjetor për vitin 2025, rezultoi se Bashkia nuk ka parashikuar një grafik të detajuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, në vlerën 4,106,389 lekë për dy raste. Gjithashtu, u konstatua se Bashkia ka në inventar detyrime të prapambetura për transferime ndaj subjekteve në shumën 2,220,000 lekë, të cilat përbëjnë detyrime të mbartura nga viti 2024 dhe i përkasin Konfederatës së Sindikatave për qira të papaguar për periudhën Janar 2016 – 31.12.2019.
-Referuar dokumentit "Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për tre vitet në vazhdim" (Aneksi nr. 2 i tabelave të vetëvlerësimit financiar për 4-mujorin e tretë të vitit 2024), dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 542, datë 26.02.2025, rezulton se detyrimet e mbetura deri më datë 31.12.2024 janë planifikuar për t'u shlyer deri më datën 31.12.2025. Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 52 "Kryerja e shpenzimeve", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" pikat 20-22 dhe 27-29; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar pika 186; Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", pikat 106-110, "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" dhe pikat 81, 148 dhe 148/1 "Raportimi i detyrimeve te prapambetura në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).

17.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa, që detyrimet e prapambetura të evidentohen me saktësi dhe të ndiqet në mënyrë të vazhdueshme likuidimi i tyre dhe përllogaritja e saktë e peshës specifike, të stokut të detyrimeve mbi shpenzimet faktike, për të menaxhuar në çdo moment situatën financiare të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, të hartoj një grafik për shlyerjen e detyrimeve të papaguara të vitit paraardhës, me qellim sigurimin në vijimësi të financimit të shërbimeve për qytetarët.

Përgjatë vitit buxhetor 2026 dhe në vijim

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizmin dhe mbajtjen e evidencës kontabile, rezulton se Regjistri i Aktiveve i vitit 2025 nuk ka përfshirë të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale e jomateriale dhe afatshkurtra, si dhe nuk është i plotësuar sipas kërkesave të Paragrafit nr.30 dhe nr.109, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Nga auditimi rezultoi se, në regjistrin e aktiveve mungojnë të dhënat mbi vlerën fillestare të aktivit në momentin e blerjes, data e hyrjes në përdorim,(në shumë raste vendosur shënimi para vitit 2015), vlera e shpenzimeve kapitale që i shtojnë vlerën aktivit dhe koha e kryerjes së këtij shpenzimi, datën e skadencës, vendndodhjen, personin përgjegjës, etj.
-Nga analiza e gjendjes së llogarisë 218 "Inventar ekonomik", konstatohet se në disa zëra, regjistri i aktiveve nuk paraqitet i detajuar me zëra analitike (nënllogari), nuk paraqitet në mënyrë të standardizuar, pasi evidentohen përsëritje të emërtimeve të aktiveve si "Laboratori i Biologjisë", "Laboratori i Fizikës" dhe "Laboratori i Kimisë", pa sqarim nëse bëhet fjalë për aktive të ndryshme apo për ndarje të të njëjtit aktiv. Gjithashtu, emërtimet e aktiveve nuk janë të unifikuara dhe

mungon përshkrimi i detajuar i përbërjes së tyre. Kjo situatë krijon paqartësi në identifikimin unik të aktiveve dhe procesin e inventarizimit të aktiveve afatgjata.
-Nuk janë përfshirë në regjistrin e aktiveve, aktivet të cilat gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe Manualit MFK; Udhëzimit nr. 30/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 "Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike", Kreu III, paragrafi 28, si dhe Udhëzimit të MF nr. 30/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 4/c.
- Nuk është hartuar nga Nëpunësi Zbatues dhe miratuar nga Nëpunësi Autorizues Regjistri i unifikuar i aktiveve të Bashkisë**.** Nga DFB, është hartuar vetëm regjistri elektronik i cili përfshin informacionin vetëm mbi vlerën e aktiveve dhe amortizimin, mosveprime këto në kundërshtim me kreun II, Paragrafi III, pika 26, 27, 28 dhe Paragrafi IV pika 81, të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar; (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).
18.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i Bashkisë Poliçan të marrin masat e nevojshme për përmirësimin e procesit të administrimit dhe evidentimit të aktiveve, duke plotësuar dhe përditësuar Regjistrin e Aktiveve të institucionit në mënyrë të plotë dhe analitike i cili duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vend ndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike. Regjistri të Aktiveve të përfshijë aktivet afatgjata dhe afatshkurtra materiale dhe monetare, si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për inventarizimin e pasurisë për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve si dhe përdorimin në mënyrën e duhur e më eficiencë të tyre, janë konstatuar disa mangësi në lidhje me rregullshmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm. Konkretisht,
-Përbërja e komisioneve të inventarizimit është në dy vitet pa ndryshuar, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kapitulli IV, paragrafi 84, "Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision".
-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk disponon të dhëna mbi kryerjen e inventarizimit fizik për Aktivet Afatgjata Materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214 përkatësisht për artikujt kontabël Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtesa e konstruksione, rrugë, rrjete e vepra ujore, instalime teknike, makineri e pajisje, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. Nuk janë përfshirë në procesin e inventarizimit për vitin 2025, aktivet e kontabilizuara si inventarë të "Zonës B", që përfshin Kombinatin Mekanik Poliçan, transferuar sipas VKM nr. 515, datë 19.09.2023 dhe marrë në dorëzim sipas akt dorëzimit nr. 922, datë 23.07.2018. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe .43-105 të Raportit të Auditimit*).
19.1. Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata (AAGJ), i cili të verifikojë dhe të rakordojë rezultatet e inventarizimit me llogaritë kontabël përkatëse për gjithë zërat e aktiveve dhe në përfundim të punës komisioni të hartojë raportin për drejtuesin e institucionit mbi rezultatet e inventarizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 8 procedura me vlerë të fondit limit 565,780 mijë lekë në

7 raste, kriteret e vendosura nuk janë argumentuar: Në procedurën me objekt: "Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare "70 Vjetori i Pavarësisë" dhe sistemimi i jashtëm i gjithë kompleksit Arsimor" me vlerë kontrate 98,417,338 lekë pa TVSh; "Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i rrugëve të varrezat e vjetra, lagjia Kalluç dhe pallati katër katësh Poliçan" me vlerë kontrate 16,540,770 lekë pa TVSh; "Mbrojtje lumore gjatësore e tokave bujqësore nga lumi Osum, fshati Vodice, Poliçan " me vlerë kontrate 56,760,640 lekë pa TVSh; "Rikonstruksioni i rrugëve te fshatrave Terpan, Teman dhe fshatrave te tjera ne Njësinë Administrative Terpan" me vlerë kontrate 77,638,308 lekë pa TVSh; "Mbrojtje lumore gjatësore e tokave bujqësore nga lumi Osum, fshati Vodice, Poliçan" me vlerë kontrate 78,004,950 lekë pa TVSh; "Asfaltimi i Rrugës Tërpan- Teman, Njësia Administrative Tërpan" me vlerë kontrate 64,644,800 lekë pa TVSh si dhe "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i ambienteve të Qendrës Polivalente të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për të moshuarit Poliçan" me vlerë kontrate 137,219,747 lekë pa TVSh. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nenin 26 pikat 1, nenin 6; nenin 36, nenin 39, pika 5; nenin 45 pika 1; nenin 67, nenin 78, pika 4, nenin 82, paragrafi i fundit dhe nenin 85 "Lidhja e kontratës", pika 2, etj. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 106-133 të Raportit të Auditimit*).

20.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan, të marrë të gjithë masat që nga njësitë e prokurimit të argumentohet vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim dhe se këto kritere të jenë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, u konstatua se në 2 procedura me fond limit 209,155 mijë lekë, nga 8 procedura të audituara, janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, konkretisht janë deklaruar mjete të cilat nuk janë të regjistruar në regjistrat publikë
në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:

- Në procedurën e prokurimit me objekt "Asfaltimi i Rrugës Tërpan- Teman, Njësia Administrative Tërpan", viti 2025 me fond limit 67,554,493 lekë, ku fitues është shpallur BOE "A." Sh.p.k dhe "E. K." Sh.p.k me vlerë kontrate 64,644,800 lekë.
- Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i ambienteve të Qëndrës Polivalente të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për të Moshuarit Poliçan", viti 2025 me fond limit 141,601,288 lekë, ku fitues është shpallur OE "M." Sh.p.k me vlerë kontrate 137,219,747 lekë.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 92, pika 3, nenit 99 pika 1 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 52-107 të Raportit të Auditimit*).

21.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Poliçan, të analizojë arsyet e parregullsive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit/zhvillimit u konstatuan 3 praktika në të cilat dokumentacioni dhe verifikimet e kryera nuk kanë garantuar përputhshmërinë e plotë të zhvillimit me kërkesat e legjislacionit dhe dokumentacionit të planifikimit të territorit. Konkretisht, në dokumentacionin e lejeve nuk janë pasqyruar saktë të gjitha kushtet dhe parametrat e zhvillimit të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe në lejen e zhvillimit, përfshirë planvendosjen, treguesit e zhvillimit dhe distancat; dokumentacioni i pronësisë i ngarkuar në sistemin e-leje, përfshirë kartelat e pasurive dhe hartat treguese, nuk rezulton i përditësuar; si dhe, përpara miratimit të lejeve, nuk janë administruar të gjitha mendimet dhe konformitetet e nevojshme nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe autoritetet e tjera publike përgjegjëse. Këto konstatime u evidentuan në lejet e

ndërtimit me objekt: “ Magazinë në funksion të kantinës së verës 2 kat ”, miratuar me vendimin nr. 06, datë 12.03.2025, me zhvillues znj. L. N.; “Ambiente argëtuese sportive ”, miratuar me vendimin nr. 12, datë 13.06.2024, me zhvillues z. S. T.; dhe “ Fabrikë vaji 1 kat ”, miratuar me vendimin nr. 08, datë 23.06.2023, me zhvillues z. A. M. Sa më sipër, rezulton se procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të këtyre lejeve nuk janë administruar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, veçanërisht nenet 15 dhe 21; Ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, si dhe Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 143-156 të Raportit të Auditimit*).
22.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Emergjencave Civile, Bujqësisë dhe Veterinarisë të Bashkisë Poliçan, të marrë masa që lejet e ndërtimit/zhvillimit të miratohen vetëm pas verifikimit të plotë të dokumentacionit teknik, pronësor dhe ligjor, përputhshmërisë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe lejen e zhvillimit, si dhe marrjes së mendimeve dhe konformiteteve të nevojshme nga autoritetet përkatëse, duke siguruar që i gjithë dokumentacioni të jetë i plotë, i saktë dhe i ngarkuar në sistemin e-Leje.

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua **1 praktikë** me objekt “Magazinë në funksion të kantinës së verës 2 kat ”, për të cilën është marrë vendimi Nr. 06, datë 12/03/2025, me zhvillues znj. L. N., në të cilën evidentohet mangësi lidhur me përcaktimin e të gjitha kushteve në dokumentin e lejes së ndërtimit. Përkatësisht, në kushtet e përcaktuara të dokumentit të lejes së ndërtimit të miratuar, nuk është përfshirë leja për prishjen e objekteve që gjënden në pasurinë në të cilën do të zhvillohet ndërtimi i ri. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, neni 11, pika ç. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 143-156 të Raportit të Auditimit*).
23.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Emergjencave Civile, Bujqësisë dhe Veterinarisë të Bashkisë Poliçan, të marrë masa që në përcaktimin e kushteve të lejes së ndërtimit, të përfshihet edhe leja për prishjen e objekteve, në rastet kur në pasuritë që marrin pjesë në zhvillim ka objekte ekzistuese.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i certifikatave të përdorimit u konstatua **1 praktikë** tek të cilat dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e-leje nuk paraqitet i plotë dhe ka mangësi lidhur me projektin “as build”, me realizimin e objektit në përputhje me lejen e ndërtimit, si dhe me kryerjen e të gjitha verifikimeve të nevojshme përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, nëse ka pasur ndryshime/ devijime në zbatimin e punimeve të ndërtimit. Përkatësisht në certifikatat e përdorimit me objekt "Magazinë për përdorim blegtoral, (stallë vicash)", për të cilën është marrë vendimi Nr. 04, datë 30/09/2024, me zhvillues z. X. M.. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me Ligjin 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 42, neni 51; me VKM 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27, neni 27/1, neni 27/2; me Ligjin Nr.9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, Neni 10. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 143-156 të Raportit të Auditimit*).
24.1.Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Emergjencave Civile, Bujqësisë dhe Veterinarisë të Bashkisë Poliçan, të marrë masa për të shqyrtuar dhe verifikuar në sistemin e-Leje të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet të paraqitet, vërtetësinë/saktësinë e tij, si dhe të kryej verifikimet në terren për realizimit e punimeve të zbatimit dhe të japë konformitetin për aktkontrollet e detyrueshme (përfundimi i karabinasë, i fasadave dhe sistemimit të jashtëm), që të jenë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.
24.2.Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Emergjencave Civile, Bujqësisë dhe Veterinarisë të Bashkisë Poliçan, në bashkëpunim me strukturat e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të vijojnë me kontrolle të vazhdueshme në terren përgjatë gjithë periudhës së zbatimit deri në përfundim të punimeve të ndërtimit dhe pas saj, në mënyrë që objekti i realizuar të mos

pësoj ndryshime/ devijime nga leja e ndërtimit e miratuar dhe të ruaj të njëjtin destinacionin sipas së cilit është miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Poliçan, rezulton se për 9 raste, është mbajtur procesverbal prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, ndajë kundërvajtësve për të cilat vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm nuk është ekzekutuar nga IMTV. Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", pika a dhe nenin 51 të ligjit 107/2017 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 156-160 të Raportit të Auditimit*).

25.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, të vijojë me ekzekutimin e prishjes së objektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Administrimit të Pyjeve nuk ka përgatitur dokumentacioni tekniko-ligjorë për 2294 pasuri, (prona) publike, për evidentimin e pasurive për çdo zonë kadastrale pranë NJA Vërtop, si dhe përgatitja e hartave kadastrale (plan rilevimet për çdo pronë) për të bërë të mundur transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, mbështetur në pikën 3 të nenit 67 ligjit 111/2018 "Për Kadastrën", të nenit 22 të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjë hapësinor në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të kryehut III pika 12 i VKM-së nr. 782, datë 7.10.2020 "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 161-167 të Raport Auditimit*).

26.1 Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marr masa për hartimin e planeve të rilevimit, verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për të bërë të mundur transferimin e 2294 pasurive që janë brenda juridiksionit të Njësisë Administrative Vërtop, Bashkia Poliçan.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve dërguar Bashkisë Poliçan me shkresën nr. 734/6 prot., datë 13.10.2025, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se Bashkia Poliçan ka respektuar afatin 20 ditor për përgatitjen e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve, dërguar me shkresën nr. 1637/10 prot., datë 27.10.2025 si dhe nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak, në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 50-Auditimi i jashtëm.

Nga auditimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve, rezulton si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 14 masa. Nga masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 2 masë, në proces zbatimi 5 masa, zbatuar pjesërisht 1 masë dhe pa zbatuar 6 masa nga të cilat rekomandimi 6.1, 8.1 11.1, 11.2 dhe 12.1 nuk rikërkohen pasi janë pjesë e gjetjeve të sipërcituara.

d. Është rekomanduar 1 masë disiplinore, e cila nuk është zbatuar. (*Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 8, faqe 167-176, të Raportit të Auditimit*).

27.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

a. Për 1 masa organizative

10.1. Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marrë masa të aplikoj për pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK (Berat dhe Skrapar), për pasuri që kanë prioritet në investime dhe në ushtrimin

e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, ku pas pajisjes me certifikatë pronësie nga ASHK-ja këto pasuri të regjistrohen në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e saj kontabël si dhe të kontabilizohen në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPERBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15, germat b) dhe c) "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së" dhe mbështetur në nenet 98-102 të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, nga ana e **Titullarit të Bashkisë Poliçan**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësish, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **422,241 lekë pa TVSh** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i kontratës "Rikonstruksioni i shkollës "70 vjetori" dhe sistemim i jashtëm i të gjithë kompleksit arsimor", me Kontraktorit BOE "Z." & "B." shpk, përfaqësuar nga "B." shpk, nënshkruar nr. 3931 rep. dt. 05.08.2023 dhe me vlerë 118,100,805 lekë me TVSh, u konstatuan mangësi në lidhje me raportimin e volumeve të prishjeve të suvatimeve, transportit, kasetave të shkarkimit dhe bojës akrilike cilësia e parë për fasadën. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Poliçan në vlerën **117,320 lekë pa Tvsh.** Mbikëqyrësi i punimeve Ing. N. M., ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3. (*Më hollësisht në pikën 4.4, faqe 133-142 të Raportit të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës së Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim, Kontroll dhe Zhvillimit Territorit të Bashkisë Poliçan, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **117,320 pa TVSh**, nga kontraktori "Z." & "B." shpk, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

Brenda datës 31.12.2026

2. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i kontratës "Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Muhamed Kondi", me Kontraktorit BOE "Z." & "B." shpk, përfaqësuar nga "Z." shpk, nënshkruar nr. 2600 prot., datë 25.10.2022 dhe me vlerë 53,923,930 lekë me TVSh, u konstatuan mangësi në lidhje me raportimin e volumeve të mureve të tullës, ku në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Poliçan në vlerën **118,500 lekë pa Tvsh.** Mbikëqyrësi i punimeve Ing. N. M., ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3. (*Më hollësisht në pikën 4.4, faqe 133-142 të Raportit të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës së Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim, Kontroll dhe Zhvillimit Territorit të Bashkisë Poliçan, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e

vlerës **118,500 pa TVSh**, nga kontraktori BOE "Z." & "B." shpk, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

Brenda datës 31.12.2026

3. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i kontratës "Mbrojtje lumore gjatësore e tokave bujqësore nga lumi Osum, fshati Vodice", me Kontraktorit BOE "T." & "M." shpk, përfaqësuar nga "T." shpk, nënshkruar nr. 1903 prot., datë 15.08.2024 dhe me vlerë 93,605,940 lekë me TVSh, u konstatuan mangësi në lidhje me raportimin e volumeve të gërmimeve, mbushjeve me gurë për skolierën, mbushje me gur pas mureve, gabina me rrjetë teli të zinguar. Në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Poliçan në vlerën **64,821 lekë pa Tvsh.** Mbikëqyrësi i punimeve Ing. E. M., ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3. (*Më hollësisht në pikën 4.4, faqe 133-142 të Raportit të Auditimit*).
3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës së Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim, Kontroll dhe Zhvillimit Territorit të Bashkisë Poliçan, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **64,821 pa TVSh**, nga kontraktori BOE "T." & "M." shpk, e cila përbën dëm ekonomik për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

Brenda datës 31.12.2026

4. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i kontratës "Mbrojtje lumore gjatësore nga lumi Osum, fshati Mbrakull", me OE "A. K." SHPK., nënshkruar nr. 2117 prot., datë 07.08.2023 dhe me vlerë 68,112,768 lekë me TVSh, u konstatuan mangësi në lidhje me raportimin e volumeve të shtresës së zhavorrit të lumi t=20 cm, rruga, ku në total rezultuan diferenca në lidhje me volumet e punës të situacionuara dhe atyre të kryera në fakt, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Poliçan në vlerën **121,600 lekë pa Tvsh.** Mbikëqyrësi i punimeve Ing. N. M., ka vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve nuk ka zbatuar me rigorozitet përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7/1 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3. (*Më hollësisht në pikën 4.4, faqe 133-142 të Raportit të Auditimit*).
4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës së Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim, Kontroll dhe Zhvillimit Territorit të Bashkisë Poliçan, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **121,600 pa TVSh**, nga kontraktori OE "A. K." SHPK., për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

Brenda datës 31.12.2026

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se detyrimi që subjektet fizikë/juridikë dhe familjarë kanë ndaj Bashkisë Poliçan në çelje të vitit 2025 është në vlerën 61,732,955 lekë, ndërsa gjendja e debitorëve në vlerë progresive në fund të vitit 2025 për 3429 subjektet është në vlerën 67,173,477 lekë, nga të cilat për taksën e tokës bujqësore në vlerën 43,302,133 lekë dhe për taksat dhe tarifat familjare

14,469,587 lekë dhe biznese fizik/juridik në vlerën 9,401,757 lekë. Në total borxhi tatimorë është në vlerën 67,173,477 lekë, vlerë e cila është evidentuar në kontabilitet.
Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 69, datë 23.12.2024 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre për vitin 2025", me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar dhe me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93. (*Më hollësisht trajtuar në pikën .2.6 faqe 38-43 të Raportit të Auditimit*).
1.1. Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e duhura administrative e ligjore me qëllim arritjen e rezultateve reale në uljen e borxhit prej 67,173,477 **lekë** nga subjektet dhe familjet debitorë, si dhe të dokumentojë ndjekjen dhe rezultatet e këtyre masave, nëpërmjet ndjekjes në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve të krijuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se për vitin 2024-2025 janë legalizuar 10 objekte me vlerë totale 307,765 lekë nga të cilat është arkëtuar vlera 60,015 lekë si dhe ka ngelur pa u arkëtuar vlera 241,750 lekë vlerë e cila përbën të ardhur të munguara për Bashkinë Poliçan në kundërshtim me VKB-në nr. 69, datë 23.12.2024 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre për vitin 2025", me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën .2.6 faqe 38-43 të Raportit të Auditimit*).
2.1. Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Poliçan të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **241,750 lekë**, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua **1 praktikë** me objekt "Magazinë në funksion të kantinës së verës 2 kat ", për të cilën është marrë vendimi Nr. 06, datë 12/03/2025, me zhvillues znj. L. N., në të cilën taksa e ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur referuar destinacionit të propozuar, sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi. Diferenca e taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **970,203 lekë** përbën të ardhura të munguara për bashkinë. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar ; me nenit 27 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore", i ndryshuar; me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 23.12.2022, "Për nivelin e taksave-tarifave vendore dhe administrimin e tyre për vitin 2023", pika 6, tabela a, kategoria III; me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.58, datë 22.12.2023, "Për nivelin e taksave-tarifave vendore dhe administrimin e tyre për vitin 2024", pika 6, tabela a, kategoria III; me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.69, datë 23.12.2024, "Për nivelin e taksave-tarifave vendore dhe administrimin e tyre për vitin 2025", pika 6, tabela a, kategoria III. (*Më hollësisht në pikën 5, faqe 143-156 të Raportit të Auditimit*).
3.1. Rekomandim: Bashkia Poliçan të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **970,203 lekë**, që përbën të ardhura të munguara ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e përllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Brenda datës 31.12.2026

4. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi për vendimet e gjobave të nxjerra nga IMTV për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2025, rezultoi se janë nxjerr në total 11 vendime për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë, në vlerë totale 15,119,656 lekë, nga e cila është arkëtuar vlera 55,900 lekë, janë në proces gjyqësor 4 masa në vlerën 8,179,635 lekë, si dhe nuk është ndërmarr asnjë masë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv, për 6 subjekte në vlerën 6,884,121 lekë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 30 pika 4 germa (b) të ligjit nr. 10279, datë

20.05.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*". (*Më hollësisht në pikën 6, faqe 156-160 të Raportit të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Kryeinspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të marra masa në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, për përgatitjen e kërkesë padive për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv dhe kryerjen e të gjitha procedurave ligjore dhe administrative për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës **6,884,121 lekë.**

Brenda datës 31.12.2026

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT